

Zyra e Auditimit të Qeverisë e Shteteve të Bashkuara të Amerikës

**GAO**

Audituesi i Përgjithshëm i Shteteve të  
Bashkuara

Dhjetor 2011

# Standardet e Auditimit të Qeverisë

Rishikim i vitit 2011



Seria: botime KLSH – 03/2015/38

**GAO**

Audituesi i Përgjithshëm i Shteteve të  
Bashkuara

Dhjetor 2011

## Standardet e Auditimit të Qeverisë

Rishikim i vitit 2011

Rishikimi i vitit 2011 i Standardeve të Auditimit të Qeverisë që zëvendëson rishikimin e 2007. Rishikimi i vitit 2011 duhet të përdoret nga audituesit e qeverisë derisa të bëhen rishikime të tjera të mëtejshme. Një version elektronik i këtij dokumenti mund të gjendet në Web faqe-n e Yellow Book Gao në <http://www.gao.gov/yellowbook>.

Rishikimi i vitit 2011 i Standardeve të Auditimit të Qeverisë është efektiv për auditimet financiare dhe vlerësimin e angazhimeve për periudha që përfundojnë në ose pas 15 dhjetor 2012, dhe për auditimet e performancës që fillojnë më ose pas 15 dhjetorit 2011. Zbatimi i hershëm nuk është i lejuar.

Rishikuar më 20 janar 2012, për të korrigjuar një gabim daktilografik në paragrafin 7.19



Titulli :

*“Standardet e Auditimit të Qeverisë”*

Redaktoi: Dr. Bujar Leskaj

Art Design: Benard Haka

Përkthimi në gjuhën shqipe u realizua nga Auditueset e KLSH-së:

Albana Gjinopulli, Dëshira Huqi, Xhuljeta Çelaj

Seria : botime KLSH - 03/2015/38

ISBN : **978-9928-159-30-4**

Shtypur në Shtypshkronjën” ONUFRI”

Tiranë 2015

---

## Përmbajtja

---

Shënime për botimin	Parathënie	i
“Standardet e Auditimit të Qeverisë” në gjuhën shqipe	Mesash drejtuar Institucionit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, nga Z. Gene Dodaro, Kontrollor i Përgjithshëm i SHBA-s	ii
	Curriculum Vitae – z. Gene L. Dodaro	iii
	Leja për botimin “Standardet e Auditimit të Qeverisë” në gjuhën shqipe	iv

---

Hyrje		1
-------	--	---

---

Kapitulli 1		4
Auditimi i Qeverisë	Hyrje	4
	Qëllimi dhe Zbatueshmëria e GAGAS	5
	Parimet Etike	7
Bazat dhe Parimet e Etikës		

---

Kapitulli 2		13
Standardet për Përdorimin dhe Aplikimin e GAGAS	Hyrje	13
	Llojet e Auditimit GAGAS dhe Angazhimet Për Certifikim	13
	Përdorimi i Terminologjive në përcaktimin e Kërkesave të GAGAS	20
	Marrëdhënia ndërmjet GAGAS dhe Standardeve të tjera Profesionale	22
	Përcaktimi i Përputhshmërisë me GAGAS në Raportet e Audituesve	24

---

Kapitulli 3		27
Standardet e Përgjithshme	Hyrje	27
	Pavarësia	27
	Gjykimi Profesional	53
	Kompetenca	56
	Kontroli dhe Sigurimi i Cilësisë	61

---

## Përmbajtja

---

<b>Kapitulli 4</b>		<b>72</b>
<b>Standardet e</b>	Hyrje	<b>72</b>
<b>Auditimit</b>	Kërkesat shtesë të GAGAS për kryerjen e	
<b>Financiar</b>	Auditimeve Financiare	<b>72</b>
	Kërkesat shtesë të GAGAS për Raportimin e	
	Auditimeve Financiare	<b>78</b>
	Kërkesat shtesë të GAGAS për Raportimin e	
	Auditimeve Financiare	<b>90</b>

---

<b>Kapitulli 5</b>		<b>92</b>
<b>Standardet e</b>	Hyrje	<b>92</b>
<b>Angazhimeve për</b>	Angazhimet e Ekzaminimit	<b>93</b>
<b>Certifikim</b>	Kërkesat shtesë për Punën në Terren për	
	Angazhimeve e Ekzaminimit	<b>93</b>
	Kërkesa shtesë për Raportimin sipas GAGAS për	
	Angazhimet e ekzaminimit	<b>100</b>
	Angazhimet e rishikimi	<b>112</b>
	Kërkesat shtesë të GAGAS në Punën në Terren të	
	Angazhimeve të Rishikimit	<b>112</b>
	Kërkesat shtesë të GAGAS për Raportimin e	
	Angazhimeve të Rishikimit	<b>113</b>
	Vlerësimet shtesë të GAGAS për	
	Angazhimet e Rishikimit	<b>115</b>
	Angazhimet për Procedurat e Pranuara	<b>117</b>
	Kërkesat shtesë të GAGAS për Punën në Terren për Angazhimet	
	për Procedurat e Pranuara	<b>117</b>
	Kërkesat shtesë për Raportimin sipas GAGAS për Angazhimet	
	për Procedurat e Pranuara	<b>118</b>
	Vlerësimet shtesë të GAGAS për Angazhimet për Procedurat e	
	Pranuara	<b>121</b>

---

<b>Kapitulli 6</b>		<b>124</b>
<b>Standardet e Punës</b>	Hyrje	<b>124</b>
<b>në Terren</b>	Siguria e Arsytueshme	<b>124</b>
<b>për Auditimet</b>	Rëndësia e Auditimit të Performancës	<b>125</b>
<b>e Performancës</b>	Risku i Auditimit	<b>125</b>
	Planifikimi	<b>126</b>
	Mbikëqyrja	<b>149</b>
	Përftimi i evidencës së mjaftueshme dhe të përshtatshme	<b>150</b>
	Dokumentimi i Auditimit	<b>159</b>

---

## Përmbajtja

---

<b>Kapitulli 7</b>		<b>163</b>
Standardet e	Hyrje	163
Raportimit për	Raportimi	163
Auditimin e	Përmbajtja e Raportimit	165
Performancës	Shpërndarja e Raporteve	176

---

<b>Shtojca</b>		
Shtojca I:	Udhëzimet Shtesë	178
	Hyrje	178
	Përmbledhje e Udhëzimeve Shtesë	178
	Informacion Shoqërues Kapitulli 1	186
	Informacion Shoqërues Kapitulli 2	190
	Informacion Shoqërues Kapitulli 3	195
	Informacion Shoqërues Kapitulli 6	206
	Informacion Shoqërues Kapitulli 7	211
Shtojca II:	Struktura Konceptuale e GAGAS për Pavarësinë	215
	Këshilli Konsultativ i Audituesit të Përgjithshëm në	
Shtojca III:	Standardet e Auditimit të Qeverisë	216
	Pjesëtarët e Këshillit Konsultativ	216
	Ekipi i Projektit GAO	220

---

<b>Indeks</b>		<b>221</b>
---------------	--	------------

---

## Përmbajtja

---

---

### Shkurtesat

AICPA	American Institute of Certified Public Accountants
AU-C	AICPA Codification of Statements on Auditing Standards for Auditing
AT	AICPA Codification of Statements on Standards for Attestation Engagements
CPA	certified public accountants
CPE	continuing professional education
COSO	Committee of Sponsoring Organizations of the Treadway Commission
ERISA	Employee Retirement Income Security Act
FISCAM	Federal Information System Controls Audit Manual
GAAP	generally accepted accounting principles
GAGAS	generally accepted government auditing standards
GAO	Government Accountability Office
IT	information technology
IAASB	International Auditing and Assurance Standards Board
IIA	Institute of Internal Auditors
ISAE	International Standards on Assurance Engagements
ISA	International Standards on Auditing
MD&A	management's discussion and analysis
OMB	Office of Management and Budget
PCAOB	Public Company Accounting Oversight Board
SAS	Statements on Auditing Standards
SSAE	Statements on Standards for Attestation Engagements

Kjo është një punë e qeverisë së SHBA dhe nuk është subjekt i mbrojtjes së drejtave të autorit në Shtetet e Bashkuara. Produkti i botuar mund të riprodhohet dhe të shpërndahet në tërësinë e saj pa lejen e mëtejshme nga GAO. Megjithatë, për shkak se kjo punë mund të përmbajë imazhe subjekt i mbrojtjes së drejtave të autorit ose materiale të tjera, mund të jetë e nevojshme marrja e autorizimit nga mbajtësi i autorit në qoftë se ju dëshironi të riprodhoni këtë material të ndarë.

## ***Parathënie***

Kontrolli i Lartë i Shtetit po sjell në gjuhën shqipe për audituesit shqiptarë dhe për të gjithë të interesuarit e fushës së auditimit dhe të ekonomisë, një botim krejt të veçantë, “*Standardet e Auditimit të Zyrës së Auditimit të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës (GAO)*”.

Ky botim është rishikim i Standardeve të Auditimit të Qeverisë realizuar në vitin 2011 dhe paraqet një version të modernizuar të standardeve në SH.B.A, duke marrë në konsideratë ndryshimet e fundit në standardet e tjera të auditimit, përfshirë edhe standardet ndërkombëtare (ky rishikim zëvendëson rishikimin e 2007). Ai përmban ndryshime të mëdha nga rishikimi i 2007 që përforcojnë parimet e transparencës dhe llogaridhënies dhe që sigurojnë kuadrin për auditime me cilësi të lartë dhe me vlerë të shtuar.

Dëshiroj të falenderoj fillimisht z. Gene Dodaro, Kontrollor i Përgjithshëm i GAO’s, pa dashamirësinë dhe mirëkuptimin e të cilit ky botim nuk do të ishte realizuar. Zoti Dodaro miratoi pa hezitim kërkesën e KLSH-së për përkthimin e këtyre standardeve në gjuhën shqipe.

Ky botim tejet profesional është i 38-ti në kolonën e botimeve të KLSH-së dhe po botohet në prag të festimit të përvjetorit të 90-të të krijimit të institucionit. Kontrollori i Përgjithshëm i GAO’s, zoti Gene Dodaro na ka dërguar një mesazh përsëritës për këtë ngjarje të rëndësishme për KLSH-në, nëpërmjet të cilit na inkurajon për punën që kemi bërë dhe thekson ndër të tjera rëndësinë e punës së SAI-ve “*...Me rastin e 90 vjetorit, dëshiroj të uroj të gjithë punonjësit e KLSH-së mbi rolin e rëndësishëm që institucioni juaj luan në promovimin e përgjegjshmërisë dhe qeverisjes së mirë. Institucionet Supreme të Auditimit janë vitalë për të ndihmuar përmirësimin e performancës së qeverisë, për të arritur më shumë transparencë, si dhe për të siguruar përgjegjshmëri në kontekstin e sfidave aktuale. Sipas mendimit tim, e ardhmja e auditimit të qeverisë është më e rëndësishme se kurrë. SAI’t si KLSH, dhe institucioni që unë drejtoj, kanë mundësi të jashtëzakonshme për të ndihmuar qeveritë e tyre të planifikojnë të ardhmen dhe të adresojnë çështje me interes për të gjithë*”.

Botimi i Standardeve të Auditimit të Qeverisë (*Government Auditing Standards-GAS*) vjen pas disa botimeve të tjera me karakter profesional që janë realizuar gjatë tre viteve të fundit nga KLSH, me qëllim për ta përqsasur veprimtarinë e këtij institucioni me thelbin e misionit të tij që konsiston në nxitjen e përgjegjshmërisë së qeverisë dhe të menaxherëve publikë për përdorimin e parasë publike me efektivitet, eficiencë dhe ekonomicitet, çka kërkon njohjen, respektimin dhe zbatimin me rigorozitet të Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI. Midis këtyre botimeve mund të veçojmë :

«*Standardet e Auditimit INTOSAI*» (ISSAI 10, 20, 30, 40, 100, 200, 300, 400);

“*Udhëzuesi i Auditimit të Performancës, ISSAI 3000-3100*”. Auditimi i performancës në KLSH po konsolidohet më tej duke rritur numrin e auditimeve të realizuara dhe zgjerimin e tematikës së përzgjedhur. Janë aktualisht në botim dy libra të tjerë që trajtojnë çështje të auditimit të Performancës, “*Indikatorët e Performancës*” dhe “*Manuali i Departamentit të Auditimit të Performancës*”.

Në bashkëpunim me Zyrën e Audituesit të Përgjithshëm të Kosovës, Kontrolli i Lartë i Shtetit ka botuar «*Udhëzuesin e Auditimit Financiar (Shënimet Praktike)*” dhe në bashkëpunim dhe me ndihmën e SIGMA’s edhe «*Udhëzuesin për Auditimin e Përputhshmërisë*».

Panorama e botimit të standardeve të auditimit plotësohet edhe më mirë me publikimin e “*Standardeve të Auditimit te Borxhit Publik (5410-5440)*”, i cili synon përmirësimin dhe rritjen e profesionalizmit të punës së audituesve të KLSH-së, duke siguruar një kuadër të përgjithshëm dhe të përdorshëm, për qasje sa më të përshtatshme në auditimin e borxhit publik si edhe me “*Standardet INTOSAI për mjedisin (ISSAI 5110-5140)*”, duke vlerësuar në këtë mënyrë rëndësinë që ka marrë zhvillimi i qëndrueshëm gjatë 20 viteve të fundit.

*Revista Shkencore “Auditimi Publik”*, është arritja jonë kryesore dhe këtë muaj doli nga shtypshkronja numri 9 i saj. Revista po vazhdon me sukses sfidën e nisur si një *revistë shkencore* periodike 4-mujore në fushën e Auditimit Publik që botohet në gjuhën shqipe dhe në gjuhën angleze. Në këtë Revistë kanë kontribuar me shkrimet e tyre personalitete të fushës së Ekonomisë nga vendi si dhe personalitete të njohura dhe me eksperiencë nga Institucionet Supreme të Auditimit (SAI) nga vende të rajonit e më gjerë, duke i dhënë “Auditimit Publik” një vlerë të shtuar dhe një përmasë rajonale, duke kontribuar në mbledhjen e mendimit të përparuar të profesionistëve të fushës së auditimit.

Zbatimi i standardeve të INTOSAI-t në praktikë është shumë i rëndësishëm për ne dhe prioritet i punës së audituesve të KLSH-së. Rëndësia e tyre theksohet edhe në letrën e z. Dodaro, “...*INTOSAI ka luajtur një rol të rëndësishëm në zhvillimin e standardeve ndërkombëtare të auditimit, dhe gjithashtu për të ndihmuar kombet nga e gjithë bota për të zbatuar këto standarde. Këto standarde kanë për qëllim të mbrojnë pavarësinë e SAI-ve dhe të ndihmojnë për realizimin e auditimeve efektive. Ata gjithashtu mbështesin anëtarët e INTOSAI-it në zhvillimin e qasjeve të tyre profesionale, bazuar në mandatet specifike të çdo vendi...*”

Në këtë botim, Standardet e Auditimit të Qeverisë(GAS) trajtohen shtatë kapituj: Auditimi i qeverisjes, bazat dhe parimet e Etikës; standardet per përdorimin dhe aplikimin e GAGAS (*General Accepted Government Auditing Standards*); standardet e përgjithshme; standardet e auditimit financiar; standardet e angazhimeve për certifikim; standardet e punës në terren dhe standardet e raportimit për auditimin e performancës.

Leximi dhe përvetësimi i këtyre standardeve nga audituesit e KLSH-së do t'i ndihmojë ata në punën e tyre të përditshme për të realizuar auditime cilësore dhe do t'i orientojë për të kapërcyer sfidat e vështira me të cilat përballen audituesit.

Të gjitha botimet tona, i shërbejnë së pari forcimit të kapaciteteve profesionale të institucionit, përmirësimit të metodologjisë së auditimit, rritjes së transparencës dhe llogaridhënies, duke bërë një hap të rëndësishëm sasior dhe cilësor në kontributin ndaj mirëqeverisjes, përmes bërjes publike dhe transparente të të gjithë veprimtarisë së tij dhe thellimit të zbatimit të standardeve profesionale. Rëndësia e transparencës së punës së Institucioneve Supreme të Auditimit (SAI) transmetohet edhe nëpërmjet mesazhit të z. Dodaro "... GAO është gjithashtu e angazhuar për të bashkëpunuar ngushtësisht me publikun në punën e saj. Ne besojmë fuqimisht tek transparenca, me idenë që qytetarët duhet të jenë të informuar sa më shumë të jetë e mundur në lidhje me performancën e qeverisë dhe rezultatet e saj. Sipas mendimit tim, të kuptuarit nga publiku dhe mbështetja e tij do të jenë jetike në adresimin e politikave të vështira që shtrihen përpara nesh ...".



Zoti Dodaro dhe Kryetari i KLSH-së  
Z.Bujar Leskaj në INCOSAI XXI,  
Pekin 2013

Rritjes së kapaciteteve profesionale të audituesve të KLSH-së do t'i shërbejë edhe përkthimi në gjuhën shqipe i Standardeve të GAO's, të cilat do të jenë referencë për kryerjen e auditimeve me cilësi të lartë, me kompetencë, integritet, objektivitet dhe pavarësi.



*Zoti David M. Walker ,Kontrollor  
i Përgjithshëm i SHBA-së*

Në qershor të vitit 2004, vizitoi KLSH-në një personalitet i rëndësishëm, Kontrollori i Përgjithshëm i SHBA-së David M.Walker. Pas kësaj periudhe pati një shkëputje disa vjeçare në bashkëpunimin mes GAO's dhe KLSH-së. Në këto tre vitet e fundit kjo marrëdhënie po forcohet dhe po merr trajta konkrete bashkëpunimi dhe ne jemi të vendosur ta thellojmë edhe më shumë në të ardhmen, mbi bazën e motos së Institucioneve Supreme të Auditimit "*Experientia mutua omnibus prodest*", me dëshirën më të mirë për të mësuar dhe shkëmbyer eksperiencë si anëtarë të INTOSAI-t, veçanërisht me Zyrën e Auditimit të Qeverisë së SHBA-së, si institucioni më modern i këtij komuniteti.

Kodi Etik i KLSH-së është rishikuar dhe në funksion të krijimit të një institucioni model që udhëheq nëpërmjet shembullit, KLSH ka përfshirë në këtë dokument dhe Kodin e Sjelljes dhe Udhëzuesit e Etikës të Gjykatës Europiane të Audituesve, duke shtuar sfidën e përshtatjes së Standardeve të GAO's që janë standardet e një Institucioni model, siç është GAO, për të gjitha Institucionet Supreme të Auditimit, anëtare të INTOSAI-t.

Synimi dhe detyra jonë do të jenë që në të ardhmen t'i përshtatim dhe t'i aplikojmë si standarde të punës së audituesve të KLSH-së. Do të jetë pa dyshim një sfidë e vështirë, por jo e pamundur, që kërkon kohën e saj...

**Bujar LESKAJ**

# Mesazh drejtuar Institucionit të Kontrollit të Lartë të Shtetit të Shqipërisë 26 Maj, 2015<sup>1</sup>



Mirëdita.

Unë quhem Gene Dodaro, Kontrollor i Përgjithshëm i Shteteve të Bashkuara dhe Drejtues i Zyrës së Auditimit të Qeverisë i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, GAO siç na referohen shpesh. Ka qenë kënaqësi e madhe për mua të takohesha me Kryetarin e KLSH-së, Dr. Bujar Leskajn në Washington D.C në janar të këtij viti. Dëshiroj të falenderoj Dr. Leskajn për ftesën që më bëri për të dhënë këtë mesazh me rastin e 90-vjetorit të institucionit të Kontrollit të Lartë të Shtetit të Shqipërisë. Dëshiroj gjithashtu të falenderoj Presidentin e Gjykatës Europiane të Audituesve, z. Vitor Caldeira, Presidentin e Gjykatës Austriake të Auditimit dhe Sekretar i Përgjithshëm i INTOSAI't, Dr. Josef Moser, Euro-Parlamentarin, z. Igor Soltes, si dhe të ftuarit e nderuar në këtë sallë.

Me rastin e 90 vjetorit, dëshiroj të uroj të gjithë punonjësit e KLSH-së mbi rolin e rëndësishëm që institucioni juaj luan në promovimin e përgjegjshmërisë dhe qeverisjes së mirë. Institucionet Supreme të Auditimit janë vitalë për të ndihmuar përmirësimin e performancës së qeverisë, për të arritur më shumë transparencë, si dhe për të siguruar përgjegjshmëri në kontekstin e sfidave aktuale. Sipas mendimit tim, e ardhmja e auditimit të qeverisë është më e rëndësishme se kurrë. SAI't si KLSH, dhe institucioni që unë drejtoj, kanë mundësi të jashtëzakonshme për të ndihmuar qeveritë e tyre të planifikojnë për të ardhmen dhe të ngrenë tematika me interes për të gjithë. Takimi që zhvillova me Dr. Leskajn në fillim të këtij viti, ishte një mënyrë shumë e mirë për të mësuar më shumë për institucionet tona të auditimit dhe sesi ne i përmbushim përgjegjësitë tona.

---

<sup>1</sup> Mesazhi përshëndetës i Zotit Gene Dodaro, Kontrollor i Përgjithshëm i Shteteve të Bashkuara dhe Drejtues i Zyrës së Auditimit të Qeverisë i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, me rastin e 90-vjetorit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Pres me padurim për mundësi të tjera ndërmjet dy institucioneve tona, me qëllim që të shkëmbejmë eksperiencat mbi çështje me interes të përbashkët.

Në GAO, ne nuk marrim vendime mbi politikat. Kjo i përket Kongresit. Por, ne besojmë se me informacione të sakta dhe të kuptueshme, zyrtarët publikë janë në gjendje të vendosin duke qenë të informuar. Informacionet e paanshme dhe të besueshme nga SAI't janë një nevojë urgjente, duke marrë parasysh sfidat e shumta fiskale, shoqërore, ekonomike dhe të sigurisë që ndeshin vendet anembanë botës.

GAO është gjithashtu e vendosur për ta mbajtur publikun të informuar mbi punën e saj.

Ne besojmë plotësisht në transparencën, në idenë se qytetarët duhet të jenë të informuar sa më shumë të jetë e mundur mbi rezultatet e performancës së qeverisë.

Sipas mendimit tim, të kuptuarit nga publiku dhe mbështetja e tij, do të jenë thelbësore në adresimin e politikave të vështira që shtrihen përpara nesh.



z.Bujar Leskaj, Kryetar i KLSH-së me z.Gene Dodaro, Kontrollor i Përgjithshëm i GAO-s  
SHBA, Washington D.C më 3 shkurt 2015

Ndërsa SAI't mund të luajnë një rol kyç në dhënien e informacioneve dhe analizave të rëndësishme zyrtarëve publikë, të cilat janë të nevojshme për të adresuar sfidat specifike të vendit, është gjithashtu e vërtetë se shumë nga problemet që ne hasim sot, janë të një natyre globale dhe kërkojnë bashkëpunim dhe zgjidhje ndërkombëtare.

Unë e di se Kontrolli i Lartë i Shtetit i Shqipërisë e ka të qartë rëndësinë e INTOSAI't për anëtarët e tij dhe auditimin e qeverive në të ardhmen. Si një organizatë autonome, e pavarur dhe jo politike, INTOSAI ofron vendin ku institucionet supreme të kontrollit mund të punojnë së bashku dhe të ndajnë eksperiencat e tyre. Këto eksperiencë variojnë nga strategjitë e bazuara në mësimet e mësuara tek praktikat më të mira si rrjedhojë e historive të suksesit. INTOSAI ofron gjithashtu një vend ku këto institucione mund të shkëmbejnë sfidat e tyre.

INTOSAI ka patur një rol shumë të rëndësishëm në zhvillimin e standardeve ndërkombëtare të auditimit, si dhe në ndihmën ndaj kombeve kudo në botë, për të zbatuar këto standarde. Këto standarde kanë për qëllim të ruajnë pavarësinë dhe auditimin efektiv. Ato gjithashtu mbështesin anëtarët e INTOSAI't në zhvillimin e qasjeve të tyre profesionale mbi bazat e mandateve specifike të vendeve të tyre.

Rëndësia e nxitjes së zbatimit dhe aplikimit të këtyre standardeve reflektohet në interesimin e shfaqur nga komuniteti i donatorëve. Ashtu si dhe shumë nga ju e dinë, Bashkëpunimi i Donatorëve i INTOSAI't filloi në 2009 kur 15 organizata donatore dhe vende të ndryshme nënshkruan Memorandumin e Mirëkuptimit për të rritur dhe forcuar mbështetjen ndaj SAI-ve, duke forcuar kështu qeverisjen, përgjegjshmërinë dhe kontributin në rritjen ekonomike dhe uljen e varfërisë. Që prej asaj kohe, 7 donatorë të tjerë e kanë nënshkruar këtë memorandum.

Grupi i Punës i INTOSAI't për Modernizimin Financiar dhe Reformat Rregullatore është një tjetër shembull i shkëlqyer i SAI've të vendeve të ndryshme që mbliidhen së bashku për të përballuar sfidat globale. Në 2012 Bordi Drejtues i INTOSAI't miratoi krijimin e këtij Grupi Pune. Duke bërë këtë, Bordi njohu se komuniteti i INTOSAI't duhet të vazhdojë të zhvillojë ekspertizën e tij dhe aftësitë, në mënyrë që të përballojë sfidat, ndërthurur kjo dhe me mbikëqyrjen e sistemit aktual financiar global.

Si drejtues i GAO's, unë kam mësuar shumë nga eksperiencat tona të shumta në INTOSAI, duke përfshirë angazhimin tonë në zhvillimin e dy planeve të parë strategjike të INTOSAI't. Si Kryetar i Task Forcës mbi Planifikimin Strategjik që e ka filluesën në planin e tretë strategjik të INTOSAI't, unë dhe kolegët e mi të kësaj task force, jemi të vendosur të zgjerojmë bashkëpunimin kudo në INTOSAI. Ne mirëpresim të gjithë kontributin për të identifikuar sesi Plani Strategjik 2017-2022 mund të vihet në shërbimin më të mirë ndaj nevojave të anëtarëve dhe sesi ai mund të ndriçojë më së miri rrugën tonë dhe zhvillimin në të ardhmen. Është e rëndësishme për ne të reflektojmë mbi diversitetin e INTOSAI't si një prej pikave të tij më të forta dhe si një burim vlerë për secilin SAI. Plani i ri është menduar të mbështetet mbi funksionet bazë të INTOSAI't dhe arritjet në përcaktimin e standardeve, zhvillimin e kapaciteteve të SAI've dhe shkëmbimin e njohurive. Task Forca është e angazhuar që të sigurojë se struktura drejtuese e INTOSAI't reflekton prioritetet ambicioze dhe të rëndësishme të organizatës sonë.

Institucionet Supreme të auditimit sot janë pozicionuar si kurrë më parë, për të bërë diferencën, jo vetëm për vendet e tyre, por në tërësi për të gjithë botën. Në nivel kombëtar, SAI't ndihmojnë në përmirësimin e shërbimeve publike dhe ndihmojnë liderët e tyre të planifikojnë për të ardhmen. Në nivel ndërkombëtar, puna me homologët e tyre, i ndihmon të zgjidhin problemet e hasura.

Dëshiroj të shpreh urimet e mia më të mira për institucionin e Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe Dr. Leskajn, si dhe për vazhdimësinë e përpjekjeve tuaja në shërbim të mirë qeverisjes.

Pres me padurim të punoj me ju për të zhvilluar më tej bashkëpunimin ndërmjet dy institucioneve tona. E vlerësoj së tepërmi që jam pjesë e ceremonisë suaj.

Ditën e mirë.

## Curriculum Vitae – z. Gene L. Dodaro



Gene L. Dodaro u zgjodh si Kontrollori i Përgjithshëm i Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe drejtues i Zyrës së Auditimit të Qeverisë së SHBA (GAO) në 22 Dhjetor, 2010 pas miratimit nga Senati i Shteteve të Bashkuara. Ai u emërua nga Presidenti Obama në Shtator 2010 nga një listë kandidatësh të përzgjedhur nga një komision bipartizan, dydhomësh i Kongresit. Ka shërbyer si zv. Kontrollor i Përgjithshëm prej Marsit 2008.

Z. Dodaro ka dëshmuar shumë herë përpara Kongresit mbi çështje të rëndësishme kombëtare, duke përfshirë këndvështrimin mbi mandatin fiskal kombëtar afat-gjatë, përpjekjet për të ulur dhe eliminuar mbivendosjen dhe duplikimin ndërmjet qeverisë federale dhe GAO's të "Listës me Risk të Lartë" që fokusohet në sfidat specifike – nga ulja e pagesave jo të duhura nën Kujdesin shëndetësor dhe Ndhimën mjekësore, në përmirësimin e praktikave të biznesit të Pentagonit. Në vijim, z. Dodaro ka bërë të gjitha përpjekjet për të përmbushur përgjegjësitë e reja audituese të GAO's nën Reformën Dodd-Frank të Wall Street dhe Ligjit mbi Mbrojtjen e Konsumatorit.

Si Kontrollor i Përgjithshëm, z. Dodaro ndihmon në mbikëqyrjen e zhvillimit dhe publikimit të qindrave raporteve dhe dëshmiave çdo vit për komisione të ndryshme dhe Anëtarë të veçantë të Kongresit. Këto, dhe produkte të tjera të GAO's kanë çuar në hetime dhe ligje, miliarda dollarë kursime të taksapaguesve dhe përmirësime të shumta të programeve dhe shërbimeve qeveritare.

Gjatë karrierës së tij në GAO, që daton 40 vjet më parë, z. Dodaro ka mbajtur një numër postesh kyçe ekzekutive. Për 9 vite, z. Dodaro ka qenë Zyrtar Drejtues Operacional, pozicioni numër dy i drejtimit në agjenci, ka asistuar Kontrollorin e Përgjithshëm në dhënien e drejtimit dhe vizionit për forcën e ndryshme të punës dhe multidisiplinore në GAO. Z. Dodaro drejtoi zhvillimin e planeve strategjike të GAO's për t'i shërbyer Kongresit dhe përmirësimit të qeverisjes në Shekullin e 21.

Ka luajtur gjithashtu një rol të rëndësishëm për t'i drejtuar përpjekjet e agjencisë drejt evidentimit të çështjeve aktuale dhe emergjente, të cilat meritojnë vëmendjen e politikëbërësve. Deri në vitin 1999, z. Dodaro drejtoi Departamentin e Kontabilitetit dhe Menaxhimit të Informacionit në GAO, njësi më e madhe e agjencisë, që ishte i specializuar në menaxhimin financiar, teknologjinë e informacionit dhe çështjet e buxhetit.

Në këtë pozicion pune, ai drejtoi auditimin e parë të kryer ndonjëherë mbi deklaratat financiare për të gjitha departamentet dhe agjencitë federale. Z. Dodaro gjithashtu dha ndihmesën e tij në krijimin e strategjisë së GAO's për forcimin e sigurisë kompjuterike për të gjithë qeverinë dhe drejtoi përditësimin e standardeve për kontrollet e brendshme në qeverinë federale.

Z. Dodaro ka punuar ngushtë me Kongresin dhe disa administrata për iniciativat më të mëdha të reformës menaxheriale, duke përfshirë Ligjin për Reformën Menaxheriale në Qeveri të vitit 1994, i cili erdhi në vijimësi të Ligjit për zyrtarët Financiarë; Ligji mbi uljen e procedurave të punës i rishikuar në vitin 1995; dhe Ligjin Clinger-Cohen të vitit 1996, i cili kërkon nga agjencitë të zbatojnë praktika menaxheriale moderne për menaxhimin e teknologjisë së informacionit; rishikimet në Ligjin mbi Auditimin e vetëm të vitit 1996, i cili përcakton kërkesat për auditimet e asistencave federale ndaj shtetit dhe qeverive. Z. Dodaro ka drejtuar gjithashtu procedurat e vlerësimeve menaxheriale të Departamentit të Drejtësisë, Shërbimit të të Ardhurave të Brendshme, Zyrës së Menaxhimit dhe Buxhetit, dhe Zyrës së Menaxhimit të Personelit, si dhe ka eksperiencë në të punuarin me zyrtarë të qeverive lokale dhe shtetërore.

Z. Dodaro, është diplomuar për kontabilitet nga Kolegji Lycoming në Williamsport, Pensilvani, është anëtar i Akademisë Kombëtare të Administratës Publike dhe anëtar i Shoqatës së Kontabilistëve të Qeverisë. Z. Dodaro ka marrë vlerësime nga organizata të ndryshme jashtë vendit gjatë karrierës së tij, duke përfshirë Çmimin për Shërbimin Publik Kombëtar nga Shoqata Amerikane për Administratën Publike dhe Akademia Kombëtare e Administratës Publike, Çmimin Roger W. Jones nga Universiteti Amerikan dhe Çmimin Braden nga Departamenti i Kontabilitetit në Universitetin Case Western Reserve.

Z. Dodaro është i martuar me Joan McCabe dhe kanë tre fëmijë të rritur.



February 5, 2015

Dr. Bujar Leskaj  
Chairman  
Republic of Albania  
State Audit Institution  
Biv. "Deshmoret e Kombit", no. 3  
Tirana, Albania

Dear Dr. Leskaj:

It was a pleasure to meet with you on your visit to Washington, D.C. earlier this week.

In our meeting you asked for permission to translate the Government Auditing Standards—"the Yellow Book." This document is a public document and you are more than welcome to translate it into Albanian.

I am very pleased to prepare a video message of congratulations to the State Audit Institution on the occasion of its 90<sup>th</sup> anniversary. Mr. Bill Keller, Director of International Relations will be in touch with your staff to get additional information that we will need in order to prepare and transmit the presentation.

We are grateful for your interest in the International Auditors Fellowship Program. Unfortunately, the start of the 2015 Fellows Program is fast approaching and it would be very difficult for a new applicant to be processed in time to begin the first day of class in March 2015. Our staff would be happy to assist your office with the application process for the 2016 program as needed.

Finally, we will consider your request to host a delegation from the Albanian State Audit Institution. Mr. Keller has already been in touch with your staff to discuss potential topics for knowledge sharing and to make arrangements for this visit later this year.

I look forward to opportunities to work with you and your office to share our experiences and work on topics of mutual interest.

Sincerely yours,

Gene L. Dodaro  
Comptroller General  
of the United States

---

# Përmbajtja

---

Hyrje	1
-------	---

---

<b>Kapitulli 1</b>	<b>4</b>
<b>Auditimi i</b>	<b>4</b>
<b>Qeverisë</b>	<b>5</b>
<b>Bazat dhe</b>	<b>7</b>
<b>Parimet e</b>	
<b>Etikës</b>	

---

<b>Kapitulli 2</b>	<b>13</b>
<b>Standardet për</b>	<b>13</b>
<b>Përdorimin dhe</b>	
<b>Aplikimin e</b>	
<b>GAGAS</b>	
Hyrje	13
Llojet e Auditimit GAGAS dhe Angazhimet Për Certifikim	13
Përdorimi i Terminologjive në përcaktimin e Kërkesave të GAGAS	20
Marrëdhënia ndërmjet GAGAS dhe Standardeve të tjera Profesionale	22
Përcaktimi i Përputhshmërisë me GAGAS në Raportet e Audituesve	24

---

<b>Kapitulli 3</b>	<b>27</b>
<b>Standardet e</b>	<b>27</b>
<b>Përgjithshme</b>	<b>27</b>
Hyrje	27
Pavarësia	27
Gjykimi Profesional	53
Kompetenca	56
Kontrolli dhe Sigurimi i Cilësisë	61

---

<b>Kapitulli 4</b>	<b>72</b>
<b>Standardet e</b>	<b>72</b>
<b>Auditimit</b>	
<b>Financiar</b>	
Hyrje	72
Kërkesat shtesë të GAGAS për kryerjen e Auditimeve Financiare	72
Kërkesat shtesë të GAGAS për Raportimin e Auditimeve Financiare	78
Kërkesat shtesë të GAGAS për Raportimin e Auditimeve Financiare	90

<b>Kapitulli 5</b>		<b>92</b>
<b>Standardet e</b>	Hyrje	<b>92</b>
<b>Angazhimeve për</b>	Angazhimet e Ekzaminimit	<b>93</b>
<b>Certifikim</b>	Kërkesat shtesë për Punën në Terren për Angazhimeve e Ekzaminimit	<b>93</b>
	Kërkesa shtesë për Raportimin sipas GAGAS për Angazhimet e ekzaminimit	<b>100</b>
	Angazhimet e rishikimi	<b>112</b>
	Kërkesat shtesë të GAGAS në Punën në Terren të Angazhimeve të Rishikimit	<b>112</b>
	Kërkesat shtesë të GAGAS për Raportimin e Angazhimeve të Rishikimit	<b>113</b>
	Vlerësimet shtesë të GAGAS për Angazhimet e Rishikimit	<b>115</b>
	Angazhimet për Procedurat e Pranuara	<b>117</b>
	Kërkesat shtesë të GAGAS për Punën në Terren për Angazhimet për Procedurat e Pranuara	<b>117</b>
	Kërkesat shtesë për Raportimin sipas GAGAS për Angazhimet për Procedurat e Pranuara	<b>118</b>
	Vlerësimet shtesë të GAGAS për Angazhimet për Procedurat e Pranuara	<b>121</b>
<b>Kapitulli 6</b>		<b>124</b>
<b>Standardet e Punës</b>	Hyrje	<b>124</b>
<b>në Terren</b>	Siguria e Arsytueshme	<b>124</b>
<b>për Auditimet</b>	Rëndësia e Auditimit të Performancës	<b>125</b>
<b>e Performancës</b>	Risku i Auditimit	<b>125</b>
	Planifikimi	<b>126</b>
	Mbikëqyrja	<b>149</b>
	Përftimi i evidencës së mjaftueshme dhe të përshtatshme	<b>150</b>
	Dokumentimi i Auditimit	<b>159</b>

---

## Përmbajtja

---

<b>Kapitulli 7</b>		<b>163</b>
Standardet e	Hyrje	163
Raportimit për	Raportimi	163
Auditimin e	Përmbajtja e Raportimit	165
Performancës	Shpërndarja e Raporteve	176

---

<b>Shtojca</b>		
Shtojca I:	Udhëzimet Shtesë	178
	Hyrje	178
	Përmbledhje e Udhëzimeve Shtesë	178
	Informacion Shoqërues Kapitulli 1	186
	Informacion Shoqërues Kapitulli 2	190
	Informacion Shoqërues Kapitulli 3	195
	Informacion Shoqërues Kapitulli 6	206
	Informacion Shoqërues Kapitulli 7	211
Shtojca II:	Struktura Konceptuale e GAGAS për Pavarësinë	215
	Këshilli Konsultativ i Audituesit të Përgjithshëm në	
Shtojca III:	Standardet e Auditimit të Qeverisë	216
	Pjesëtarët e Këshillit Konsultativ	216
	Ekipi i Projektit GAO	220

---

<b>Indeks</b>		<b>221</b>
---------------	--	------------

Zyra e Auditimit të Qeverisë e Shteteve të Bashkuara të Amerikës  
Washington, D.C. 20548

Auditimet sigurojnë llogaridhënie thelbësore dhe transparencë mbi programet qeveritare. Duke pasur parasysh sfidat aktuale me të cilat përballen qeveritë dhe programet e tyre, mbikëqyrja e siguruar nëpërmjet auditimit është më kritike se kurrë. Auditimi i qeverisë ofron analizë dhe informacione objektive që janë të nevojshme për të marrë vendime në ndihmë të një të ardhmeje më të mirë. Standardet profesionale të paraqitura në këtë rishikim të Standardeve të Auditimit të Qeverisë 2011 ofrojnë një kuadër për kryerjen e punës audituese të cilësisë së lartë me kompetencë, integritet, objektivitet dhe pavarësi për të siguruar llogaridhënie dhe për të ndihmuar në përmirësimin e operacioneve dhe shërbimeve qeveritare. Këto standarde sigurojnë bazën për audituesit e qeverisë për të udhëhequr përmes shembullit në fushat e pavarësisë, transparencës, llogaridhënies dhe cilësisë përmes procesit të auditimit.

Rishikimi i Standardeve të Auditimit të Qeverisë 2011 paraqet një version të modernizuar të standardeve, duke marrë në konsideratë ndryshimet e fundit në standardet e tjera të auditimit, përfshirë edhe standardet ndërkombëtare. Ky rishikim zëvendëson rishikimin e 2007. Ai përmban ndryshime të mëdha nga rishikimi i 2007 që përforcojnë parimet e transparencës dhe përgjegjshmërisë dhe që sigurojnë kuadrin për auditimet qeveritare me cilësi të lartë dhe me vlerë të shtuar.

- Është shtuar një kuadër konceptual për pavarësinë për të siguruar një mjet për audituesit, për të vlerësuar pavarësinë e tyre për aktivitete që nuk janë të ndaluara shprehimisht në standarde. Kjo qasje e bazuar kryesisht në parime në analizën e pavarësisë ofron kornizën për audituesit për të vlerësuar faktet unike dhe rrethanat që lindin gjatë punës së tyre.
- Ky rishikim sjell diskutime rreth Deklaratave të Standardeve të Auditimit (SAS) të AICPA-s dhe rreth Deklaratave mbi Standardet për

Angazhimet për Certifikim(SSAE), për ato kërkesa që janë të inkuorporuara me referenca dhe të përfshira në rishikimin e 2007, duke qenë se standardet kanë konverguar në ato zona.

- Është sqaruar për auditimet e performancës përkufizimi i vlefshmërisë si një aspekt i cilësisë së provave.

Efektive me datat e zbatimit për rishikimin e Standardeve të Auditimit të Qeverisë 2011, GAO gjithashtu po tërheq Standartet e Auditimit të Qeverisë: Përgjigjet për Pyetjet rreth Standardeve të Pavarësisë (GAO-02-870G, Korrik 2002).

Ky rishikim i standardeve ka kaluar në një proces të gjerë diskutimi, duke përfshirë komentet publike të dhëna nga Këshillit Konsultativ për Standartet e Auditimit të Qeverisë i Audituesit të Përgjithshëm. Këshilli Konsultativ në përgjithësi përbëhet nga rreth 25 ekspertë nga fushat e auditimit financiar, të performancës dhe raportimit, të cilët vijnë nga niveli federal, shtetëror dhe i qeverisjes vendore, sektori privat dhe bota akademike. Pikëpamjet e të gjitha palëve janë konsideruar plotësisht në finalizimin e standardeve.

Rishikimi i Standardeve të Auditimit të Qeverisë 2011 do të jetë efektiv për auditimet financiare dhe angazhimet për certifikim për periudha që përfundojnë në ose pas 15 dhjetor 2012, dhe për auditimet e performancës që fillojnë më datën 15 dhjetor 2011. Zbatimi i hershëm i tyre nuk është i lejuar.

Një version elektronik i këtij dokumenti dhe ndonjë publikim interpretues mund të gjendet në <http://www.gao.gov/yellowbook>.

---

Falënderoj në mënyrë të veçantë anëtarët e Këshillit Konsultativ për kontributin e tyre të gjerë dhe reagimet gjatë tërë procesit të zhvillimit dhe finalizimit të standardeve.



Gene L. Dodaro  
Audituesi i Përgjithshëm  
i Shteteve të Bashkuara

Dhjetor 2011

# Auditimi i Qeverisë: Bazat dhe Parimet Etike

## Hyrje

**1.01** Koncepti i përgjegjshmërisë për përdorimin e fondeve publike dhe të autoritetit qeveritar është kyç për proceset qeverisëse të vendit tonë. Menaxhimi dhe zyrtarët e besuar me burimet publike janë përgjegjës për kryerjen e funksioneve publike dhe ofrimin e shërbimeve për publikun në mënyrë efektive, efikase, ekonomike, etike, si dhe në mënyrë të barabartë brenda kontekstit të kufijve ligjorë të programit specifik qeveritar.

**1.02** Siç pasqyrohet në ligjet, rregulloret, marrëveshjet dhe standardet e zbatueshme, menaxhimi dhe zyrtarët e programeve qeveritare janë përgjegjës për sigurimin e informacionit të besueshëm, të dobishëm dhe në kohë për transparencën dhe llogaridhënien e këtyre programeve dhe operacioneve të tyre.<sup>1</sup> Ligjvënësit, organet mbikëqyrëse, ata që merren me qeverisjen<sup>2</sup> dhe publiku kanë nevojë të dinë nëse: (1) menaxhimi dhe zyrtarët që menaxhojnë burimet qeveritare e përdorin autoritetin e tyre siç duhet dhe në përputhje me ligjet dhe rregulloret; (2) programet qeveritare kanë arritur objektivat e tyre dhe rezultatet e dëshiruara; dhe (3) shërbimet qeveritare janë siguruar në mënyrë efektive, eficiente, ekonomike, etike, si dhe në mënyrë të barabartë.

**1.03** Auditimi i qeverisë është thelbësor në sigurimin e llogaridhënies së ligjvënësve, organeve të mbikëqyrjes, atyre që janë të ngarkuar me qeverisje dhe publikun. Auditimet<sup>3</sup> sigurojnë një vlerësim të pavarur, objektiv, jopartiak për administrimin, performancën, ose koston e politikave të qeverisë, programeve, ose operacioneve, në varësi të llojit dhe fushëveprimit të auditimit.

<sup>1</sup> Shiko paragrafin A1.08 për informacion shtesë mbi përgjegjësitë e menaxhimit.

<sup>2</sup> Shiko paragrafët A1.05 deri tek A1.07 për diskutim shtesë në lidhje rolin e atyre që janë të ngarkuar me qeverisjen.

<sup>3</sup> Shiko paragrafin 1.07c për diskutimin e termit "auditim" ashtu siç është përdorur në kapitujt 1 deri 3 dhe seksionet përkatëse të shtojcës.

**Kapitulli 1**  
**Auditimi i Qeverisjes:**  
**Bazat dhe Parimet e Etikës**

---

Qëllimi dhe  
Zbatimi i  
GAGAS

**1.04** Standardet profesionale dhe udhëzimet e përfshira në këtë dokument, zakonisht të referuara si Standardet e Auditimit të Qeverisë të Pranuara Përgjithësisht (General Accepted Government Auditing Standards), ofrojnë një kornizë për kryerjen e auditimeve me cilësi të lartë, me kompetencë, integritet, objektivitet dhe pavarësi. Këto standarde janë në përdorim të audituesve të subjekteve qeveritare dhe subjekteve që marrin financime qeveritare, si dhe organizatave të auditimit që kryejnë auditime sipas GAGAS. Në përgjithësi, GAGAS përmban standarde për auditimet, të cilat janë të përbërë nga kërkesat individuale që janë të identifikuara nga terminologjia siç diskutohet në paragrafët 2.14 - 2.18. GAGAS përmban kërkesa dhe udhëzime që kanë të bëjnë me etikën, pavarësinë, gjykimin profesional të audituesve, kompetencën, kontrollin e cilësisë, performancën e auditimit dhe raportimin.

**1.05** Auditimet që kryhen në përputhje me GAGAS japin informacion që përdoret për mbikëqyrjen, përgjegjshmërinë, transparencën dhe përmirësimin e programeve dhe operacioneve të qeverisë. GAGAS përmbajnë kërkesat dhe udhëzimet për të ndihmuar audituesit në marrjen dhe vlerësimin me objektivitet të evidencës së mjaftueshme e të përshtatshme dhe raportimin e rezultateve. Kur audituesit kryejnë punën e tyre në këtë mënyrë dhe në përputhje me GAGAS në raportimin e rezultateve, puna e tyre mund të çojë në menaxhimin e përmirësuar të qeverisë, vendimmarrje dhe mbikëqyrje më të mirë, operacione efektive dhe efçente, si dhe përgjegjshmëri e transparencë për burimet dhe rezultatet.

**Kapitulli 1**  
**Auditimi i Qeverisjes:**  
**Bazat dhe Parimet e Etikës**

---

**1.06** Dispozitat e ligjeve, rregulloreve, kontratave, marrëveshjeve të grandit, ose politikave shpesh kërkojnë që auditimet të kryhen në përputhje me GAGAS. Përveç kësaj, shumë auditues dhe organizata të auditimit zgjedhin vullnetarisht të kryejnë punën e tyre në përputhje me GAGAS. Kërkesat dhe udhëzimet në GAGAS zbatohen për auditimet e njëjësive, programet, veprimtaritë dhe funksionet qeveritare, si dhe për asistencën ndaj qeverisë kur administrohet nga kontraktorët, organizatat jofitimprurëse, si dhe njëjësive të tjera joqeveritare kur përdorimi i GAGAS kërkohet ose ndiqet vullnetarisht.<sup>4</sup>

**1.07** Ky paragraf përshkruan përdorimin e termave të mëposhtme në GAGAS.

**a.** Termi "auditues", i përdorur gjatë gjithë GAGAS përshkruan individët që kryejnë punën në përputhje me GAGAS (duke përfshirë auditimet dhe angazhimet për certifikim) pavarësisht profesionit të punës. Prandaj, individët të cilët mund të kenë titullin auditues, analist, mjek, vlerësues, inspektor, apo profesione të tjerë të ngjashëm konsiderohen auditues në GAGAS.

**b.** Termi "organizatë e auditimit", përdorur gjatë gjithë GAGAS, i referohet organizatave qeveritare të auditimit, si dhe të kontabilitetit publik apo firmat e tjera që kryejnë auditime dhe angazhime për certifikim sipas GAGAS.

**c.** Termi "auditim", përdorur në kapitujt 1 deri 3 dhe seksione të shtojcës përkatëse, i referohet auditimeve financiare, angazhimeve për certifikim dhe auditimeve të performancës të kryer në përputhje me GAGAS.

---

<sup>4</sup> Shiko paragrafët A1.02 - A1.04 për diskutimin e ligjeve, rregulloreve dhe udhëzimeve që kërkojnë përdorimin e GAGAS.

**Kapitulli 1**  
**Auditimi i Qeverisjes:**  
**Bazat dhe Parimet e Etikës**

---

**1.08** Një organizatë qeveritare e auditimit mund të gjendet brenda ose jashtë strukturës së organizatave të audituara.<sup>5</sup> Organizatat e auditimit që janë jashtë njësisë së audituar dhe raportojnë tek palët e treta janë organizata të auditimit të jashtëm. Organizatat e auditimit që përgjigjen tek menaxhimi i lartë dhe të ngarkuarit me qeverisjen e njësisë së audituar, dhe nuk raportojnë në përgjithësi te palët e treta të jashtme të njësisë së audituar, janë organizatat e auditimit të brendshëm.

**1.09** Disa organizata të auditimit të qeverisë përfaqësojnë një kombinim unik të auditimit të jashtëm dhe të brendshëm në rolin e tyre mbikëqyrës për subjektet që ata auditojnë. Këto organizata të auditimit kanë kërkesa të jashtme të raportimit në përputhje me kërkesat e raportimit për audituesit e jashtëm, ndërkohë që janë pjesë e agjencive përkatëse të tyre. Këto organizata të auditimit shpesh kanë një përgjegjësi të dyfishtë raportimi, ndaj organit legjislativ, si dhe ndaj drejtuesit të agjencisë dhe menaxhimit.

---

**Parimet Etike**

**1.10** Parimet etike të paraqitura në këtë seksion sigurojnë themelin, disiplinën dhe strukturën, si dhe mjedisin që ndikon në aplikimin e GAGAS.

Ky seksion përcakton parimet themelore, dhe jo zhvillimin e standardeve apo kërkesat specifike.

**1.11** Duke qenë se auditimi është thelbësor për përgjegjshmërinë e qeverisë ndaj publikut, publiku pret që organizatat e auditimit dhe audituesit që kryejnë punën e tyre në përputhje me GAGAS të ndjekin parimet etike. Menaxhimi i organizatës së auditimit përcakton qëndrimin për sjellje etike në të gjithë organizatën duke ruajtur një kulturë etike, duke

---

<sup>5</sup> Shiko paragrafin 1.19 për një diskutim të objektivitetit dhe paragrafët 3.27, 3.32 për kërkesat në lidhje me konsideratat e pavarësisë për audituesit e qeverisë dhe strukturën organizative të auditimit.

**Kapitulli 1**  
**Auditimi i Qeverisjes:**  
**Bazat dhe Parimet e Etikës**

---

komunikuar qartë sjellje të pranueshme dhe pritshmëritë për çdo punonjës, si dhe krijimin e një mjedisi që përforcon dhe nxit sjelljen etike në të gjitha nivelet e organizatës. Të etikës që ruhet dhe tregohet nga menaxhimi dhe stafi është një element thelbësor i mjedisit pozitiv etik për organizatën e auditimit.

**1.12** Kryerja e punës së auditimit në përputhje me parimet etike është një çështje e përgjegjësisë personale dhe organizative. Parimet etike zbatohen për të mbrojtur pavarësinë e audituesit<sup>6</sup>, duke marrë përsipër vetëm punë për të cilat organizata e auditimit është kompetente<sup>7</sup> për të kryer, për t'i kryer ato me cilësi të lartë dhe duke ndjekur standardet e zbatueshme të përmendura në raportin e audituesve. Integriteti dhe objektiviteti ruhen atëherë kur audituesit kryejnë punën e tyre dhe marrin vendime që janë në përputhje me interesin më të gjerë të atyre të cilët mbështeten në raportin e audituesve, përfshirë publikun.

**1.13** Kërkesat e tjera etike ose kodet e sjelljes profesionale mund të zbatohen për audituesit që kryejnë auditime në përputhje me GAGAS. Për shembull, audituesit individual të cilët janë anëtarë të organizatave profesionale ose janë të licencuar ose profesionistë të certifikuar mund të jenë subjekt i kërkesave etike të këtyre organizatave profesionale ose organeve të licencimit. Audituesit e punësuar nga organet qeveritare mund të jenë subjekt i ligjeve dhe rregulloreve të qeverisë për etikën.

---

<sup>6</sup> Shiko paragrafët 3.02, 3.59 për kërkesat që lidhen me pavarësinë.

<sup>7</sup> Shiko paragrafët 3.69 dhe 3.81 për informacion shtesë mbi kompetencën.

**Kapitulli 1**  
**Auditimi i Qeverisjes:**  
**Bazat dhe Parimet e Etikës**

---

**1.14** Parimet etike që udhëheqin punën e audituesve që kryejnë auditime në përputhje me GAGAS janë:

- a. interesi publik;
  - b. integriteti;
  - c. objektiviteti;
  - d. përdorimi i duhur i informacionit të qeverisë, burimet, dhe pozicionet;  
dhe
  - e. sjellja profesionale.
- 

**Interesi Publik**

**1.15** Interesi publik përkufizohet si mirëqenia kolektive e komunitetit të publikut dhe organeve të cilëve audituesit u shërbejnë. Respektimi i integritetit, objektivitetit dhe pavarësisë në kryerjen e përgjegjësive të tyre profesionale i ndihmon audituesit në përmbushjen e parimit të interesit publik dhe respektimit të besimit publik. Parimi i interesit publik është themelor për përgjegjësitë e audituesve dhe kritik në mjedisin qeverisës.

**1.16** Një tipar dallues i-e një audituesi është pranimi i përgjegjësisë për t'i shërbyer interesit publik. Kjo përgjegjësi është kritike gjatë auditimit në mjedisin e qeverisë. GAGAS mishëron konceptin e përgjegjshmërisë për burimet publike, që është themelor për t'i shërbyer interesit publik.

---

**Integriteti**

**1.17** Besimi i publikut në qeveri forcohet nga audituesit që kryejnë përgjegjësitë e tyre profesionale me integritet. Integriteti përfshin audituesit që punojnë me një qëndrim që është objektiv, i bazuar në fakte, jopartiak, dhe jo ideologjik në lidhje me subjektet e audituara

**Kapitulli 1**  
**Auditimi i Qeverisjes:**  
**Bazat dhe Parimet e Etikës**

---

dhe përdoruesit e raporteve të audituesve. Brenda kufizimeve të ligjeve të zbatueshme të konfidencialitetit, rregullave ose politikave, komunikimet me njësinë e audituar, me të ngarkuarit me qeverisjen, dhe individët kontraktues ose ata që kërkojnë auditimin, pritet të jenë të ndershme, të sinqerta dhe konstruktive.

**1.18** Marrja e vendimeve në pajtueshmëri me interesin publik për programin apo veprimtarinë nën auditim, është pjesë e rëndësishme e parimit të integritetit. Në përmbushjen e përgjegjësive të tyre profesionale, audituesit mund të përballen me presione kontradiktore nga menaxhimi i njësisë të audituar, nga nivele të ndryshme të qeverisë, si dhe nga përdorues të tjerë të mundshëm. Audituesit mund të ndeshen edhe me presione me qëllim përfitimin e pavend personal ose organizativ. Në zgjidhjen e këtyre konflikteve dhe presioneve, të veprsh me integritet do të thotë që audituesit të kenë prioritet interesin publik mbi interesin personal.

---

Objektiviteti

**1.19** Besueshmëria e auditimit në sektorin qeveritar bazohet në objektivitetin e audituesve në përmbushjen e përgjegjësive të tyre profesionale. Objektiviteti përfshin pavarësinë në fakt dhe në dukje gjatë auditimeve, duke ruajtur një sjellje të paanshme, duke pasur ndershmëri intelektuale dhe të jenë të lira nga konfliktet e interesit. Ruajtja e objektivitetit përfshin një vlerësim të vazhdueshëm të marrëdhënieve me subjektet e audituara dhe aktorët e tjerë në kontekstin e përgjegjësive të audituesve për publikun. Konceptet e objektivitetit dhe pavarësisë janë të lidhura ngushtë. Cënimet e pavarësisë kanë ndikim në objektivitet.<sup>8</sup>

---

<sup>8</sup> Shiko standardet e pavarësisë në paragrafet 3.02, 3.59.

**Kapitulli 1**  
**Auditimi i Qeverisjes:**  
**Bazat dhe Parimet e Etikës**

---

---

Përdorimi i duhur  
i Informacioneve  
të Qeverisë,  
Burimeve,  
dhe Pozicioneve

**1.20** Informacionet qeveritare, burimet, dhe pozicionet duhen përdorur për qëllime zyrtare dhe jo në mënyrë të papërshtatshme për përfitime personale të audituesit, në kundërshtim me ligjin ose në dëm të interesave legjitime të njësisë së audituar ose organizatave të auditimit. Ky koncept përfshin trajtimin e duhur të informacionit ose të burimeve të ndjeshme apo të klasifikuara.

**1.21** Në mjedisin e qeverisë, e drejta e publikut për transparencën e informacionit të qeverisë duhet balancuar me përdorimin e përshtatshëm të këtij informacioni. Përveç kësaj, shumë programe qeveritare i nënshtrohen ligjeve dhe rregulloreve që kanë të bëjnë me nxjerrjen e informacionit. Për të arritur këtë ekuilibër, liria në përdorimin e informatave të fituara gjatë detyrave të audituesve është një pjesë e rëndësishme në arritjen e këtij qëllimi. Përhapja dhe nxjerrja e papërshtatshme e këtyre informacioneve ndaj palëve të treta nuk është praktikë e pranueshme.

**1.22** Përgjegjshmëria ndaj publikut për përdorimin e duhur dhe menaxhimin e kujdesshëm të informacioneve të qeverisë është një pjesë thelbësore e përgjegjësive të audituesve. Mbrojtja dhe ruajtja e burimeve qeveritare dhe përdorimi i tyre në mënyrë të përshtatshme për veprimtari të autorizuar është një element i rëndësishëm në pritshmëritë e publikut për audituesit.

**1.23** Shpërdorimi i pozitës, për përfitime financiare apo përfitime të tjera shkel përgjegjësitë themelore të një audituesi. Besueshmëria e audituesit mund të dëmtohet nga veprime, të cilat nga një palë e tretë objektive me njohuri të informacionit përkatës, mund të perceptohen si një përfitim financiar i papërshtatshëm i audituesit apo i një personi lidhur me të ose anëtar i afërm të familjes; një partner i përgjithshëm; një organizatë për të cilën audituesi shërben si zyrtar, drejtor, administrator i besuar, apo punonjës; ose një organizatë me të cilën audituesi është në diskutime në lidhje me punësimin e ardhshëm.

**Kapitulli 1**  
**Auditimi i Qeverisjes:**  
**Bazat dhe Parimet e Etikës**

---

---

Sjellja  
Profesionale

**1.24** Pritshmëritë e mëdha për profesionin e auditimit përfshijnë pajtueshmërinë me të gjitha detyrimet përkatëse ligjore, rregullatore dhe profesionale, si dhe shmangien e çdo sjelljeje që mund të sjellë zhvlerësimin e punës së audituesve, duke përfshirë edhe veprimet që do të shkaktonte një palë e tretë objektive me njohuri të informacionit përkatës të arrijë në konkluzionin se puna e audituesit ka mangësi profesionale. Sjellje profesionale do të thotë që audituesit duhet të përpiqen të jenë të ndershëm në kryerjen e detyrave dhe të shërbimeve të tyre profesionale në përputhje me standardet përkatëse teknike dhe profesionale.

Kapitulli 2

---

## Standardet për Përdorimin dhe Zbatimin e GAGAS

---

---

### Hyrje

**2.1** Në këtë kapitull jepen kërkesat dhe udhëzimet për auditimet e kryera<sup>9</sup> në përputhje me Standardet e Auditimit të Qeverisë Përgjithësisht të Pranuara (më poshtë GAGAS). Në këtë kapitull identifikohen gjithashtu edhe llojet e auditimeve që mund të kryen sipas GAGAS; shpjegohet terminologjia e përdorur nga GAGAS për të identifikuar kërkesat; shpjegohet marrëdhënia midis GAGAS dhe standardeve të tjera profesionale; si dhe jepen kërkesat që nevojiten për të përcaktuar përputhshmërinë me GAGAS në raportimin e audituesve.

---

### Llojet e Auditimeve sipas GAGAS dhe Angazhimet për Certifikim

**2.02** Ky seksion përshkruan llojet e auditimit që organizatat e auditimit mund të kryejnë në përputhje me GAGAS. Ky përshkrim nuk ka për qëllim të kufizojë apo të kërkojë që të gjithë llojet e auditimeve të kryen në përputhje me GAGAS.

**2.03** Të gjithë auditimet fillojnë me objektiva. Janë objektivat ato që vendosin llojin e auditimit që do të kryhet si dhe standardet e zbatueshme. Për qëllime të këtij dokumenti, llojet e auditimeve që mbulohen nga GAGAS, të klasifikuar sipas objektivave, janë auditimet financiare, angazhimet për certifikim dhe auditimet e performancës.

**2.04** Në disa auditime, standardet e zbatueshme në funksion të një objektivi të caktuar janë përgjithësisht të dukshme. Për shembull, nëse objektivi është dhënia e një opinionit për pasqyrat financiare, atëherë zbatohen standardet për auditimet financiare. Megjithatë, disa auditime mund të kenë objektiva të shumëfishta dhe të mbivendosura. Për shembull, nëse objektivat janë për përcaktimin e besueshmërisë së treguesve të performancës, kjo mund të arrihet si me standardet e angazhimeve për certifikim, po ashtu dhe me standardet për auditimin e performancës.

---

<sup>9</sup> Shiko paragrafin 1.07c për diskutimin e termit "auditim", siç është përdorur në kapitujt 1 deri 3 dhe seksionet përkatëse të shtojcës.

**Kapitulli 2**  
**Standardet për Përdorimin**  
**Dhe Aplikimin e GAGAS**

---

Në rastet kur ekziston mundësia e zgjedhjes midis standardeve, për të vendosur çfarë standardesh të ndjekin audituesit duhet të vlerësojnë nevojat e përdoruesve si dhe aftësitë, njohuritë dhe eksperiencën e audituesve.

**2.05** Kërkesat e GAGAS zbatohen për llojet e auditimeve të cilat mund të kryen në pajtueshmëri me GAGAS si vijon:

- a. Për Auditimet Financiare: zbatohen kërkesat dhe udhëzimet nga kapitulli 1 deri në 4.
- b. Për Angazhimet për certifikim zbatohen kërkesat dhe udhëzimet nga kapitulli 1 deri në 3, dhe kapitulli 5.
- c. Për Auditimet e Performancës: zbatohen kërkesat dhe udhëzimet nga kapitulli 1 deri në 3, kapitulli 6 dhe kapitulli 7.

**2.06** Shtojca I përfshin udhëzime shitesë për audituesit dhe njësitë e audituara për të ndihmuar në zbatimin e GAGAS. Shtojca I nuk vendos kërkesa për audituesit por ka për qëllim lehtësimin e zbatimit të standardeve të përfshira në kapitujt 2 deri në 7. Shtojca II përmban një diagramë e cila mund të ndihmojë në zbatimin e kuadrit konceptual për pavarësinë.<sup>10</sup>

---

Auditimet  
Financiare

**2.07** Auditimet financiare japin një vlerësim të pavarur të faktit nëse informacioni financiar i raportuar nga njësia ekonomike (p.sh., gjendja financiare, rezultatet dhe përdorimi i burimeve) prezantohen në mënyrë të drejtë dhe në përputhje me kriteret e njohura. Auditimet financiare të kryera sipas GAGAS përfshijnë Auditime të Pasqyrave Financiare dhe Auditime Financiare të Tjera të ngjashme:

---

<sup>10</sup> Shiko paragrafët 3.07, 3.32 për diskutimin e kuadrit konceptual.

**Kapitulli 2**  
**Standardet për Përdorimin**  
**Dhe Aplikimin e GAGAS**

---

**a. Auditimet e Pasqyrave Financiare:** Qëllimi kryesor i një auditimi të pasqyrave financiare është dhënia e një opinioni nëse pasqyrat financiare të një njësie ekonomike janë prezantuar në mënyrë të drejtë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar. Raportimi mbi auditimet e pasqyrave financiare të kryera në përputhje me GAGAS, gjithashtu përfshin raporte mbi kontrollin e brendshëm, mbi raportimin financiar dhe raporte mbi pajtueshmërinë me dispozitat e ligjeve, rregulloreve, kontratave dhe marrëveshjeve të grandeve që kanë një efekt material në pasqyrat financiare.

**b. Llojet e tjera të Auditimeve Financiare:** Llojet e tjera të auditimeve financiare të kryera në përputhje me GAGAS bartin qëllime pune të ndryshme, duke përfshirë: (1) marrjen e evidencës së mjaftueshme dhe të përshtatshme për të formuar një opinion mbi pasqyrat financiare, elementet specifik, llogaritë, ose zërat e një pasqyre financiare<sup>11</sup>; (2) dhënien e dokumenteve zyrtare për nënshkruesit dhe disa palë të tjera kërkuese<sup>12</sup>; dhe (3) auditivin e përputhshmërisë me kërkesat e zbatueshme të pajtueshmërisë lidhur me një ose më shumë programe të qeverisë.<sup>13</sup>

**2.08 GAGAS përmbajnë Deklaratat e Standardeve të Auditimit, të Institutit Amerikan të Kontabilistëve Publik të Çertifikuar (AICPA)<sup>14</sup>. Kërkesat shtesë për kryerjen e**

---

<sup>11</sup> Shiko Institutin Amerikan të Kontabilistëve Publik të Çertifikuar (AICPA-ja), Kodifikimin e Deklaratave të Standardeve të Auditimit për Auditimin (AU-C) Seksioni 805, Konsiderata të veçanta - Auditimi i Pasqyrave Financiare dhe Elemente të Veçanta, Llogaritë, ose Zërat e një Pasqyre Financiare.

<sup>12</sup> Shiko AICPA-ja, AU-C Seksioni 920, Letra për Nënshkruesit dhe Disa Palë të tjera Kërkuese.

<sup>13</sup> Shiko AICPA-ja AU-C Seksioni 935, Auditimet e Pajtueshmërisë.

<sup>14</sup> Shiko te AICPA-s, Kodifikimin e Deklaratave të Standardeve të Auditimit për Auditimin dhe paragrafin 2.20 për diskutime shtesë mbi marrëdhëniet mes GAGAS dhe standardet e tjera profesionale. Referencat identifikuese për AICPA dhe Kodifikimin e Deklaratave të Standardeve të Auditimit për Auditimin është "AU-C" si identifikues për t'u referuar SASs, në vend të "AU". "AU-C" është një identifikues i përkohshëm për të shmangur konfuzionin me referencën "AU" të seksioneve ekzistuese, të cilat mbeten në fuqi deri në vitin 2013. "AU-C" do të kthehet në "AU" në 2014 për AICPA dhe Kodifikimin e Deklaratave të Standardeve të Auditimit, kur SASs (Deklaratat e Standardeve të Auditimit) do të bëhen plotësisht efektive për të gjitha angazhimet.

---

**Kapitulli 2**  
**Standardet për Përdorimin**  
**Dhe Aplikimin e GAGAS**

---

auditimeve financiare në përputhje me GAGAS janë të përfshira në kapitullin 4. Për auditimet financiare të kryera në përputhje me GAGAS, audituesit duhet të përmbushin gjithashtu kërkesat e kapitujve nga 1 deri në 3.

---

Angazhimet  
për Certifikim

**2.09 Angazhimet për certifikim** mund të mbulojnë një gamë të gjerë objektivash financiare ose jo financiare në lidhje me çështjen apo pohimin në varësi të nevojave të përdoruesve.<sup>15</sup> GAGAS përfshin referenca me Deklaratat e AICPA-së mbi Standardet e Angazhimeve për Certifikim (SSAE).<sup>16</sup> Kërkesat shtesë për kryerjen e angazhimeve për certifikim sipas GAGAS janë të përfshira në kapitullin 5. Standardet AICPA njohin angazhime për certifikim që rezultojnë në një raport të një ekzaminimi, një rishikimi apo një procedurë të pranuar për një çështje ose për një pohim në lidhje me një çështje që është përgjegjësi e një pale tjetër.<sup>17</sup> Tre llojet e angazhimeve për certifikim janë:

**a. Ekzaminimi:** Përbëhet nga marrja e evidencës së mjaftueshme dhe të përshtatshme për të shprehur një opinion nëse çështja në shqyrtim është e bazuar në (ose në përputhje me) kriteret në të gjitha aspektet materiale ose pohimi është paraqitur (ose deklaruar) në të gjitha aspektet materiale, në bazë të kriterëve.

---

<sup>15</sup> Shiko A 2.01 për shembuj të objektivave për vërtetimin e angazhimeve.

<sup>16</sup> Shiko AICPA, Kodifikimi i Deklaratave mbi Standardet për Verifikimin e Angazhimeve.

<sup>17</sup> Shiko AICPA, Seksioni 101, Verifikimi i angazhimeve dhe Seksionin 201, Procedurat e Dakorduara të Angazhimeve.

**Kapitulli 2**  
**Standardet për Përdorimin**  
**Dhe Aplikimin e GAGAS**

---

**b. Rishikimi:** Përbëhet nga një testim i mjaftueshëm për të shprehur një konkluzion, nëse ndonjë informacion që vjen në vëmendjen e audituesve në bazë të punës së kryer tregon se çështja në shqyrtim nuk është bazuar në (ose në përputhje me) kriteret në të gjitha aspektet materiale ose pohimi nuk është paraqitur (ose deklaruar) në të gjitha aspektet materiale, në bazë të kriterëve Audituesit nuk duhet të kryejnë punën në nivel rishikimi për raportimet mbi kontrollin e brendshëm ose për përputhshmërinë me dispozitat e ligjeve dhe rregulloreve.<sup>18</sup>

---

Auditimet e  
Performancës

**2.10** Auditimet e performancës përkufizohen si auditime që ofrojnë gjetje apo konkluzione të bazuara në një vlerësim të mjaftueshëm dhe të përshtatshëm të evidencave ndaj kriterëve.<sup>19</sup> Auditimet e performancës sigurojnë analizë objektive për të ndihmuar menaxhimin dhe të ngarkuarit me qeverisjen dhe mbikëqyrjen në përdorimin e informacionit për të përmirësuar performancën dhe operacionet e programit, për të zvogëluar shpenzimet, për të lehtësuar vendimmarrjen e palëve përgjegjëse, për të mbikëqyrur ose të nisur veprime për të kontribuar në përgjegjshmërinë publike. Termi "program" është përdorur në GAGAS për të përfshirë njësitë qeveritare, organizatat, programet, aktivitetet dhe funksionet.

---

<sup>18</sup> Shiko AICPA, Seksioni 501, Raportimi mbi Kontrollin e Brendshëm të Raportimit Financiar të njësisë Ekonomike dhe seksioni 601, Verifikimi i Përputhshmërisë.

<sup>19</sup> Shiko paragrafët 6.37 dhe A 6.02 për diskutim të kriterëve.

**Kapitulli 2**  
**Standardet për Përdorimin**  
**Dhe Aplikimin e GAGAS**

---

**2.11** Objektivat e auditimit të performancës variojnë gjerësisht dhe përfshijnë vlerësime të efektivitetit, ekonomicitetit dhe eficientës së programit; kontrollit të brendshëm; pajtueshmërisë dhe analizat për të ardhmen. Këto objektiva të përgjithshme nuk janë reciprokisht përjashtimore. Kështu, një auditim performance mund të ketë më shumë se një objektiv të përgjithshëm. Për shembull, një auditim performance me qëllim përcaktimin ose vlerësimin e efektivitetit të programit mund të përfshijë edhe një objektiv shtesë për vlerësimin e kontroleve të brendshme për të përcaktuar arsyet për mungesën e efektivitetit ose si efektiviteti mund të përmirësohet. Shembuj të llojeve të ndryshme të objektivave të auditimit të performancës të diskutuara më poshtë përfshihen në Shtojcën I.<sup>20</sup>

**a.** Efektiviteti i programit dhe objektivat e rezultateve të auditimit janë të ndërlidhura shpesh me ato të ekonomicitetit dhe eficientës së objektivave. Objektivat e auditimit që fokusohen tek efektiviteti dhe rezultatet e programit matin shkallën në të cilën një program arrin qëllimet dhe objektivat e tij. Objektivat e auditimit që fokusohen tek ekonomiciteti dhe eficienta trajtojnë kostot dhe burimet e përdorura për të arritur rezultatet e programit.

**b.** Objektivat e auditimit të kontrollit të brendshëm kanë të bëjnë me vlerësimin e një ose të më shumë elementëve të sistemit të kontrollit të brendshëm të organizatës që është projektuar për të ofruar siguri të arsyeshme për arritjen veprimeve të suksesshme dhe efektive, raportimin e besueshëm financiar dhe të performancës, ose pajtueshmërinë me ligjet dhe rregulloret në fuqi. Objektivat e kontrollit të brendshëm gjithashtu mund të jenë të rëndësishme për të përcaktuar shkallën e performancës së dobët të programit.

---

<sup>20</sup> Shiko paragrafët A2.02 - A2.05 për diskutimin e objektivave të auditimit të performancës.

**Kapitulli 2**  
**Standardet për Përdorimin**  
**Dhe Aplikimin e GAGAS**

---

Kontrolli i brendshëm përfshin planet, politikat, metodat dhe procedurat e përdorura për të përmbushur misionin e organizatës, qëllimet dhe objektivat. Kontrolli i brendshëm përfshin proceset dhe procedurat për planifikimin, organizimin, drejtimin, dhe kontrollin e operacioneve të programit; dhe sistemin e menaxhimit për matjen, raportimin dhe monitorimin e performancës të programit.<sup>21</sup>

**c.** Objektivat e auditimit të përputhshmërisë kanë të bëjnë me vlerësimin e pajtueshmërisë me kriteret e përcaktuara nga dispozitat e ligjeve, rregulloreve, kontratave dhe marrëveshjeve ose grandeve, apo kërkesat e tjera që mund të ndikojnë në blerjen, mbrojtjen, përdorimin dhe vlefshmërinë e burimeve të njësisë ekonomike si dhe sasinë, cilësinë, kohën dhe koston e shërbimeve që njësia prodhon dhe shpërndan. Kërkesat e përputhshmërisë mund të jenë financiare ose jofinanciare.

**d.** Objektivat e auditimit të analizave për periudhat e ardhshme ofrojnë analiza apo konkluzione rreth informacionit që bazohet në supozime rreth ngjarjeve që mund të ndodhin në të ardhmen, së bashku me veprimet e mundshme që njësia ekonomike mund të marrë në përgjigje të ngjarjeve të ardhshme.

---

Shërbimet  
Joaudituese  
të Ofruara nga  
Organizatat e  
Auditimit

**2.12** GAGAS nuk mbulojnë shërbime joaudituese, të cilat përcaktohen si shërbime profesionale ndryshe nga auditimet ose angazhimet për certifikim. Prandaj, audituesit nuk raportojnë nëse shërbimet joaudituese janë kryer në përputhje me GAGAS. Kur kryejnë shërbime joaudituese për një njësi ekonomike për të cilën organizata e auditimit kryen një auditim GAGAS, organizata e auditimit duhet të komunikojë me kërkuesit dhe të ngarkuarit me qeverisjen për të qartësuar se puna e kryer nuk është një auditim i kryer në përputhje me GAGAS.

**K**

---

<sup>21</sup> Shiko paragrafët A.03 - A.04 për diskutim shtesë të kontrollit të brendshëm.

**Kapitulli 2**  
**Standardet për Përdorimin**  
**Dhe Aplikimin e GAGAS**

---

**2.13** Kur organizatat e auditimit u ofrojnë shërbime joaudituese njërive për të cilat ata gjithashtu ofrojnë auditime GAGAS, ato duhet të vlerësojnë ndikimin që ofrimi i këtyre shërbimeve joaudituese mund të ketë në pavarësinë e audituesit dhe organizatës së auditimit, si dhe duhet ti përgjigjen çdo kërcënimi të identifikuar të pavarësisë në përputhje me standardin GAGAS për pavarësinë.<sup>22</sup>

---

**Përdorimi i**  
**Terminologjisë**  
**për të**  
**Përkufizuar**  
**Kërkesat**  
**GAGAS**

**2.14** GAGAS përmban kërkesa së bashku me udhëzime përkatëse, në formën e aplikimit dhe materiale të tjera shpjeguese. Terminologjia është në përputhje me terminologjinë e përcaktuar në Kodifikimin e Deklaratave të Standardeve të Auditimit të AICPA-së.<sup>23</sup> Audituesit kanë përgjegjësi të shqyrtojnë të gjithë tekstin e GAGAS kur kryejnë punën e tyre dhe të kuptojnë zbatimin e kërkesave të GAGAS. Jo çdo paragraf i GAGAS mbart një kërkesë që audituesit dhe organizatat e auditimit pritet ta përmbushin. Përkundrazi, kërkesat janë identifikuar përmes përdorimit të gjuhës specifike.

**2.15** GAGAS përdor dy kategori kërkesash, të identifikuara nga kushte specifike, për të përshkruar shkallën e përgjegjësisë që ato imponojnë mbi audituesit dhe organizatat e auditimit, si vijon:

**a. Kërkesat e Pakushtëzuara:** Audituesit dhe organizatat e auditimit duhet të përmbushin kërkesat e pakushtëzuara në të gjitha rastet kur një kërkesë e tillë është e rëndësishme. GAGAS përdor fjalën “duhet/must” për të treguar një kërkesë të pakushtëzuar.

---

<sup>22</sup> Shih paragrafët 3.02 - 3.59 për standardin GAGAS të pavarësisë.

<sup>23</sup> Shih AICPA, AU-C, Seksioni 200, Objektivat e Përgjithshme të Audituesit të Pavarur dhe sjelljen e auditimit në pajtueshmëri me GAGAS.

**Kapitulli 2**  
**Standardet për Përdorimin**  
**Dhe Aplikimin e GAGAS**

---

**b.** <sup>24</sup>*Kërkesat e Prezumuara të Detyrueshme*: Audituesit dhe organizatat e auditimit duhet të përputhen me një kërkesë të prezumuar të detyrueshme në të gjitha rastet kur një kërkesë e tillë është e përshtatshme përveç se në rrethana të rralla të trajtuara në paragrafin 2.16. Në GAGAS përdoret fjala “duhet/should” për të treguar një kërkesë të prezumuar të detyrueshme.

**2.16** Në rrethana të rralla, audituesit dhe organizatat e auditimit mund ta quajnë të nevojshme të shmangen nga një kërkesë e prezumuar e detyrueshme. Në rrethana të tilla të rralla, audituesit duhet të kryejnë procedura alternative për të arritur qëllimin e asaj kërkesë. Nevoja për audituesit që të shmangen nga një kërkesë e tillë lind vetëm kur kërkesa është për një procedurë të veçantë që do duhet të kryhet dhe se, në rrethanat specifike të auditimit, ajo do të jetë e paefektshme në arritjen e qëllimit të kërkesës. Në qoftë se, në rrethana të rralla, audituesit e gjykojnë të nevojshme të shmangen nga një kërkesë e prezumuar e detyrueshme, ata duhet të dokumentojnë arsyetimin e tyre dhe që procedurat alternative të kryera në ato rrethana kanë qenë të mjaftueshme për të arritur qëllimin e asaj kërkesë.

**2.17** Përveç kërkesave të identifikuar në paragrafin 2.15, GAGAS përmbajnë udhëzime lidhur me formën e aplikimit dhe materiale të tjera shpjeguese. Aplikimi dhe materiali tjetër shpjegues japin shpjegime shtesë të kërkesave dhe udhëzimeve për kryerjen e tyre. Në veçanti, ato mund të shpjegojnë më saktësisht çfarë do të thotë një kërkesë ose çfarë ka për qëllim të mbulojë ajo, apo të përfshijë shembuj të procedurave që mund të jenë të përshtatshme për rrethanat. Edhe pse një udhëzim i tillë nuk ka në vetvete për qëllim të imponojë një kërkesë, ato janë të rëndësishëm për zbatimin e duhur të kërkesave. Audituesit duhet të njohin zbatimin dhe materialet e tjera shpjeguese; mënyra se si audituesit e zbatojnë udhëzimin gjatë auditimit varet nga gjykimi profesional në rrethanat në përputhje me objektivin e kërkesës.

---

<sup>24</sup> Shih paragrafin 2.25 për dokumentacion shtesë që shkëputet nga botëkuptimi i kërkesave GAGAS.

**Kapitulli 2**  
**Standardet për Përdorimin**  
**Dhe Aplikimin e GAGAS**

---

Fjalët "të mundesh", "do të mundesh", dhe "mundet" janë përdorur për të përshkruar këto veprime dhe procedura. Aplikimi dhe materialet e tjera shpjeguese mund të sigurojnë informacion mbi çështjet e trajtuara në GAGAS.

**2.18** Audituesit gjithashtu përdorin "publikimet interpretuese" në planifikimin dhe kryerjen e auditimeve GAGAS. Publikimet interpretuese janë rekomandimet për zbatimin e GAGAS në rrethana të veçanta, duke përfshirë auditimet e njëjësive në industri të specializuara. Publikimet interpretuese, si dokumente udhëzuese dhe interpretimet GAGAS, publikohen nga GAO për të ofruar udhëzime shtesë mbi aplikimin e publikimeve GAGAS.<sup>25</sup> Publikimet interpretuese nuk janë të standarde auditimi, por kanë të njëjtin autoritet për sa i përket zbatimit si çdo material tjetër shpjegues i GAGAS.

---

**Marrëdhënia**  
**midis GAGAS**  
**dhe Standardeve**  
**të Tjera**  
**Profesionale**

**2.19** Audituesit mund të përdorin GAGAS njëkohësisht me standardet profesionale të nxjerra nga organet e tjera që kanë këtë autoritet.

**2.20** Marrëdhënia mes GAGAS dhe standardeve të tjera profesionale për auditimet financiare dhe angazhimeve për certifikim është si vijon:

---

<sup>25</sup> Shih <http://www.gao.gov/yellowbook> për një listë GAGAS në lidhje me publikimet interpretuese.

**Kapitulli 2**  
**Standardet për Përdorimin**  
**Dhe Aplikimin e GAGAS**

---

a. AICPA ka vendosur standarde profesionale që zbatohen për auditimet financiare dhe angazhimet për certifikim për ato njësi që nuk e kanë autoritetin të nxjerrin standarde (njësi të tjera janë përcaktuar në Ligjin Sarbanes - Oxley të vitit 2002<sup>26</sup>, dhe janë kompanitë private, njësitë jofitimprurëse dhe organet qeveritare) të kryera nga kontabilistët e certifikuar publikë (CPA). Për auditimet financiare dhe angazhimet për certifikim, GAGAS i përfshin standardet e AICPA-s duke i inkorporuar ato, siç diskutohet në paragrafin 2.08.

b. *Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit dhe Sigurisë (IAASB)* ka vendosur standardet profesionale që zbatohen për auditimet financiare dhe angazhimeve të sigurisë. Audituesit mund të zgjedhin standardet IAASB dhe standardet përkatëse ndërkombëtare të auditimit (SNA) dhe Standardet Ndërkombëtare për Angazhimet e Sigurisë (ISAE) së bashku me GAGAS.

c. *Bordi Mbikëqyrës i Kompanive Publike të Kontabilitetit (PCAOB)* ka vendosur standardet profesionale që zbatohen për auditimet financiare dhe angazhimet për certifikim për publikuesit e standarteve (në përgjithësi, për kompanitë publike tregtare të cilat kanë detyrim raportimin sipas Ligjit të Këmbimit të Letrave me Vlerë i vitit 1934). Audituesit mund të zgjedhin të përdorin standardet PCAOB së bashku me GAGAS.

**2.21** Për auditimet e performancës, GAGAS nuk përfshijnë standarde të tjera duke i inkorporuar ato, por pranojnë se audituesit mund të përdorin ose mund t'iu kërkohet që të përdorin standarde të tjera profesionale së bashku me GAGAS, si në vijim:

---

<sup>26</sup> Shih Ligjin Sarbanes - Oxley 2002 (Ligji Publik 107-204).

**Kapitulli 2**  
**Standardet për Përdorimin**  
**Dhe Aplikimin e GAGAS**

---

- a. *Standardet Ndërkombëtare për Praktikën Profesionale të Auditimit të Brendshëm, Instituti i Audituesve të Brendshëm;*
- b. *Parimet Udhëzuese për Vlerësuesit, Shoqata Amerikane e Vlerësimit;*
- c. *Standardet e Vlerësimit të Programit, Komiteti i Përbashkët për Standardet e Vlerësimit të Edukimit;*
- d. *Standardet për Testimin Arsimor dhe Psikologjik, Shoqata Amerikane e Psikologjisë;*  
*dhe*
- e. *Standardet IT, Udhëzimet, Mjetet dhe Teknikat të Profesionistëve të Auditimit të Sigurisë dhe Kontrollit, ISACA.*

**2.22** Kur audituesit citojnë respektimin e GAGAS dhe të një tjetër grup standardesh, si ato të listuara në paragrafët 2.20 dhe 2.21, ata duhet t'i referohen paragrafit 2.24 për kërkesat duke përmendur përputhshmërinë me GAGAS. Përveç citimit të GAGAS, audituesit mund të përmendin përdorimin e standardeve të tjera në raportet e tyre kur këto pajtohen edhe me kërkesat për përputhshmërinë me standardet e tjera.<sup>27</sup> Audituesit duhet t'i referohen grupit tjetër të standardeve për të cituar përputhshmërinë me këto standarde.

---

Deklarimi i  
Përputhshmërisë  
me GAGAS në  
Raportin e  
Audituesve

**2.23** Kur audituesve u kërkohet të ushtrojnë një auditim sipas GAGAS ose u kërkohet tu tregojnë të tjerëve se auditimi është kryer sipas GAGAS, ata duhet të citojnë në raport përputhshmërinë me GAGAS, sipas përcaktimeve në paragrafët 2.24 dhe 2.25.

---

<sup>27</sup> Shih paragrafët 4.18, 5.19, 5.51, dhe 5.61 për kërkesat shtesë për përputhshmërinë me standardet e AICPA-s.

**Kapitulli 2**  
**Standardet për Përdorimin**  
**Dhe Aplikimin e GAGAS**

---

**2.24** Audituesit duhet të përfshijnë një nga këto lloje Deklaratash të Përputhshmërisë me GAGAS në raportet e tyre sipas rastit.<sup>28</sup>

**a. Deklaratë Përputhshmërie me GAGAS e Pamodifikuar:** e cila deklaron se audituesi ka kryer auditimin në përputhje me GAGAS. Audituesit duhet të përfshijnë një Deklaratë Përputhshmërie me GAGAS të Pamodifikuar në raportin e tyre kur ata kanë (1) ndjekur kërkesat e pakushtëzuara dhe kërkesat e zbatueshme GAGAS të prezumuara të detyrueshme, ose (2) kanë ndjekur kërkesat e pakushtëzuara dhe dokumentuar arsyetimin për çdo shmangie nga kërkesat e prezumuara të detyrueshme të zbatueshme dhe kanë arritur objektivat e këtyre kërkesave me mjete të tjera.

**b. Deklaratë Përputhshmërie me GAGAS e Modifikuar:** e cila përcakton që, ose (1) audituesi ka kryer auditimin në përputhje me GAGAS, me përjashtim të kërkesave të veçanta të zbatueshme, që nuk u ndoqën, ose (2) për shkak të rëndësisë së shmangies nga kërkesat, audituesi nuk ishte në gjendje ta kryente dhe nuk e kreu auditimin në përputhje me GAGAS. Situatat kur audituesit përdorin Deklaratat e Përputhshmërisë me GAGAS të Modifikuara gjithashtu përfshijnë kufizimet e objektit, si kufizime në aksesin në të dhënat, tek zyrtarët qeveritarë, apo individë të tjerë që nevojiten për të kryer auditimin. Kur audituesit përdornin deklaratën e modifikuar, ata duhet të shpjegojnë në raport kërkesat e zbatueshme që nuk kanë ndjekur, arsyet pse, si dhe si ky fakt ka ndikuar, ose mund të ketë ndikuar në auditim dhe në sigurinë e dhënë.

---

<sup>28</sup> Shih paragrafin A2.06 për diskutime shtesë mbi deklaratat e përputhshmërisë me GAGAS.

**Kapitulli 2**  
**Standardet për Përdorimin**  
**Dhe Aplikimin e GAGAS**

---

**2.25** Kur audituesit nuk veprojnë sipas kërkesave të zbatueshme, ata duhet (1) të vlerësojnë rëndësinë e mospërputhjes me objektivat e auditimit, (2) dokumentojnë vlerësimin së bashku me arsyet e mos ndjekjes së kërkesave, dhe (3) të përcaktojnë llojin e Deklaratës së Përputhshmërisë me GAGAS. Vendimi i audituesit ka të bëjë me gjykimin profesional, i cili kushtëzohet nga rëndësia e kërkesës në lidhje me objektivat e auditimit.

---

## Standardet e Përgjithshme

---

### Hyrje

**3.01** Ky kapitull përcakton standardet e përgjithshme dhe ofron udhëzime për kryerjen e auditimeve financiare, angazhimet për certifikim dhe auditimet e performancës sipas GAGAS. Këto standarde të përgjithshme, së bashku me parimet gjithëpërfshirëse etike të paraqitura në kapitullin 1, krijojnë një bazë për besueshmërinë e punës së audituesve. Këto standarde të përgjithshme theksojnë rëndësinë e pavarësisë së organizatës së auditimit dhe audituesit e saj; të ushtrimit të gjyqimit profesional gjatë kryerjes së punës dhe përgatitjes së raporteve; të kompetencës së stafit; dhe të kontrollit dhe sigurimit të cilësisë.

---

### Pavarësia

**3.02** Në të gjitha çështjet që lidhen me punën e auditimit, organizata e auditimit dhe audituesi, qoftë qeveritar apo publik, duhet të jetë i pavarur.

#### **3.03** Pavarësia përfshin:

##### **a.** Pavarësia në fakt

Është gjendja e të menduarit që lejon kryerjen e një auditimi pa u prekur nga ndikimet që komprometojnë gjykimin profesional, duke lejuar një individ të veprojë me integritet dhe të ushtrojë objektivitet dhe skepticizëm profesional.

##### **b.** Pavarësia në dukje

Është mungesa e rrethanave që do të shkaktojnë tek palët e tretë të arsyeshme dhe të informuara, duke pasur njohuri për informacionin përkatës, të arrijë në konkluzionin logjik se integriteti, objektiviteti, ose skepticizmi profesional i një organizate të auditimit ose anëtari të grupit të auditimit është i komprometuar.

**3.04** Audituesit dhe organizatat e auditimit duhet të ruajnë pavarësinë në mënyrë që mendimet, gjetjet, konkluzionet, veprimet dhe rekomandimet e tyre të jenë të paanshme dhe të shihen logjikisht si të paanshme nga palët e treta të informuara.

**Kapitulli 3**  
**Standardet e Përgjithshme**

---

Audituesit duhet të shmangin situata që mund të çojnë palët e treta të informuara në konkluzionin se audituesit nuk janë të pavarur dhe në këtë mënyrë nuk janë të aftë të ushtrojnë gjykim objektiv dhe të paanshëm për të gjitha çështjet që lidhen me kryerjen e auditimit dhe raportimin mbi punën.

**3.05** Me përjashtim të rasteve të kufizuara në paragrafët 3.47 dhe 3.48 audituesit duhet të jenë të pavarur nga një subjekt i audituar gjatë:

**a.** ndonjë periudhë kohore që përputhet me periudhën e mbuluar nga pasqyrat financiare apo çështja në auditim dhe;  
**b.** periudhës së angazhimit profesional, i cili fillon kur audituesit nënshkruajnë një letër angazhimi fillestar apo marrëveshje të tjera për të kryer një auditim ose fillojnë një auditim, cilido që ndodh më herët. Kjo periudhë vazhdon gjatë gjithë kohëzgjatjes së marrëdhënies profesionale (që për auditime të përsëritura mund të mbulojnë shumë periudha) dhe përfundon me njoftimin formal ose joformal, për audituesit apo njësinë e audituar, të ndërprerjes së marrëdhënieve profesionale ose me nxjerrjen e një raporti, cilado që të ndodhë më vonë. Prandaj, periudha e angazhimit profesional jo gjithmonë përfundon me nxjerrjen e një raporti dhe rifillon me nisjen e auditimit të vitit të ardhshëm apo një auditim të mëvonshëm me një objektiv të ngjashëm.

**3.06** Konsideratat praktike të pavarësisë në GAGAS përbëhen nga katër seksione të ndërlidhura, duke siguruar:

**a.** një kuadër konceptual për marrjen e vendimeve të pavarësisë në bazë të fakteve dhe rrethanave që janë shpesh unike në mjedise të veçanta;

**Kapitulli 3**  
**Standardet e Përgjithshme**

---

- b.** kërkesat për dhe udhëzime mbi pavarësinë për organizatat e auditimit që janë të vendosura brenda strukturës së njësisë që ata auditojnë;
- c.** kërkesat për dhe udhëzime për pavarësi për audituesit që kryejnë shërbime joaudituese, duke përfshirë tregues të shërbimeve specifike joaudituese që gjithmonë çenojnë pavarësinë dhe të tjerët që normalisht nuk do të çenojnë pavarësinë;
- dhe
- d.** kërkesat për dhe udhëzime për dokumentacionin e nevojshëm për të mbështetur shqyrtimin e nevojshëm të pavarësisë së audituesit.

---

Përqsaja e  
Kuatit  
Konceptual  
GAGAS  
ndaj Pavarësisë

**3.07** Shumë rrethana të ndryshme, apo kombinime rrethanash, janë të rëndësishme në vlerësimin e kërcënimeve ndaj pavarësisë. Prandaj, GAGAS krijon një kuadër konceptual që audituesit e përdorin për të identifikuar, vlerësuar, dhe zbatuar masa mbrojtëse për të adresuar kërcënimet ndaj pavarësisë.<sup>29</sup> Kuadri konceptual ndihmon audituesit në ruajtjen e pavarësisë në fakt dhe pavarësisë në dukje. Ajo mund të aplikohet në shumë në rrethana të ndryshme që krijojnë kërcënime për pavarësinë dhe lejon audituesit të adresojnë kërcënimet që rezultojnë nga aktivitetet që nuk janë të ndaluara në mënyrë specifike nga GAGAS.

**3.08** Audituesit duhet të zbatojnë kuadrin konceptual në nivelin e organizatës së auditimit dhe në nivel individual për:

- a.** të identifikuar kërcënimet ndaj pavarësisë;
- b.** të vlerësuar rëndësinë e kërcënimeve të identifikuara, si individualisht dhe në total;
- dhe
- c.** të aplikuar masa mbrojtëse të nevojshme për të eliminuar kërcënimet apo për ti reduktuar ato në një nivel të pranueshëm.

---

<sup>29</sup> Shih Shtojcën II për një diagrame për të ndihmuar në zbatimin e kuadrit konceptual për pavarësinë.

**Kapitulli 3**  
**Standardet e Përgjithshme**

---

**3.09** Nëse nuk ka masa mbrojtëse në dispozicion për të eliminuar një kërcënim të papranueshëm ose për ta reduktuar atë në një nivel të pranueshëm, pavarësia do të konsiderohet e dëmtuar.

**3.10** Përdorimi i termit "organizatë e auditimit" në GAGAS është përshkruar në paragrafin 1.07. Për qëllimin e pavarësisë së audituesve, zyrat ose njësitë e një organizate të auditimit, ose njësitë ekonomike të lidhura apo të lidhura nën kontroll të përbashkët, nuk janë të diferencuara nga njëra-tjetra. Rrjedhimisht, për qëllimet e vlerësimit të pavarësisë duke përdorur kuadrin konceptual, një organizatë e auditimit që përfshin shumë zyra apo njësit, ose përfshin shumë njësi të lidhura përmes kontrollit të përbashkët, konsiderohen si një organizatë e auditimi. Pronësia e përbashkët mund të ndikojë edhe pavarësinë në dukje, pavarësisht nga niveli i kontrollit.

**3.11** Seksioni GAGAS mbi shërbimet joaudituese në paragrafët 3.33 – 3.58 ofron kërkesat dhe udhëzimet për vlerësimin e kërcënimeve ndaj pavarësisë në lidhje me shërbimet joaudituese të ofruara nga audituesit për njësitë e audituara. Kjo pjesë gjithashtu përmban shërbime specifike joaudituese që gjithmonë dëmtojnë pavarësinë e audituesit në lidhje me njësitë e audituara dhe që audituesve u ndalohet t'jua ofrojnë njërive e audituara.

**3.12** Seksionet e mëposhtme diskutojnë kërcënimet ndaj pavarësisë, garancitë apo kontrollet për të eliminuar apo reduktuar kërcënimet, si dhe aplikimin e kuadrit konceptual për pavarësinë.

---

**Kapitulli 3**  
**Standardet e Përgjithshme**

---

**Kërcënimet**

**3.13** Kërcënimet ndaj pavarësisë janë rrethana që mund të dëmtojnë pavarësinë. Nëse pavarësia është dëmtuar varet nga natyra e kërcënimit; nëse kërcënimi është i një rëndësie të tillë që mund të kompromentojë gjykimin profesional të audituesit ose të krijojë përshtypjen se gjykimi profesional i audituesit mund të jetë komprometuar; dhe nga garancitë të zbatuara shprehimisht për të eliminuar kërcënimin ose për ta reduktuar atë në një nivel të pranueshëm. Kërcënimet janë kushte që duhet të vlerësohen duke përdorur kuadrin konceptual. Kërcënimet jo gjithmonë e dëmtojnë pavarësinë.

**3.14** Kërcënimet ndaj pavarësisë mund të lindin nga një sërë marrëdhëniesh dhe rrethanash. Audituesit duhet të vlerësojnë këto kategori të gjera kërcënimesh ndaj pavarësisë kur i identifikojnë dhe i vlerësojnë ato:<sup>30</sup>

- a.** Kërcënimi i interesit vetjak - kërcënim që një interes financiar ose i tjetër lloji do të ndikojë në mënyrë të papërshtatshme në gjykimin ose sjelljen e një audituesi;
- b.** Kërcënimi i vetë-ekzaminimit - kërcënim që një organizatë audituese apo auditues që ka ofruar shërbime joaudituese nuk do të vlerësojë siç duhet rezultatet e gjykimeve të mëparshme të bëra ose shërbimeve të kryera si pjesë e shërbimeve joaudituese kur është duke formuar një gjykim të rëndësishëm të një auditimi;
- c.** Kërcënimi i anshmërisë - kërcënimi që një auditues do të marrë një pozicion që nuk është objektiv, si rezultat i bindjeve politike, ideologjike, sociale, apo të tjera;
- d.** Kërcënimi i familjaritetit - kërcënimi që aspektet e një marrëdhënieje me menaxhimin apo personelin e një njësie e të audituar, si p.sh. një marrëdhënie e ngushtë apo e gjatë, ose ajo me një të afërm apo familjar të ngushtë, do ta çojë një auditues të marrë një pozicion që nuk është objektiv;

---

<sup>30</sup> Shih A 3.02 - A3.09 për diskutim dhe shembuj të kërcënimeve të mëtejshëm.

**Kapitulli 3**  
**Standardet e Përgjithshme**

---

- e. Kërcënimi i ndikimit të tepruar - kërcënimi se ndikimet e jashtme apo presionet do të ndikojnë në aftësinë e audituesit për të dhënë gjykime të pavarura dhe objektive;
- f. Kërcënimi i pjesëmarrjes së menaxhimit - kërcënimi që rezulton nga marrja e audituesit të rolit të menaxhimit ose përndryshe kryerja e funksioneve të menaxhimit në emër të njësisë që i nënshtrohet një auditimi; dhe
- g. Kërcënimi strukturor - kërcënimi që vendosja e një organizate audituese brenda një njësie qeveritare, në kombinim me strukturën e njësisë ekonomike qeveritare që auditohet, do të ndikojë në aftësinë e organizatës së auditimit për të kryer punën dhe për të raportuar rezultatet objektivisht.

**3.15** Rrethanat që rezultojnë në një kërcënim ndaj pavarësisë në një nga kategoritë e mësipërme, mund të rezultojnë në kërcënime të tjera. Për shembull, një rrethanë që rezulton në një kërcënim strukturor ndaj pavarësisë mundet gjithashtu të ekspozojë audituesit ndaj ndikimeve të panevojshme dhe kërcënimit të pjesëmarrjes në menaxhim.

**Masat Mbrojtëse**

**3.16** Masat mbrojtëse janë kontrollet e projektuara për të eliminuar ose reduktuar në një nivel të pranueshëm kërcënimet ndaj pavarësisë. Sipas kuadrit konceptual, audituesi aplikon masa mbrojtëse që adresojnë faktet dhe rrethanat në të cilat ndodhin kërcënimet ndaj pavarësisë. Në disa raste, masa mbrojtëse të shumta mund të jenë të nevojshme për të adresuar një kërcënim. Lista e garancive në këtë seksion jep shembuj që mund të jenë efektiv në rrethana të caktuara. Lista nuk mund të sigurojë mbrojtje për të gjitha rrethanat. Megjithatë, kjo mund të sigurojë një listë të masave mbrojtëse që mund t'i eliminojnë këto kërcënime apo t'i reduktojnë ato në një nivel të pranueshëm.

**Kapitulli 3**  
**Standardet e Përgjithshme**

---

**3.17** Shembuj të masave mbrojtëse përfshijnë:

- a. konsultimin me një palë të tretë të pavarur, si një organizatë profesionale, një organ profesional rregullator, ose një auditues tjetër;
- b. përfshirjen e një organizate auditimi tjetër për të kryer ose rikryer pjesë të një auditimi;
- c. përfshirja e një anëtari të stafit profesional, i cili nuk është një anëtar i grupit të auditimit, për të shqyrtuar punën e kryer; dhe
- d. heqja e një individi nga një grup auditimi kur interesat financiare apo interesa të tjera ose marrëdhëniet e atij individi përbëjnë një kërcënim për pavarësinë.

**3.18** Në varësi nga natyra e auditimit, një auditues mund të jetë në gjendje të vendosë besim të kufizuar në masat mbrojtëse që njësia ekonomike ka zbatuar. Nuk është e mundur që të mbështetesh vetëm në masa mbrojtëse të tilla për të eliminuar kërcënimet apo t'i reduktuar ato në një nivel të pranueshëm.

**3.19** Shembuj të masave mbrojtëse brenda sistemeve dhe procedurave të njësisë ekonomike përfshijnë:

- a. kërkesa e një njësie ekonomike që persona të tjerë, ndryshe nga menaxhimi të ratifikojnë ose miratojnë caktimin e një organizate auditimi për të kryer një auditim;
- b. procedurat e brendshme në njësinë ekonomike që sigurojnë zgjedhje objektive në dhënien e shërbimeve joaudituese; dhe
- c. një strukturë qeverisjeje në njësinë ekonomike që ofron mbikëqyrje dhe komunikim të përshtatshëm në lidhje me shërbimet e organizatës audituese.

**Kapitulli 3**  
**Standardet e Përgjithshme**

---

**Zbatimi i Kuadrit  
Konceptual**

**3.20** Audituesit duhet të vlerësojnë kërcënimet ndaj pavarësisë duke përdorur kuadrin konceptual kur faktet dhe rrethanat nën të cilat ata kryejnë punën e tyre mund të krijojnë ose shtojnë kërcënime të pavarësisë. Audituesit duhet të vlerësojnë kërcënimet individualisht dhe në tërësi sepse kërcënimet mund të kenë një efekt të grumbulluar mbi pavarësinë e audituesit.

**3.21** Faktet dhe rrethanat që krijojnë kërcënime ndaj pavarësisë mund të rezultojnë nga ngjarje si fillimi i një auditimi të ri; caktimi i stafit të ri në një auditim në vijim; dhe pranimi i një shërbimi joauditues në një njësi të audituar. Shumë ngjarje të tjera mund të rezultojnë në kërcënime ndaj pavarësisë. Audituesit përdorin gjykimin profesional për të përcaktuar nëse faktet dhe rrethanat e krijuara nga një ngjarje justifikojnë përdorimin e duhur të kuadrit konceptual. Sa herë që informacion përkatësisht i ri në lidhje me një kërcënim ndaj pavarësisë vjen në vëmendjen e audituesit gjatë auditimit, audituesi duhet të vlerësojë rëndësinë e kërcënimit, në përputhje me kuadrin konceptual.

**3.22** Audituesit duhet të përcaktojnë nëse kërcënimet e identifikuar ndaj pavarësisë janë në nivel të pranueshëm ose janë eliminuar apo reduktuar në një nivel të pranueshëm. Një kërcënim ndaj pavarësisë nuk është i pranueshëm nëse ai (a) mund të ndikojë në aftësinë e audituesit për të bërë auditim pa u prekur nga ndikimet që komprometojnë gjykimin profesional ose (b) mund të ekspozojë audituesit apo organizatën e auditimit në rrethana që logjikisht do të çonin një palë të tretë të informuar të besonte se integriteti, objektiviteti, ose skepticizmi profesional i organizatës së auditimit, ose i një anëtarit të grupit të auditimit, është komprometuar.

**3.23** Kur një auditues identifikon kërcënimet ndaj pavarësisë dhe, bazuar në një vlerësim të këtyre kërcënimeve, konstaton se ato nuk janë në nivel të pranueshëm, audituesi duhet të përcaktojë nëse ka masa mbrojtëse të përshtatshme dhe nëse ato mund të aplikohen për të eliminuar kërcënimet

**Kapitulli 3**  
**Standardet e Përgjithshme**

---

apo reduktuar ato në një nivel të pranueshëm. Audituesi duhet të ushtrojë gjykimin profesional kur bën këtë përcaktim dhe duhet të marrë parasysh nëse është ruajtur pavarësia në fakt dhe pavarësia në dukje. Audituesi duhet të vlerësojë faktorët sasiorë dhe cilësorë kur përcakton rëndësinë e një kërcënimi.

**3.24** Në rastet kur kërcënimet ndaj pavarësisë nuk janë në nivel të pranueshëm, duke kërkuar zbatimin e masave mbrojtëse, audituesit duhet të dokumentojnë kërcënimet e identifikuar dhe masat mbrojtëse të zbatuara për të eliminuar kërcënimet apo për t'i reduktuar ato në një nivel të pranueshëm.

**3.25** Disa situata mund të sjellin kërcënime që janë aq të rëndësishme saqë nuk mund të eliminohen ose reduktohen në një nivel të pranueshëm me zbatimin e masave mbrojtëse, duke rezultuar në pavarësi të dëmtuar. Në kushte të tilla, audituesit duhet të refuzojnë të kryejnë një auditim të ardhshëm ose të përfundojnë një auditim në vazhdim.<sup>31</sup>

**3.26** Nëse një kërcënim për pavarësinë identifikohet për herë të parë pas publikimit të raportit, audituesi duhet të vlerësojë ndikimin e kërcënimit mbi auditimin dhe me përputhshmërinë me GAGAS. Nëse audituesit përcaktojnë se kërcënimi i sapo identifikuar ka pasur një ndikim në auditim, i cili do të kishte rezultuar në një raport tjetër të ndryshëm nga raporti i publikuar, po të kishin qenë të vetëdijshëm për këtë kërcënim, ata duhet të komunikojnë në të njëjtën mënyrë siç veprohet për raportin e publikuar fillimisht, duke njoftuar personat e ngarkuar me qeverisje, zyrtarët përkatës të njësisë së audituar, zyrtarët përkatës të organizatave që kërkojnë ose që planifikojnë auditime, dhe përdorues të tjerë të njohur, që ata

---

<sup>31</sup> Shih paragrafin 3.44 për një diskutim të kushteve nën të cilat një audituesi mund t'i kërkojë me ligj ose rregullore të kryej edhe një auditim dhe një shërbim joauditues dhe nuk mund të refuzojë të kryejë ose përfundojë shërbimin. Shih diskutimin e shërbimeve joaudituese duke filluar në paragrafin 3.45 për shqyrtimin e kërcënimeve në lidhje me shërbimet joaudituese që nuk mund të eliminohen ose të reduktuara në nivel të duhur.

---

**Kapitulli 3**  
**Standardet e Përgjithshme**

---

mos të mbështeten në rezultatet apo përfundimet që janë ndikuar nga kërcënimi ndaj pavarësisë. Nëse raporti është i publikuar që më parë në faqen e internetit, audituesit duhet ta tërheqin atë dhe të shtojnë një njoftim publik se raporti është tërhequr. Audituesit duhet të përcaktojnë nëse është e nevojshme kryerja e një pune audituese shtesë për të ribotuar raportin, duke përfshirë në të çdo gjetje apo konkluzion të rishikuar, ose duhet të ripublikojnë raportin origjinal në qoftë se puna shtesë audituese nuk rezulton në një ndryshim në gjetje apo konkluzione.

---

Audituesit e  
Qeverisë  
dhe Struktura  
Organizative e  
Auditimit

**3.27** Aftësia e organizatave të auditimit në njësitë qeveritare për të kryer punë dhe raportuar rezultatet në mënyrë objektive mund të çenohet nga vendosja e saj brenda qeverisë dhe strukturës së njësisë ekonomike të qeverisë që auditohet. Standardi i pavarësisë zbatohet për audituesit në subjektet qeveritare kur ata i raportojnë palëve të treta (audituesit e jashtëm), ose menaxhimit të lartë në kuadër të njësisë të audituar (audituesi i brendshëm), ose për të dyja rastet.

Pavarësia e  
Audituesit të  
Jashtëm

**3.28** Organizatat e auditimit që janë të vendosura brenda strukturës organizative të njësisë qeveritare janë shpesh njësi garancive kushtetuese ose ligjore që zbutin efektet e kërcënimeve strukturore të pavarësisë. Për organizatat e auditimit të jashtëm, masa mbrojtëse të tilla mund të përfshijnë struktura qeveritare, sipas të cilave një organizatë auditimi e qeverisë është:

- a.** në një nivel të qeverisë të ndryshëm nga ajo njësi së audituar (federal, shtetëror ose lokal); për shembull, audituesit federal që auditojnë një program qeveritar në nivel shtetëror; ose
- b.** vendosur brenda një dege tjetër të qeverisë ndryshe nga ajo e njësisë së audituar; për shembull, audituesit legjislativ kur auditojnë një program të degës ekzekutive.

**Kapitulli 3**  
**Standardet e Përgjithshme**

---

**3.29** Masat mbrojtëse përveç atyre të përshkruara më sipër mund të zbusin kërcënimet që rezultojnë nga strukturat qeveritare. Për audituesit e jashtëm apo audituesit që raportojnë si jashtë dhe brenda organizatës, kërcënimet strukturore mund të zbuten në qoftë se kreu i një organizate të auditimit plotëson cilindo nga kriteret e mëposhtme në përputhje me kërkesat kushtetuese ose statutore:

**a.** zgjidhet drejtpërdrejt nga zgjedhësit e juridiksionit që auditohet;

**b.** është i zgjedhur ose i emëruar nga një organ legjislativ dhe i nënshtrohet shkarkimit nga një organ legjislativ, si dhe raporton rezultatet e auditimeve tek dhe është i përgjegjshëm ndaj një organi legjislativ;

**c.** është i emëruar nga dikush tjetër përveç një organi legjislativ, për sa kohë që emërimi është konfirmuar nga një organ legjislativ dhe shkarkimi nga pozicioni i nënshtrohet mbikëqyrjes ose miratimit nga një organ legjislativ, dhe raporton rezultatet e auditimeve te dhe është i përgjegjshëm ndaj një organi legjislativ;  
ose

**d.** është i emëruar nga, jep llogari, raporton, dhe mund të hiqet vetëm nga një organ i krijuar me ligj, shumica e anëtarëve të të cilit zgjidhet në mënyrë të pavarur ose janë të emëruar dhe janë jashtë organizatës që auditohet.

**3.30** Përveç kriterëve në paragrafët 3.28 dhe 3.29, GAGAS pranon se mund të ketë struktura të tjera organizative në të cilat organizatat e auditimit të jashtëm në subjektet qeveritare mund të konsiderohen të pavarur. Nëse hartohen dhe zbatohen në mënyrë të përshtatshme, këto struktura ofrojnë masa mbrojtëse që pengojnë njësinë e audituar të ndërhyjë me aftësinë e organizatës së auditimit për të kryer punën dhe raportuar rezultatet në mënyrë të paanshme. Për një organizatë të jashtme të auditimit ose e tillë që raporton si jashtë dhe brenda që të quhet e pavarur nën një strukturë ndryshme nga ato të listuara në paragrafët 3.28 dhe 3.29, organizata e

**Kapitulli 3**  
**Standardet e Përgjithshme**

---

auditimit duhet të ketë të gjitha masat mbrojtëse të mëposhtme. Në situata të tilla, organizata e auditimit duhet të dokumentojë që secila nga garancitë e mëposhtme përmbushet dhe t'u sigurojë dokumentacionin atyre që kryejnë monitorimin e kontrollit të cilësisë dhe inspektorëve homologë të jashtëm për të përcaktuar nëse të gjitha garancitë e nevojshme ekzistojnë. Masat mbrojtëse të mëposhtme mund të përdoren gjithashtu për të shtuar ato të listuara në paragrafët 3.28 dhe 3.29:

- a.** Mbrojtjet ligjore që parandalojnë njësinë e audituar nga shkrirja e organizatës së auditimit;
- b.** Mbrojtjet ligjore që kërkojnë që në qoftë se kreu i organizatës së auditimit është larguar nga detyra, kreu i agjencisë raporton këtë fakt dhe arsyet e largimit tek organi legjislativ;
- c.** Mbrojtjet ligjore që pengojnë njësinë e audituar të ndërhyjë tek fillimi, fushëveprimi, koha dhe përfundimi i çdo auditimi;
- d.** Mbrojtjet ligjore që pengojnë njësinë e audituar të ndërhyjë tek raporti i auditimit, duke përfshirë gjetjet dhe konkluzionet apo mënyrën, mjetet ose kohën e raporteve të organizatës së auditimit;
- e.** Mbrojtjet ligjore që i kërkojnë organizatës së auditimit të raportojë te një organ legjislativ apo organ tjetër qeveritar të pavarur mbi një bazë përsëritëse;
- f.** Mbrojtjet ligjore që i japin autoritetin e vetëm organizatës së auditimit mbi zgjedhjen, ruajtjen, zhvillimin e karrierës , dhe shkarkimin e stafit të saj;  
dhe

**Kapitulli 3**  
**Standardet e Përgjithshme**

---

**g.** Qasje staturore për të dhënat dhe dokumentet që lidhen me agjenci, programe, apo funksione që auditohen dhe qasje zyrtarëve të qeverisë apo individëve të tjerë që janë të nevojshëm për të kryer auditimin.

Pavarësia e  
Audituesit të  
Brendshëm

**3.31** Disa njësi punësojnë audituesit për të punuar për menaxhimin e njësisë. Këta auditues mund t'i nënshtrohen drejtimit administrativ nga personat e përfshirë në procesin e menaxhimit të njësisë. Organizata të tilla të auditimit janë funksionet e auditimit të brendshëm dhe nxiten nga Instituti i Audituesve të Brendshëm (IIA) të përdorin Standardet Ndërkombëtare për Praktikën Profesionale të Auditimit të Brendshëm së bashku me GAGAS. Në përputhje me GAGAS, audituesit e brendshëm të cilët punojnë nën drejtimin e menaxhimit të njësisë së audituar konsiderohen të pavarur për qëllime të raportimit të brendshëm nëse kreu i organizatës së auditimit plotëson të gjitha kriteret e mëposhtme:

- a.** varet nga titullari apo zëvendës titullari i organit qeveritar apo të ngarkuarve me qeverisjen;
- b.** raporton rezultatet e auditimit tek dy titullarë të njësisë ekonomike të qeverisë dhe tek të ngarkuarit me qeverisjen;
- c.** nga ana organizative është i vendosur jashtë stafit apo linjës së menaxhimit të njësisë nën auditim;
- d.** ka qasje tek ata që janë të ngarkuarit me qeverisjen; dhe
- e.** është i mbrojtur në mënyrë të mjaftueshme nga presionet politike për të kryer auditime dhe për të raportuar gjetjet, opinionet dhe konkluzionet objektivisht pa frikë hakmarrjeje politike.

**3.32** Kur organizatat e auditimit të brendshëm kryejnë auditime të palëve të jashtme, si auditime të kontraktuesve të auditimit ose të marrëveshjeve me palë të treta, dhe nuk ka dëmtime të pavarësisë organizata e auditimit mund të

---

**Kapitulli 3**  
**Standardet e Përgjithshme**

---

konsiderohet e pavarur sikurse një organizatë e jashtme e auditimit të këtyre palëve të treta.

---

Ofrimi i  
Shërbimeve  
Joaudituese në  
Subjektet e  
Audituara

**3.33** Audituesit kanë dhënë tradicionalisht një gamë shërbimesh joaudituese për njësitë në të cilat ata kryejnë auditime, që janë në përputhje me aftësitë dhe ekspertizën e tyre. Ofrimi i shërbimeve të tilla joaudituese mund të krijojë kërcënime për pavarësinë e audituesit.

Kërkesat për  
Kryerjen e  
Shërbimeve  
Joaudituese

**3.34** Para se një auditues të pranojë që të ofrojë një shërbim joauditues ndaj një njësie të audituar, audituesi duhet të përcaktojë nëse ofrimi i një shërbimi të tillë do të krijonte një kërcënim për pavarësinë, vetëm ose së bashku me shërbimet e tjera joaudituese të ofruara, në lidhje me ndonjë auditim GAGAS që ai po kryen. Një komponent i rëndësishëm i këtij përcaktimi është konsiderimi i aftësisë së drejtimit për të mbikëqyrur efektivisht shërbimin joauditues që duhet të kryhet. Audituesi duhet të përcaktojë se njësia i audituar ka caktuar një individ i cili zotëron aftësi të përshtatshme, njohuri, ose përvojë, dhe se individ i njej shërbimet që do të kryhen në mënyrë të mjaftueshme për t'i mbikëqyrur ato. Individu nuk është e nevojshme të zotërojë ekspertizën e nevojshme për të kryer ose ri kryer shërbimet. Audituesi duhet të dokumentojë aftësinë e drejtimit për të mbikëqyrur në mënyrë efektive shërbimet joaudituese që duhet të kryhen.

**3.35** Nëse një auditues do të marrë përgjegjësitë e menaxhimit të një njësie të audituar, risku i menaxhimit i krijuar nga pjesëmarrja do të jetë aq i rëndësishëm sa që nuk ka masa mbrojtëse që mund të zvogëlojnë riskun në një nivel të pranueshëm. Përgjegjësitë e menaxhimit përfshijë, kryesimin dhe drejtimin e një njësie ekonomike, duke përfshirë marrjen e vendimeve në lidhje me blerjen, vendosjen dhe kontrollin njerëzor, financiar, fizik, dhe burimet e paprekshme.

**Kapitulli 3**  
**Standardet e Përgjithshme**

---

**3.36** Nëse një veprimtari është një përgjegjësi e menaxhimit, kjo varet nga faktet dhe rrethanat, dhe audituesi ushtron gjykimin profesional në identifikimin e këtyre veprimtarive. Shembuj të aktiviteteve që konsiderohen përgjegjësi e menaxhimit dhe për këtë arsye do të çënojnë pavarësinë nëse kryhen për një subjekt të audituar përfshijnë:

- a.** vendosjen e politikave dhe drejtimin strategjik për njësinë ekonomike të audituar;
- b.** drejtimi dhe pranimi i përgjegjësiëve për veprimet e punonjësve të njësisë ekonomike të audituar në performancën e tyre rutinë, të përsëritur të aktiviteteve;
- c.** mbajtja e kujdestarisë së aseteve të një njësie ekonomike të audituar;
- d.** raportimi ndaj të ngarkuarve me qeverisjen në emër të menaxhimit;
- e.** vendimmarrja se cilat nga rekomandimet e audituesit apo e një pale të tretë të jashtme do të zbatohen;
- f.** pranimi i përgjegjësisë për menaxhimin e projektit të një njësie ekonomike të auditimit;
- g.** pranimi i përgjegjësisë për hartimin, zbatimin, ose mbajtjen e kontrollit të brendshëm;
- h.** ofrimi i shërbimeve që kanë për qëllim të përdoren si bazë kryesore nga menaxhimi për marrjen e vendimeve që janë të rëndësishme për çështjet e auditimit;
- i.** zhvillimi i sistemit të matjes së performancës të një njësie ekonomike të audituar kur sistemi është material apo i rëndësishëm për objektin e auditimit; dhe
- j.** të qenit anëtar me të drejtë vote i komitetit drejtues të një njësie ekonomike të audituar ose bordit të drejtorëve.

**Kapitulli 3**  
**Standardet e Përgjithshme**

---

**3.37** Audituesit që kryejnë shërbime joaudituese për subjektet për të cilat ata kryejnë auditime duhet të sigurohen që menaxhimi i njësisë të audituar kryen funksionet e mëposhtme në lidhje me shërbimet joaudituese:

- a. merr të gjitha përgjegjësitë e menaxhimit;
- b. mbikëqyr shërbimet, duke përcaktuar një individ, mundësisht brenda menaxhimit të lartë, i cili zotëron aftësi të përshtatshme, njohuri, ose përvojë;<sup>32</sup>
- c. vlerëson rezultatet e shërbimeve të kryera dhe përshtatshmërinë;  
dhe
- d. pranon përgjegjësinë për rezultatet e shërbimeve.

**3.38** Në rastet kur njësia i audituar nuk është në gjendje apo nuk është i gatshëm për të marrë përsipër këto përgjegjësi (për shembull, njësia e audituar nuk ka një individ me aftësi të përshtatshme, njohuritë, ose përvojë për të mbikëqyrur shërbimet joaudituese, ose nuk është i gatshëm për të kryer funksione të tilla për shkak të mungesës së kohës apo dëshirës), ofrimi i audituesit për këto shërbime do të dëmtonte pavarësinë.

**3.39** Në lidhje me shërbimet joaudituese, audituesit duhet të krijojnë dhe të dokumentojnë njohjen e tyre me menaxhimin e njësisë të audituar ose të ngarkuar me qeverisje, sipas rastit, në lidhje me sa më poshtë:

- a. Objektivat e shërbimit joauditues;
- b. Shërbimet që do të kryhen;
- c. Pranimi i përgjegjësive nga subjektet e audituara;
- d. Përgjegjësitë e audituesit;  
dhe
- e. Çdo kufizim i shërbimit joauditues.

---

<sup>32</sup> Shih paragrafin 3,34 për diskutim shtesë të aftësisë së drejtimit për të mbikëqyrur efektivisht shërbimin joauditues.

**Kapitulli 3**  
**Standardet e Përgjithshme**

---

**3.40** Aktivitetet rutinë të kryera nga audituesit që kanë të bëjnë drejtpërdrejt me kryerjen e një auditimi, si ofrimi i këshillave dhe iu përgjigjur pyetjeve si pjesë e një auditimi, nuk konsiderohen shërbimet joaudituese sipas GAGAS. Aktivitete të tilla rutinë përgjithësisht përfshijnë ofrimin e këshillave ose ndihmës për njësinë ekonomike në mënyrë joformale, si pjesë e një auditimi. Aktivitetet rutinë në mënyrë tipike janë të parëndësishme në aspektin e kohës apo burimeve të shpenzuara dhe përgjithësisht nuk rezultojnë në një projekt apo angazhim specifik apo prodhimin e një raport formal ose produkti tjetër formal të punës. Megjithatë shërbimet dhe aktivitetet si përgatitja e pasqyrave financiare, e mjeteve monetare për konvertimet sipas parimit aktual dhe e harmonizimeve konsiderohen joaudituese sipas GAGAS. Aktivitetet jo rutinë që kanë të bëjnë me kryerjen e një auditimi vlerësohen duke përdorur kuadrin konceptual të trajtuar në paragrafin 3.46 më poshtë.

**3.41** Aktivitetet rutinë të lidhura drejtpërdrejt me një auditim përfshijnë:

- a. ofrimin e këshillave ndaj njësisë së audituar për një çështje të kontabilitetit si pjesë ndihmëse e auditimit financiar në përgjithësi;
- b. hulumtimin dhe përgjigjen ndaj pyetjeve teknike të njësisë së audituar për ligjet mbi taksat si pjesë ndihmëse e sigurimit të shërbimeve tatimore;
- c. ofrimin e këshillave ndaj njësisë të audituar për çështje rutinë të biznesit;
- d. edukimin e njësisë të audituar për çështje në kuadër të ekspertizës teknike të audituesve;  
dhe
- e. sigurimin e informacionit ndaj njësisë të audituar që është në dispozicion të audituesve, si praktikat më të mira dhe studimet të tjera për krahasim.

**Kapitulli 3**  
**Standardet e Përgjithshme**

---

**3.42** Një auditues i cili më parë ka kryer shërbime joaudituese për një njësi që është një subjekt i ardhshëm i auditimit duhet të vlerësojë ndikimin e të tilla shërbimeve joaudituese mbi pavarësinë para se të pranojë një auditim. Nëse shërbimet joaudituese janë kryer në periudhën që do të mbulohet nga auditimi, audituesi duhet (1) të përcaktojë nëse shërbimi joauditues ndalohet shprehimisht nga GAGAS dhe, në qoftë se jo, (2) të përcaktojë nëse ekziston një kërcënim për pavarësinë dhe adresuar çdo kërcënim në përputhje me kuadrin konceptual.

**3.43** Shërbimet joaudituese të ofruara nga audituesit mund të ndikojnë në pavarësinë në fakt dhe në dukje në periudhat e mëvonshme pas asaj në të cilën është siguruar shërbimi joauditues. Për shembull, në qoftë se audituesit kanë projektuar dhe zbatuar një sistem kontabiliteti dhe raportimi financiar që pritet të përdoret për shumë vite, mund të ekzistojë një kërcënim për pavarësinë në dukje të auditimeve financiare ose angazhimeve për certifikim ardhshme të kryera nga këta auditues në periudha të mëvonshme. Për auditime të përsëritura, pasja e një organizate të pavarur auditimi që të kryen auditimin e fushave të prekura nga shërbimi joauditues mund të sigurojë një mbrojtje që lejon organizatën e auditimit që ka dhënë shërbimin joauditues të zbusë kërcënim ndaj pavarësisë së saj. Audituesit përdorin gjykimin profesional për të përcaktuar nëse masat mbrojtëse zbusin në mënyrë të përshtatshme kërcënimet.

**3.44** Një audituesi në një njësi qeveritare mund t'i kërkohet të kryejë një shërbim joauditues që mund të rrezikojë pavarësinë e tij në lidhje me një auditim të kërkuar. Nëse audituesi nuk mund, si pasojë e kërkesave kushtetuese apo ligjore mbi të cilën audituesi nuk ka kontroll, të zbatojë masa mbrojtëse për të zvogëluar në një nivel të pranueshëm kërcënimin që rezulton, ose të refuzojë të kryej ose të përfundojë një shërbim joauditues që është i papajtueshëm me përgjegjësitë e auditimit, audituesi duhet të japë informacione shpjeguese për natyrën e kërcënimin që nuk

---

**Kapitulli 3**  
**Standardet e Përgjithshme**

---

mund të eliminohet ose të reduktohet në një nivel të pranueshëm dhe të modifikojë këtë deklaratë përputhshmërie me GAGAS në përputhje me rrethanat.<sup>33</sup>

---

Marrja në  
Konsideratë  
e Shërbimeve të  
Veçanta  
Joaudituese

**3.45** Nga natyra e tyre, shërbime të caktuara joaudituese mbështesin drejtpërdrejt operacionet e njësisë ekonomike dhe pengojnë aftësinë e audituesve për të ruajtur pavarësinë në fakt dhe në dukje. Shërbimet joaudituese të trajtuara më poshtë janë ndër ato të kërkuara shpesh ndaj audituesve që punojnë në një mjedis qeveritar. Disa aspekte të këtyre shërbimeve pengojnë aftësinë e audituesit për të kryer auditime në subjektet për të cilat shërbimet janë ofruar. Shërbimet e veçanta nuk janë të vetmet shërbime joaudituese që mund të dëmtojnë pavarësinë e një audituesi.

**3.46** Audituesit mund të jenë në gjendje të ofrojnë shërbime joaudituese në fusha të gjera të treguara në paragrafët 3.49 - 3.58 pa dëmtuar pavarësinë në qoftë se (1) shërbimet joaudituese nuk janë të ndaluara shprehimisht, (2) audituesi ka konstatuar se kërkesat për kryerjen e shërbimeve joaudituese në paragrafët 3.34 – 3.44 janë plotësuar, dhe (3) çdo kërcënim i rëndësishëm për pavarësinë është eliminuar ose reduktuar në një nivel të pranueshëm falë aplikimit të masave mbrojtëse. Audituesit duhet të përdorin kuadrin konceptual për të vlerësuar pavarësinë duke pasur parasysh faktet dhe rrethanat e shërbimeve individuale që nuk janë të ndaluara në mënyrë specifike në këtë seksion.

**3.47** Për auditimet e performancës dhe angazhimet për procedurat e pranuar, shërbimet joaudituese që janë të ndaluara nga GAGAS, mund të ofrohen kur këto shërbime nuk kanë të bëjnë me objektin e angazhimit.

---

<sup>33</sup> Shih paragrafët 2.24 dhe 2.25 për diskutimin e modifikimit e deklaratës së përputhshmërisë me GAGAS.

**Kapitulli 3**  
**Standardet e Përgjithshme**

---

**3.48** Për auditimet e pasqyrave financiare dhe angazhimeve të ekzaminimit apo shqyrtimit, një shërbim joauditues i kryer gjatë periudhës që mbulojnë pasqyrat financiare nuk mund të pengojë pavarësinë e një audituesi në lidhje me këto pasqyra financiare, nëse ekzistojnë kushtet e mëposhtme:

**a.** shërbimi joauditues është ofruar para periudhës së angazhimit profesional;

**b.** shërbim joauditues lidhet vetëm me periudhat para periudhës së mbuluar nga pasqyrat financiare;  
dhe

**c.** pasqyrat financiare për periudhën me të cilën shërbimi joauditues është i lidhur janë audituar nga një auditues tjetër (ose në rastin e një angazhimi ekzaminimi apo rishikimi, të shqyrtuar, rishikuar, apo audituar nga një auditues tjetër sipas rastit).

Përgjegjësitë e  
Menaxhimit

**3.49** Nëse kryhet në emër të një njësie të audituar nga audituesi i njësisë, përgjegjësitë menaxhimit të njësisë ekonomike si ato të listuara në paragrafin 3.36 do të krijonin kërcënime të pjesëmarrjes së menaxhimit aq të rëndësishme saqë asnjë masë mbrojtjeje nuk do të mund ti zvogëlonte ato në një nivel të pranueshëm. Si pasojë pavarësia e audituesit në lidhje me atë njësi do të jetë e dëmtuar.

Përgatitja e  
Evidencave  
Kontabël dhe  
Pasqyrave  
Financiare

**3.50** Disa shërbime që përfshijnë përgatitjen e regjistrave kontabël gjithmonë dëmtojnë pavarësinë e një audituesi në lidhje me një njësi të audituar. Këto shërbime përfshijnë:

**a.** vendosjen ose ndryshimin e regjistrimeve në ditar, kodet e llogarive apo sqarime për transaksionet, apo të dhënave të tjera të kontabilitetit për njësinë ekonomike pa marrë miratimin e menaxhimit;

**Kapitulli 3**  
**Standardet e Përgjithshme**

---

**b.** autorizimin ose miratimin e transaksioneve të njësisë ekonomike;  
dhe

**c.** përgatitjen ose ndryshimet në dokumentet burim pa miratimin e menaxhimit. Dokumentacioni burimor përfshin ato dokumente që japin prova të kryerjes të transaksioneve (për shembull, urdhrat e blerjes, të dhënat kohore mbi pagat, porositë e konsumatorëve dhe kontratat). Regjistrime të tilla përfshijnë gjithashtu Librin e Madh të një njësie ekonomike të audituar dhe të dhënat plotësuese ose ekuivalente.

**3.51** Menaxhimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar, edhe në qoftë se audituesi ka ndihmuar në hartimin e këtyre pasqyrave financiare. Si pasojë, pranimi nga ana e audituesit i përgjegjësisë për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare që më pas ai do të auditojë, dëmton pavarësinë e tij.

**3.52** Shërbimet lidhur me përgatitjen e llogarive të kontabilitetit dhe pasqyrat financiare, që audituesi mund të jetë në gjendje t'ia ofrojë një njësie të audituar, nëse kushtet në paragrafin 3.46 plotësohen, përfshijnë:

**a.** regjistrimin e transaksioneve për të cilin është i përcaktuar ose i miratuar klasifikimi i duhur i llogarisë, ose postimi i transaksioneve të koduar në Librin e Madh të njësisë ekonomike të audituar;

**b.** përgatitjen e pasqyrave financiare në bazë të informacionit në bilancin vërtetues;

**c.** postimi i regjistrimeve të aprovuara nga drejtuesit e njësisë ekonomike të audituar në bilancin vërtetues të njësisë ekonomike;

**Kapitulli 3**  
**Standardet e Përgjithshme**

---

**d.** përgatitja e rakordimit të llogarive që identifikojnë artikuj për vlerësimin e menaxhimit të njësisë të audituar; dhe

**e.** propozimin e standardeve, rregullimin, ose korrigjimin e regjistrimeve në ditar apo ndryshime të tjera që ndikojnë në pasqyrat financiare të menaxhimit me kusht që rishikimet e menaxhimit të një njësie ekonomike të audituar janë pranuar dhe audituesi është i bindur që menaxhimi kupton natyrën e shënimeve të propozuara dhe ndikimin e këtyre shënimeve tek pasqyrat financiare.

Shërbimet e Asistencës së Auditimit të Brendshëm të Ofruara nga Audituesit e Jashtëm

**3.53** Shërbimet e asistencës së auditimit të brendshëm kanë të bëjnë me ndihmën ndaj një njësie ekonomike për kryerjen e veprimtarive të auditimit të brendshëm të saj. Disa aktivitete të asistencës së auditimit të brendshëm gjithmonë dëmtojnë pavarësinë e një audituesi të jashtëm në lidhje me një subjekt të audituar. Këto aktivitete përfshijnë:

**a.** vendosjen e politikave të auditimit të brendshëm ose drejtimit strategjik të aktiviteteve të auditimit të brendshëm;

**b.** kryerjen e procedurave që formojnë pjesë të kontrollit të brendshëm, si shqyrtimi dhe miratimi ndryshimeve në preferencat e qasjes së të dhënave të punonjësve; dhe

**c.** përcaktimin e fushëveprimit të funksionit të auditimit të brendshëm dhe rezultatet e punës.

Monitorimi i Kontrollit të Brendshëm si një Shërbim Joauditues

**3.54** Pranimi i përgjegjësisë për hartimin, zbatimin ose mbajtjen e kontrollit të brendshëm përfshin pranimin e përgjegjësisë për hartimin, zbatimin, ose mbajtjen e monitorimit të procedurës.<sup>34</sup> Monitorimi përfshin përdorimin e procedurave të vazhdueshme të monitorimit apo vlerësimeve të veçanta për të mbledhur dhe analizuar informacionin bindës dhe konkluzione mbështetëse për efikasitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm.

---

<sup>34</sup> Shih A.03 dhe A.04 për një diskutim të kontrollit të brendshëm.

**Kapitulli 3**  
**Standardet e Përgjithshme**

---

Procedurat e vazhdueshme të monitorimit të kryera në emër të menaxhimit janë ndërtuar mbi aktivitet rutinë dhe operacione të përsëritura të një organizate. Prandaj, kërcënimi i pjesëmarrjes së menaxhimit që krijohet nëse një auditues kryen apo mbikëqyr procedurat e vazhdueshme të monitorimit është aq i rëndësishëm saqë asnjë masë mbrojtje nuk mund të zvogëlojë kërcënimin në një nivel të pranueshëm.

**3.55** Vlerësime të veçanta kryen ndonjëherë si shërbime joaudituese nga individë të cilët nuk janë të përfshirë drejtpërdrejt në funksionimin e kontrolleve që po monitorohen. Është e mundur për një auditues të ofrojë një analizë objektive të efektivitetit të kontrollit duke kryer vlerësime të veçanta, pa krijuar një kërcënim të pjesëmarrjes së menaxhimit që do të rrezikojë pavarësinë. Megjithatë, në të gjitha rastet e tilla, rëndësia e kërcënimit të krijuar duke kryer vlerësime të veçanta duhet të vlerësohen dhe masat mbrojtëse të aplikohen kur është e nevojshme për të eliminuar kërcënimin ose për ta reduktuar atë në një nivel të pranueshëm. Audituesit duhet të vlerësojnë shpeshtësinë e vlerësimeve të veçanta, si dhe fushëveprimin ose shtrirjen e kontrolleve (në lidhje me fushëveprimin e auditimit të kryer) që testohen kur vlerësohet rëndësia e kërcënimit. Një vlerësim i përgatitur si një shërbim joauditues nuk është zëvendësim i procedurave të auditimit në një auditim sipas GAGAS.

Shërbimet e Sistemeve të Teknologjisë së Informacionit

**3.56** Shërbimet e lidhura me sistemet e teknologjisë së informacionit (TI) përfshijnë hartimin ose zbatimin e sistemeve hardware ose software. Sistemet mund të bashkojnë të dhënat burim, të jenë pjesë e kontrollit të brendshëm për çështjen nën auditim, apo të japin informacione që ndikojnë në çështjen e auditimit. Shërbimet TI që dëmtojnë pavarësinë nëse ofrohen nga një organizatë auditimi të një njësie nën audituar përfshijnë:

**a.** projektimin apo zhvillimin e një sistemi TI financiar ose sistemi TI tjetër që do të luajë një rol të rëndësishëm në

---

**Kapitulli 3**  
**Standardet e Përgjithshme**

---

menaxhimin e një zone të operacioneve që është ose do të jetë objekt i një auditimi;

**b.** ofrimin e shërbimeve që implikojnë ndërhyrje të tjera ndryshe nga modifikimet e parëndësishme të kodit themelor të një sistemi të tillë;  
dhe

**c.** veprojnë ose mbikëqyrin funksionimin e një sistemi të tillë.

Shërbimet e  
Vlerësimit

**3.57** Një vlerësim përfshin marrjen e supozimeve në lidhje me zhvillimet e ardhshme, zbatimin e metodologjive dhe teknikave të duhura, dhe kombinimin e të dyjave për të llogaritur një vlerë të caktuar, apo varg vlerash, për një aktiv, pasiv, ose një njësi ekonomike në tërësi. Nëse një organizatë auditimi ofron shërbime të vlerësimit të një njësie të audituar dhe vlerësimet do të kenë ndikim material, veç e veç ose së bashku, në pasqyrat financiare apo në ndonjë informacion tjetër në të cilën ato raportohen, dhe vlerësimi përmban një shkallë të konsiderueshme subjektivizmi, atëherë pavarësia e organizatës audituese do të jetë e dëmtuar.

Shërbime të tjera  
Joaudituese

**3.58** Sigurimi i disa shërbimeve të tjera joaudituese gjithmonë dëmton pavarësinë e një audituesi të jashtëm në lidhje me një subjekt të audituar. Këto aktivitete përfshijnë:

**a.** Mosdisbursimi i taksave - Ndalohen shërbimet joaudituese:

**(1)** Pranimi i përgjegjësisë për të autorizuar pagesën e fondeve të audituara të njësisë, në mënyrë elektronike ose ndryshe.

**(2)** Pranimi i përgjegjësisë për nënshkrimin ose nënshkrimin e përbashkët të kontrolleve të audituara të njësisë, qoftë edhe vetëm në situata të jashtëzakonshme.

**Kapitulli 3**  
**Standardet e Përgjithshme**

---

(3) Mbajtja e llogarive bankare të një njësie ekonomike të audituar ose pasja e kujdestarisë së fondeve të një njësie ekonomike të audituar apo marrja e vendimeve për kredit bankare për njësinë e audituar.

(4) Miratimi i faturave të shitësit për pagesë.

**b. Administrimi i Planit të Përfitimeve - Ndalohen Shërbimet Joaudituese**

(1) Marrja e vendimeve të politikës në emër të menaxhimit të njësisë të audituar.

(2) Interpretimi i dokumentit të planit në emër të menaxhimit për pjesëmarrësit në plan, pa e marrë pëlqimin e menaxhimit.

(3) Marrja e disbursimeve në emër të planit.

(4) Pasja e kujdestarisë së aseteve të një plani.

(5) Ofrimi i një plani në rolin e ndërmjetësit si përcaktohet nga Ligji i Sigurimeve për të Ardhurat nga Pensinet për Punonjësit.

**c. Investime - këshillim ose menaxhim- shërbime joaudituese të ndaluara**

(1) Marrja e vendimeve për investime në emër të menaxhimit të njësisë së audituar apo ndryshe të paturit pushtet të pakufizuar mbi investimet e një njësie ekonomike të audituar.

(2) Ekzekutimi i një transaksioni për të blerë ose shitur investimin e një njësie ekonomike të audituar.

(3) Pasja e kujdestarisë së aseteve të një njësie ekonomike të audituar, zotëruar përkohësisht letrat me vlerë të blera nga një njësi ekonomike të audituar.

**Kapitulli 3**  
**Standardet e Përgjithshme**

---

**d. Financat e korporatës - konsultimi apo këshillimi - Shërbime Joaudituese të Ndaluar.**

(1) Angazhimi në njësinë e audituar me aspektet të një transaksioni ose kryerja e një transaksioni në emër të njësisë të audituar.

(2) Veprimi si mbështetës, nënshkrues, ndërmjetës, apo garant i letrave me vlerë të njësisë së audituar, apo shpërndarës i memorandumëve private apo ofrimi dokumenteve.

(3) Mbajtja e kujdestarisë së letrave me vlerë të një njësie ekonomike të audituari.

**e. Çështje Ekzekutive apo të personelit punonjës - Ndalohen shërbimet joaudituese**

(1) Angazhimi në njësinë e audituar në marrëveshjet e kompensimit dhe të përfitimit të punonjësve.

(2) Punësimi ose largimi i punonjësve të njësisë të audituar.

**f. Këshillim mbi Riskun e Biznesit - Ndalohen Shërbimet Joaudituese**

(1) Marrja ose miratimi i vendimeve mbi riskun e biznesit.

(2) Paraqitja e konsideratave të riskut të biznesit për të ngarkuarit me qeverisjen apo të tjerë në emër të menaxhimit.

---

**Dokumentimi**

**3.59** Dokumentimi i konsideratave të pavarësisë ofron evidencë për vendimet e audituesit në formimin e konkluzioneve lidhur me përputhshmërinë me kërkesat për pavarësi. GAGAS përmban kërkesa specifike për dokumentacion që lidhet me pavarësinë që mund të jetë krahas dokumentacionit që audituesit kanë mbajtur më parë.

**Kapitulli 3**  
**Standardet e Përgjithshme**

---

Dokumentacioni i pamjaftueshëm i përputhshmërisë së audituesit me standardin e pavarësisë nuk dëmton pavarësinë, por dokumentacioni i duhur është i nevojshëm për kontrollin dhe sigurimin e cilësisë sipas kërkesave të GAGAS<sup>35</sup>. Standardi i pavarësisë përfshin kërkesat vijuese të dokumentacionit:

**a.** dokumentimin e kërcënimeve ndaj pavarësisë që kërkojnë zbatimin e masave mbrojtëse, së bashku me masat mbrojtëse të zbatuara në përputhje me kuadrin konceptual të pavarësisë siç kërkohet nga paragrafi 3.24;

**b.** dokumentimin e masave mbrojtëse të kërkuara nga paragrafi 3.30 nëse një organizatë auditimi është e vendosur brenda strukturës së një njësie qeveritare dhe konsiderohet si e pavarur në bazë të këtyre masave;

**c.** dokumentimi i konsideratave të aftësive së drejtimit të njësisë të audituar për të mbikëqyrur në mënyrë efektive një shërbim joauditues që do të ofrohet nga audituesi siç tregohet në paragrafin 3.34;  
dhe

**d.** dokumentimi i marrëveshjes së audituesit me një njësi të audituar për të cilën audituesi do të kryejë një shërbim joauditues siç tregohet në paragrafin 3.39.

---

**Gjykimi**  
**Profesional**

**3.60** Audituesit duhet të përdorin gjykimin profesional në planifikimin dhe kryerjen e auditimeve dhe në raportimin e rezultateve.

**3.61** Gjykimi profesional përfshin ushtrimin e kujdesit të arsyeshëm dhe skepticizmit profesional. Kujdesi i arsyeshëm përfshin veprimin e kujdesshëm në përputhje me standardet

---

<sup>35</sup> Shih paragrafin 3.84 për diskutime shtesë për respektimin e politikave të kontrollit të cilësisë dhe procedurat, si dhe paragrafin 3.88 për diskutime shtesë të politikave dhe procedurave për pavarësinë ligjore dhe kërkesat etike.

**Kapitulli 3**  
**Standardet e Përgjithshme**

---

profesionale të zbatueshme dhe parimet etike. Skepticizmi profesional është një qëndrim që përfshin të menduarit dyshues dhe një vlerësim kritik të provave. Skepticizmi profesional përfshin një qasje e të menduarit sipas të cilës audituesit supozojnë që menaxhimi nuk është as i pandershëm as që ka ndershmëri të padiskutueshme.

**3.62** Përdorimi i njohurive profesionale, aftësive dhe përvojës së audituesve për të kryer në mënyrë të kujdesshme, me qëllim të mirë dhe me integritet mbledhjen e informacioneve dhe vlerësimin objektiv të mjaftueshmërisë dhe përshtatshmërisë së evidencës është një komponentë kritik i auditimit. Gjykimi profesional dhe kompetenca janë të ndërlidhura, sepse gjykimet e dhëna varen nga kompetenca e audituesve.

**3.63** Gjykimi profesional përfaqëson zbatimin e njohurive të përbashkëta, aftësive dhe përvojave të të gjithë personelit të përfshirë në një auditim, si dhe gjykimin profesional të çdo audituesi. Përveç personelit të përfshirë drejtpërdrejt në auditim, gjykimi profesional mund të përfshijë bashkëpunimin me aktorë të tjerë, me specialistë të jashtëm dhe me menaxhimin e organizatës së auditimit.

**3.64** Përdorimi i gjykit profesional është i rëndësishëm për audituesit gjatë kryerjes së të gjitha aspekteve të përgjegjësisë të tyre profesionale, duke përfshirë zbatimin e standardeve të pavarësisë dhe kuadrin konceptual; ruajtjen e objektivitetit dhe besueshmërisë; caktimin e stafit kompetent për auditimin; përkufizimin e fushëveprimit të auditimit; vlerësimin, dokumentimin, dhe raportimin e rezultateve të punës; dhe mbajtjen e kontrollit të duhur të cilësisë mbi procesin e auditimit.

**3.65** Përdorimi i gjykit profesional është i rëndësishëm për audituesit kur zbatojnë kuadrin konceptual për të përcaktuar pavarësinë në një situatë të caktuar. Kjo përfshin marrjen në konsideratë të çdo kërcënimi ndaj pavarësisë së audituesit dhe masat mbrojtëse të cilat mund të zbutin kërcënimet e identifikuar. Audituesit përdorin gjykimin profesional në

**Kapitulli 3**  
**Standardet e Përgjithshme**

---

identifikimin dhe vlerësimin e çdo kërcënimi ndaj pavarësisë, duke përfshirë edhe kërcënime në dukje të pavarësisë.<sup>36</sup>

**3.66** Përdorimi i gjykimit profesional është i rëndësishëm për audituesit në përcaktimin e nivelit të kuptuarit të çështjes së auditimit dhe rrethanave të lidhura me të. Kjo përfshin konsideratën nëse përvoja kolektive e grupit të auditimit, trajnimi, njohuritë, aftësitë dhe të kuptuarit e përgjithshëm janë të mjaftueshme për të vlerësuar riskun që çështja e auditimit mund të përmbajë një pasaktësi të konsiderueshme ose mund të keqinterpretohet.

**3.67** Konsiderata e audituesit për nivelin e riskut të secilit auditim, duke përfshirë riskun për të arritur në konkluzione të gabuara, është gjithashtu e rëndësishme. Në kontekstin e riskut të auditimit, ushtrimi i gjykimit profesional në përcaktimin e mjaftueshmërisë dhe përshtatshmërisë së provave që do të përdoren për të mbështetur gjetjet dhe konkluzionet bazuar në objektivat e auditimit si dhe çdo rekomandim të raportuar, është një pjesë integrale e procesit të auditimit.

**3.68** Ky standard pa dyshim përcakton përgjegjësinë e çdo audituesi dhe organizate audituese për të ushtruar gjykimin profesional në planifikimin dhe kryerjen e auditimit, por kjo nuk nënkupton përgjegjësi të pakufizuar, as nuk nënkupton pagabueshmëri nga ana e audituesit ose organizatës së auditimit. Siguria absolute nuk është e arritshme për shkak të faktorëve si natyra e provave dhe karakteristikat e mashtrimit. Gjykimi profesional nuk do të thotë eliminimin e të gjitha kufizimeve apo dobësive të mundshme që lidhen me një auditim të veçantë, por identifikimin, vlerësimin, zbutjen dhe shpjegimin e tyre.

---

<sup>36</sup> Shih paragrafin 3.03 për një përshkrim të pavarësisë në dukje.

**Kapitulli 3**  
**Standardet e Përgjithshme**

---

Kompetenca	<p><b>3.69</b> Staf i caktuar për kryerjen e auditimit duhet të zotërojë në tërësi kompetencë të mjaftueshme dhe të nevojshme profesionale për të trajtuar objektivat e auditimit dhe duhet të kryejë punën në përputhje me GAGAS.</p> <p><b>3.70</b> Menaxhimi i organizatës audituese duhet të analizojë nevojat për aftësi për të vlerësuar nëse stafi i angazhuar ka aftësitë thelbësore që përputhen me kërkesat për kryerjen e një auditimi të caktuar. Prandaj, organizatat e auditimit duhet të kenë një proces për rekrutimin, punësimin, zhvillimin e vazhdueshëm, detyrat dhe vlerësimin e personelit me qëllim që të ruhet stafi kompetent. Natyra, fushëveprimi dhe formalitetet e procesit do të varen nga faktorë të ndryshëm si madhësia e organizatës së auditimit, strukturën e saj dhe puna.</p> <p><b>3.71</b> Kompetenca e ka prejardhjen nga një kombinim e edukimit dhe përvojës. Kompetencat nuk maten detyrimisht me vite përvojë në auditim për shkak se një matje e tillë sasiore mund të mos pasqyrojë saktësisht llojet e përvojave të fituara nga një auditues në çdo periudhë të caktuar kohore. Ruajtja e kompetencës nëpërmjet një përkushtimi për të mësuar dhe për tu zhvilluar gjatë gjithë jetës profesionale të një audituesi është një element i rëndësishëm për audituesit. Kompetenca i mundëson një audituesi të jap gjykime të bazuara profesionalisht.</p>
Njohurië Teknike	<p><b>3.72</b> Staf i caktuar për të kryer auditime në përputhje me GAGAS duhet bashkërisht të zotërojë njohuri teknike, aftësi dhe përvojë të nevojshme për të qenë kompetent për llojin e punës së kryer para fillimit të punës në këtë auditim. Staf i caktuar për një auditim GAGAS duhet të zotërojë bashkërisht:</p>

**Kapitulli 3**  
**Standardet e Përgjithshme**

---

**a.** njohuri të GAGAS të zbatueshme për llojin e punës që u është caktuar dhe arsimin, aftësitë dhe përvojë për të zbatuar këto njohuri konkretisht;

**b.** njohuri të përgjithshme të mjedisit në të cilin vepron njësia dhe çështjen nën auditim;

**c.** aftësi për të komunikuar në mënyrë të qartë dhe në mënyrë efektive, verbalisht dhe me shkrim; dhe;

**d.** aftësitë e duhura për punën që do të kryhet, për shembull, aftësi në

**(1)** marrjen e kampionëve statistikor ose jo statistikor nëse puna parashikon përdorimin e tyre;

**(2)** teknologjinë e informacionit, nëse puna parashikon rishikimin e sistemeve të informacionit;

**(3)** inxhinieri nëse puna përfshin rishikimin e të dhënave inxhinierike komplekse;

**(4)** metodologjitë e specializuara të auditimit apo teknika analitike, si përdorimi i instrumenteve komplekse të anketimi, vlerësimit mbi bazë aktuariale, ose testet e analizave statistikore; ose

**(5)** njohuri të specializuara në çështjet shkencore, mjekësore, mjedisore, arsimore, apo ndonjë çështje tjetër të specializuar të njësisë, nëse puna kërkon një ekspertizë të tillë.

Kualifikimet  
Shtesë për  
Auditimet  
Financiare dhe  
Angazhimet për  
Certifikim

**3.73** Audituesit që kryejnë auditime financiare duhet të kenë njohuri të Parimeve të Kontabilitetit Përgjithësisht të Pranuara në SHBA (GAAP), ose të kuadrit të zbatueshëm të raportimit financiar të përdorur si dhe Deklaratat mbi Standartet e

**Kapitulli 3**  
**Standardet e Përgjithshme**

---

Auditimit (SAS)<sup>37</sup> të Institutit Amerikan të Kontabilistëve Publik të Certifikuar (AICPA), dhe duhet të jenë kompetent në zbatimin e këtyre standardeve.

**3.74** Në mënyrë të ngjashme, audituesit që kryejnë angazhimet për certifikim duhet të kenë njohuri për standardet e përgjithshme të AICPA-s për certifikimin në lidhje me kriteret, standardet e AICPA për certifikimin gjatë punës në terren dhe raportimin, dhe Deklaratat mbi Standardet e Angazhimeve për Certifikim (SSAE),<sup>38</sup> si dhe duhet të jenë kompetent në zbatimin e këtyre standardeve dhe deklaratave në punën certifikuese.<sup>39</sup>

**3.75** Audituesit e angazhuar për të kryer auditime financiare apo angazhimet për certifikim duhet të jenë kontabilistë publikë të licencuar, ose persona që punojnë për një firmë të licencuar të kontabilitetit publik apo për një organizatë të auditimit të qeverisë, ose kontabilistë të licencuar në shtetet që kanë sisteme me shumë klasifikime të licencimit dhe që njohin kontabilistë të tjerë të licencuar, ndryshe nga kontabilistët publikë të licencuar.

---

Edukimi  
Vazhdueshëm  
Profesional

**3.76** Audituesit që auditojnë sipas GAGAS, duke përfshirë planifikimin, drejtimin, kryerjen e procedurave të auditimit, ose raportimin e një auditimi të kryer sipas GAGAS, duhet të ruajnë kompetencën e tyre profesionale përmes edukimit të vazhdueshëm profesional (CPE). Prandaj, për çdo punë audituese të kryer në përputhje me GAGAS, audituesi duhet të kryejë, çdo 2 vjet, të paktën 24 orë edukim të vazhdueshëm (CPE) që lidhet drejtpërdrejt me auditimin e qeverisë, mjedisin e qeverisë, ose mjedisin specifik apo të veçantë në të cilën vepron njësisia e audituar.

---

<sup>37</sup> Shih paragrafët 2.08 dhe 4.01 për diskutimin e standardeve të AICPA-s të përfshira në GAGAS për auditimet financiare.

<sup>38</sup> Shih paragrafët 2.09 dhe 5.01 për diskutimin e standardeve të AICPA-s të përfshira në GAGAS për angazhimet e certifikimit.

<sup>39</sup> Shih paragrafët 2.19 – 2.22 për informacion shtesë mbi marrëdhëniet ndërmjet GAGAS dhe standardeve të tjera profesionale për auditimet financiare dhe angazhimet e certifikimit.

**Kapitulli 3**  
**Standardet e Përgjithshme**

---

Audituesit që janë të përfshirë në planifikimin, drejtimin, ose raportimin sipas GAGAS dhe audituesit të cilët nuk janë të përfshirë në këto aktivitete, por i dedikojnë 20% ose më shumë të kohës së tyre në vit auditimeve GAGAS, gjithashtu duhet të kryejnë të paktën 56 orë shtesë CPE (për një total prej 80 orësh CPE në çdo periudhë 2-vjeçare), për të rritur aftësitë profesionale për të kryer auditime. Audituesit që duhet të kryejnë në total 80 orë CPE, duhet të kryejnë të paktën 20 orë CPE në çdo vit për një periudhë 2-vjeçare. Audituesit e punësuar rishtazi ose të caktuar fillimisht për auditimet GAGAS, pas fillimit të periudhës 2-vjeçare CPE të një organizate auditimi, duhet të plotësojnë një numër orësh CPE të përlllogaritur për ta.

**3.77** Programet CPE janë veprimtari edukimi të strukturuar me objektiva mësimore të përcaktuara për të ruajtur ose shtuar njohuritë, kompetencat e pjesëmarrësve dhe aftësitë në fushat e zbatueshme për kryerjen e auditimeve. Përcaktimi i subjekteve të përshtatshme për audituesit për të përmbushur kriteret e 80-orëve dhe 24-orëve i përket gjyqimit profesional të audituesit në konsultim me zyrtarët përkatës në organizatat e tij të auditimit. Ndër konsideratat për të ushtruar gjykimin profesional janë përvoja e audituesit, përgjegjësitë që ata marrin përsipër kur kryejnë auditime GAGAS dhe mjedisi operativ i njësisë së audituar.

**3.78** Përmbushja e kërkesave CPE është kryesisht përgjegjësi e audituesve. Organizata e auditimit duhet të ketë procedura të kontrollit të cilësisë për tu siguruar që audituesit i përmbushin kërkesat e edukimit të vazhdueshëm, duke përfshirë dokumentacionin e CPE – së të përfunduar.

---

**Kapitulli 3**  
**Standardet e Përgjithshme**

---

GAO ka hartuar udhëzime që kanë të bëjnë me kërkesat CPE për të ndihmuar audituesit dhe organizatat e auditimit në ushtrimin e gjykimit profesional për të qenë në përputhje me kërkesat CPE.<sup>40</sup>

---

Kërkesat CPE  
(Edukimi  
Vazhdueshëm  
Profesional)  
për Specialistët

**3.79** Grupi i auditimit duhet të përcaktojë që specialistët e jashtëm që ndihmojnë në kryerjen e një auditimi GAGAS të jenë të kualifikuar dhe kompetent në fushat e tyre të specializimit; megjithatë, specialistët e jashtëm nuk e kanë të detyrueshme përmbushjen e kërkesave GAGAS për CPE-në.

**3.80** Grupi i auditimit duhet të përcaktojë që specialistët e brendshëm për konsultime mbi një auditim GAGAS të cilët nuk janë të përfshirë në drejtimin, kryerjen e procedurave të auditimit, ose raportimin mbi një auditim GAGAS, të jenë të kualifikuar dhe kompetent në fushat e tyre të specializimit; megjithatë, këto specialistë të brendshëm nuk e kanë të detyrueshme përmbushjen e kërkesave GAGAS për CPE-në.

**3.81** Grupi i auditimit duhet të përcaktojë që specialistët e brendshëm, që kanë punuar sipas GAGAS si pjesë e grupit të auditimit, duke përfshirë drejtimin, kryerjen e procedurave të auditimit, ose raportimin mbi një auditim GAGAS, duhet të jenë në përputhje të plotë me to, duke përfshirë kërkesat CPE.<sup>41</sup> Kërkesat GAGAS për CPE-në hyjnë në fuqi për specialistët e brendshëm kur një organizatë e auditimit fillimisht cakton një specialist të brendshëm për një auditim. Për arsye se specialistët e brendshëm zbatojnë njohuritë e specializuara në auditimet e qeverisë, trajnimi në fushat e tyre të specializimit i kualifikon në bazë të kërkesës për 24 orë CPE që drejtpërdrejt lidhet me auditimin e qeverisë, mjedisin e qeverisë ose mjedisin specifik apo të veçantë në të cilën vepron njësia i audituar.

---

<sup>40</sup> Standardet e Auditimit të Qeverisë: Udhëzime për Kërkesat GAGAS për Arsimimin e Vazhdueshëm Profesional, Gao-05-568G (Washington, DC: prill 2005), <http://www.gao.gov/yellowbook>.

<sup>41</sup> Shih paragrafët 3.76 – 3.81 për diskutimin e kërkesave CPE.

**Kapitulli 3**  
**Standardet e Përgjithshme**

---

**Kontrolli i Cilësisë  
dhe Sigurimi**

**3.82** Çdo organizatë auditimi që kryen auditime sipas GAGAS duhet:

a. të krijojë dhe mbajë një sistem të kontrollit të cilësisë që është projektuar për t'i dhënë asaj siguri të arsyeshme se organizimi dhe personeli janë në përputhje me standardet profesionale dhe kërkesat ligjore dhe rregullave në fuqi,<sup>42</sup> dhe

b. të ketë kryer një “peer review” të realizuar nga rishikues të jashtëm dhe të pavarur nga organizata e auditimit, të paktën një herë në çdo 3 vjet.

---

**Sistemi i  
Kontrollit të  
Cilësisë**

**3.83** Sistemi i kontrollit të cilësisë së një organizate auditimi përfshin theksin e vendosur nga titullari i saj në kryerjen e punës me cilësi të lartë, si dhe politikat dhe procedurat e krijuara për të dhënë siguri të arsyeshme që veprohet në përputhje me standardet profesionale dhe kërkesat ligjore dhe rregullatore në fuqi. Natyra, shtrirja, dhe formalitetet e sistemit të kontrollit të cilësisë të organizatës audituese do të ndryshojnë bazuar në rrethanat e organizatës, si madhësia e saj, numri i zyrave dhe shpërndarja gjeografike, njohuritë dhe eksperiencia e personelit të saj, natyra dhe kompleksiteti i auditimit dhe konsideratat kosto-përfitim.

**3.84** Çdo organizatë auditimi duhet të dokumentojë politikat dhe procedurat e saj të kontrollit të cilësisë dhe t'ia komunikojnë ato personelit të saj. Organizata e auditimit duhet të dokumentojë pajtueshmërinë me politikat dhe procedurat e saj të kontrollit të cilësisë dhe duhet ta ruajë këtë dokumentacion për një periudhë kohore të mjaftueshme për të mundësuar kryerjen e procedurave të monitorimit dhe komenteve nga kolegët për të vlerësuar shkallën e përputhshmërisë së organizatës së auditimit me politikat dhe

---

<sup>42</sup> Shih paragrafin A3.10 për diskutime shtesë të sistemit të kontrollit të cilësisë.

**Kapitulli 3**  
**Standardet e Përgjithshme**

---

procedurat e saj të kontrollit të cilësisë. Forma dhe përmbajtja e dokumentacionit janë një çështje e gjykimit profesional dhe do të ndryshojnë bazuar në rrethanat e organizatës së auditimit.

**3.85** Një organizatë auditimi duhet të vendosë politika dhe procedura në sistemin e saj të kontrollit të cilësisë që bashkërisht të adresojnë:

- a. përgjegjësitë e titullarit për cilësinë brenda organizatës së auditimit,
- b. pavarësinë, kërkesat ligjore dhe etike,
- c. fillimin, pranimin dhe vazhdimin e auditimeve,
- d. burimet njerëzore,
- e. performancën e auditimit, dokumentacionin dhe raportimin dhe,
- f. monitorimin e cilësisë.

Përgjegjësitë e  
Titullarit për  
Cilësinë në  
Kudër të  
Organizatës së  
Auditimit

**3.86** Organizatat e Auditimit duhet të vendosin politika dhe procedura për përgjegjësitë e titullarit për cilësinë brenda organizatës së auditimit që përfshijnë përcaktimin e përgjegjësisë për cilësinë e auditimeve financiare të kryera në përputhje me GAGAS dhe komunikimin e politikave dhe procedurave lidhur me cilësinë. Politikat e përshtatshme dhe komunikimet nxisin një kulturë që pranon se cilësia është thelbësore në kryerjen e auditimeve GAGAS dhe se titullari i organizatës së auditimit është në fund të fundit përgjegjës për sistemin e kontrollit të cilësisë.

---

**Kapitulli 3**  
**Standardet e Përgjithshme**

---

Pavarësia,  
Kërkesat Ligjore  
dhe Etike

**3.87** Organizata e auditimit duhet të vendosë politika dhe procedura të zhvilluara për t'i dhënë siguri të arsyeshme se, pikërisht përgjegjësit operativ të caktuar për sistemin e kontrollit të cilësisë të organizatës së auditimit, kanë përvojën e mjaftueshme dhe të përshtatshme, aftësinë dhe autoritetin e duhur për t'i marrë përsipër këto përgjegjësi.

**3.88** Organizatat e Auditimit duhet të vendosin politika dhe procedura për pavarësinë, kërkesat ligjore, dhe etike të hartuara për të ofruar siguri të arsyeshme se organizata e auditimit dhe personeli i saj e ruan pavarësinë në përputhje me kërkesat ligjore dhe etike në fuqi.<sup>43</sup> Këto politika dhe procedura ndihmojnë organizatën e auditimit:

**a.** të komunikojë kërkesat për pavarësi të stafit,

dhe

**b.** të identifikojë dhe të vlerësojë rrethanat dhe marrëdhëniet që krijojnë kërcënime ndaj pavarësisë, dhe të marrë masat e duhura për të eliminuar këto kërcënime apo për t'i reduktuar ato në një nivel të pranueshëm duke aplikuar masa mbrojtëse, ose, nëse konsiderohet e përshtatshme, të tërhiqet nga auditimi, atëherë kur ky veprim nuk është i ndaluar me ligj ose rregullore.

Fillimi, Pranimi  
dhe Vazhdimi i  
auditimeve

**3.89** Organizatat e auditimit duhet të vendosin politika dhe procedura për fillimin, pranimin, dhe vazhdimësinë e auditimeve që zhvillohen për të ofruar siguri të arsyeshme se do të ndërmarrë auditime vetëm në qoftë se të tilla auditime të mund jenë në pajtueshmëri me standardet profesionale,

---

<sup>43</sup> Shih paragrafët 3.02 dhe 3.59 për kërkesat e pavarësisë sipas GAGAS. Shih kapitullin 1 për parimet etike sipas GAGAS.

---

**Kapitulli 3**  
**Standardet e Përgjithshme**

---

kërkesat ligjore dhe parimet etike dhe po veprohet brenda mandatit ligjor ose autoritetit të organizatës së auditimit.<sup>44</sup>

Burimet  
Njerëzore

**3.90** Organizatat e auditimit duhet të vendosin politika dhe procedura për burimet njerëzore të hartuara për t'i ofruar organizatës siguri të arsyeshme se ka personel me aftësi dhe kompetencë për të kryer auditime në përputhje me standardet profesionale dhe kërkesat ligjore dhe rregullatore.<sup>45</sup>

Performanca e  
Auditimit,  
Dokumentimi  
dhe Raportimi

**3.91** Organizatat e auditimit duhet të vendosin politika dhe procedura për kryerjen e auditimit, dokumentimin dhe raportimin të zhvilluara për t'i ofruar asaj siguri të arsyeshme se auditimet kryhen dhe raportet nxirren sipas standardeve profesionale dhe kërkesave ligjore dhe rregullatore.<sup>46</sup>

**3.92** Kur kryejnë auditime GAGAS, organizatat e auditimit duhet të kenë politika dhe procedura për ruajtjen dhe mbajtjen e sigurt të dokumentacionit të auditimit për një kohë të mjaftueshme për të përmbushur kërkesat ligjore, rregullatore, dhe administrative për të ruajtjen e të dhënave. Nëse dokumentacioni i auditimit është në formë shkresore, elektronike, ose mediatike, integriteti, qasja, dhe rigjenerimi i informacionit kryesor mund të rrezikohet nëse dokumentacioni ndryshohet, shtohet ose fshihet pa dijeninë e audituesve, ose nëse dokumentacioni humbet apo dëmtohet. Për dokumentacionin e auditimit që ruhet në mënyrë elektronike, organizata e auditimit duhet të krijojë kontrole

---

<sup>44</sup> Shih paragrafin A3.10a për diskutimin e inicimin e auditimeve nga ana e organizatave të auditimit të qeverisë.

<sup>45</sup> Shih paragrafët 3.69 – 3.81 për kërkesat që lidhen me kompetencën profesionale.

<sup>46</sup> Për auditimet financiare zbatohen kapitujt 2 - 4; për vërtetimin e angazhimeve zbatohen kapitujt 2, 3 dhe 5; për auditimet e performancës zbatohen kapitujt 2, 3, 6, dhe 7.

**Kapitulli 3**  
**Standardet e Përgjithshme**

---

efektive të sistemeve të informacionit në lidhje me qasjen dhe përditësimin e dokumentacionit të auditimit.

**Monitorimi i  
Cilësisë**

**3.93** Organizatat e auditimit duhet të vendosin politika dhe procedura për monitorimin e cilësisë në strukturën organike të auditimit.<sup>47</sup> Monitorimi i cilësisë është një vlerësim i vazhdueshëm, periodik i punës së kryer mbi auditimet e hartuara për t'i dhënë menaxhimit të organizatës së auditimit siguri të arsyeshme se politikat dhe procedurat të sistemit të kontrollit të cilësisë janë të përshtatshme dhe veprojnë në mënyrë efektive në praktikë. Qëllimi i monitorimit të përputhshmërisë me politikat dhe procedurat e kontrollit të cilësisë është të sigurojë një vlerësim nëse:

**a.** janë ndjekur standardet profesionale dhe kërkesat ligjore dhe rregullatore,

**b.** është ndërtuar mënyrë të përshtatshme sistemi i kontrollit të cilësisë,  
dhe

**c.** politikat dhe procedurat e kontrollit të cilësisë veprojnë në mënyrë efektive edhe në praktikë.

**3.94** Procedurat e monitorimit mund të ndryshojnë në varësi të fakteve dhe rrethanave të organizatës së auditimit. Organizata e auditimit duhet të kryejë procedura monitorimi që mundësojnë vlerësimin e përputhshmërisë me standardet e zbatueshme profesionale dhe me politikat e kontrollit të cilësisë, si dhe procedurat për auditimet GAGAS. Individët që kryejnë monitorimin duhet të kenë bashkërisht ekspertizën dhe autoritetin e mjaftueshëm për këtë rol.

**3.95** Organizata e auditimit duhet të analizojë dhe të përmbledhë rezultatet e procesit të monitorimit jo më pak se një herë në vit, kur identifikohet ndonjë çështje sistematike

---

<sup>47</sup> Shih paragrafin A3.10c për diskutime shtesë të monitorimit.

**Kapitulli 3**  
**Standardet e Përgjithshme**

---

ose e përsëritur që ka nevojë për përmirësim, së bashku me rekomandimet për veprime korigjuese. Organizata audituese duhet të komunikojë me personelin për ndonjë mangësi të vërejtur gjatë procesit të monitorimit dhe të bëjë rekomandime për masat korigjuese.

---

Rishikimi nga  
Kolegët e Jashtëm

**3.96** Organizata e auditimit duhet të kryejë një rishikim nga kolegë të jashtëm të paktën një herë në çdo 3 vjet, i cili është i mjaftueshëm për të përcaktuar nëse, për periudhën në shqyrtim, rishikimi i sistemit të kontrollit të cilësisë së organizatës audituese është hartuar në mënyrë të përshtatshme dhe nëse organizata audituese është në përputhje me sistemin e saj të kontrollit të cilësisë në mënyrë që t'i jap organizatës së auditimit siguri të arsyeshme të përputhshmërisë me standardet e zbatueshme profesionale.

**3.97** Rishikimi i parë nga kolegët për një organizatë auditimi, që nuk i është nënshtruar ende kërkesave të rishikimit nga kolegët, mbulon një periudhë rishikimi e cila mbaron jo më vonë se 3 vjet nga data që organizata ka kryer auditimin e saj të parë sipas GAGAS. Periudha e rishikimit përgjithësisht mbulon 1 vit, edhe pse programet e rishikimit nga kolegët mund të zgjidhin një periudhë më të gjatë rishikuese. Në përgjithësi, afatet për raportet e rishikimit nga kolegët vendosen nga njësia që administron programin e rishikimit. Zgjatjet e afateve për paraqitjen e raportit të analizës nga kolegët që i tejkalojnë 3 muaj nga data e caktuar, jepen nga njësia që administron programin e rishikimit dhe nga GAO.

**3.98** Grupi i rishikimit duhet të përfshijë elementet e mëposhtme në objektin e shqyrtimit:

**a.** rishikimi i politikave dhe procedurave të kontrollit të cilësisë së organizatës së auditimit;

**b.** konsiderata për përshtatshmërinë e rezultateve dhe procedurave të monitorimit të brendshëm të organizatës audituese dhe;

**Kapitulli 3**  
**Standardet e Përgjithshme**

---

c. shqyrtimi i raporteve të audituesve të përzgjedhur dhe dokumentacionin përkatës;

d. rishikimi i dokumenteve të tjera të nevojshme për vlerësimin e përputhshmërisë me standardet, për shembull, dokumentacionin për pavarësinë, të dhënat CPE dhe dosjet përkatëse të menaxhimit të burimeve njerëzore; dhe

e. intervistat me përzgjedhje të stafit profesional të organizatës audituese në nivele të ndryshme për të vlerësuar të kuptuarit dhe përputhshmërinë me politikat dhe procedurat përkatëse të kontrollit të cilësisë.

**3.99** Grupi i rishikimit duhet të kryejë një vlerësim të riskut të shqyrtimit për të ndihmuar në përcaktimin e numrit dhe llojeve të auditimeve të zgjedhura për rishikim.<sup>48</sup> Bazuar në vlerësimin e riskut, grupi duhet të përdorë një ose kombinim të këtyre qasjeve për të zgjedhur auditimet individuale për shqyrtim duke u fokusuar tek auditimet me nivel më të lartë risku: (1) të zgjedhë auditime GAGAS që të japin një panoramë të qartë të auditimeve GAGAS të kryera nga organizata e rishikuar e auditimit; ose (2) të zgjedhë auditime që japin një panoramë të qartë të të gjitha llojeve të punëve të kryera në sistemin e kontrollit të cilësisë së organizatës së rishikuar të auditimit, duke përfshirë një ose më shumë auditime financiare të kryera në përputhje me GAGAS. Qasja e dytë është përgjithësisht e zbatueshme për organizatat që kryejnë vetëm një numër të vogël të auditimeve GAGAS në raport me llojet e tjera të auditimeve. Në këto raste, një ose disa auditime GAGAS mund të përfaqësojnë më shumë se ç'ka është e nevojshme për të dhënë një panoramë të qartë të punës së organizatës të auditimit në tërësi.

---

<sup>48</sup> Shih paragrafin A3.11 për shembuj të faktorëve për t'u marrë parasysh në vlerësimin e riskut të vlerësimit nga kolegët.

**Kapitulli 3**  
**Standardet e Përgjithshme**

---

**3.100** Grupi i rishikimit duhet të përgatisë një ose më shumë raporte të shkruara për të komunikuar rezultatet e rishikimit nga kolegët, duke përfshirë sa më poshtë:

a. një përshkrim të fushës të shqyrtimit nga kolegët, duke përfshirë çdo kufizim;

b. një opinion nëse sistemi i kontrollit të cilësisë së praktikave të auditimit të organizatës së auditimit të rishikuar është hartuar në mënyrë të përshtatshme dhe është ndjekur gjatë periudhës së shqyrtuar, për t'i ofruar organizatës së auditimit siguri të arsyeshme për përputhshmërinë me standardet e zbatueshme profesionale;

c. specifikimin e standardeve profesionale të cilave u përmbahet organizata audituese që shqyrtohet;

**dhe**

d. referencën për çdo komunikim të veçantë shkresor, të mbajtur në kuadër të programit të shqyrtimit.

**3.101** Grupi i rishikimit përdor gjykimin profesional në përcaktimin e llojit të raportit të shqyrtimit. Në vijim janë listuar disa lloje raportesh.

a. **Raport Rishikimi Kalues/Pozitiv:** Një konkluzion se sistemi i kontrollit të cilësisë të organizatës audituese është hartuar në mënyrë të përshtatshme dhe është i zbatueshëm me qëllim që t'i ofrojë organizatës audituese siguri të arsyeshme të kryerjes së auditimit dhe raportimit të tij në përputhje me standardet e zbatueshme profesionale në të gjitha aspektet materiale.

b. **Raport Rishikimi Kalues/Pozitiv me Mangësi/Rezerva:** Një konkluzion se sistemi i kontrollit të cilësisë të organizatës audituese është hartuar në mënyrë të përshtatshme dhe është i zbatueshëm me qëllim që t'i ofrojë organizatës së auditimit siguri të arsyeshme të kryerjes së auditimit dhe raportimit të tij në

**Kapitulli 3**  
**Standardet e Përgjithshme**

---

përputhje me standardet e zbatueshme profesionale në të gjitha aspektet materiale, me përjashtim të një mangësie të caktuar ose mangësive që janë përshkruar në raport.

**c. Raport Rishikimi Jo Kalues/Negativ:** Një konkluzion, bazuar në mangësi të theksuara që janë të përshkruara në raport, se sistemi i organizatës audituese të kontrollit të cilësisë të organizatës nuk është ndërtuar në mënyrë të përshtatshme për t'i ofruar asaj siguri të arsyeshme të kryerjes së auditimit dhe raportimit në përputhje me standardet e zbatueshme profesionale në të gjitha aspektet materiale; apo organizata e auditimit nuk ka vepruar në përputhje me sistemin e saj të kontrollit të cilësisë për t'i ofruar vetvetes siguri të arsyeshme të kryerjes së auditimit dhe raportimit në përputhje me standardet e zbatueshme profesionale në të gjitha aspektet materiale.

**3.102** Kur objekti i rishikimit është i kufizuar nga disa kushte që përjashtojnë zbatimin e një ose më shumë procedurave të shqyrtimit që janë të nevojshme në ato rrethana dhe rishikuesi nuk mund t'i arrijë objektivat e këtyre procedurave nëpërmjet procedurave alternative, llojet e raporteve të përshkruara në paragrafët 3.101/a - c modifikohen duke përfshirë deklarata në paragrafin e qëllimit të raportit, shtjellimin e tij dhe në opinionin përfundimtar. Këto deklarata përshkruajnë marrëdhënien e auditimit/eve të përjashtuar ose fushës/ave funksionale, me fushëveprimin e plotë praktik dhe sistemit të kontrollit të cilësisë të organizatës së rishikuar, si edhe me efektet e përjashtimit të fushës dhe rezultatet e shqyrtimit.

**3.103** Për çdo mangësi apo mangësi të rëndësishme të përfshirë në raportin e rishikimit ose çdo komunikim tjetër shkresor, grupi duhet të përfshijë, ose në raportin e rishikimit ose në një komunikim të veçantë shkresor, një përshkrim të detajuar të gjetjeve, konkluzioneve dhe rekomandimeve që lidhen me këto të meta ose mangësi të rëndësishme.

**Kapitulli 3**  
**Standardet e Përgjithshme**

---

**3.104** Grupi duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:

**a.** Grupi i rishikimit në tërësi ka njohuri të përditësuara të GAGAS dhe të auditimit të qeverisë.

**b.** Organizata që kryen rishikimin dhe anëtarët e grupit janë të pavarur (siç përcaktohet në GAGAS)<sup>49</sup> nga organizata e auditimit që shqyrtojnë, stafi i saj, dhe auditimet e përzgjedhura për rishikim.

**c.** Grupi i rishikimi bashkërisht ka njohuri të mjaftueshme se si të kryejë një rishikim nga kolegët. Këto njohuri mund të përfitohen nga përvoja në punë, kurset e trajnimit, ose një kombinim i të dyjave. Është e dëshirueshme prezenca e personelit me përvojë të mëparshme në një rishikim bashkëkohor apo të grupit të inspektimit të brendshëm.

**3.105** Një organizatë e jashtme e auditimit<sup>50</sup> duhet të publikojë raportin më të fundit të rishikimit.<sup>51</sup> Për shembull, një organizatë auditimi mund të plotësojë këtë kërkesë nëpërmjet postimit të raportit në një faqe interneti në dispozicion të publikut ose në një skedar në dispozicion të publikut të krijuar për transparencën publike të rezultateve të rishikimit nga kolegët. Në të kundërt, nëse asnjëra prej këtyre opsioneve është e mundur për organizatë e auditimit, atëherë ajo duhet të përdorë të njëjtin mekanizëm transparence që përdor për të bërë publike informacione të tjera. Organizata e auditimit duhet t'u sigurojë raportin edhe të tjerëve kur kërkohet. Në qoftë se publikohet një komunikim i veçantë që detajon gjetjet, përfundimet dhe rekomandimet, atëherë disponueshmëria publike e atij komunikimi nuk është e nevojshme.

---

<sup>49</sup> Shih paragrafët 3.02 – 3.32 për diskutimin e pavarësisë.

<sup>50</sup> Shih paragrafin 1.07b për përkufizimin e "organizatave të auditimit" dhe paragrafi 1.08 për diskutimin e organizatave të auditimit të jashtëm.

<sup>51</sup> Shih paragrafin A3.12 për diskutim shtesë mbi transparencën e raportit të rishikimit nga kolegët.

**Kapitulli 3**  
**Standardet e Përgjithshme**

---

Organizatat e auditimit të brendshëm që raportojnë te menaxhimi i brendshëm dhe ndaj atyre të ngarkuarve me qeverisjen duhet të sigurojnë një kopje të raportit edhe për ata që janë të ngarkuar me qeverisje.

**3.106** Informacioni në raportet e rishikimit të kolegëve mund të jetë i rëndësishëm për vendimet në lidhje me prokurimin e auditimeve. Prandaj, organizatat e auditimit që kërkojnë të lidhin një kontratë për të ushtruar auditime në përputhje me GAGAS, duhet t'i sigurojnë palës kontraktuese raportin e rishikimit për këto shërbime kur kërkohet:

a. raporti më i fundit i rishikimit të organizatës së auditimit, dhe

b. çdo raport pasues rishikimi gjatë periudhës së kontratës.

**3.107** Audituesit që përdorin punën e një organizate tjetër të auditimit duhet të kërkojnë një kopje të raportit më të fundit të rishikimit të organizatës së auditimit dhe çdo komunikim tjetër shkresor të publikuar; dhe organizata e auditimit duhet të sigurojë këto dokumente kur kërkohet.<sup>52</sup>

---

<sup>52</sup> Shih paragrafët 6.40 – 6.44 për diskutim shtesë për përdorimin e punës së audituesve të tjera

---

## Standardet për Auditimin Financiar

---

---

### Hyrje

**4.01** Ky kapitull përmban kërkesat, udhëzimet dhe konsideratat për kryerjen dhe raportimin e auditimeve financiare të kryera në përputhje me GAGAS. GAGAS inkorporojnë Deklaratat e Standardeve të Auditimit (SAS) të Institutit Amerikan të Kontabilistëve Publik të Certifikuar (AICPA), të trajtuara në paragrafin 2.08.<sup>53</sup> Të gjitha seksionet janë të përfshira në SAS, dhe përmbajnë hyrjen, objektivat, përkufizimet, kërkesat, zbatimin dhe materiale të tjera shpjeguese. Audituesit që kryejnë auditime financiare në përputhje me GAGAS duhet të veprojnë në përputhje me SAS dhe kërkesat shtesë në këtë kapitull. Kërkesat dhe udhëzimet e përfshira në kapitujt 1 deri 3 zbatohen gjithashtu për auditimet financiare të kryera në përputhje me GAGAS.

---

### Kërkesat Shtesë GAGAS për Kryerjen e Auditimeve Financiare

**4.02** GAGAS përcaktojnë kërkesat për kryerjen e auditimeve financiare përveç kërkesave që përfshihen në standardet AICPA. Audituesit duhet të veprojnë në përputhje me këto kërkesa shtesë, së bashku me SAS duke cituar GAGAS në raportet e tyre. Kërkesat shtesë për kryerjen e auditimeve financiare lidhen me:

---

<sup>53</sup> Shih te AICPA-s, Kodifikimin e Deklaratave të Standardeve të Auditimit dhe paragrafin 2.20 për diskutime shtesë mbi marrëdhëniet mes GAGAS dhe standardet e tjera profesionale. Referencat për AICPA dhe Kodifikimin e Deklaratave të Standardeve të Auditimit përdoret një "AU-C" si identifikues për t'iu referuar SASs, në vend të "AU". "AU-C" është një identifikues i përkohshëm për të shmangur konfuzionin me referencën "AU" të seksioneve ekzistuese, të cilat mbeten në fuqi deri në vitin 2013. "AU-C" do të kthehet në "AU" në 2014 për AICPA-s dhe Kodifikimin e Deklaratave të Standardeve të Auditimit, kur SASs do të bëhen plotësisht efektive për të gjitha angazhimet.

**Kapitulli 4**  
**Standardet për Auditimin Financiar**

---

- a. komunikimi i audituesit;
- b. auditimet dhe angazhimet për certifikim të mëparshme;
- c. mashtrimi, mospërputhje me dispozitat e ligjeve, rregulloret, kontratat dhe marrëveshjet e grantit dhe shpërdorimit;
- d. zhvillimin i elementeve të gjetjeve;  
dhe
- e. dokumentimi i auditimit.<sup>54</sup>

---

**Komunikimi i  
Audituesit**

**4.03** Përveç kërkesave të AICPA-s për komunikimin e audituesit,<sup>55</sup> kur kryejnë një auditim financiar GAGAS, audituesit duhet të japin informacionet përkatëse që në gjykimin e tyre profesional duhet t'u kalojnë palëve kontraktuese për ose kërkuese të një auditimi, si dhe duhet të bëjnë me dije komitetet legjislative kur ata auditojnë në bazë të një ligji ose rregulloreje, ose kur auditojnë për llogari të komitetit legjislativ që mbikëqyr njësinë e audituar. Kjo kërkesë nuk zbatohet nëse ligji apo rregullorja që kërkon auditimin e pasqyrave financiare nuk i identifikon në mënyrë specifike njësi të do të auditohen, si p. sh. auditimet e kërkuara nga Amendimet e Ligjit të Auditimeve Individuale të vitit 1996.

**4.04** Në ato situata kur nuk është një individ i vetëm apo grup por të dy mbikëqyrin drejtimin strategjik të njësisë së audituar dhe përmbushjen e detyrimeve të përgjegjshmërisë ose në situata të tjera ku identiteti i të ngarkuarve me qeverisje nuk është qartësisht i dukshëm, audituesit duhet të dokumentojnë procesin e ndjekur dhe përfundimet e arritura për identifikimin e individëve të përkatës për të marrë komunikimet e kërkuara të audituesve.

---

<sup>54</sup> Shih paragrafët 4.03 – 4.16 për diskutim shtesë të paragrafit 4.02 AE.

<sup>55</sup> Shih AICPA, AU-C Seksioni 260, Komunikim i audituesit me të ngarkuarit me qeverisjen.

---

**Kapitulli 4**  
**Standardet për Auditimin Financiar**

---

Auditimet e  
Mëparshme  
dhe Angazhimet  
për Certifikim

**4.05** Kur kryet një auditim GAGAS, audituesit duhet të vlerësojnë nëse njësia i audituar ka marrë masat e duhura korrigjuese për të adresuar gjetjet dhe rekomandimet nga angazhimet e mëparshme që mund të kenë efekt material në pasqyrat financiare apo të dhëna të tjera financiare të rëndësishme për objektivat e auditimit. Gjatë planifikimit të auditimit, audituesit duhet të pyesin menaxhimin e njësisë të audituar për të identifikuar auditimet e mëparshme, angazhimet për certifikime dhe studime të tjera që lidhen drejtpërdrejt me objektivat e auditimit, duke përfshirë edhe zbatimin e rekomandimeve. Audituesit duhet të përdorin këtë informacion në vlerësimin e riskut dhe përcaktimin e natyrës, kohës dhe shtrirjes së punës së auditimit, duke përfshirë përcaktimin e shkallës në të cilën testimi i zbatimit të veprimeve korrigjuese është i zbatueshëm për objektivat aktuale të auditimit.

---

Mashtrimi,  
Papajtuueshmëria  
me Dispozitat  
Ligjore dhe  
Rregulloret,  
Kontratat,  
Marrëveshjet e  
Grandit dhe  
Shpërdorimet

**4.06** Përveç kërkesave të AICPA-s në lidhje me mashtrimin<sup>56</sup> dhe moszbatimin e dispozitave të ligjeve dhe rregulloreve<sup>57</sup>, kur kryejnë një auditim financiar GAGAS, audituesit duhet të zbatojnë kërkesat AICPA që kanë të bëjnë me përgjegjësitë e audituesve ndaj ligjeve dhe rregulloreve duke zbatuar edhe shqyrtimin e përputhshmërisë me dispozitat e kontratave ose marrëveshjeve të grantit.

**4.07** Shpërdorimi përfshin sjellje që është me mangësi ose të pahijshme, krahasuar me sjelljen që një person i matur do të konsideronte praktikë biznesi të arsyeshme dhe domosdoshme në fakte dhe rrethana të dhëna.

---

<sup>56</sup> Shih AICPA-ja, AU-C Seksioni 240, Konsiderata e Mashtrimit në Auditimin e Pasqyrave Financiare.

<sup>57</sup> Shih AICPA-ja, AU-C Seksioni 250, Shqyrtimi i Ligjeve dhe Rregulloreve në një Auditim të Pasqyrave Financiare.

#### **Kapitulli 4**

#### **Standardet për Auditimin Financiar**

---

Shpërdorimi gjithashtu përfshin keqpërdorimin e autoritetit ose pozitës për interesa personale financiare ose ato të një anëtarit të familjes ose të afërmi apo bashkëpunëtor të lidhur të biznesit.<sup>58</sup> Shpërdorimi nuk përfshin domosdoshmërisht mashtrimin, ose moszbatimin e dispozitave ligjeve, rregulloreve, kontratave ose marrëveshjeve të grantit.

**4.08** Duke qenë se përcaktimi i shpërdorimit është subjekt, audituesve nuk u kërkohet të zbulojnë shpërdorime në auditimet financiare. Megjithatë, si pjesë e një auditimi GAGAS, nëse audituesit bëhen të vetëdijshëm për shpërdorime që mund të jenë materiale nga pikëpamja sasiore ose cilësore për pasqyrat financiare apo të dhëna të tjera financiare të rëndësishme për objektivat e auditimit, ata duhet të zbatojnë procedurat e auditimit të drejtuara në mënyrë specifike për të konstatuar efektin e mundshëm në pasqyrat financiare ose të dhënat e tjera financiare të rëndësishme për objektivat e auditimit. Pas kryerjes së punëve shtesë, audituesit mund të zbulojnë nëse shpërdorimi paraqet mashtrim të mundshëm apo moszbatim të dispozitave ligjore, rregulloreve, kontratave ose marrëveshjeve të grantit.

**4.09** Shmangia e ndërthurjeve me hetimet ose procedurat ligjore është e rëndësishme në ndjekjen e treguesve të mashtrimit, pajtueshmërisë me dispozitat ligjore, rregulloret, kontratat, ose marrëveshjeve të grantit, ose shpërdorimit. Ligjet, rregulloret, ose politikat mund t'u kërkojë audituesve të raportojnë treguesit për lloje të caktuara mashtrimi, moszbatimin të dispozitave ligjore, rregulloreve, kontratave ose marrëveshjeve të grantit, ose shpërdorimit, ndaj autoriteteve të zbatimit të ligjit apo atyre hetimore para kryerjes së procedurave të tjera të auditimit. Kur hetimet ose procedurat ligjore kanë filluar apo janë në proces, audituesit duhet të vlerësojnë ndikimin mbi auditimin aktual. Në disa raste, mund të jetë e përshtatshme për audituesit të punojnë me hetuesit ose autoritetet ligjore, ose të tërhiqen nga auditimi ose

---

<sup>58</sup> Shih paragrafin A.08 për shembuj shtesë të shpërdorimit.

**Kapitulli 4**  
**Standardet për Auditimin Financiar**

---

ta shtyjnë auditimin ose një pjesë të tij për të shmangur ndërthurjen me një hetim apo procedim ligjor në vazhdim.

---

Zhvillimi i  
Elementeve  
të një Gjetje

**4.10** Në një auditim financiar, gjetjet mund të përfshijnë mangësi në kontrollin e brendshëm; moszbatim të dispozitave ligjore, rregulloreve, kontratave ose marrëveshjeve të grantit; mashtrime; apo shpërdorime. Si pjesë e një auditimi GAGAS, kur audituesit identifikojnë gjetjet, ata duhet të planifikojnë dhe të kryejnë procedurat për të zhvilluar elementet e gjetjeve që janë të rëndësishme dhe të nevojshme për të arritur objektivat e auditimit. Elementet e gjetjeve diskutohen në paragrafët 4.11 – 4.14 më poshtë.

**4.11** Kriteret: Ligjet, rregulloret, kontratat, marrëveshjet e grantit, standardet, masat, performanca e pritshme, praktikat e vendosura të biznesit, si dhe standarde kundrejt të cilave performanca krahasohet apo vlerësohet. Kriteret identifikojnë gjendjen apo pritshmërinë e kërkuar apo të dëshiruar në lidhje me programin apo operacionin. Kriteret sigurojnë një kontekst për vlerësimin e evidencave dhe kuptimin e gjetjeve.

**4.12** Kushti: Kushti është një situatë që ekziston. Kushti përcaktohet dhe dokumentohet gjatë auditimit.

**4.13** Shkaku: Shkaku identifikon arsyen ose shpjegimin për gjendjen ose faktorin apo faktorët përgjegjës për diferencën midis situatës që ekziston (gjendjes) dhe gjendjes së kërkuar apo dëshiruar (kriteret), e cila mund të shërbejë si bazë për rekomandime për veprimet korrigjuese. Faktorët e përbashkët përfshijnë politikat e hartuara keq, procedurat, ose kriteret; zbatimin kontradiktor, jo të plotë, apo të pasaktë; ose faktorë jashtë kontrollit të menaxhimit të programit. Audituesit mund të vlerësojnë nëse gjetjet ofrojnë një argument të arsyeshëm dhe bindës përse shkaku i deklaruar është faktor apo faktorët kyç që kontribuojnë në ndryshimin midis gjendjes dhe kriterëve.

**Kapitulli 4**  
**Standardet për Auditimin Financiar**

---

**4.14** Efekti ose efekti i mundshëm: Efekti është një lidhje e qartë logjike për të përcaktuar ndikimin apo ndikimin e mundshëm të ndryshimit midis situatës që ekziston (gjendje) dhe asaj të kërkuar apo dëshiruar (kriteret). Efekti ose efekti i mundshëm identifikon rezultatet apo pasojat e gjendjes. Kur objektivat e auditimit përfshijnë identifikimin e pasojave aktuale ose të mundshme të një gjendje që ndryshon (ose pozitivisht ose negativisht) nga kriteret e identifikuar në auditim, "efekti" është një përlllogaritje e këtyre pasojave. Efekti ose efekti i mundshëm mund të përdoren për të treguar nevojën për veprim korrigjues, në përgjigje të problemeve të identifikuar ose risqeve përkatëse.

---

Dokumentimi i  
Auditimit

**4.15** Përveç kërkesave të AICPA-s për dokumentimin e auditimit,<sup>59</sup> audituesit duhet të jenë në përputhje me kërkesat e mëposhtme shtesë kur kryejnë një auditim financiar GAGAS.<sup>60</sup>

**a.** Dokumentimi i rishikimit nga mbikëqyrësit, para datës së publikimit të raport, të evidencave që mbështetin gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet e përfshira në raportin e audituesve.

**b.** Dokumentimi i çdo shmangie nga kërkesat GAGAS, ndikimi në auditim dhe në konkluzionet e audituesve kur auditimi nuk është në përputhje me kërkesat e zbatueshme GAGAS shkak të ligjit, rregulloreve, kufizimeve të fushës, kufizimeve në aksesin e të dhënave apo çështje të tjera që ndikojnë tek auditimi. Kjo vlen për shmangien nga kërkesat e pakushtëzuara dhe kërkesat e prezumuara të detyrueshme kur procedurat alternative të kryera në ato rrethana nuk kanë qënë të mjaftueshme për të arritur objektivat e kërkesave.<sup>61</sup>

---

<sup>59</sup> Shih AICPA-ja, AU-C Seksioni 230, Dokumentimi i Auditimit.

<sup>60</sup> Shih paragrafët 4.04, 4.06, 4.26, dhe 4.45 për kërkesat shtesë të dokumentimit lidhur me auditimet financiare.

<sup>61</sup> Shih paragrafët 2.24 dhe 2.25 për kërkesat shtesë të përputhshmërisë me GAGAS.

**Kapitulli 4**  
**Standardet për Auditimin Financiar**

---

**4.16** Kur kryejnë auditime financiare GAGAS që u nënshtrohen edhe dispozitave të zbatueshme ligjore dhe rregulloreve, audituesit duhet të vënë në dispozicion individët e duhur, si dhe dokumentacionin e auditimit, sipas kërkesave dhe në kohën e duhur për audituesit e tjerë ose rishikuesit. Është parim i auditimeve GAGAS që organizatat e auditimit federale, shtetërore dhe lokale, si dhe firmat e kontabilitetit publik të angazhuara në kryerjen e një auditimi financiar në përputhje me GAGAS, të bashkëpunojnë në programe auditimi me interes të përbashkët në mënyrë që audituesit të përdorin punën e të tjerëve dhe të shmangin mbivendosjen e përpjekjeve. Përdorimi i punës së audituesve nga audituesit e tjerë mund të lehtësohet nga marrëveshjet kontraktuale për auditimet GAGAS që ofrojnë akses të plotë dhe në kohë ndaj individëve dhe dokumentacionit të auditimit.

---

Kërkesat shtesë  
GAGAS për  
Raportimin mbi  
Kontrollet Financiare

**4.17** Përveç kërkesave të AICPA-s për raportim,<sup>62</sup> audituesit duhet të zbatojnë kërkesat shtesë të mëposhtme kur citojnë GAGAS në raportet e tyre. Kërkesat shtesë kanë të bëjnë me:

- a. raportimin e përputhshmërinë së audituesve me GAGAS;
- b. raportimin mbi kontrollin e brendshëm dhe përputhshmërinë me dispozitat ligjore, rregulloret, kontratat dhe marrëveshjet e grantit;
- c. komunikim e mangësive në kontrollin e brendshëm, mashtrimin, mospërputhjen me dispozitat e ligjeve, rregulloreve, kontratave, dhe marrëveshjeve të grantit dhe shpërdorimet;

---

<sup>62</sup> Shih AICPA-ja, AU-C Seksionet 700 Formimi i një Opinioni dhe Raportimi i Pasqyrave Financiare; 705 Modifikimi në Opininionin në Raportin e Audituesit të Pavarur, dhe 706 Paragrafëve e theksimi të çështjes dhe të tjerë Paragrafë në Raportin e Audituesit të Pavarur.

**Kapitulli 4**  
**Standardet për Auditimin Financiar**

---

- d. raportimin e pikëpamjeve të zyrtarëve përgjegjës;
- d. raportimin e informacionit sekret ose të ndjeshëm; dhe
- f. shpërndarjen e raporteve.<sup>63</sup>

---

Raportimi i  
Përputhshmërisë  
së Audituesve  
sipas GAGAS

**4.18.** Kur audituesit janë në pajtueshmëri me të gjithë kërkesat e aplikueshme të GAGAS për auditimet financiare, ata duhet të përfshijnë një deklaratë në raportin e auditimit që auditimi është kryer në pajtueshmëri me GAGAS<sup>64</sup>. Për shkak se GAGAS përfshin në referencë SASs AICPA<sup>65</sup>, GAGAS nuk kërkon që audituesit të citojnë përputhshmërinë me standardet e AICPA nëse citojnë përputhshmërinë me GAGAS. Në vijim, një njësi ekonomike që merr një raport të audituesve sipas GAGAS mund t'i kërkojë audituesve një raport auditimi financiar jo vetëm për qëllime të përputhshmërisë me një auditim të GAGAS<sup>66</sup>. GAGAS nuk i pengon audituesit që të nxjerrin një raport të veçantë që përputhet vetëm me standardet e AICPA apo standarde të tjera.

---

<sup>63</sup> Shih paragrafët 4.18 – 4.45 për paragrafin shtesë në vazhdim të 4.17 a – f.

<sup>64</sup> Shih paragrafët 2.24 dhe 2.25 për kërkesa shtesë të citimit të pajtueshmërisë me GAGAS

<sup>65</sup> Shih paragrafin 2.08 për një diskutim të SASs të AICPA të inkorporuara në GAGAS.

<sup>66</sup> Shih AICPA AU-C Seksioni 700, Formimi opinionit dhe Raportimi mbi Pasqyrat Financiare

---

**Kapitulli 4**  
**Standardet për Auditimin Financiar**

---

Raportimi për  
Kontrollin  
e Brendshëm dhe  
Pajtueshmëria me  
Dispozitat Ligjore,  
Rregulloret,  
Kontratat  
dhe Marrëveshjet e  
Grandit.

**4.19** Kur japin opinion mbi pasqyrat financiare , audituesit gjithashtu duhet të raportojnë për kontrollin e brendshëm mbi pasqyrat financiare<sup>67</sup> dhe për përputhshmërinë me dispozitat e e ligjeve, rregulloreve, kontratave apo marrëveshjeve të grantit të cilat kanë ndikim material në pasqyrat financiare<sup>68</sup>. Audituesit raportojnë për kontrollin e brendshëm dhe pajtueshmërinë, pavarësisht nëse kanë identifikuar apo jo mangësi të kontrollit të brendshëm apo raste të moszbatimit.

**4.20** Audituesit duhet të përfshijnë qoftë në të njëjtin raport apo dhe në raport të veçantë një përshkrim të fushëveprimit të testimit të audituesve për kontrollin e brendshëm në raportimin financiar dhe të përputhshmërisë me dispozitat ligjore, rregulloret, kontratat apo marrëveshjet e grantit. Audituesit duhet gjithashtu të deklarojnë në raport nëse testimet e kryera japin evidencë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të mbështetur opinionet mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm dhe mbi përputhshmërinë me dispozitat ligjore rregulloret , kontratat ose marrëveshjet e grandit.

**4.21** Objektiva e kërkesave të GAGAS për të raportuar për kontrollin e brendshëm në raportimin financiar ndryshon nga objektiva për një ekzaminim të kontrollit të brendshëm në pajtueshmëri me Deklaratën e Standardeve të Angazhimeve për Certifikim (SSAE) të AICPA sipas së cilës shprehet një opinion mbi projektimin apo ndërtimin dhe funksionimin efektiv të kontrollit të brendshëm të një njësie, sikurse zbatohen. Për të formuar bazat për shprehjen e një opinionit të

---

<sup>67</sup> Shih paragrafin A.05 për shembujt e mangësive në kontrollin e brendshëm

<sup>68</sup> Shih paragrafin A.11 për diskutim të mëtejshëm të ligjeve, rregulloreve, dhe dispozitave të kontratës dhe marrëveshjeve të grantit

**Kapitulli 4**  
**Standardet për Auditimin Financiar**

---

tillë audituesit do t'i nevojitet që të planifikojë dhe të kryejë ekzaminimin për të dhënë një nivel të lartë sigurie nëse njësia mban, në të gjitha aspektet materiale, kontroll të brendshëm efektiv mbi raportimin financiar si në një moment në kohë apo për një periudhë specifike<sup>69</sup>. Nëse audituesit japin një opinion për kontrollin e brendshëm, opinionin duhet të plotësojë kërkesën e GAGAS për raportimin mbi kontrollin e brendshëm.

**4.22** Nëse audituesit raportojnë veçmas ( përfshirë dhe raporte të veçanta në lidhje me të njëjtin dokument) për kontrollin e brendshëm në raportimin financiar dhe përputshmërinë me dispozitat ligjore, rregulloret, kontratat dhe marrëveshjet e grandit, ata duhet të deklarojnë në raportimin e audituesve, që ata janë duke nxjerrë këto raporte shtesë. Ata duhet të përfshijnë një referencë në raportet e veçanta dhe gjithashtu të deklarojnë që raportet për kontrollin e brendshëm mbi pasqyrat financiare dhe përputshmërinë me dispozitat ligjore, rregulloret, kontratat dhe marrëveshjet e grandit, janë një pjesë përbërëse e një auditimi të GAGAS kur merret në konsideratë kontrolli i brendshëm mbi pasqyrat financiare dhe përputshmëria e njësisë ekonomike.

---

Komunikimi i mangësive mbi kontrollin e brendshëm, mashtrimin, papajtueshmërinë me dispozitat e ligjeve, rregulloreve, kontratave dhe marrëveshjeve të grantit dhe shpërdorimi.

**4.23** Kur kryejnë auditime financiare sipas GAGAS, audituesit bazuar në punën e kryer, duhet të komunikojnë në raportin për kontrollin e brendshëm mbi pasqyrat financiare dhe pajtueshmërinë:1) mangësitë më të rëndësishme dhe dobësitë materiale në kontrollin e brendshëm; (2) rastet e mashtrimit dhe të papajtueshmërisë me dispozitat parashikimet ligjore dhe rregulloret që kanë ndikim material mbi auditimin dhe çdo rast tjetër që tërheq vëmendjen e të ngarkuarve me qeverisjen; (3) papajtueshmërinë me dispozitat e kontratave ose marrëveshjet e grandit që kanë një ndikim material mbi auditimin; dhe (4) shpërdorimi që ka një ndikim material në auditim;

---

<sup>69</sup> Shih AICPA AT Seksioni 501, Një ekzaminim i Kontrollit të Brendshëm në Pasqyrat Financiare të një njësie që është integruar me një Auditim të Pasqyrave të saj Financiare.

**Kapitulli 4**  
**Standardet për Auditimin Financiar**

---

Mangësitë në  
Kontrollin e  
Brendshëm

**4.24** Kërkesat e AICPA për të komunikuar me shkrim mangësitë më të rëndësishme dhe dobësitë materiale të identifikuara gjatë një auditimi<sup>70</sup> krijojnë bazat për raportimin për kontrollin e brendshëm mbi raportimin financiar kur këto mangësi identifikohen gjatë auditimit.

Mashtrimi,  
Papajtueshmëria  
me Dispozitat e  
Ligjeve,  
Rregulloreve,  
Kontratat dhe  
Marrëveshjet e  
Grandit  
dhe Shpërdorimi

**4.25** Kur kryhet një auditim financiar sipas GAGAS, dhe audituesit konkludojnë, bazuar në evidencë të mjaftueshme dhe të përshtatshme, që secila prej të mëposhtmeve ka ndodhur ose ka gjasa të ketë ndodhur, ata duhet të përfshijnë në raportin e tyre për kontrollin e brendshëm dhe pajtueshmërinë informacionin përkatës për :

**a.** mashtrimin<sup>71</sup> dhe papajtueshmërinë me dispozitat e ligjeve ose rregulloreve që kanë një ndikim material në pasqyrat financiare ose të dhëna të tjera financiare të rëndësishme për objektivat e auditimit dhe çdo rast tjetër që tërheq vëmendjen e të ngarkuarve me qeverisjen.

**b.** papajtueshmërinë me kushtet e kontratave ose marrëveshjeve të grandit që kanë një ndikim material në përcaktimin e shumave të pasqyrave financiare ose të dhëna të tjera financiare të rëndësishme për objektivat e auditimit; ose

**c.** shpërdorimin<sup>72</sup> që është material , si nga pikëpamja sasiore ashtu dhe cilësore<sup>73</sup>.

---

<sup>70</sup> Shih AICPA AU-C Seksioni 265, Komunikimi i Cështjeve të lidhura me kontrollin e brendshëm të identifikuara në një auditim.

<sup>71</sup> Shih paragrafin A.10 për shembuj të treguesve të riskut të mashtimit

<sup>72</sup> Shih paragrafin A.08 për shembuj të abuzimit.

<sup>73</sup> Shih paragrafet 4.07 dhe 4.08 për një diskutim të abuzimit

---

**Kapitulli 4**  
**Standardet për Auditimin Financiar**

---

**4.26** Kur audituesit zbulojnë raste të papajtueshmërisë me kushtet e kontratave apo të marrëveshjeve të grandit ose shpërdorim që ka ndikim material në pasqyrat financiare ose te dhëna të tjera financiare të rëndësishme për objektivat e auditimit që janë më pak materiale por tërheqin vëmendjen e të ngarkuarve me qeverisjen, ata duhet t'i komunikojnë këto gjetje me shkrim tek zyrtarët e njësisë ekonomike të audituar. Kur audituesit zbulojnë ndonjë rast të mashtrimit, papajtueshmërisë me dispozitat e ligjeve, rregulloreve, kontratave ose marrëveshjeve të grandit, ose shpërdorimit që nuk tërheq vëmendjen e të ngarkuarve me qeverisjen, vendimi i audituesve nëse dhe si të komunikojnë të tilla raste për zyrtarët e njësisë ekonomike të audituar është çështje e gjykimit profesional.

**4.27** Kur mashtrimi, papajtueshmëria me parashikimet e ligjeve, rregulloreve, kontratave ose marrëveshjet e grandit, ose shpërdorimi ka ndodhur ose ka gjasa të ndodhe, audituesit mund të këshillohen me autoritetet ose organet ligjore nëse publikimi i këtij informacioni do të komprometonte procedimin hetimor ose ligjor. Audituesit mund ta kufizojnë raportimin deri çështje të cilat nuk komprometojnë këto procedime, dhe për shembull, të raportojnë vetëm për informacionin që është tashmë një pjesë e të dhënave publike.

**4.28** Kur kryejnë një auditim financiar të GAGAS dhe paraqesin gjetje të tilla si mangësi të kontrollit të brendshëm, papajtueshmëri me dispozitat e ligjeve, rregulloreve, kontratave dhe marrëveshjeve të grandit, ose shpërdorim/shpërdorim, audituesit duhet të zhvillojnë elementet e gjetjeve në shtrirjen e nevojshme, përfshirë dhe gjetjet lidhur me mangësitë nga viti i mëparshëm por që nuk janë përmirësuar. Gjetjet e zhvilluara në mënyrë të qartë, siç diskutohen në paragrafët 4.10 deri 4.14, ndihmojnë menaxhimin ose nëpunësit mbikëqyrës e njësisë ekonomike të audituar për të kuptuar nevojën e ndërmarrjes së veprimeve korrigjuese. Nëse audituesit zhvillojnë mjaftueshëm elementët e një gjetjeje, ata mund të japin rekomandime për veprime korrigjuese.

Paraqitja e  
Gjetjeve ne  
Raportin e  
Audituesve

---

**Kapitulli 4**  
**Standardet për Auditimin Financiar**

---

Raportimi i  
Gjetjeve direkt  
tek Palët Jashtë  
Njesisë së  
Audituar

**4.29** Audituesit duhet të vendosin gjetjet e tyre në perspektivë duke përshkruar natyrën dhe shtrirjen e çështjes së raportuar dhe masën e punës së kryer që ka rezultuar në gjetje. Për t'i dhënë lexuesit bazat për të gjykuar për prevalencën dhe pasojat e këtyre gjetjeve , audituesit duhet , kur është e përshtatshme , të lidhin rastet e identifikuara me popullatën ose numrin e rasteve të ekzaminuara/shqyrtuara dhe të përcaktojnë sasinë e rezultateve në aspekte të vlerës së dollarit ose masa të tjera, Nëse rezultatet nuk mund te projektohen, audituesit duhet të kufizojnë në mënyrë të përshtatshme konkluzionet e tyre.

**4.30** Audituesit duhet të raportojnë mashtrimin e njohur apo të mundshëm, papajtueshmërinë me dispozitat e ligjeve, rregulloreve, kontratave ose marrëveshjet e grandit, ose shpërdorimin në mënyrë direkte tek palët jashtë njesisë ekonomike të audituar në dy rrethanat e mëposhtme:

**a.** Kur menaxhimi i njesisë ekonomike nuk arrin të përmbushë kërkesat ligjore ose rregullore për të raportuar këtë informacion palëve të jashtme të përcaktuara në ligj ose rregullore, audituesit duhet së pari t'ua komunikojnë dështimin për të raportuar këtë informacion tek të ngarkuarit me qeverisjen. Nëse njësia ekonomike e audituar ende nuk e raporton këtë informacion tek palët e jashtme të caktuara sa më shpejt të jetë e mundur pas komunikimit me të ngarkuarit me qeverisjen, atëherë audituesit duhet të raportojnë informacionin drejtpërdrejt me palët e jashtme të specifikuara.

**b.** kur menaxhimi i njesisë së audituar nuk arrin të ndërmarrë në kohë hapat e përshtatshëm për t'iu përgjigjur mashtrimit , papajtueshmërisë me ligjet, rregullat ,kontratat dhe marrëveshjet e grandit, ose shpërdorimin/shpërdorimin e njohur ose të mundshëm që (1) ka mundësi të ketë një ndikim material në pasqyrat financiare dhe (2) përfshin financimin e marrë direkt ose indirekt nga një agjenci qeveritare, audituesit duhet së pari të raportojnë dështimin e menaxhimit për të ndërmarrë në kohë hapat e përshtatshëm tek të ngarkuarit me

**Kapitulli 4**  
**Standardet për Auditimin Financiar**

---

qeverisjen. Nëse njësi e audituar ende nuk ka ndërmarrë hapat e përshtatshëm sa më shpejt që është e mundur pas komunikimit të audituesve me të ngarkuarit me qeverisjen, atëherë audituesit duhet ta raportojnë dështimin e njësisë së audituar për të ndërmarrë në kohë hapat e përshtatshëm drejtpërdrejt tek agjencia financuese.

**4.31** Raportimi në paragrafin 4.30 është vijim i çdo kërkesë ligjore për të raportuar këtë informacion direkt tek palët jashtë njësisë ekonomike të audituar. Audituesit duhet të jenë në pajtueshmëri me këto kërkesa edhe nëse ata janë dorëhequr apo larguar nga auditimi para përfundimit të tij.

**4.32** Audituesit duhet të marrin evidencë të mjaftueshme dhe të përshtatshme, të tillë si konfirmimet nga palët e jashtme, për të vërtetuar pohimet e menaxhimit të njësisë së audituar që ai i ka raportuar këto gjetje në përputhje me dispozitat e ligjeve, rregulloreve apo marrëveshjeve të financimit. Kur audituesit janë të paaftë të bëjnë këtë, ata duhet të raportojnë këtë informacion direkt siç diskutohet në paragrafët 4.30 dhe 4.31.

---

Raportimi  
pikëpamjeve  
të zyrtarëve  
përgjegjës

**4.33** Kur kryhet një auditim financiar i GAGAS, nëse raporti i auditimit jep informacione shpjeguese për mangësitë e kontrollit të brendshëm, mashtrimin, papajtueshmërinë me dispozitat e ligjeve, rregulloreve, kontratave ose marrëveshjeve të grandit, apo shpërdorimin, audituesit duhet të marrin dhe raportojnë pikëpamjet e zyrtarëve përgjegjës të njësisë ekonomike të audituar lidhur me gjetjet, konkluzionet, dhe rekomandimet, po ashtu dhe çdo veprim korrigjues të planifikuara.

**4.34** Dhënia e Projekt raportit me gjetje për rishikim dhe komente tek zyrtari përgjegjës i njësisë së audituar dhe të tjerët i ndihmon audituesit të hartojnë një raport që është i drejtë, i plotë dhe objektiv. Duke përfshirë pikëpamjet e zyrtarëve përgjegjës rezulton në një raport që paraqet jo vetëm gjetjet e audituesve, konkluzionet dhe rekomandimet, por gjithashtu dhe perspektivën e zyrtarëve përgjegjës të njësisë

**Kapitulli 4**  
**Standardet për Auditimin Financiar**

---

ekonomike të audituar dhe veprimet korrigjuese që ata planifikojnë të ndërmarrin. Preferohet marrja e komenteve me shkrim, por dhe komentet me gojë janë të pranueshme.

**4.35** Kur audituesit marrin komentet me shkrim nga zyrtarët përgjegjës, ata duhet të përfshijnë në raportin e tyre një kopje të komenteve të shkruara të zyrtarëve ose një përmbledhje të komenteve të marra. Kur zyrtarët përgjegjës japin vetëm komente me gojë, audituesit duhet të përgatisin një përmbledhje të komenteve me gojë dhe t'i japin një kopje të përmbledhjes zyrtarëve përgjegjës për të vërtetuar se komentet janë deklaruar me saktësi.

**4.36** Audituesit duhet gjithashtu të përfshijnë, kur është e përshtatshme, në raport një vlerësim të komenteve. Në rastet në të cilat njësitë ekonomike e audituar jep komente teknike në vijim të komenteve të saj me gojë apo të shkruara në raport, audituesit mund të japin informacione shpjeguese në raport që këto komente janë marrë.

**4.37** Marrja e komenteve me gojë mund të jetë e përshtatshme kur, p.sh, ka një datë raportimi kritike për të përmbushur kërkesat e përdoruesit, kur audituesit kanë punuar ngushtësisht me zyrtarëve përgjegjës gjatë gjithë kohës së punës dhe palët janë familjarizuar me gjetjet dhe çështjet e trajtuara në projekt-raport; ose kur audituesit nuk presin të kenë mosmarrëveshje të mëdha lidhur me gjetjet, konkluzionet, ose rekomandimet në projekt raport, ose kundërshti në lidhje me çështjet e diskutuara në projekt-raport.

**4.38** Kur komentet e njësisë ekonomike të audituar janë në kundërshti apo konflikt me gjetjet, konkluzionet ose rekomandimet në projekt-raport, ose kur veprimet korrigjuese të parashikuara nuk u adresohen në mënyrë të përshtatshme komenteve të audituesve, audituesit duhet të vlerësojnë vlefshmërinë e komenteve të njësisë së audituar. Nëse audituesit nuk janë dakord me komentet ata duhet të shpjegojnë në raport arsyet e tyre për këtë mospranim.

**Kapitulli 4**  
**Standardet për Auditimin Financiar**

---

Nga ana tjetër, audituesit duhet të modifikojnë raportin e tyre kur është e nevojshme në rast se ata i gjejnë komentet të vlefshme dhe të mbështetura në evidencë të mjaftueshme dhe të përshtatshme.

**4.39** Nëse njësia ekonomike e audituar refuzon të japë komentet apo nuk ka mundur të japë komente brenda një kohe të arsyeshme, audituesit mund të nxjerrin raportin pa i marrë komentet nga njësia ekonomike e audituar. Në këto raste, audituesit duhet të pasqyrojnë në raport që njësia ekonomike e audituar nuk ka dhënë komente.

---

Raportimi i  
Informacionit  
Sekret dhe me  
Ndjeshmëri

**4.40** Kur kryhet një auditim financiar i GAGAS, nëse një informacion i caktuar ndalohet nga të bërit publik ose është përjashtuar nga raporti për shkak të natyrës sekrete ose të ndjeshmërisë së informacionit, audituesit duhet të japin shpjegime në raport që një informacion i tillë është përjashtuar, si dhe arsyet apo kushtet e tjera që e bëjnë të domosdoshëm përjashtimin.

**4.41** Informacioni i caktuar mund të jetë klasifikuar ose ndryshe mund të jetë i ndaluar për shpërndarje të përgjithshme nga shteti federal, apo ligjet ose rregulloret lokale. Në këto situata, audituesit mund të lëshojnë një raport të veçantë, të klasifikuar ose me përdorim të kufizuar, i cili përmban të tillë informacion dhe shpërndajnë raportin vetëm për personat që janë të autorizuar nga ligji ose rregulloret për ta marrë atë.

**4.42** Rrethana të tjera që lidhen me sigurinë publike, jetën private ose probleme të sigurisë mund të arsyetojnë gjithashtu përjashtimin e një informacioni të caktuar nga një raport në dispozicion ose për t'u shpërndarë gjerësisht tek publiku. Për shembull, informacion i detajuar lidhur me sigurinë kompjuterike për një program të veçantë mund të përjashtohet nga raportet në dispozicion të publikut për shkak të dëmit të mundshëm që mund të shkaktohet nga keqpërdorimi i këtij

**Kapitulli 4**  
**Standardet për Auditimin Financiar**

---

informacioni dhe ta shpërndajë raportin vetëm për ato palë që janë përgjegjëse për të vepruar ndaj rekomandimeve të auditimit. Në disa raste, mund të jetë e përshtatshme që të publikohet si një raport i disponueshëm publikisht me informacionin të ndjeshëm të përjashtuar ashtu dhe një raport i përdorimit të kufizuar. Audituesit mund të këshillohen me këshillin ligjor lidhur me ndonjë kërkesë apo kushte të tjera që mund të kërkojnë lënien jashtë të informacionit të caktuar.

**4.43** Marrja në konsideratë e interesit të gjerë publik në programin apo veprimtarinë nën auditim, i ndihmon audituesit kur vendosin për të përjashtuar informacion të caktuar nga raportet në dispozicion të publikut. Kur rrethanat kërkojnë që të lihet jashtë informacion i caktuar, audituesit duhet të vlerësojnë nëse ky përjashtim mund të shtrembërojë rezultatet e auditimit ose të fshehin praktikat e paligjshme apo jokorrekte.

**4.44** Kur organizatat audituese janë subjekt i ligjeve të të dhënave publike, audituesit duhet të përcaktojnë nëse ligjet e të dhënave publike mund të ndikojnë disponueshmërinë e raporteve të përdorimit të kufizuar ose të klasifikuar, dhe të vendosin nëse ka mjete të tjera të komunikimit me menaxhimin dhe të ngarkuarit me qeverisjen të cilat janë më të përshtatshme. Për shembull, audituesit mund të komunikojnë informacion të përgjithshëm në një raport të shkruar dhe të komunikojnë informacion të detajuar me gojë. Audituesit mund të këshillohen me këshillin ligjor lidhur me ligjet e të dhënave publike të aplikueshme.

---

Shpërndarja  
e Raporteve

**4.45** Shpërndarja e raporteve të përfunduara në përputhje me GAGAS varet nga marrëdhënia e audituesve me organizatën e audituar dhe natyrën e informacionit që përmban raportin. Audituesit duhet të dokumentojnë çdo kufizim mbi shpërndarjen e raportit<sup>74</sup>. Diskutimet e mëparshme përshkruajnë shpërndarjen e përgjithshme për raportet e plotësuara në përputhshmëri me GAGAS:

---

<sup>74</sup> Shih paragrafët 4.41 dhe 4.42 për diskutim mbi përdorimin e kufizuar të raporteve që përmbajnë informacion konfidencial ose të ndjeshëm.

**Kapitulli 4**  
**Standardet për Auditimin Financiar**

---

a. Organizatat audituese në njësitë ekonomike qeveritare duhet të dërgojnë raportet e auditimit të ngarkuarit me qeverisjen, tek zyrtarët përkatës të njësisë ekonomike të audituar ose organizatave të cilat kanë kërkuar apo kanë rënë dakord për auditimin. Kur është e nevojshme, audituesit duhet të shpërndajnë kopje të raporteve tek zyrtarët e tjerë të cilët kanë autoritetin ligjor mbikëqyrës ose tyre që mund të jenë përgjegjës për të vepruar ndaj gjetjeve të auditimit dhe rekomandimeve, dhe të tjerë të autorizuar për të marrë të tilla raporte.

b. Organizatat e auditimit të brendshëm në njësitë qeveritare mund të ndjekin gjithashtu Standardet Ndërkombëtare për Praktikën Profesionale të Auditimit të Brendshëm të Institutit të Audituesve të Brendshëm (IIA)<sup>75</sup>. Në përputhje me GAGAS dhe Standardet e IIA, drejtuesi i auditimit të brendshëm duhet të komunikojë rezultatet tek palët të cilat mund të sigurojnë që rezultatet janë shqyrtuar si duhet. Nëse nuk përcaktohet ndryshe nga kërkesat statutoare apo rregullatore, para se të publikohen rezultatet për palët jashtë organizatës, drejtuesi i organizatës së auditimit të brendshëm duhet të: (1) vlerësojë riskun e mundshëm për organizatën, (2) këshillohet me menaxhimin e lartë ose organet ligjore sipas rastit dhe (3) kontrollojë shpërndarjen duke përcaktuar përdoruesit e synuar në raport.

c. Kompanitë e Auditimit Publik të kontraktuara për të kryer një auditim në pajtueshmëri me GAGAS duhet të qartësojnë përgjegjësitë e shpërndarjes së raportit me organizatën e angazhuar. Nëse kompania kontraktuese është përgjegjëse për shpërndarjen, me palën e kontraktuar duhet të arrihet marrëveshje se cilët prej zyrtarëve apo organizatave do të

---

<sup>75</sup> Shih paragrafin 2.21 për diskutim të mëtejshëm mbi përdorimin e standarteve të IIA-së të lidhura me GAGAS dhe paragrafin 2.22 për diskutim të mëtejshëm mbi citimin e përputhshmërisë me grup tjetër standartes.

---

**Kapitulli 4**  
**Standardet për Auditimin Financiar**

---

marrin raportin dhe hapat që janë ndërmarrë për ta bërë raportin të disponueshëm për publikun.

---

Konsiderata  
Shtesë  
të GAGAS për  
Auditimet  
Financiare

**4.46** Për shkak të objektivave dhe përgjegjshmërisë publike të auditimeve të GAGAS, mund të aplikohen konsiderata shtesë për auditimet financiare të kryera në pajtueshmëri me GAGAS. Këto konsiderata lidhen me:

**a.** materialitetin në auditimet financiare të GAGAS;  
dhe

**b.** komunikimin e hershëm të mangësive<sup>76</sup>.

---

Materialiteti në  
Auditimet  
Financiare  
sipas GAGAS

**4.47** Standardet e AICPA kërkojnë që audituesi të aplikojë në mënyrë të përshtatshme konceptim e materialitetit në planifikim dhe kryerjen e auditimit<sup>77</sup>. Konsiderata shtesë mund të aplikohen për auditimet financiare të GAGAS në njësitë qeverisëse ose njësitë që marrin financime qeveritare. Për shembull, në auditimet e kryera në pajtueshmëri me GAGAS, audituesit mund të gjejnë të përshtatshme që të përdorin nivele më të ulëta të materialitetit krahasuar me nivelin e materialitetit të përdorur në auditimet e jo sipas GAGAS për shkak të përgjegjshmërisë publike të njësitë qeverisëse dhe njësitë ekonomike që marrin fonde nga qeveria, kërkesave të ndryshme ligjore dhe rregullatore, dhe vizibilitetit/fokusit dhe ndjeshmërisë së programeve qeveritare.

---

<sup>76</sup> Shih paragrafët 4.47 deri në 4.48 për diskutim të mëtejshëm të paragrafit 4.46 a-b

<sup>77</sup> Shih AICPA AU-C Seksionin 320, *Materialiteti në planifikimin dhe kryerjen e një auditimit*

**Kapitulli 4**  
**Standardet për Auditimin Financiar**

---

Komunikimi  
i Hershem i  
Mangësive

**4.48** Për disa çështje, komunikimi i hershëm tek të ngarkuarit me qeverisjen ose menaxhimin, mund të jetë i rëndësishëm për shkak të lidhjes domethënëse dhe urgjencës të veprimeve pasuese korrigjuese<sup>78</sup>. Në vijim, kur një mangësi e kontrollit rezulton në papajtueshmëri me dispozitat e ligjeve, rregulloreve, kontratave dhe marrëveshjeve të grandit, ose shpërdorim, komunikimi i hershëm është i rëndësishëm që t'i mundësojë menaxhimin të ndërmarrë veprime korrigjuese për të parandaluar papajtueshmërinë. Kur një mangësi komunikohet herët, aplikohen kërkesat e raportimit në paragrafët 4.19 deri në 4.23.

---

<sup>78</sup> Shih AICPA AU-C Seksioni 265, Komunikimi i Çështjeve të Lidhura me kontrollin e brendshëm të identifikuar në auditim.

---

## Standardet e Angazhimeve për Certifikim

---

### Hyrje

**5.01** Ky kapitull përmban kërkesat, udhëzimet dhe konsiderata për kryerjen dhe raportimin e angazhimeve për certifikim të kryera në pajtueshmëri me standardet e auditimit qeveritar të pranuar përgjithësisht (GAGAS). Audituesit që kryejnë angazhime për certifikim në pajtueshmëri me GAGAS duhet të përputhen me Standardin e Përgjithshëm të Vërtetimit mbi kriteret të Institutit Amerikan të Kontabilistëve të Certifikuar Publikë (AICPA), standardet e punës në terren dhe të raportimit, dhe deklaratat përkatëse mbi standardet e angazhimeve të certifikimit (SSAEs), të cilat janë përfshirë në këtë kapitull si referenca<sup>79</sup>. Audituesit që kryejnë angazhimet për certifikim në pajtueshmëri me GAGAS duhet gjithashtu të pajtohen me kërkesat shtesë në këtë kapitull. Kërkesat dhe udhëzimet që përfshihen në kapitujt 1 deri në 3 aplikohen gjithashtu për angazhimet për certifikim të kryera në pajtueshmëri me GAGAS.

**5.02** Një angazhim për certifikim mund të jap një nga tre nivelet e shërbimit që përcaktohen nga AICPA, të quajtura angazhim shqyrtimi, një angazhim rishikimi, ose një angazhim të sipas procedurave të pranuar<sup>80</sup>. Audituesit që kryejnë një angazhim për certifikim duhet të vendosin cilin nga tre nivelet e shërbimit të aplikojnë në këtë angazhim dhe t'i referohen standardeve përkatëse të AICPA dhe seksionit të GAGAS të mëposhtëm për kërkesat dhe konsideratat e aplikueshme për Angazhimet e Ekzaminimit.

---

<sup>79</sup> AICPA AT Seksioni 50, *SSAE Hierarkia*

<sup>80</sup> Shih paragrafin 2.09 dhe AICPA AT Seksioni 101, Angazhimet e Certifikimit

**Kapitulli 5**  
**Standardet e Angazhimeve**  
**për Certifikim**

---

---

**Angazhimet e Ekzaminimit**

---

**Kërkesa shtesë**  
të punës në terren  
për Angazhimet e  
Ekzaminimit

**5.03** GAGAS përcakton kërkesat e punës në terren për kryerjen e angazhimeve të ekzaminimit në vijim të kërkesave që përmbajnë standardet e AICPA. Audituesit duhet të pajtohen me këto kërkesa shtesë, së bashku me standardet përkatëse të AICPA për Angazhimet për Certifikim Ekzaminuese, kur citojnë GAGAS në raportet e tyre ekzaminuese. Kërkesat shtesë të punës në terren lidhen me:

- a. komunikimin e audituesit;
- b. Auditimet dhe Angazhimet për Certifikim të mëparshme;
- c. mashtrimin, papajtueshmërinë me ligjet rregullore, kontratat dhe marrëveshjet e grandit, dhe shpërdorimin/shpërdorimin;
- d. zhvillimin e elementëve të një gjetjeve;  
dhe
- e. dokumentimin e angazhimit ekzaminues<sup>81</sup>.

---

**Komunikimi**  
**Audituesit**

**5.04** Në vijim të kërkesave të AICPA për komunikimin e audituesit<sup>82</sup> kur kryejnë një angazhim ekzaminues të GAGAS, audituesit duhet të komunikojnë informacionin lidhur me çështjen që në gjykimin profesional të audituesve, nevojitet t'u komunikohet individëve të kontraktuar ose që kanë kërkuar angazhimin ekzaminues, dhe për komisionet e njohura ligjrisht kur audituesit kryejnë angazhimin ekzaminues sipas një ligji apo rregullore, ose ata kryejnë punën për llogari të komisioneve ligjore që kanë mbikëqyrjen e njësisë ekonomike të audituar.

---

<sup>81</sup> Shih paragrafët nga 5.04 deri në 5.17 për diskutime shtesë të 5.03 a-e.

<sup>82</sup> Shih AICPA AT Seksionin 101.14 dhe 101.46, Angazhimet e Vërtetimit

**Kapitulli 5**  
**Standardet e Angazhimeve**  
**për Certifikim**

---

**5.05** Në ato situata ku nuk ka një individ ose grup të vetëm apo që të dy të mbikëqyrin drejtimin strategjik të njësisë ekonomike të audituar ashtu dhe përmbushjen e detyrimeve të saj të përgjegjshmërisë ose në situata të tjera ku identiteti i të ngarkuarve me qeverisjen nuk është i qartësisht i evidentueshëm, audituesit duhet të dokumentojnë procesin e ndjekur dhe konkluzionet e arritura për identifikimin e individëve përkatës për të marrë komunikimin e kërkuar të audituesit.

---

Auditimet dhe  
Angazhimet për  
Certifikim

**5.06** Kur kryhet një angazhim ekzaminues GAGAS, audituesit duhet të vlerësojnë nëse njësia e audituar ka ndërmarrë veprimet korrigjuese përkatëse për të trajtuar gjetjet dhe rekomandimet nga auditimet e mëparshme që mund të kenë një ndikim, material mbi çështjen në shqyrtim , ose një vlerësim mbi çështjen në shqyrtim të angazhimit ekzaminues. Ku planifikohet angazhimi, audituesit duhet të pyesin menaxhimin e njësisë së audituar për të identifikuar auditime të mëparshme, Angazhimet për Certifikim dhe studime të tjera që lidhen direkt me çështjen në shqyrtim ose një vlerësim rreth çështjes në shqyrtim të angazhimit të ekzaminimit që është ndërmarrë, përfshirë nëse rekomandimet përkatëse janë implementuar. Audituesit duhet ta përdorin informacionin në vlerësimin e riskut dhe përcaktimin e natyrës kohës dhe shtrirjes së punës aktuale, përfshirë përcaktimin e masës në të cilën testimi i implementimit të veprimeve korrigjuese është i aplikueshëm për objektivat e angazhimit ekzaminues aktual.

**Kapitulli 5**  
**Standardet e Angazhimeve**  
**për Certifikim**

Mashtrimi,  
Papajtueshmëria  
me  
Dispozitat e  
Ligjeve,  
Rregulloreve,  
Kontratave, dhe  
Marrëveshjeve të  
Grandit, dhe  
Shpërdorimi.

**5.07** Në vijim të kërkesave të AICPA lidhur me mashtrimin<sup>83</sup>, kur kryen një angazhim ekzaminues të GAGAS, audituesit duhet të planifikojnë angazhimin për të zbuluar rastet e mashtrimit dhe papajtueshmërisë me dispozitat ligjore, rregulloreve, kontratave dhe marrëveshjeve të grantit që mund të kenë ndikim material mbi çështjen në shqyrtim ose pohim mbi atë të angazhimit ekzaminues. Kur identifikohen faktorët e riskut, audituesit duhet të dokumentojnë faktorët e riskut të identifikuar, përgjigjen e audituesve ndaj këtyre faktorëve të riskut si individualisht ose të kombinuar dhe konkluzionet e audituesve<sup>84</sup>.

**5.08** Shpërdorimi përfshin sjellje që kanë mangësi ose janë të pahijshme, krahasuar me sjelljen që një person i matur do të konsideronte praktikë biznesi të arsyeshme dhe domosdoshme në fakte dhe rrethana të caktuara. Shpërdorimi gjithashtu përfshin keqpërdorimin e autoritetit ose pozitës për interesa personale financiare ose ato të një anëtari të familjes ose bashkëpunëtor të ngushtë ose të biznesit lidhur me të.<sup>85</sup> Shpërdorimi nuk përfshin domosdoshmërisht mashtrimin, ose moszbatimin me dispozitat e ligjeve, rregulloreve, kontratave ose marrëveshjeve të grantit.

<sup>83</sup> Shih AICPA AT Seksionet 501.27, Një ekzaminim një Kontrolli të Brendshëm të Njësisë mbni Raportimin Financiar që integrohet me një Auditim të Pasqyrave të saj Financiare, 601.33, *Vërtetimi i Pajtueshmërisë*, dhe 701.42, Diskutimi i Menaxhimit dhe Analizat.

<sup>84</sup> Shih paragrafët nga A.09 deri A.13 për diskutim shtesë të indikatorëve të riskut të mashtrimit dhe rëndësisë së dispozitave të ligjeve, rregulloreve, dhe kontratave dhe marrëveshjeve të grantit

<sup>85</sup> Shih paragrafin A.08 për shembuj shtesë të abuzimit.

**Kapitulli 5**  
**Standardet e Angazhimeve**  
**për Certifikim**

---

**5.09** Për shkak se përcaktimi i shpërdorimit është njësiav, audituesve nuk u kërkohet që të zbulojnë shpërdorimin në angazhimet shqyrtuese. Megjithatë si pjesë e një angazhimi ekzaminues të GAGAS, nëse audituesit janë të vetëdijshëm që shpërdorimi mund të jetë material nga pikëpamja sasiore ose cilësore, audituesit duhet të aplikojnë procedura të drejtuara në mënyrë të veçantë për pohimin e efektit/ ndikimit potencial mbi çështjen në shqyrtim, ose pohimin mbi të, ose të dhëna të tjera domethënëse për objektivat e angazhimit ekzaminues. Pasi të kryejë punë shtesë, audituesit mund të zbulojnë që shpërdorimi përfaqëson mashtrim të mundshëm ose moszbatim të dispozitave ligjore, rregulloreve, kontratave ose marrëveshjeve të grantit.

**5.10** Shmangia e ndërhyrjes me procedurat investiguese /hetuese ose ligjore është e rëndësishme në ndjekjen e treguesve të mashtrimit, papajtueshmërisë me parashikimet e ligjeve, rregulloreve, kontratave dhe marrëveshjeve të grantit, ose shpërdorimit. Ligjet, rregulloret ose politikat mund t'i kërkojnë audituesve të raportojnë treguesit e llojeve të caktuara të mashtrimit, moszbatimin e dispozitave të ligjeve, rregulloreve, kontratave ose marrëveshjeve të grantit dhe shpërdorimin ndaj detyrimeve ligjore ose autoriteteve investiguese/hetimore para se të kryhen procedura auditimi shtesë. Kur procedurat e investigimit dhe ligjore kanë filluar apo janë në proces, audituesit duhet të vlerësojnë impaktin në angazhimin ekzaminues aktual. Në disa raste, mund të jetë e përshtatshme për audituesit që të punojnë me hetuesit ose autoritetet ligjore, ose të tërhiqet nga, ose të shtyjë më tej punën për angazhimin për certifikim ose nga një pjesë e angazhimit për certifikim për të shmangur ndërhyrjen me një hetim apo procedim ligjor në vazhdim.

**Kapitulli 5**  
**Standardet e Angazhimeve**  
**për Certifikim**

---

Zhvillimi  
elementëve  
të një gjetjeje

**5.11** Në një angazhim ekzaminues, gjetjet mund të përfshijnë mangësi në kontrollin e brendshëm, papajtueshmërinë me dispozitat e ligjeve, rregulloreve, kontratave ose marrëveshjeve të grantit; mashtrimin; shpërdorimin.

Si pjesë e një angazhimi ekzaminues të GAGAS, kur audituesit identifikojnë gjetjet, audituesit duhet të planifikojnë dhe kryejnë procedura për të zhvilluar elementet e gjetjeve që janë të lidhura dhe të nevojshme për të arritur objektivat e angazhimit të ekzaminimit. Elementët e një gjetjeje janë diskutuar në paragrafët 5.12 deri tek 5.15 më poshtë.

**5.12** Kriteret: Ligjet, rregulloret, kontratat marrëveshjet e grantit, standardet, mjetet, performanca e pritshme, praktikat e biznesit të vendosura, dhe analizat kundrejt të cilave vlerësohet ose krahasohet performanca. Kriteret identifikojnë gjendjen e kërkuar ose të dëshiruara apo pritshmëritë në lidhje me programin ose funksionimin. Kriteret japin një kontekst për vlerësimin e evidencës dhe kuptimin e gjetjeve.

**5.13** Kushti: Kushti është një situatë që ekziston . Kushti përcaktohet dhe dokumentohet gjatë angazhimit.

**5.14** Shkaku: Shkaku identifikon arsyen ose shpjegimin për gjendjen ose faktorin apo faktorët përgjegjës për ndryshimin midis situatës që ekziston ( gjendjes) dhe të dhënave të kërkuara ose të dëshiruara (kriteret) të cilat gjithashtu mund të shërbejnë si një bazë për rekomandimet për veprime korrigjuese. Faktorët e zakonshëm përfshijnë politika, procedura, ose kritere të hartuara keq, papajtueshmërinë, zbatim jo të plotë ose jo korrekt; ose faktorë jashtë kontrollit të menaxhimit të programit. Audituesit mund të vlerësojnë nëse evidenca ofron një argument të arsyeshëm dhe bindës për të cilin shkaku i deklaruar është faktori ose faktorët kyç që kontribuojnë në ndryshimin midis gjendjes dhe kriterit.

**5.15** Efekti ose efekti i mundshëm: efekti është një lidhje e pastër logjike për të përcaktuar ndikimin ose ndikimin e mundshëm të diferencës midis situatës që ekziston ( gjendjes) dhe gjendjes së kërkuar apo të dëshiruara ( kriterit).

**Kapitulli 5**  
**Standardet e Angazhimeve**  
**për Certifikim**

---

Efekt i ose efekti i mundshëm identifikon rezultatet apo pasojat e gjendjes. Kur objektivat e auditimit përfshijnë identifikimin e pasojave aktuale ose të mundshme të një gjendje që ndryshon (ose pozitivisht ose negativisht) nga kriteret e identifikuar në angazhim, "efekti" është një përlllogaritje apo matës i këtyre pasojave. Efekt i ose efekt i mundshëm mund të përdoren për të treguar nevojën për veprim korrigjues, në përgjigje të problemeve të identifikuar ose risqeve përkatëse.

---

**Dokumentimi i**  
**Angazhimeve**  
**të Ekzaminimit**

**5.16** Në vijim të kërkesave të AICPA për dokumentimin e auditimit<sup>86</sup>, audituesit duhet të pajtohen me kërkesat e mëposhtme shtesë kur kryejnë një angazhim ekzaminues të GAGAS<sup>87</sup>.

**a.** Përgatitja e dokumentacionit vërtetues në detaje të mjaftueshme që t'i mundësojë një audituesi me eksperiencë, që nuk ka patur lidhje të mëparshme me angazhimin e ekzaminues, të kuptojë nga dokumentimi natyrën kohën dhe shtrirjen dhe rezultatet e procedurave të kryera, evidencën e marrë e burimin e saj dhe konkluzionet e arritura, përfshirë evidencën që mbështet gjykimin e rëndësishëm dhe konkluzionet e audituesit. Një auditues me eksperiencë nënkupton një individ (nga brenda apo jashtë organizatës) i cili zotëron kompetencat dhe aftësitë për të qenë i aftë të kryejë angazhime ekzaminuese. Këto kompetenca dhe aftësi përfshijnë një njohje të (1) proceseve të angazhimit ekzaminues dhe të lidhura me SSAEs<sup>88</sup>, (2) kërkesat e GAGAS dhe kërkesat ligjore e rregullatore të aplikueshme, (3) çështjen në shqyrtim mbi të cilën audituesit janë angazhuar të raportojnë, (4) përshtatshmëria dhe vlefshmëria e kriterëve, dhe (5) çështjet lidhur me mjedisin e njësisë së audituar.

---

<sup>86</sup>Shih AICPA AT Seksionet 101.100–101.107, Angazhimet e Vërtetimit.

<sup>87</sup> Shih paragrafët 5.05, 5.07, 5.25, dhe 5.44 për kërkesat shtesë të dokumentimit lidhur me angazhimet e vërtetimit

<sup>88</sup> Shih paragrafët 3.74 dhe 3.75 për diskutime shtesë të kualifikimeve për angazhimet e vërtetimit.

**Kapitulli 5**  
**Standardet e Angazhimeve**  
**për Certifikim**

---

**b.** Dokumentimi rishikimit mbikëqyrës, para datës së raportit të ekzaminimit, i evidencës që mbështet gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet që përmban raporti ekzaminimit.

**c.** Dokumentimi i çdo shmangie nga kërkesat e GAGAS dhe ndikimin në angazhim dhe në konkluzionet e audituesve kur angazhimi ekzaminues nuk është në përputhje me kërkesat e GAGAS të aplikueshme të ligjit, rregullores, kufizimit të objektit, kufizimeve në aksesin në të dhëna, apo çështje të tjera që ndikojnë në auditim. Kjo aplikohet për shmangie nga kërkesa të pakushtëzuara dhe nga kërkesat e detyrueshme të prezumuara atëherë kur procedurat alternative të kryera në këto kushte nuk kanë qenë të mjaftueshme për të arritur objektivat e kërkesës<sup>89</sup>.

**5.17** Kur kryhen angazhimet ekzaminuese të GAGAS dhe që janë subjekt i ligjeve dhe rregulloreve të aplikueshme, audituesit duhet të bëjnë të disponueshëm individët përkatës po ashtu dhe dokumentacionin vërtetues, kur dhe në kohën që kërkohet për audituesit e tjerë apo rishikuesit. Theksimi i angazhimeve të GAGAS është një parakusht që organizatat e auditimit në qeverisjen federale, shtetërore dhe lokale dhe firmat kontabiliste publike të angazhuara për kryerjen e një angazhimi në pajtueshmëri me GAGAS të bashkëpunojnë në kryerjen e angazhimeve ekzaminuese të programeve me interesa të përbashkëta me qëllim që audituesit të mund të përdorin punën e të tjerëve dhe të shmangin mbivendosjen e përpjekjeve. Përdorimi i punës së audituesve nga auditues të tjerë mund të lehtësohet nga marrëveshje kontraktuale për angazhimet GAGAS që ofrojnë akses të plotë dhe në kohë për individë përkatës, po ashtu dhe dokumentimin e certifikimit.

---

<sup>89</sup> Shih paragrafin 2.15 për një përkufizim të kërkesave të GAGAS

**Kapitulli 5**  
**Standardet e Angazhimeve**  
**për Certifikim**

---

Kërkesa shtesë të raportimit sipas GAGAS për angazhimet ekzaminuese

**5.18** Në vijim të kërkesave të AICPA për raportimin mbi angazhimet ekzaminuese<sup>90</sup>, audituesit duhet të pajtohen me kërkesat shtesë të mëposhtme kur citojnë GAGAS në raporte të tyre të ekzaminimit. Kërkesat shtesë të raportimit lidhen me:

- a. raportimin e pajtueshmërisë së audituesve me GAGAS;
- b. raportimin e mangësive në kontrollin e brendshëm, mashtrimin, papajtueshmërinë me parashikimet e ligjeve, rregulloreve, kontratave, dhe marrëveshjeve të grandit, dhe shpërdorimin;
- c. raportimin e pikëpamjeve të zyrtarëve përgjegjës;
- d. raportimin e informacionin sekret ose të ndjeshëm; dhe
- e. shpërndarjen e raporteve<sup>91</sup>.

---

Raportimi i Përputhshmërisë së audituesve me GAGAS

**5. 19** Kur audituesit plotësojnë të gjitha kërkesat e zbatueshme të GAGAS për angazhimet e ekzaminimit, ata duhet të përfshijnë një deklaratë në raportin e ekzaminimit që ata e kanë kryer ekzaminimin në përputhje me GAGAS<sup>92</sup>. Për shkak se GAGAS përfshijnë referenca të standardit të përgjithshëm për certifikim të AICPA mbi kriteret, standardet e punës në terren dhe standardet e raportimit të certifikimit, dhe SSAE- të koresponduese, GAGAS nuk kërkojnë që audituesit të citojnë pajtueshmërinë me standardet e AICPA kur ata kanë

---

<sup>90</sup> Shih AICPA AT Seksioni 101.63-101.87, Angazhimet për certifikim.

<sup>91</sup> Shih paragrafët 5.19 deri 5.44 për një diskutim të detajuar të paragrafit 5.18 a-e.

<sup>92</sup> Shih paragrafët 2.24 dhe 2.25 për kërkesa shtesë mbi citimin e përputhshmërisë me GAGAS.

---

**Kapitulli 5**  
**Standardet e Angazhimeve**  
**për Certifikim**

---

cituar pajtueshmërinë me GAGAS. GAGAS nuk i ndalojnë audituesit nga nxjerrja i një raporti të veçantë në pajtueshmëri vetëm me kërkesat e AICPA ose të standardeve të tjera<sup>93</sup>.

---

Raportimi i mangësive të kontrollit të brendshëm, mashtrimin, papajtueshmërinë me dispozitat e Ligjeve, Rregulloret. Kontratat dhe Marrëveshjet e Grantit, dhe shpërdorimi/shpërdorimi.

**5.20** Kur kryhen angazhimet ekzaminuese të GAGAS audituesit duhet të raportojnë, bazuar në punën e kryer, (1) mangësitë të rëndësishme dhe dobësitë materiale në kontrollin e brendshëm<sup>94</sup>; (2) rastet e mashtrimit<sup>95</sup> dhe papajtueshmërinë me dispozitat e ligjeve ose rregulloreve që kanë një efekt material mbi çështjen në shqyrtim ose një pohim mbi çështjen në shqyrtim dhe çdo rast tjetër që tërheq vëmendjen e të ngarkuarve më qeverisjen; (3) papajtueshmërinë me dispozita të kontratave ose marrëveshjet e grantit që ka një efekt material mbi çështjen në fjalë ose një pohim mbi çështjen subjekt i angazhimit ekzaminues; dhe (4) shpërdorimin që ka një efekt material mbi çështjen në shqyrtim ose një pohim mbi çështjen subjekt i angazhimit ekzaminues. Audituesit duhet të përfshijnë këtë informacion qoftë si pjesë e të njëjtit raport ose si një raport të veçantë.

**5.21** Nëse audituesit raportojnë veçmas (përfshirë raporte të veçanta të lidhura me të njëjtin dokument) mbi çështjen e diskutuar në paragrafin 5.20, ata duhet të deklarojnë në raportin ekzaminues që ata janë duke nxjerrë këto raporte shtesë. Ata duhet të përfshijnë një referencë për raportet e veçanta dhe gjithashtu të deklarojnë që raportet janë pjesë integrale e një angazhimi ekzaminues sipas GAGAS.

---

<sup>93</sup> Shih AICPA AT Seksionet 101. 85e, *Angazhimet për Certifikim*

<sup>94</sup> Shih paragrafin A. 06 për shembuj të mangësive në kontrollin e brendshëm.

<sup>95</sup> Shih paragrafin A. 10 për shembuj të treguesve të riskut të mashtrimit

---

**Kapitulli 5**  
**Standardet e Angazhimeve**  
**për Certifikim**

---

Mangësitë në  
Kontrollin e  
Brendshëm

**5.22** Në vijim të kërkesave të AICPA lidhur me kontrollin e brendshëm<sup>96</sup>, kur kryhen Angazhimet për Certifikim sipas GAGAS, përfshirë Angazhimet për Certifikim lidhur me kontrollin e brendshëm<sup>97</sup>, audituesit duhet të përfshijnë në raportin e ekzaminimit të gjitha mangësitë, edhe ato të raportuara më parë<sup>98</sup>, të cilat konsiderohen të jenë mangësi të rëndësishme ose dobësi materiale.

**5.23** Përcaktimi nëse dhe si të komunikohen tek zyrtarët e njësisë së audituar mangësitë e kontrollit të brendshëm që tërheqin vëmendjen e të ngarkuarve me qeverisjen, por që nuk janë konsideruar mangësi të rëndësishme, domethënëse ose dobësi materiale, është një çështje e gjykimit profesional.

Mashtrimi,  
Papajtueshmëria  
me Dispozitat e  
Ligjeve,  
Rregulloreve,  
Kontratave dhe  
Marrëveshjet e  
Grandit,dhe  
Shpërdorimi

**5.24** Kur kryhet një angazhim për certifikim sipas GAGAS, dhe audituesit, bazuar në një evidencë të mjaftueshme dhe të përshtatshme, arrijnë në konkluzionin që secila prej të mëposhtëmve ka ndodhur ose ka gjasa të ketë ndodhur, ata duhet të përfshijnë në raportin e tyre të shqyrtimit informacionin përkatës rreth:

**a.** mashtrimin<sup>99</sup> dhe papajtueshmërisë me dispozitat e ligjeve apo rregulloreve që kanë një efekt material mbi çështjen e shqyrtuar ose një pohim mbi çështjen në shqyrtim dhe çdo rast tjetër që tërheq vëmendjen e të ngarkuarve me qeverisjen,

---

<sup>96</sup> Shih AICPA AT Seksioni nga 101.52 deri 101.53, *Angazhimet e Vërtetimit*.

<sup>97</sup> Shih AICPA AT Seksioni 501.07, një ekzaminim i Kontrollit të Brendshëm të një Njësie mbi Raportimin Financiar që integrohet me një Auditim të Pasqyrave Financiare.

<sup>98</sup> Shih paragrafin 5.47 për një diskutim të komunikimit të hershëm të mangësive

<sup>99</sup> Shih paragrafin A. 10 për shembuj të treguesve të riskut të mashtrimit

**Kapitulli 5**  
**Standardet e Angazhimeve**  
**për Certifikim**

---

b. papajtueshmërinë me dispozitat e kontratave ose marrëveshjeve të grantit që kanë efekt material mbi çështjen e shqyrtuar ose një pohim mbi çështjen e shqyrtuar , ose

c. shpërdorimin<sup>100</sup> që është material për çështjen e shqyrtuar , si nga pikëpamja sasiore ashtu dhe nga pikëpamja cilësore<sup>101</sup>.

**5.25** Kur audituesit zbulojnë raste të papajtueshmërisë me dispozitat e kontratave dhe marrëveshjeve të grantit , ose shpërdorim që ka një efekt mbi çështjen e ekzaminuar ose një pohim mbi çështjen e ekzaminuar që janë më pak materiale por që tërheqin vëmendjen e të ngarkuarve me qeverisjen, ata duhet tua komunikojnë me shkrim këto gjetje zyrtarëve të njësisë së audituar. Kur audituesit zbulojnë ndonjë rast të mashtrimit, papajtueshmërisë me ligjet dhe rregulloret, kontratat, ose marrëveshjet e grantit, ose shpërdorim që nuk kërkon vëmendjen e të ngarkuarve me qeverisjen , vendimi i audituesve nëse dhe se si do tua komunikojnë këto raste zyrtarëve të njësisë së audituar është çështje e gjykimit profesional.

**5.26** Kur mashtrimi, papajtueshmëria me ligjet, rregulloret, kontratat ose marrëveshjet e grantit, ose shpërdorim kanë ndodhur ose ka gjasa të ndodhë , audituesit mund të këshillohen me autoritetet ose organet ligjore nëse publikimi i raportimit të këtyre informacioneve mund të komprometojë procedimin investigativ/ hetimor ose ligjor. Audituesit mund të kufizojnë raportimin e tyre publik vetëm për çështjet të cilat mund të mos e komprometojnë këto procedime dhe, për shembull të raportojnë vetëm për atë informacion që është tashmë një pjesë e të dhënave publike.

---

<sup>100</sup> Shih paragrafin A. 08 për shembuj të abuzimit

<sup>101</sup> Shih paragrafët 5.08 dhe 5.09 për një diskutim të abuzimit.

**Kapitulli 5**  
**Standardet e Angazhimeve**  
**për Certifikim**

---

Paraqitja e  
Gjetjeve  
në Raportin e  
Ekzaminimit

**5.27** Kur kryhet një angazhim ekzaminues sipas GAGAS dhe prezantohen gjetje të tilla si mangësitë e kontrollit të brendshëm , mashtrimi, papajtueshmëria me dispozitat e ligjeve, rregulloreve, kontratave , ose marrëveshjet e grantit , apo shpërdorimin, audituesit duhet të zhvillojnë elementët e gjetjeve në shtrirjen e nevojshme. Gjetjet e zhvilluara në mënyrë të qartë , si diskutohet në paragrafët 5.11 deri në 5.15, ndihmojnë menaxhimin ose zyrtarët mbikëqyrës të njësisë së audituar të kuptojnë nevojën për të ndërmarrë veprime korrigjuese , dhe ndihmojnë audituesit të japin rekomandime për veprime korrigjuese. Nëse audituesit zhvillojnë mjaftueshëm elementë të një gjetje , ata mund të japin rekomandime për veprime korrigjuese.

**5.28** Audituesit duhet të vendosin gjetjet e tyre në perspektivë duke shpjeguar natyrën dhe shtrirjen e çështjeve që raportohen dhe masën e punës të kryer që rezulton në këto gjetje. Për të dhënë lexuesit një bazë për të gjykuar prevalencën dhe pasojat e këtyre gjetjeve, audituesit duhet, sipas rastit, të lidhin rastet e identifikuara me popullatën ose numrin e rasteve të ekzaminuara dhe të përcaktojnë sasinë e rezultateve në aspekte të vlerës së dollarit apo masave të tjera. Nëse rezultatet nuk mund të projektohen, audituesit duhet të kufizojnë në mënyrë të përshtatshme konkluzionet e tyre.

Raportimi i  
Gjetjeve  
Direkt tek Palët  
Jashtë Njësisë  
së Audituar

**5.29** Audituesit duhet të raportojnë mashtrimin, papajtueshmërinë me dispozitat e ligjeve, rregulloreve, kontratave ose marrëveshjeve të grantit, ose shpërdorimin e njohur apo të mundshëm në mënyrë të drejtpërdrejtë direkt tek palët jashtë njësisë së audituar në dy rrethanat e mëposhtme.

**a.** Kur menaxhimi i njësisë ekonomike nuk arrin të përmbushë kërkesat ligjore apo rregullatore për raportimin e këtij informacioni tek palët e jashtme të specifikuar në ligj apo rregullore , audituesit duhet që fillimisht tua komunikojnë dështimin për të raportuar këtë informacion, të ngarkuarve me qeverisjen. Nëse njësia e audituar ende nuk e raporton këtë

---

**Kapitulli 5**  
**Standardet e Angazhimeve**  
**për Certifikim**

---

informacion tek palët e jashtme të specifikuar sa më shpejt që të jetë e mundur pas komunikimit me të ngarkuarit me qeverisjen, atëherë audituesit duhet ta raportojnë informacionin direkt tek palët e jashtme të specifikuar.

**b.** Kur menaxhimi i njësisë ekonomike nuk arrin të ndërmarrë në kohë hapat e përshtatshëm për t'iu përgjigjur mashtrimit, papajtueshmërisë me dispozitat e ligjeve, rregulloret, kontratat, ose marrëveshjet e grandit të njohura apo të mundshme ose shpërdorim që (1) ka mundësi të ketë ndikim material në çështjen në shqyrtim ose një pohim mbi çështjen në shqyrtim dhe (2) përfshin financimin e marrë direkt ose indirekt nga një agjenci qeveritare, audituesit duhet fillimisht ta raportojnë dështimin e menaxhimit për të ndërmarrë në kohë hapat e përshtatshme, sa më shpejt që të jetë e mundur pas komunikimit të audituesve me të ngarkuarit me qeverisjen, atëherë audituesit duhet të raportojnë dështimin e njësisë ekonomike për të ndërmarrë në kohë hapat e përshtatshëm, direkt tek agjencia financuese.

**5.30** Raportimi në paragrafin 5.29 është në vijim të çdo kërkesë ligjore për të raportuar këto informacione direkt tek palët jashtë njësisë së audituar. Audituesit duhet të jenë në pajtueshmëri me këto kërkesa edhe nëse ata janë dorëhequr apo janë larguar nga angazhimi para përfundimit të tij.

**5.31** Audituesit duhet të marrin evidencë të mjaftueshme dhe të përshtatshme, të tillë si konfirmimet nga palët jashtë, për të vërtetuar pohimet e menaxhimit të njësisë së audituar që i ka raportuar këto gjetje në pajtueshmëri me ligjet, rregulloret ose marrëveshjet e financimit. Kur audituesit e kanë të pamundur të bëjnë këtë, ata duhet të raportojnë këtë informacion direkt siç është diskutuar në paragrafin 5.29.

---

Raportimi i  
Pikëpamjeve të  
Zyrtarëve  
Përgjegjës

**5.32** Kur kryhet një angazhim ekzaminues sipas GAGAS, nëse raporti ekzaminimit jep informacion shpjegues mbi mangësitë në kontrollin e brendshëm, mashtrimin, papajtueshmërinë me dispozitat e ligjeve, rregulloreve, kontratave, ose marrëveshjet

**Kapitulli 5**  
**Standardet e Angazhimeve**  
**për Certifikim**

---

e grandit, apo shpërdorimin, audituesit duhet të marrin dhe raportojnë pikëpamjet e zyrtarëve përgjegjës të njësisë së audituar lidhur me gjetjet, konkluzionet, dhe rekomandimet, po ashtu dhe veprimet korigjuese të planifikuara.

**5.33** Dhënia e projekt raportit me gjetjet për rishikim dhe komente nga zyrtarët përgjegjës të njësisë së audituar dhe të tjerë, ndihmon audituesit të hartojnë një raport që është i drejtë, i plotë dhe objektiv. Përfshirja e pikëpamjeve të zyrtarëve përgjegjës rezulton në një raport që paraqet jo vetëm gjetjet e audituesve, konkluzionet dhe rekomandimet, por gjithashtu perspektivat e zyrtarëve përgjegjës për të njësisë së audituar si dhe veprimet korigjuese që ata planifikojnë të ndërmarrin. Marrja e komenteve me shkrim preferohet por komente me gojë janë të pranueshme gjithashtu.

**5.34** Kur audituesit marrin komentet me shkrim nga zyrtarët përgjegjës ata duhet të përfshijnë në raportin e tyre një kopje të komenteve të shkruara të zyrtarëve , ose një përmbledhje e komenteve të marra. Kur zyrtarët përgjegjës japin komente vetëm me gojë , audituesit duhet të përgatisin një përmbledhje të komenteve dhe t'i japin një kopje të përmbledhjes zyrtarëve përgjegjës për të vërtetuar që komentet janë deklaruar me saktësi.

**5.35** Audituesit duhet gjithashtu të përfshijnë në raport kur është e përshtatshme një vlerësim të komenteve. Në rastet në të cilat njësia e audituar jep komente teknike shtesë mbi ato të shkruara ose komentet me gojë, audituesit mund të japin informacion shtesë në raport se këto komente janë marrë.

**Kapitulli 5**  
**Standardet e Angazhimeve**  
**për Certifikim**

---

**5.36** Marrja e komenteve me goje mund të jetë e përshtatshme kur, për shembull ka një datë kritike ( të rëndësishme) për të respektuar një kërkesë të përdoruesit; audituesit kanë punuar nga afër me personat përgjegjës gjatë gjithë punës. Palët janë të familjarizuar me gjetjet dhe çështjet e trajtuara në projekt raport; ose kur audituesit nuk presin të kenë mosmarrëveshje të mëdha lidhur me gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet në projekt raport, apo kundërshti të mëdha lidhur me çështjet që diskutohen në projekt raport.

**5.37** Kur komentet e njësisë së audituar janë në kundërshti ose në konflikt me gjetjet, konkluzionet ose rekomandimet në projekt raport, ose kur veprimet korrigjuese të planifikuara nuk adresojnë/ trajtojnë në mënyrë të përshtatshme rekomandimet e audituesve, audituesit duhet të vlerësojnë vlefshmërinë e komenteve të njësisë së audituar. Nëse audituesit nuk bien dakord me komentet, ata duhet të shpjegojnë në raport arsyet e tyre për këtë mospranim. Nga ana tjetër, audituesit duhet të modifikojnë raportin e tyre kur është e nevojshme nëse ata i gjejnë komentet të vlefshme dhe të mbështetura nga evidencë e mjaftueshme dhe e përshtatshme.

**5.38** Nëse njësia e audituar refuzon të japë komente ose nuk e ka të mundur të japë komente brenda një periudhe kohe të arsyeshme, audituesit mund të nxjerrin raportin pa i marrë komentet nga njësia e audituar. Në këto raste , audituesit duhet të tregojnë në raport që njësia e audituar nuk ka dhënë komente.

---

Raportimi  
informacionit  
sekret dhe me  
ndjeshmëri

**5.39** Kur kryhet një angazhim ekzaminimi sipas GAGAS ,nëse për një informacion të caktuar është e ndaluar të jepen informacione shtesë publike, ose është i përjashtuar nga një raport për shkak të natyrës sekrete dhe të ndjeshme të informacionit, audituesit duhet të japin informacione shtese në raport që informacioni i caktuar është përjashtuar dhe arsyen apo rrethanat e tjera që e bëjnë përjashtimin të domozdoshëm.

**Kapitulli 5**  
**Standardet e Angazhimeve**  
**për Certifikim**

---

**5.40** Informacion i caktuar mund të jetë i klasifikuar ose mund të jetë i ndaluar nga dhënia e informacioneve shpjeguese të përgjithshme nga ligjet ose rregulloret e shtetit federal, ose lokale. Në këto kushte, audituesit mund të publikojnë një raport të përdorimit të kufizuar që përmban këtë informacion dhe tua shpërndajë raportin vetëm personave të autorizuar nga ligjet apo rregulloret për ta marrë atë.

**5.41** Rrethana të tjera që lidhen me sigurinë publike, jetën private dhe çështje të sigurisë mundet gjithashtu që të arsyetojnë përjashtimin e informacionit të caktuar nga një raport i shpërndarë në dispozicion të publikut apo i shpërndarë gjërësisht. Për shembull, informacion i detajuar lidhur me sigurinë kompjuterike për një program të veçantë mund të përjashtohet nga raportet e disponueshëm publikisht për shkak të dëmit të mundshëm që mund të shkaktohet nga keqpërdorimi i këtij informacioni. Në këto kushte, audituesit mund të nxjerrin një raport për përdorim të kufizuar që përmban këtë informacion dhe e shpërndajnë raportin vetëm tek palët që janë përgjegjëse për të vepruar ndaj rekomandimeve të auditimit. Në disa raste mund të jetë e përshtatshme që të nxirren të dyja , si një raport i disponueshëm publikisht në të cilin informacioni me ndjeshmëri është i përjashtuar ashtu dhe një raport për përdorim të kufizuar. Audituesit mund të këshillohen me organin ligjor lidhur me ndonjë kërkesë ose kushte të tjera që mund të bëjnë të domosdoshme përjashtimin e informacionit të caktuar.

**5.42** Duke marrë në konsideratë interesin e gjerë të publikut në programe ose veprimtari nën rishikim ndihmon audituesit për të vendosur nëse duhet të përjashtojnë informacioni të caktuar nga raportet e vlefshëm publikisht.

**5.43** Kur organizatat e auditimit janë subjekt i ligjeve të publikimit të të dhënave mund të ndikojnë në vlefshmërinë e raporteve të klasifikuara ose të kufizuara dhe të përcaktojnë nëse mjete të tjera të komunikimit me menaxhimin dhe të ngarkuarve me qeverisjen mund të jenë më të përshtatshme ..

**Kapitulli 5**  
**Standardet e Angazhimeve**  
**për Certifikim**

---

Për shembull, audituesit mund të komunikojnë informacion të përgjithshëm në një raport të shkruar dhe komunikojnë informacionin e detajuar me gojë. Audituesit mund të këshillohen me organin ligjor lidhur me ligjet e zbatueshme për publikimin e të dhënave.

---

**Shpërndarja e Raporteve**

**5.44** Shpërndarja e raporteve të plotësuar në përputhje me GAGAS varet nga marrëdhënia e audituesit me organizatën e audituar dhe natyra e informacionit që përmban raportin. Audituesit duhet të dokumentojnë çdo kufizim në shpërndarjen e raportit<sup>102</sup>. Trajtimet e mëposhtme përcaktojnë shpërndarjen e raporteve të përfunduara në pajtueshmëri me GAGAS:

**a.** Organizatat audituese në njësitë qeveritare duhet t'ua shpërndajnë raportet të ngarkuarve me qeverisjen, zyrtarëve përkatës të njësisë së audituar, dhe organeve mbikëqyrëse, ose organizatave që kanë rënë dakord apo kanë kërkuar auditimin. Kur është e përshtatshme audituesit duhet gjithashtu të shpërndajnë kopje të raporteve tek zyrtarë të tjerë të cilët kanë autoritetin ligjor mbikëqyrës dhe i cili mund të jetë përgjegjës për veprimin kundrejt gjetjeve të angazhimit dhe rekomandimeve, dhe tek të tjerët të autorizuar për të marrë këto raporte.

**b.** Organizatat e auditimit të brendshëm në njësitë qeverisëse mundet gjithashtu të ndjekin Standardet Ndërkombëtare për Praktika Profesionale të Auditimit të Brendshëm të Institutit të Audituesve të Brendshëm<sup>103</sup> (IIA). Në përputhje me standardet GAGAS dhe të IIA, drejtuesi i organizatës së auditimit të brendshëm duhet të komunikojë rezultatet tek palët që mund të sigurojnë se rezultatet janë duke u marrë në konsideratë. Nëse nuk është vendosur ndryshe nga kërkesat ligjore dhe rregullatore, para se të shpërndajnë rezultatet tek palët jashtë

---

<sup>102</sup> Shih paragrafët 5.40 dhe 5.41 për diskutim të raporteve të kufizuara që përmbajnë informacion konfidencial apo të ndjeshëm

<sup>103</sup> Shih paragrafin 2.21 për diskutime shtesë mbi përdorimin e standardeve të IIA në lidhje me GAGAS dhe paragrafin 2.22 për diskutim shtesë mbi citimin e pajtueshmërisë me ndonjë grup tjetër standardesh.

**Kapitulli 5**  
**Standardet e Angazhimeve**  
**për Certifikim**

---

organizatës , drejtuesi i auditimit të brendshëm duhet të :(1) vlerësojë riskun e mundshëm të organizatës. (2) këshillohet me menaxhimin e lartë ose organin ligjor kur të jetë e përshtatshme (3) kontrollojë shpërndarjen duke përcaktuar përdoruesit e synuar në raport.

c. Kompanitë Audituese Publike të kontraktuara për të kryer një angazhim ekzaminimi në pajtueshmëri me GAGAS duhet të qartësojnë përgjegjësitë e shpërndarjes së raportit me organizatën kontraktuese. Nëse firma e kontraktuar është përgjegjëse për shpërndarjen e raportit , ajo duhet të bëjë marrëveshje me palën kontraktuese për angazhimet rreth të cilave zyrtarët e organizatës do marrin raportin dhe hapat që do të ndërmerren për ta bërë raportin të disponueshëm për publikun.

---

Konsiderata shtesë të GAGAS për Angazhimet e Ekzaminimit

**5.45** Për shkak të objektivave dhe përgjegjshmërisë publike të angazhimeve shqyrtuese sipas GAGAS , mund të aplikohen konsiderata shtesë për angazhimet ekzaminuese të përfunduara në pajtueshmëri me GAGAS . Këto konsiderata lidhen me

a. Materialitetin në angazhimet ekzaminuese sipas GAGAS, dhe

b. Komunikimin e hershem të mangësive<sup>104</sup>.

---

Materialiteti në Angazhimet e Ekzaminimit sipas GAGAS

**5.46** Standardet AICPA kërkojnë që një nga faktorët që duhet të merren në konsideratë kur planifikohet një angazhim për certifikim përfshin gjykime paraprake rreth riskut të certifikimit dhe materialitetit për qëllime certifikimi<sup>105</sup>. Kosideratat shtesë mund të aplikohen për angazhimet ekzaminuese të njëjësive qeverisëse ose njëjësive ekonomike që marrin fonde qeveritare.

---

<sup>104</sup> Shih paragrafët 5.46 dhe 5.47 për diskutim shtesë të paragrafit 5.45 a-b

<sup>105</sup> Shih GAGAS AT Seksioni 101.45b dhe 101.67, *Angazhimet për certifikim*

**Kapitulli 5**  
**Standardet e Angazhimeve**  
**për Certifikim**

---

Për shembull, në angazhimet e kryera në përputhje me GAGAS, audituesit mund të gjejnë të përshtatshme që të përdorin nivele më të ulëta materialiteti krahasuar me nivelet e materialitetit të përdorura në angazhimet jo-sipas GAGAS për shkak të përgjegjshmërisë publike të njëjësive qeveritare dhe njëjësive ekonomike që marrin financime qeveritare, kërkesave të ndryshme ligjore , dhe këndvështrimin dhe ndjeshmërisë së programeve qeveritare.

---

**Komunikimi i**  
**Hershëm i**  
**Mangësive**

**5.47** Për disa arsye , komunikimi i hershëm për të ngarkuarit me qeverisjen ose menaxhimin mund të jetë i rëndësishëm për shkak të rëndësisë përkatëse dhe emergjencës për veprime korrigjuese pasuese<sup>106</sup>. Për më tepër, kur një mangësi kontrolli rezulton në papajtueshmëri me dispozitat e ligjeve, rregulloreve, kontratave ose marrëveshjet e grandit , apo shpërdorimet, komunikimi është i rëndësishëm për të lejuar menaxhimin për të ndërmarrë veprime korrigjuese të menjëhershme për të parandaluar papajtueshmërinë e mëtejshme. Kur një mangësi komunikohet herët , kërkesat për raportimin në paragrafin 5.20 vazhdojnë të aplikohen.

---

<sup>106</sup> Shih AICPA AT Seksioni 501.103, Një ekzaminim i Kontrollit të Brendshëm mbi Raportimin Financiar të një Njësie që integrohet me një Auditim të Pasqyre Financiare

**Kapitulli 5**  
**Standardet e Angazhimeve**  
**për Certifikim**

---

**Angazhimet**  
**e Rishikimit**

---

Kërkesa Shtesë të  
Punës në Terren të  
GAGAS për  
Angazhimet e  
Rishikimit

**5.48** GAGAS vendos një kërkesë të punës në terren për angazhimet e rishikimit, në vijim të kërkesave që përmbajnë Standardet AICPA. Audituesit duhet të jenë në pajtueshmëri me këtë kërkesë shtesë , së bashku me standardet përkatëse të AICPA për angazhimet e rishikimit kur citojnë GAGAS në raportet e tyre të angazhimeve të rishikimit. Kërkesat shtesë lidhen me komunikimin e mangësive domethënëse, dobësive materiale, rastet e mashtrimit, papajtueshmërinë me dispozitat e ligjeve, rregulloreve, kontratave, ose marrëveshjeve të grandit, apo shpërdorimin që konstatohet nga audituesit gjatë një angazhimi të rishikimit.

Komunikimi i  
Mangësive të  
Rëndësishme,  
Dobësive  
Materiale, Rasteve  
të Mashtrimit,  
Papajtueshmërisë  
me Dispozitat e  
Ligjeve,  
Rregulloreve,  
Kontratave,  
Marrëveshjeve të  
Grandit dhe  
Shpërdorimit.

**5.49** Nëse, bazuar në kryerjen e procedurave të nevojshme për të realizuar një rishikim, mangësitë e rëndësishme, dobësitë materiale, rastet e mashtrimit, papajtueshmëria me dispozitat e ligjeve, rregulloreve, kontratave, ose marrëveshjeve të grantit, apo shpërdorimit konstatohen nga audituesit dhe kërkojnë vëmendjen e të ngarkuarve me qeverisjen , GAGAS kërkojnë që audituesit duhet të komunikojnë këto çështje me zyrtarët e njësisë së audituar. Kur audituesit zbulojnë ndonjë rast të mashtrimit, papajtueshmërisë me dispozitat e ligjeve, rregulloreve, kontratave, ose marrëveshjeve të grantit ose shpërdorimit që nuk kërkojnë vëmendjen e të ngarkuarve me qeverisjen, vendimi i audituesve nëse dhe se si të komunikojnë të tilla raste tek zyrtarët e njësisë së audituar është një çështje e gjykimit profesional. Në vijim , audituesit duhet të përcaktojnë nëse ekzistenca e këtyre çështjeve prek aftësinë e audituesve për të kryer apo për të raportuar mbi rishikimin.

---

**Kapitulli 5**  
**Standardet e Angazhimeve**  
**për Certifikim**

---

Kërkesat e Raportimit të GAGAS për Angazhimet e Rishikimit

**5.50** GAGAS përcakton kërkesat e raportimit për angazhimet e rishikimit në vijim të kërkesave që përmbajnë standardet e AICPA<sup>107</sup>. Audituesit duhet të jenë në pajtueshmëri me këto kërkesa shtesë kur citojnë GAGAS në raportet e tyre të angazhimeve të rishikimit. Kërkesat shtesë lidhen me:

- a. Raportimin e pajtueshmërisë së audituesve me GAGAS; dhe
- b. Shpërndarjen e raporteve<sup>108</sup>

---

Raportimi i Përputhshmërisë së Audituesve me GAGAS

**5.51** Kur audituesit kanë përmbushur plotësisht të gjitha kërkesat e zbatueshme të GAGAS për një angazhim rishikimi të kryer në përputhshmëri me GAGAS, ata duhet të përfshijnë një deklaratë në raportin e rishikimit që ata e kanë kryer angazhimin në përputhshmëri me GAGAS<sup>109</sup>. Për shkak se GAGAS përfshin në referencë standardin e përgjithshëm mbi kriteret, dhe standardet e punës në terren dhe raportimin të SSAEs të AICPA, GAGAS nuk kërkojnë që audituesit të citojnë pajtueshmërinë me standardet e AICPA nëse kanë cituar përputhshmërinë me GAGAS. GAGAS nuk i ndalojnë audituesit nga nxjerrja e një raporti të veçantë në përputhje vetëm me kërkesat e AICPA ose standarde të tjera<sup>110</sup>.

---

Shpërndarja e Raporteve

**5.52** Shpërndarja e raporteve të plotësuara në përputhje me GAGAS varet nga marrëdhënia e audituesit me organizatën e audituar dhe natyrën e informacionit që përmban raporti.

---

<sup>107</sup> Shih AICPA AT Seksioni 101.63-101.83 dhe 101.88-101.90, *Angazhimet për Certifikim*

<sup>108</sup> Shih paragrafët 5.51 dhe 5.52 për diskutime shtesë të paragrafit 5.50 a-b

<sup>109</sup> Shih paragrafët 2.24 dhe 2.25 për kërkesa shtesë mbi citimin e pajtueshmërisë me GAGAS.

<sup>110</sup> Shih AICPA AT Seksioni 101.89d, *Angazhimet për Certifikim*

**Kapitulli 5**  
**Standardet e Angazhimeve**  
**për Certifikim**

---

Audituesit duhet të dokumentojnë çdo kufizim në shpërndarjen e raportit. Diskutimet e mëposhtme përcaktojnë shpërndarjen e raporteve të përfunduara në pajtueshmëri me GAGAS.

**a.** Organizatat audituese në njësitë qeveritare duhet t'ua shpërndajnë raportet të ngarkuarve me qeverisjen, zyrtarëve përkatës të njësisë së audituar, dhe organeve mbikëqyrëse , ose organizatave që kanë rënë dakord apo kanë kërkuar auditimin. Sipas rastit audituesit duhet gjithashtu të shpërndajnë kopje të raporteve tek zyrtarë të tjerë të cilët kanë autoritetin ligjor mbikëqyrës dhe i cili mund të jetë përgjegjës për veprimi kundrejt gjetjeve të angazhimit dhe rekomandimeve, dhe tek te tjerë të autorizuar për të marrë këto raporte.

**b.** Organizatat e auditimit të brendshëm në njësitë qeverisëse mundet gjithashtu të ndjekin Standardet Ndërkombëtare për Praktika Profesionale të Auditimit të Brendshëm të Institutit të Audituesve të Brendshëm<sup>111</sup> (IIA). Në përputhje me standardet GAGAS dhe të IIA, drejtuesi i organizatës së auditimit të brendshëm duhet të komunikojë rezultatet tek palët që mund të sigurojnë se rezultatet janë duke u marrë në konsideratë. Nëse nuk është vendosur ndryshe nga kërkesat ligjore dhe rregullator, para se të shpërndajnë rezultatet tek palët jashtë organizatës , drejtuesi i auditimit të brendshëm duhet të : (1) vlerësojë riskun e mundshëm të organizatës. (2) këshillohet me menaxhimin e lartë ose organin ligjor kur të jetë e përshtatshme (3) kontrollojë shpërndarjen duke përcaktuar përdoruesit e synuar në raport.

---

<sup>111</sup> Shih paragrafin 2.21 për diskutime shitesë mbi përdorimin e standardeve të IIA në lidhje me GAGAS dhe paragrafin 2.22 për diskutim shitesë mbi citimin e pajtueshmërisë me ndonjë grup tjetër standardesh.

**Kapitulli 5**  
**Standardet e Angazhimeve**  
**për Certifikim**

---

c. Kompanitë Audituese Publike të kontraktuara për të kryer një angazhim rishikimi në pajtueshmëri me GAGAS duhet të qartësojnë përgjegjësitë e shpërndarjes së raportit me organizatën kontraktuese. Nëse kompania e kontraktuar është përgjegjëse për shpërndarjen e raportit, ajo duhet të bëjë marrëveshje me palën kontraktuese për angazhimet rreth të cilave zyrtarët e organizatës do marrin raportin dhe hapat që do të ndërmerren për ta bërë raportin të disponueshëm për publikun.

---

Konsiderata  
Shtesë të GAGAS  
për Angazhimet e  
Rishikimit

**5.53** Për shkak të objektivave dhe përgjegjshmërisë publike të angazhimeve të rishikimit GAGAS, mund të aplikohen konsiderata shtesë për angazhimet e rishikimit të kryera në përputhshmëri me GAGAS. Këto konsiderata lidhen me:

a. krijimin e një kuptimi lidhur me shërbimet që duhet të kryejnë;  
dhe

b. raportimi mbi angazhimet e rishikimit<sup>112</sup>

---

Krijimi i një  
Kuptimi për  
Shërbimet që  
Duhet të Kryhen

**5.54** Standardet e AICPA kërkojnë që audituesit të krijojnë një kuptim mbi njësinë e audituar (klientin) lidhur me shërbimet për t'u kryer për çdo angazhim rishikimi. i tillë kuptim pakëson riskun që si audituesit ( praktikuesit) ashtu dhe njësia e audituar mund të keqinterpretojnë kërkesat ose pritshmërinë e palës tjetër. Kuptimi apo njohja përfshin objektivat e angazhimit, përgjegjësitë e menaxhimit të njësisë, përgjegjësitë e audituesve, dhe kufizimet e angazhimit<sup>113</sup>.

---

<sup>112</sup> Shih paragrafët 5.54 deri 5.57 për diskutime shtesë të 5.53 a-b.

<sup>113</sup> Shih AICPA AT Seksioni 101.46, *Angazhimet për Certifikim*.

**Kapitulli 5**  
**Standardet e Angazhimeve**  
**për Certifikim**

---

**5.55** Audituesit shpesh kryejnë angazhime të GAGAS sipas një kontrate me një palë tjetër nga zyrtarët audituar ose sipas kërkesës së një pale të tretë. Në të tilla raste , audituesit mundet gjithashtu të vlerësojnë si të përshtatshme të komunikojnë informacion në lidhje me shërbimet për t'u kryer për individët kontraktues ose për kërkuesit e angazhimit. Një kuptim i tillë mund të ndihmojë audituesit të shmangin ndonjë keqkuptim lidhur me natyrën e angazhimit të rishikimit. Për shembull, angazhimet e rishikimit ofrojnë vetëm një nivel të moderuar sigurie të shprehur si një konkluzion në formën e sigurisë negative, dhe si rezultat, audituesit nuk mund të kryejnë mjaftueshëm punë për të qenë të aftë të zhvillojnë elementë të një gjetje ose të japin rekomandime që janë të zakonshme për llojet e tjera të angazhimeve sipas GAGAS. Në këto kushte, për shembull, palët kërkuese mund të gjejnë një lloj tjetër të angazhimi për certifikim ose një auditim performance mund të japë nivel të përshtatshëm sigurie për të plotësuar kërkesat e tyre.

---

**Raportimi i**  
**Angazhimeve të**  
**Rishikimit**

**5.56** Standardet AICPA kërkojnë që raporti i rishikimit të audituesve të jetë në formën e një konkluzioni të shprehur në formën e sigurisë negative<sup>114</sup>.

**5.57** Për shkak se rishikimet kanë në thelb fushëveprim më të pakët se auditimet dhe angazhimet ekzaminuese, është e rëndësishme që të përfshihen të gjithë elementët e raportimit të kërkuara që përmbajnë SSAEs<sup>115</sup>. Për shembull, një element i kërkuar i raportit të rishikimit është një deklaratë që, një angazhim rishikimi ka në thelb fushëveprim më të pakët se një ekzaminim, objektivi i të cilit është shprehja e një opinionimi mbi çështjen në rishikim dhe përkatësisht, raportet e rishikimit nuk e shprehin të tillë opinion. Duke përfshirë vetëm këto elementë që standardet e raportimit të AICPA për angazhime rishikimi kërkojnë ose lejojnë që audituesit të jenë në përputhje me standardet e AICPA dhe që përорuesit e

---

<sup>114</sup> Shih AICPA AT Seksioni 101.68, *Angazhimet për Certifikim*

<sup>115</sup> Shih AICPA AT Seksioni 101.89, *Angazhimet për Certifikim*

**Kapitulli 5**  
**Standardet e Angazhimeve**  
**për Certifikim**

---

raporteve të GAGAS kanë një kuptim të natyrës së punës së kryer dhe rezultatet e angazhimit të rishikimit.

---

**Angazhimet e**  
**Procedurave të Pranuara**

---

**Kërkesa Shtese**  
**të Punës në Terren**  
**të GAGAS për**  
**Angazhimet e**  
**Procedurave të**  
**Pranuara**

**5.58.** GAGAS përcaktojnë një kërkesë të punës në terren për angazhimet për procedurat e pranuar në vijim të kërkesave që përmbajnë standardet AICPA . Audituesit duhet të jenë në përputhje me këtë kërkesë shtesë , së bashku me standardet përkatëse të AICPA për angazhimet për procedurat e pranuar , kur citojnë GAGAS në raportet e tyre të angazhimeve për procedurat e pranuar. Kërkesat shtesë lidhen me komunikimin e mangësive të rëndësishme, dobësive materiale , rasteve të mashtrimit, papajtueshmërisë me dispozitat e ligjeve, rregulloreve, kontratat ose marrëveshjet e grantit, apo shpërdorimin gjatë një angazhimi për procedurat e pranuar.

---

**Kapitulli 5**  
**Standardet e Angazhimeve**  
**për Certifikim**

---

Komunikimi i Mangësive në Kontrollin e Brendshëm, Mashtrimin, Papajtueshmërisë me Dispozitat e Ligjeve, Rregulloreve, Kontratave dhe Marrëveshjeve të Grantit dhe Shpërdorimit

**5.59** Nëse, bazuar në kryerjen e procedurave të nevojshme për të realizuar një angazhim për procedurat e pranuar<sup>116</sup>, mangësi të rëndësishme; dobësi materiale, raste të mashtrimit; papajtueshmëri me dispozitat e ligjeve, rregulloreve, kontratave, ose marrëveshjeve të grantit; apo shpërdorimi konstatohen nga audituesit dhe që kërkon vëmendjen e të ngarkuarve me qeverisjen, GAGAS kërkojnë që audituesit duhet të komunikojnë këto çështje me zyrtaret e njësisë së audituar. Kur audituesit zbulojnë ndonjë rast të mashtrimit, papajtueshmërisë me dispozitat e ligjeve, rregulloreve, kontratave, ose marrëveshjeve të grantit apo shpërdorim që nuk kërkojnë vëmendjen e të ngarkuarve me qeverisjen, vendimi i audituesve nëse dhe se si të komunikojnë të tilla raste tek zyrtarët e njësisë së audituar është një çështje e gjykimit profesional. Në vijim, audituesit duhet të përcaktojnë nëse ekzistenca e këtyre çështjeve prek aftësinë e audituesve për të kryer apo për të raportuar mbi angazhimin për procedurat e pranuar.

---

Kërkesat e Raportimit të GAGAS për Angazhimet për Procedurat e Pranuar

**5.60** GAGAS përcaktojnë kërkesat e raportimit për angazhimet për procedurat e pranuar në vijim të kërkesave që përmbajnë Standardet e AICPA<sup>117</sup>. Audituesit duhet të jenë në përputhje me këto kërkesa kur citojnë GAGAS në raportet e tyre të angazhimeve për procedurat e pranuar. Kërkesat shtesë lidhen me:

- a. Raportimin e përputhshmërisë së audituesve me GAGAS;
- b. Shpërndarjen e raporteve<sup>118</sup>

---

<sup>116</sup> Shih AICPA AT Seksioni 201.03, Angazhimet për procedurat e pranuar

<sup>117</sup> Shih AICPA AT Seksioni 201.31-201.36, Angazhimet për procedurat e pranuar

<sup>118</sup> Shih paragrafët 5.61 dhe 5.62 për diskutime shtesë të paragrafit. 60 a-b

**Kapitulli 5**  
**Standardet e Angazhimeve**  
**për Certifikim**

---

Raportimi i  
Përputhshmërisë  
të Audituesve  
me GAGAS

**5.61** Kur audituesit kanë përbushur plotësisht të gjitha kërkesat e zbatueshme të GAGAS për një angazhim për procedurat e pranuar, ata duhet të përfshijnë një deklaratë në raportin e angazhimit për procedurat e pranuar që ata e kanë kryer angazhimin në përputhje me GAGAS<sup>119</sup>. Për shkak se GAGAS përfshijnë në referencë standardet e përgjithshme për kriteret, dhe standardet e punës në terren dhe raportimin të SSAEs AICPA, GAGAS nuk kërkojnë që audituesit të citojnë përputhshmërinë me standardet e AICPA kur citojnë përputhshmërinë me GAGAS. GAGAS nuk i ndalojnë audituesit nga nxjerrja e një raporti të standard në përputhje vetëm me kërkesat e AICPA ose standarde të tjera<sup>120</sup>.

Shpërndarja e  
Raporteve

**5.62** Shpërndarja e raporteve të plotësuara në pajtueshmëri me GAGAS varet nga marrëdhënia e audituesit me organizatën e audituar dhe natyrën e informacionit që përmban raporti. Për angazhimet për procedurat e pranuar, nëse çështja subjekt ose pohimi përfshin material që është klasifikuar për qëllime të sigurisë ose përmban informacion sekret ose të ndjeshëm, audituesit duhet të kufizojnë shpërndarjen e raportit. Audituesit duhet të dokumentojnë çdo kufizim mbi shpërndarjen e raportit. Trajtimi i mëposhtëm përshkruan shpërndarjen për raportet e kryera në përputhje me GAGAS:

---

<sup>119</sup> Shih paragrafët 2.24 dhe 2.25 për kërkesa shtesë mbi citimin e pajtueshmërisë me GAGAS.

<sup>120</sup> Shih AICPA AT Seksioni 101. 89d, *Angazhimet për Certifikim*

**Kapitulli 5**  
**Standardet e Angazhimeve**  
**për Certifikim**

---

**a.** Organizatat mbikëqyrëse në njësitë qeverisëse duhet të shpërndajnë raportet e të ngarkuarve me qeverisjen, tek zyrtarët përkatës të njësisë së audituar dhe tek organet përkatëse mbikëqyrëse ose organizatat kërkuese apo organizuese të angazhimit. Kur është e përshtatshme , audituesit duhet gjithashtu të shpërndajnë kopje te raporteve tek zyrtarët e tjerë të cilët kanë autoritetin e ligjshëm mbikëqyrës, dhe tek të tjerët të autorizuar për marrjen e këtyre raporteve.

**b.** Organizatat e auditimit të brendshëm në njësitë qeveritare mund të ndjekin gjithashtu Standardet Ndërkombëtare për Praktikën Profesionale të Auditimit të Brendshëm të Institutit të Audituesve të Brendshëm (IIA)<sup>121</sup>. Në përputhje me GAGAS dhe Standardet e IIA , drejtuesi i auditimit të brendshëm duhet të komunikojë rezultatet tek palët të cilat mund të sigurojnë që rezultatet janë shqyrtuar si duhet. Nëse nuk përcaktohet ndryshe nga kërkesat ligjore apo rregullatore, para se të shpërndahen rezultatet për palët jashtë organizatës, drejtuesi i organizatës së auditimit të brendshëm duhet: (1) vlerësojë riskun potencial për organizatën, (2) këshillohet me menaxhimin e lartë ose organet ligjore sipas rastit , dhe (3) kontrollojë shpërndarjen duke përcaktuar përdoruesit e synuar në raport.

**c.** Kompanitë audituese publike të kontraktuara për të kryer një angazhim për procedurat e pranura në pajtueshmëri me GAGAS duhet të qartësojnë përgjegjësitë e shpërndarjes së raportit me organizatën e angazhuar. Nëse kompania kontraktuese është përgjegjëse për shpërndarjen, me palën e kontraktuar duhet të arrihet marrëveshje se cilët prej zyrtarëve apo organizatave do të marrin raportin dhe hapat që duhet të ndërmerren për ta bërë raportin të disponueshëm për publikun.

---

<sup>121</sup> Shih paragrafin 2.21 për diskutime shtesë mbi përdorimin e standardeve të IIA në lidhje me GAGAS dhe paragrafin 2.22 për diskutim shtesë mbi citimin e pajtueshmërisë me ndonjë grup tjetër standardesh

---

**Kapitulli 5**  
**Standardet e Angazhimeve**  
**për Certifikim**

---

Konsiderata Shtesë të GAGAS për Angazhimet për Procedurat e Pranuara	<p><b>5.63</b> Për shkak të objektivave dhe përgjegjshmërisë publike të angazhimeve për procedura të pranuar GAGAS, mund të aplikohen konsiderata shtesë për angazhimet për procedurat e pranuar të kryera në përputhje me GAGAS. Këto konsiderata lidhen me:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>a. krijimin e një kuptimi lidhur me shërbimet që duhet të kryhen; dhe</li><li>b. raportimi mbi angazhimet për procedura të pranuar.<sup>122</sup></li></ul>
---	---

---

Krijimi i një Kuptimi lidhur me Shërbimet që duhet të Kryhen	<p><b>5.64</b> Standardet e AICPA kërkojnë që audituesit të krijojnë një kuptim mbi njësinë e audituar (klientin) lidhur me shërbimet për t'u kryer për çdo angazhim certifikimi. I tillë kuptim apo njohje pakëson riskun që si audituesit ( praktikuesit) ose njësia e audituar mund të keqinterpretojnë kërkesat ose pritshmëritë e palës tjetër. Kuptimi përfshin objektivat e angazhimit, përgjegjësitë e menaxhimit të njësisë, përgjegjësitë e audituesve, dhe kufizimet e angazhimit.<sup>123</sup></p>
---	---

**5.65** Audituesit shpesh kryejnë angazhimet GAGAS sipas një kontrate me palë tjetër nga zyrtarët e njësisë së audituar ose sipas kërkesës së një pale të tretë. Në këto raste , audituesit mund ta gjejnë të përshtatshme tua komunikojnë informacionin lidhur me shërbimin që duhet të kryhet, individëve të kontrktuar ose kërkues të angazhimit. Një kuptim i tillë mund të ndihmoj audituesit të shmangin ndonjë keqkuptim lidhur me natyrën e angazhimit për procedurat e pranuar Për shembull , angazhimet për procedurat e pranuar nuk ofrojnë as nivel të lartë dhe as të moderuar të sigurisë , dhe si rezultat, audituesit nuk kryejnë mjaftueshëm punë për të qenë të aftë që të zhvillojnë elementë të një gjetje ose të japin

---

<sup>122</sup> Shih paragrafët 5.54 deri 5.57 për diskutime shtesë të 5.53 a-b

<sup>123</sup> Shih AICPA AT Seksionet 101.46, *Angazhimet për Certifikim*, dhe 201.10, *Angazhimet për Procedurat e Pranuara*

**Kapitulli 5**  
**Standardet e Angazhimeve**  
**për Certifikim**

---

rekomandime që janë të zakonshme në lloje të tjera të angazhimeve të GAGAS. Në këto kushte, për shembull, palët kërkuuese mund të vlerësojnë se një lloj i ndryshëm i angazhimit të certifikimit ose një auditim i performancës mund të ofrojë nivel të përshtatshëm të sigurisë për të plotësuar kërkesat e tyre<sup>124</sup>.

---

Raportimi mbi  
Angazhimet për  
Procedurat e  
Pranuara

**5.66** Standardet AICPA kërkojnë që raporti audituesve mbi angazhimet për procedurat e pranuar të jetë në formën e procedurave dhe gjetjeve dhe specifikojë elementët që përmban një raport.

**5.67** Për shkak se angazhimet për procedurat e pranuar sipas GAGAS kanë në thelb fushëveprim më të pakët se auditimet dhe angazhimet për certifikime, është e rëndësishme që të mos ketë shmangie nga elementet e kërkuara të raportimit që përmbajnë Standardet SSAE. Për shembull, një element i kërkuar në raport mbi procedurat e pranuar është një deklaratë që audituesit nuk kanë qenë të angazhuar dhe nuk kanë kryer një ekzaminim apo rishikim të çështjes nën shqyrtim, objektiv e të cilave mund ketë jetë shprehja e një opinioni ose sigurisë së kufizuar dhe nëse audituesit kanë kryer procedura shtese auditimi, çështje të tjera mund të kenë ardhur në vëmendjen e audituesve të cilat mund të ishin raportuar.<sup>125</sup> Një tjetër element i kërkuar është një deklaratë që mjaftueshmëria e procedurave është përgjegjësi vetëm e palëve të specifikuar dhe një kusht i përgjegjësisë për mjaftueshmërinë e këtyre procedurave<sup>126</sup>.

---

<sup>124</sup> Shih AICPA AT Seksioni 201.31, Angazhimet për Procedurat e Pranuara

<sup>125</sup> Shih AICPA AT Seksioni 201. 31k, Angazhimet për Procedurat e Pranuara

<sup>126</sup> Shih AICPA AT Seksioni 201.31 h dhe 201.11-201.14, Angazhimet për Procedurat e Pranuara

**Kapitulli 5**  
**Standardet e Angazhimeve**  
**për Certifikim**

---

Duke përfshirë vetëm këto elementë që standardet e AICPA për raportimin e angazhimeve për procedurat e pranuar kërkojnë apo lejojnë sigurojnë që audituesit të jenë në pajtueshmëri me standardet e AICPA dhe që përdoruesit e raporteve sipas GAGAS kanë një kuptim të natyrës së punës së kryer dhe rezultatet e angazhimit të procedurave të pranuar.

Kapitulli 6

---

## Standardet e Punës në Terren për Auditimet e Performancës

---

---

### Hyrje

**6.01** Ky kapitull përmban kërkesat të punës në terren dhe udhëzime për auditimet e performancës të kryera në përputhje me standardet shtetërore përgjithësisht të pranuar të auditimit (GAGAS). Qëllimi i kërkesave të punës në terren është të krijohet një qasje të përgjithshme për audituesit në marrjen e një sigurie të arsyeshme se evidenca është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të mbështetur gjetjet dhe konkluzionet. Kërkesat e punës në terren për auditimet e performancës kanë të bëjnë me planifikimin e auditimit; mbikëqyrjen e stafit; marrjen e një evidence të mjaftueshme e të përshtatshme dhe përgatitjen e dokumentimit të auditimit. Konceptet e sigurisë së arsyeshme, rëndësisë dhe riskut të auditimit formojnë një kuadër për zbatimin e këtyre kërkesave dhe janë të përfshira në të gjithë shtjellimin e auditimeve të performancës.

**6.02** Për auditimet e performancës të kryera në përputhje me GAGAS, zbatohen kërkesat dhe udhëzimet në kapitujt nga 1 deri në 3, 6 dhe 7.

---

### Siguria e arsyeshme

**6.03** Në auditimet e performancës që përputhen me GAGAS, audituesit marrin siguri të arsyeshme që evidenca është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të mbështetur gjetjet dhe konkluzionet në lidhje me objektivat e auditimit. Kështu, mjaftueshmëria dhe përshtatshmëria e evidencës së nevojshme dhe testimet e evidencës ndryshojnë bazuar në objektivat, gjetjet dhe konkluzionet e auditimit. Objektivat për auditimet e performancës renditen në nivele nga ,më të ngushta në nivele më të gjera dhe përfshijnë lloje dhe cilësi të ndryshme të evidencës. Në disa auditime, rezultojnë evidencë e mjaftueshme dhe e përshtatshme, por në disa të tjera, informacioni mund të jetë i kufizuar.

**Kapitulli 6**  
**Standardet e Punës në Terren për Auditimet e**  
**Performancës**

---

Gjykimi profesional ndihmon audituesit në përcaktimin e fushëveprimit të auditimit dhe metodologjinë e nevojshme për të arritur objektivat e auditimit, dhe në vlerësimin nëse është marrë evidencë e mjaftueshme dhe përshtatshme për të arritur objektivat e auditimit.

---

Rëndësia në një  
Auditim  
Performance

**6.04** Koncepti i rëndësisë ndihmon auditorët gjatë një auditimi performance, duke përfshirë edhe vendimin për llojin dhe shtrirjen e punës së auditimit, kur vlerësohen rezultatet e punës audituese, kur hartohet raporti me gjetjet dhe konkluzionet përkatëse. Rëndësia është përcaktuar si domethënia përkatëse e një çështje brenda kontekstit në të cilin shqyrtohet, duke përfshirë faktorët sasiore dhe cilësore. Faktorë të tillë të përfshijnë rëndësinë e çështjes në lidhje me çështjen nën auditim, natyrën dhe efektin e çështjes, përkatësinë e çështjes, kërkesat dhe interesat e një pale të tretë në dijeni të informacionit përkatës si dhe ndikimin në çështjen e programit apo veprimtarisë së audituar. Gjykimi profesional ndihmon audituesit në vlerësimin e rëndësisë së çështjeve brenda kontekstit të objektivave të auditimit. Në kërkesat e auditimit të performancës, termi "i rëndësishëm" është i krahasueshëm me termin "material" siç përdoret në kontekstin e auditimeve të pasqyrave financiare.

---

Risku i  
Auditimit

**6.05** Risku i auditimit është mundësia që gjetjet, konkluzionet, rekomandimet ose siguria e audituesit të jenë të gabuara ose jo të plota, si rezultat i faktorëve të tillë si: evidenca është e pamjaftueshme dhe/ose e papërshtatshme, një proces i papërshtatshëm auditimi apo mangësi të qëllimshme ose informacion të gabuar për shkak të shtrembërimeve/keqdeklarimeve ose mashtrimit. Vlerësimi i riskut të auditimit përfshin si vlerësimin cilësor dhe sasior. Faktorët që ndikojnë në riskun e auditimit përfshijnë kuadrin kohor, kompleksitetin apo ndjeshmërinë e punës; madhësinë e programit në aspektin e vlerave monetare dhe numrin e qytetarëve që iu është shërbyer; përshtatshmëria e sistemeve

**Kapitulli 6**  
**Standardet e Punës në Terren për Auditimet e**  
**Performancës**

---

dhe proceseve të njësisë së audituar, për të zbuluar mospërputhjet, gabimet e rëndësishme apo mashtrimin; dhe mundësia e audituesve për të marrë të dhëna. Risku i auditimit përfshin rrezikun që audituesit të mos zbulojnë një gabim, mospërputhje, gabim të rëndësishëm ose mashtrimin në evidencën e auditimit. Risku i auditimit mund të zvogëlohet duke ndërmarrë veprime të tilla si duke rritur fushën e veprimeve audituese; duke shtuar specialistë dhe burime të tjera për auditimin; ndryshimin e metodologjisë duke marrë evidencë shtesë dhe të një cilësie më të lartë ose forma alternative të evidencës mbështetëse ose paraqitjen e gjetjeve dhe konkluzioneve në përputhje me evidencën e marrë.

---

**Planifikimi**

**6.06** Audituesit duhet të planifikojnë me kompetencë dhe të dokumentojnë planifikimin e punës që duhet për të adresuar objektivat e auditimit.

**6.07** Audituesit duhet të planifikojnë auditimin për të zvogëluar riskun e auditimit në një nivel të përshtatshëm për të marrë siguri të arsyeshme se evidenca është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të mbështetur gjetjet dhe konkluzionet. Ky përcaktim është çështje e gjykimit profesional. Në planifikimin e auditimit, audituesit duhet të vlerësojnë rëndësinë dhe riskun e auditimit dhe të aplikojnë këto vlerësime në përcaktimin e objektivave të auditimit, fushëveprimin dhe metodologjinë për adresimin e këtyre objektivave. Planifikimi është një proces i vazhdueshëm gjatë gjithë auditimit. Prandaj, audituesit mund të kenë nevojë për të rregulluar objektivat, fushën dhe metodologjinë e auditimit, ndërkohë që puna është drejt përfundimit. Në rastet kur objektivat e auditimit janë të përcaktuara me statut ose mbikëqyrje legjislative, audituesit nuk mund të kenë liri për të përcaktuar apo rregulluar objektivat ose fushën e auditimit.

**Kapitulli 6**  
**Standardet e Punës në Terren për Auditimet e**  
**Performancës**

---

**6.08** Objektivat janë ato që auditimi ka për qëllim të përmbushë. Ato identifikojnë çështjen e auditimit dhe aspektet e performancës që duhet të përfshihen dhe mund të përfshijnë edhe gjetjet e mundshme e elementë të raportimit që audituesit mund të trajtojnë. Objektivat e auditimit mund të paraqiten si pyetje rreth programit, që audituesit kërkojnë t'u përgjigjen, bazuar në evidencën e marrë dhe të vlerësuara kundrejt kriterëve. Termi "program" i përdorur sipas GAGAS, përfshin njësitë, organizatat, programet, aktivitetet dhe funksionet qeveritare.

**6.09** Fusha është kufiri i auditimit dhe është i lidhur direkt me objektivat e auditimit. Fusha përcakton çështjen rreth së cilës audituesit do të vlerësojnë dhe raportojnë, si p.sh një program i veçantë ose një aspekt të një programi, dokumentet ose regjistrat e nevojshme, periudhën kohore që verifikohet dhe vendet që do të përfshihen.

**6.10** Metodologjia përshkruan natyrën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit për mbledhjen dhe analizimin e evidencës për adresimin e objektivave të auditimit. Procedurat e auditimit janë hapat specifike dhe testet që audituesit kryejnë për të adresuar objektivat e auditimit. Audituesit duhet të hartojnë metodologjinë për të marrë siguri të arsyeshme se evidenca është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të mbështetur gjetjet dhe konkluzionet e audituesve lidhur me objektivat e auditimit dhe për të zvogëluar riskun e auditimit në një nivel të pranueshëm.

**6.11** Auditorët duhet të vlerësojnë riskun e auditimit dhe rëndësinë brenda kontekstit të objektivave të auditimit duke grumbulluar njohuri si më poshtë:

- a. natyra dhe profili i programeve dhe nevojat e përdoruesve të mundshëm të raportit të auditimit;
- b. kontrollit të brendshëm në lidhje me objektivat specifike dhe fushëveprimin e auditimit;

**Kapitulli 6**  
**Standardet e Punës në Terren për Auditimet e**  
**Performancës**

---

- c. Kontrollat e sistemeve të informacionit për qëllime të vlerësimit të riskut të auditimit dhe planifikimin e auditimit brenda kontekstit të objektivave të auditimit;
- d. Dispozitat e ligjeve, rregulloreve, kontratave dhe marrëveshjeve të grantit si dhe mashtrimin dhe shpërdorimin e të mundshëm, që janë domethënëse në kontekstin e objektivave të auditimit;
- e. Hetimet ose procedimet ligjore brenda kontekstit të objektivave të auditimit;  
Dhe
- f. Rezultatet e auditimeve dhe angazhimeve për certifikim të mëparshme që kanë të bëjnë direkt me objektivat e auditimit aktual;

**6.12** Gjatë planifikimit, audituesit duhet gjithashtu:

- a. të identifikojnë kriteret e mundshme të nevojshme për të vlerësuar çështjet nën auditim;
- b. të identifikojnë burimet e evidencave të auditimit dhe të përcaktojnë sasinë dhe llojin e evidencës së nevojshme për nivel të caktuar të riskut të auditimit dhe rëndësisë;
- c. të vlerësojnë nëse do të përdoret puna e audituesve dhe specialistëve të tjerë për të adresuar disa nga objektivat e auditimit;
- d. të caktojnë staf dhe specialistë të mjaftueshëm, me kompetencën e duhur profesionale kolektive dhe të identifikojnë burime të tjera të nevojshme për kryerjen e auditimit;
- e. të komunikojnë lidhur me planifikimin dhe kryerjen e auditimit me menaxherët, të ngarkuarit me qeverisjen dhe të tjerët sipas rastit,  
dhe

**Kapitulli 6**  
**Standardet e Punës në Terren për Auditimet e**  
**Performancës**

---

f. të përgatisin një plan të shkruar auditimi.

---

Natyra dhe Profili i  
Programit dhe  
Nevojave të  
Përdoruesve

**6.13** Audituesit duhet të fitojnë një kuptim të natyrës së programit ose komponentëve të programit që auditohet dhe përdorimin e mundshëm që do t'u bëhet nga rezultateve apo raportit të auditimit ndërkohë që planifikojnë auditimin e performancës. Natyra dhe profili i një programi përfshijnë:

a. qartësinë, ndjeshmërinë dhe risqet përkatëse që lidhen me programin e auditimit;

b. kohëzgjatja e programit ose të ndryshimet e kushteve të tij;

c. Madhësia e programit, vlera monetare, numri i qytetarëve të prekur apo masa të tjera;

d. Niveli dhe shtrirja e rishikimit apo formave të tjera të mbikëqyrjes së pavarur;

e. Plani strategjik i programit dhe objektivat;  
dhe

f. faktorë të jashtëm ose kushte që mund të ndikojnë drejtpërdrejt programin.

**6.14** Një grup i përdoruesve të raportit të auditorëve janë zyrtarë qeveritarë që mund të kenë të autorizuar ose kërkuar auditimin. Përdoruesi të tjerë të rëndësishëm të raportit janë njësia e audituar, ata që janë përgjegjës për të zbatuar rekomandimet e audituesve, organet mbikqyrëse dhe organet legjislative. Përdoruesit e tjerë të mundshëm të raportin të auditimit përfshijnë ligjvënësit ose zyrtarë (të tjerë nga ata që mund të kenë autorizuar ose kërkuar auditimin), mediat, grupet e interesit dhe qytetarë të veçantë. Përveç interesit për

**Kapitulli 6**  
**Standardet e Punës në Terren për Auditimet e**  
**Performancës**

---

programin, përdoruesit e mundshëm mund të kenë mundësi për të ndikuar në kryerjen e programit. Ndërgjegjësimi për interesat dhe pasojat e këtyre përdoruesve potencialë mund të ndihmojë audituesit nëse gjetjet e mundshme mund të jenë domethënëse për përdoruesit përkatës.

**6.15** Kuptimi i programit të auditimit i ndihmon audituesit për të vlerësuar risqet që lidhen me programin dhe ndikimin e risqeve në objektivat, fushën dhe metodologjinë, e auditimit. Kuptimi i audituesve mund të krijohet nga njohuritë që ata tashmë kanë në lidhje me programin ose njohuri që i marrin nga intervistat, vëzhgimet dhe shqyrtimi i dokumenteve gjatë planifikimit të auditimit. Shtrirja dhe gjerësia e këtyre pyetjeve dhe vëzhgimeve ndryshon në varësi të objektivave të auditimit, ashtu si dhe nevoja për të kuptuar aspektet e programeve të veçanta, të tilla si më poshtë:

**a.** Dispozitat e ligjeve, rregulloreve, kontratave dhe marrëveshjeve të grantit: Programet e qeverisë zakonisht miratohen me ligj dhe i nënshtrohen ligjeve dhe rregullave të veçanta. Ligjet dhe rregulloret zakonisht përcaktojnë çfarë duhet të bëhet, kush duhet ta bëjë, qëllimi që duhet të arrihet, popullsisë që do t'i shërbehet dhe udhëzime të ngjashme për financimin ose kufizimet. Programet e qeverisë mund të jenë subjekt i kontratave ose marrëveshjeve të grantit. Kështu, të kuptuarit e ligjeve dhe ecurisë si legjislativi ka miratuar programin dhe dispozitat e çdo kontrate ose marrëveshjeje granti është thelbësore për të kuptuar vetë programin.

Kuptimi i programit është edhe një hap i nevojshëm në identifikimin e dispozitave të ligjeve, rregulloreve, kontratave apo marrëveshjeve të grantit që janë të rëndësishme në kontekstin e objektivave të auditimit.

**b.** Qëllimi dhe Objektivat: Qëllimi është rezultati ose efekti që ka për qëllim të arrihet nga një program. Legjislativi zakonisht vendos qëllimin e programit kur vendosin përgjegjësitë e programit.

**Kapitulli 6**  
**Standardet e Punës në Terren për Auditimet e**  
**Performancës**

---

Zyrtarët e njësisë mund të japin informacion më të hollësishëm mbi qëllimin e programit si shtesë e legjislacionit përkatës. Zyrtarëve të njësisë nganjëherë u kërkohet të caktojnë objektivat për ecurinë dhe operacionet e programit, duke përfshirë si produktin dhe rezultatet. Audituesit mund të përdorin qëllimin e deklaruar të programit dhe objektivat si kriterë për vlerësimin e performancës së programit ose mund të zhvillojnë kriterë shtesë në vlerësimin të performancës.

**c. Kontrolli i brendshëm:** Kontrolli i brendshëm, ndonjëherë cilësohet si kontroll i menaxhimit, në kuptimin më të gjerë përfshin planin, politikat, metodat dhe procedurat e miratuara nga drejtuesit për të përmbushur misionin, qëllimet dhe objektivat. Kontrolli i brendshëm përfshin proceset për planifikimin, organizimin, drejtimin, dhe kontrollin e operacioneve të programit. Ai përfshin sisteme për matjen, raportimin, dhe monitorimin e performancës së programit. Kontrolli i brendshëm shërben si një mbrojtje në ruajtjen e pasurive dhe në parandalimin dhe zbulimin e gabimeve; mashtrimit; mospërputhjen me dispozitat ligjore, rregulloret, kontratat, marrëveshjet e grantit; ose shpërdorimet.

**d. Inputet:** Inputet janë tërësia e burimeve (monetare, materiale, personeli, etj.) që vihen në dispozicion të një programi. Këto burime mund të vijnë nga brenda ose jashtë njësisë që zbaton programin. Inputet mund të përfshijnë koston, kohën dhe cilësinë. Shembuj të inputeve janë shpenzime në para, orë-punonjës të shpenzuara dhe metra katror të sipërfaqes së ndërtimit.

**e. Operacionet e Programit:** operacionet e programit janë strategjitë, proceset dhe aktivitetet që përdor menaxhimi për të kthyer burimet në produkte. Operacionet e Programit mund të jenë subjekt i kontrollit të brendshëm.

**Kapitulli 6**  
**Standardet e Punës në Terren për Auditimet e**  
**Performancës**

---

f. Produktet: produktet paraqesin sasinë e mallrave apo shërbimeve të prodhuara nga një program. Për shembull, për një program trajnimi të punonjësve mund të jetë numri i personave që përfundojnë trajnimin, ndërsa për një program inspektimi të sigurisë së aviacionit, mund të jetë numri i inspektimeve të kryera.

g. Rezultatet: Rezultatet janë të arritjet ose përfundimet e një programi. Për shembull, për një program trajnimi, mund të jetë përqindja e punonjësve të trajnuar dhe që janë ende në vendin e punës pas një periudhe të caktuar kohore. Shembull i rezultateve të një programi të inspektimit të sigurisë së aviacionit mund të jetë reduktimi i përqindjes së problemet të sigurisë të konstatuara në inspektimet e mëvonshme ose në përqindjen e problemeve të korrigjuara. Vlerësime të tillë i rezultateve tregojnë progresin e bërë në arritjen e qëllimit të programit në ndihmë të qytetarëve për t'u punësuar dhe mbajtur vendet e punës dhe përmirësimin e sigurisë së operacioneve të aviacionit. Rezultatet mund të ndikohen nga faktorë kulturorë, ekonomikë, fizike apo teknologjike, jashtë programit. Audituesit mund të përdorin metoda të nxjerra nga disiplina të tjera, të tilla si vlerësimi i programit, për të mënjeluar ndikimet e tjera në efektin e programit. Rezultatet gjithashtu përfshijnë efekte të papritura dhe/ose të paqëllimshme të një programi, si pozitive dhe negative.

**Kapitulli 6**  
**Standardet e Punës në Terren për Auditimet e**  
**Performancës**

---

---

Kontrolli i  
Brendshëm

**6.16** Audituesit duhet të marrin njohuri për kontrollin e brendshëm që është i rëndësishëm në kontekstin e objektivave të auditimit.<sup>127</sup> Për kontrollin e brendshëm që është i rëndësishëm në kontekstin e objektivave të auditimit, audituesit duhet të vlerësojnë nëse kontrolli i brendshëm është projektuar dhe zbatuar siç duhet dhe duhet të kryejnë procedurat e përcaktuara për të marrë evidencë të mjaftueshme e të përshtatshme për të mbështetur vlerësimin e tyre në lidhje me efektivitetin e këtyre kontrolleve. Kontrollat e Sistemeve të Informacionit shpesh janë një pjesë integrale e kontrollit të brendshëm të një njësie ekonomike. Efektiviteti i kontrolleve kryesore të brendshme është shpesh i varur nga efektiviteti i kontrolleve të sistemeve të informacionit. Kështu, për të kuptuar kontrollin e brendshëm që ka rëndësi për objektivat e auditimit, audituesit duhet gjithashtu të përcaktojnë nëse është e nevojshme për të vlerësuar kontrollet e sistemeve të informacionit.<sup>128</sup>

**6.17** Efektiviteti i kontrollit të brendshëm që ka rëndësi në kontekstin e objektivave të auditimit mund të ndikojë në riskun e auditimit. Rrjedhimisht, audituesit mund të përcaktojnë se është i nevojshëm modifikimi i natyrës, kohës apo shtrirjes së procedurave të auditimit, bazuar në vlerësimin e kontrollit të brendshëm dhe të rezultateve të testimit të kontrollit të brendshëm. Për shembull, aspekte të kontrolluara keq të një programi kanë risk më të lartë dështimi, kështu që audituesit mund të zgjedhin të përqendrojnë më shumë përpjekje në këto fusha. Në anën tjetër, kontrollet efektive në njësinë e audituar mund t'i mundësojnë audituesve, të kufizojnë shkallën dhe llojin e testeve të auditimit.

---

<sup>127</sup> Për më tepër rreth kontrollit të brendshëm shih paragrafet A 03 dhe A 04

<sup>128</sup> Për më tepër rreth vlerësimit të efektivitetit të kontrolleve të sistemeve të informacionit shih paragrafet 6.23 dhe 6.27

**Kapitulli 6**  
**Standardet e Punës në Terren për Auditimet e Performancës**

---

**6.18** Auditorët marrin njohuri të kontrollit të brendshëm nëpërmjet intervistave, vëzhgimeve, inspektimit të dokumenteve dhe të dhënave, shqyrtimin e raporteve të audituesve të tjerë ose testeve të drejtpërdrejta. Natyra dhe shtrirja e procedurave që audituesit bëjnë për të fituar një kuptim për kontrollin e brendshëm mund të ndryshojë bazuar në objektivat e auditimit, riskut të auditimit, mangësitë e njohura ose të mundshme të kontrollit të brendshëm dhe njohuritë e audituesve në lidhje me kontrollin e brendshëm bazuar në auditimet e mëparshme.

**6.19** Diskutimi në vijim për llojet kryesore të objektivave të kontrollit të brendshëm ka për qëllim të ndihmojë audituesit të kuptojnë më mirë kontrollet e brendshme dhe të përcaktojnë përse apo deri në çfarë mase ato janë të rëndësishme për objektivat e auditimit.

**a.** Efektiviteti dhe eficientia e operacioneve të programit: Kontrollet mbi operacionet e programit përfshijnë politikat dhe procedurat që njësia i auditimit zbaton për të ofruar siguri të arsyeshme se një program i plotëson objektivat, duke pasur parasysh efektivitetin dhe eficientien e shpenzimeve. Kuptimi i këtyre kontrolleve mund të ndihmojë audituesit të kuptojnë operacionet e programit që shndërrojnë inputet në produkte dhe rezultate.

**b.** Përshtatshmëria dhe besueshmëria e informacionit: Kontrollet mbi përkatësinë dhe besueshmërinë e informacionit përfshijnë politikat dhe procedurat që zyrtarët e njësisë të audituar kanë zbatuar për t'i dhënë vetes siguri të arsyeshme se informacioni operacional dhe financiar që ata përdorin për marrjen e vendimeve dhe raportimin është përkatës e i besueshëm dhe është paraqitur drejt në raporte. Kuptimi i këtyre kontrolleve i ndihmon audituesit

(1) të vlerësojnë riskun që informacioni i mbledhur nga njësia mund të mos jetë i përshtatshëm ose i besueshëm dhe (2) të zhvillojnë teste të përshtatshme të informacionit duke marrë parasysh objektivat e auditimit.

**Kapitulli 6**  
**Standardet e Punës në Terren për Auditimet e**  
**Performancës**

---

c. Pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, kontratat dhe marrëveshjet e granteve: Kontrollët mbi pajtueshmërinë përfshijnë politikat dhe procedurat që njëzia i auditimit ka zbatuar për të patur siguri të arsyeshme se programi i zbatuar është në përputhje me dispozitat e ligjeve, rregulloreve, kontratave dhe marrëveshjeve të grantit. Kuptimi i kontrolleve përkatëse lidhur me pajtueshmërinë me këto ligje, rregullore, kontrata ose marrëveshjeve për grante, nga audituesit janë të rëndësishme në kontekstin e objektivave të auditimit sepse mund t'i ndihmojë ata, të vlerësojnë riskun e papajtueshmërisë me dispozitat e ligjeve, rregulloreve, kontratave, marrëveshjeve të grantit ose shpërdorimeve.

**6.20** Ndërmjet kategorive të objektivave të kontrollit të brendshëm është edhe ruajtja e aseteve dhe burimeve. Kontrollët mbi ruajtjen e aseteve dhe burimeve përfshijnë politikat dhe procedurat që njëzia i auditimit zbaton për të parandaluar në mënyrë të arsyeshme ose të evidentojë menjëherë përvetësimin, përdorimin apo mbajtjen e paautorizuar të aktiveve dhe burimeve.

**6.21** Në auditimet e performancës, ka mangësi në kontrollin e brendshëm kur vendosja ose veprimi i një kontrolli nuk lejon menaxhimin ose me punonjësit, në rrjedhën normale të kryerjes së funksioneve, për të parandaluar ose zbuluar dhe korrigjuar në kohën e duhur :

(1) dobësitë e operacioneve në drejtim të efektivitetit ose efijencës, (2) gabimet në informacionin financiar apo të performancës, ose (3) papajtueshmërinë me dispozitat e ligjeve, rregulloreve, kontratave ose marrëveshjeve të grantit. Një mangësi rezulton kur (a) një kontroll i nevojshëm për të përmbushur objektivin e kontrollit mungon ose (b) një kontroll ekzistues nuk është projektuar siç duhet në mënyrë të tillë që, edhe nëse kontrolli vepron siç ishte parashikuar, objektivi i kontrollit nuk përmbushet. Një mangësi në funksionimin ekziston kur një kontroll i projektuar siç duhet

**Kapitulli 6**  
**Standardet e Punës në Terren për Auditimet e**  
**Performancës**

---

nuk funksionon sipas parashikimit ose kur personi që kryen kontrollin nuk gëzon autoritetin ose kualifikimet e nevojshme për ta kryer këtë kontroll në mënyrë efektive.

**6.22** Auditimi i brendshëm është një pjesë e rëndësishme e qeverisjes së përgjithshme, përgjegjshmërisë dhe kontrollit të brendshëm. Një rol kyç i shumë strukturave të auditimit të brendshëm është që të ofrojnë siguri që kontrollet e brendshme funksionojnë në zvogëlimin e risqeve dhe arritjen e qëllimeve dhe objektivave të programit. Audituesit mund të përcaktojnë se përdorimi i punës së audituesve të brendshëm është i vlefshëm në lidhje me efektivitetin e projektit ose funksionimin e kontrolleve të brendshme, domethënëse në kontekstin e objektivave auditimit.

---

**Kontrollet e**  
**Sistemeve të**  
**Informacionit**

**6.23** Njohja e kontrolleve të sistemeve të informacionit është e rëndësishme kur sistemet e informacionit përdoren gjerësisht në të gjithë programin që auditohet dhe proceset themelore të aktivitetit që lidhen me objektivat e auditimit mbështeten në sistemet e informacionit. Kontrollet e sistemeve të informacionit përbëhen nga ato kontrolleve të brendshme që varen në procedurat e sistemeve të informacionit dhe përfshijnë kontrollet e përgjithshme, kontrollet e aplikimit dhe kontrollet e përdoruesit.

- a.** Kontrollet e përgjithshme të sistemeve të informacionit (në nivel njësie, sistemi dhe aplikimi) janë politikat dhe procedurat që zbatohen për të gjithë ose një segment të madh të sistemeve të informacionit të një njësie ekonomike. Kontrollet e përgjithshme ndihmojnë për të siguruar funksionimin e duhur të sistemeve të informacionit, duke krijuar mjedisin për funksionimin e duhur të kontrolleve të aplikimit. Kontrollet e përgjithshme përfshijnë menaxhimin e sigurisë, qasje logjike dhe fizike, menaxhimin e konfigurimit, ndarjen e detyrave, dhe planifikimin e kontigjencës.

**Kapitulli 6**  
**Standardet e Punës në Terren për Auditimet e**  
**Performancës**

---

- b. Kontrollat e aplikimit, nganjëherë të referuara si kontrolle të procesit të biznesit, janë ato kontrolle që janë të përfshira direkt në aplikimet kompjuterike, për të ndihmuar në sigurimin e vlefshmërisë, plotësisë, saktësisë dhe besueshmërisë së transaksioneve dhe të dhënave gjatë përpunimit të aplikimit. Kontrollat e aplikimit përfshijnë kontrolle ndaj inputeve, procedimit/përpunimit, outputeve, skedarëve master, ndërhyrjeve, dhe kontrollet e sistemit të menaxhimit të dhënave.
- c. Kontrollat e përdoruesit, janë pjesët e kontrolleve që kryhen nga njerëz që ndërveprojnë me kontrollet e sistemit të informacionit. Një kontroll përdoruesi është një kontroll sistemi informacioni nëse efektiviteti i tij varet nga përpunimi i sistemit të informacionit ose besueshmëria (saktësia, plotësia dhe vlefshmëria) e informacionit të përpunuar nga sistemet e informacionit.

**6.24** Përdorimi i kontrolleve të sistemeve të informacionit në një njësinë e audituar mund të jetë i gjerë; megjithatë audituesit janë të interesuar kryesisht në ato kontrolle të sistemeve të informacionit që janë të rëndësishëm për objektivat e auditimit. Kontrollat e sistemeve të Informacionit janë të rëndësishme për objektivat e auditimit nëse audituesit përcaktojnë se janë të nevojshme për të vlerësuar efektivitetin e kontrolleve të sistemeve të informacionit në mënyrë që të marrin evidencë të mjaftueshme. Kur kontrollet e sistemeve të informacionit vlerësohen të rëndësishme për objektivat e auditimit ose kur efektiviteti i kontrolleve kryesore varet nga efektiviteti i kontrolleve të sistemeve të informacionit, audituesit duhet të vlerësojnë efektivitetin e strukturimit dhe funksionimit të këtyre kontrolleve.

Ky vlerësim do të përfshijë kontrollet e sistemeve të tjera informacionit që ndikojnë në efektivitetin e kontrolleve kryesore ose besueshmërinë e informacionit të përdorur në kryerjen e këtyre kontrolleve. Audituesit duhet të marrin njohuri të mjaftueshme të kontrolleve të sistemeve të

**Kapitulli 6**  
**Standardet e Punës në Terren për Auditimet e**  
**Performancës**

---

informacionit, e nevojshme kjo për të vlerësuar riskun e auditimit dhe planifikimin e auditimit brenda kontekstit të objektivave të auditimit.

**6.25** Procedurat e auditimit për të vlerësuar efektivitetin e kontrolleve të sistemeve të kryesore të informacionit përfshijnë:

(1) Të kuptuarit e sistemit që lidhet me informacionin dhe (2) identifikimin dhe vlerësimin e kontrolleve të përgjithshme, të aplikimit dhe përdoruesit që janë kyçe për të ofruar siguri rreth besueshmërisë së informacionit, që kërkohet për auditimin.<sup>129</sup>

**6.26** Vlerësimi i kontrolleve të sistemeve të informacionit mund të bëhet i lidhur me shqyrtimin e kontrollit të brendshëm nga audituesit, brenda kontekstit të objektivave të auditimit ose si një objektiv apo procedurë e veçantë auditimi, varësisht nga objektivat e auditimit.

Në varësi të rëndësisë të kontrolleve të sistemeve të informacionit ndaj objektivave të auditimit, shtrirja e procedurave të auditimit për të fituar njohuri, mund të jetë e kufizuar ose e gjerë. Përveç kësaj, natyra dhe shkalla e riskut të auditimit lidhur me kontrollet e sistemeve të informacionit ndikohen nga lloji i hardware-ve dhe software-ve të përdorur, konfigurimi i sistemeve dhe rrjeteve të njësisë si dhe Strategjia e Sistemeve të informacionit.<sup>130</sup>

**6.27** Audituesit duhet të përcaktojnë procedurat e auditimit që lidhen me kontrollet e sistemeve informacionit që duhen për të marrë evidencë të mjaftueshme dhe të përshtatshme, për të dokumentuar gjetjet dhe konkluzionet e auditimit. Faktorët e mëposhtëm ndihmojnë audituesit në këtë përcaktim:

---

<sup>129</sup> Shih. udhëzuesit dhe kriterit shtesë të Manuali i Auditimit të Kontrolleve të Sistemit Federal të Informacionit (FISCAM), Uashington DC, shkurt 2009 dhe Standardet e IT, Udhëzuesit dhe Mjetet dhe Teknikat për profesionistët e Auditimit, Sigurisë dhe Kontrollit, botuar nga ISACA

<sup>130</sup> Shih paragrafët 6, 16 deri 6.22 për shqyrtime të mëtejshme rreth kontrollit të brendshëm

**Kapitulli 6**  
**Standardet e Punës në Terren për Auditimet e**  
**Performancës**

---

**a.** Shkalla në të cilën kontrollet e brendshme që janë të rëndësishëm për auditimin varet nga besueshmëria e informacionit të përpunuar ose të krijuar nga sistemet e informacionit.

**b.** Vlefshmëria e evidencës jashtë sistemit të informacionit për të mbështetur gjetjet dhe konkluzionet: mund të bëjë të pamundur për audituesit të marrin evidencën e duhur dhe të mjaftueshme, pa vlerësuar efektivitetin të kontrolleve përkatëse të sistemeve të informacionit. Për shembull, në qoftë se të dhënat që mbështesin gjetjet dhe konkluzionet janë gjeneruar nga sistemet e informacionit ose besueshmëria e kësaj evidence është e varur nga kontrollet e sistemeve të informacionit, mund të mos jetë e mjaftueshme për të mbështetur ose vërtetuar, apo dokumentojë evidencën, përveç asaj që del nga sistemet e informacionit.

**c.** Lidhja e kontrolleve të sistemeve të informacionit me besueshmërisë e të dhënave: Për të marrë evidencë lidhur me besueshmërinë e informacionit të gjeneruar nga kompjuteri, audituesit mund të vlerësojnë efektivitetin e kontrolleve të sistemeve të informacionit, si pjesë e marrjes së evidencë mbi besueshmërinë e të dhënave. Nëse audituesit gjykojnë se kontrollet e sistemeve të informacionit janë efektive, audituesit mund të zvogëlojnë nivelin e testimi të drejtpërdrejtë të të dhënave.

**d.** Vlerësimi i efektivitetit të kontrolleve të sistemeve të informacionit si një objektivë e auditimit: Kur vlerësimi i efektivitetit të kontrolleve të sistemeve të informacionit është drejtpërdrejt pjesë e një objektivi të auditimit, audituesit duhet të testojnë kontrollet e sistemeve të informacionit, të nevojshme për të adresuar objektivat e auditimit. Për shembull, auditimi mund të përfshijë efektivitetin e kontrolleve të sistemeve të informacionit për sisteme, pajisje, ose organizata të caktuara.

---

**Kapitulli 6**  
**Standardet e Punës në Terren për Auditimet e**  
**Performancës**

---

Dispozitat e Ligjeve,  
Rregulloreve, Kontratave,  
dhe Marrëveshjeve të  
Grantit, Mashtrimi  
dhe Shpërdorimet

---

Dispozitat e  
Ligjeve,  
Rregulloreve,  
Kontratave,  
dhe  
Marrëveshjeve të  
Grantit,

**6.28** Audituesit duhet të identifikojnë çdo dispozitë të ligjeve, rregulloreve, kontratave ose marrëveshjeve të grantit që janë të rëndësishme në kontekstin e objektivave të auditimit dhe vlerësojnë riskun e moszbatimit të tyre.<sup>131</sup> Bazuar në vlerësimin e riskut, audituesit duhet të hartojnë dhe të zbatojnë procedura, për të marrë siguri të arsyeshme për zbulimin e rasteve të papajtueshmërisë me dispozitat e ligjeve, rregulloreve, kontratave apo marrëveshjeve të grantit që janë të rëndësishme në kontekstin e objektivave të auditimit.

**6.29** Vlerësimi i riskut të auditimit nga audituesit, mund të ndikohet nga faktorë të tillë si kompleksiteti apo risia e ligjeve, rregulloreve, kontratave ose marrëveshjeve të granteve. Vlerësimi i riskut të auditimit gjithashtu mund të ndikohet nga faktorë të tillë, nëse njësia ekonomike ka kontrolle që janë efektive në parandalimin ose zbulimin e papajtueshmërisë të dispozitave të ligjeve, rregulloreve, kontratave ose marrëveshjeve të grantit. Nëse audituesit marrin mjaftueshëm evidencë të përshtatshme të efektivitetit të këtyre kontrolleve, ata mund të zvogëlojnë shkallën e testeve të përputhshmërisë.

Mashtrimi

**6.30** Në planifikimin e auditimit, audituesit duhet të vlerësojnë mundësinë e riskut të mashtrimit ndodh që është i rëndësishëm në kontekstin e objektivave të auditimit.<sup>132</sup>

---

<sup>131</sup> Shih paragrafët A. 11 deri A. 13 për shqyrtime shtesë mbi rëndësinë e klauzoleve të ligjeve, rregulloreve, kontratave ose marrëveshjeve të granteve.

<sup>132</sup> Shih paragrafin A. 10 për shembuj të treguesve të riskut të mashtrimit.

**Kapitulli 6**  
**Standardet e Punës në Terren për Auditimet e**  
**Performancës**

---

Mashtrimi përfshin përvetësimin e vlerave nëpërmjet paraqitjes false / shtrembërimit të qëllimshëm. Nëse një veprim është, në fakt, mashtrim është një përcaktim duhet të bëhet përmes sistemit gjyqësore ose ndonjë sistemi tjetër me funksione gjyqësore dhe është përtej përgjegjësisë profesionale audituesve. Anëtarët e grupit të auditimit duhet të diskutojnë si grup risqet e mashtrimit, duke përfshirë edhe faktorë të tillë si nxitës apo presion individual për të kryer mashtrimin, mundësinë që mashtrimi të ndodhë dhe arsyetimin ose qëndrimin që mund të lejojë që individët të kryejnë mashtrime. Audituesit duhet të mbledhin dhe të vlerësojnë informacionin për të identifikuar risqet e mashtrimit që janë të rëndësishme në kuadër të objektivave të auditimit ose që mund të ndikojnë te gjetjet dhe konkluzionet. Për shembull, audituesit mund të marrin informata nëpërmjet diskutimeve me zyrtarë të njësisë të audituar apo përmes mënyrave të tjera për të përcaktuar dobësinë e programit kundrejt mashtrimit, statusi i kontrolleve të brendshme që njësia e audituar ka vendosur për të parandaluar dhe zbuluar mashtrimin apo risku që punonjësit e njësisë të audituar mund të shmangin kontrollin e brendshëm. Skepticizmi profesional në vlerësimin e këtyre risqeve ndihmon audituesit në përcaktimin se cilët faktorë ose risqe mund të ndikojnë në mënyrë të konsiderueshme në objektivat e auditimit.

**6.31** Kur audituesit identifikojnë faktorët ose risqet që lidhen me mashtrimin e ndodhur ose që mund të ndodhë, që ata besojnë se janë të rëndësishme në kontekstin e objektivave të auditimit, duhet të përcaktojnë procedurat, për të marrë siguri të arsyeshme për zbulimin e ndonjë mashtrimi të tillë. Vlerësimi riskut të mashtrimit është një proces i vazhdueshëm gjatë gjithë auditimit dhe lidhet jo vetëm me planifikimin e auditimit, por edhe gjatë vlerësimit të evidencës së marrë në procesin e auditimit.

**6.32** Kur audituesit marrin informacion se mashtrimi, që është i rëndësishëm në kontekstin e objektivave të auditimit, mund të ketë ndodhur, audituesit duhet të shtrijnë hapat dhe procedurat e auditimit, për të:

**Kapitulli 6**  
**Standardet e Punës në Terren për Auditimet e**  
**Performancës**

---

(1) përcaktuar nëse mashtrimi ka ndodhur dhe

(2) në qoftë se ka ndodhur, të përcaktojnë ndikimin në gjetjet e auditimit.

Nëse mashtrimi i rezultuar nuk është i rëndësishëm në kontekstin e objektivave të auditimit, audituesit mund të kryejnë verifikime shtesë auditimi me tematikë të veçantë ose t'ia referojnë çështjen palëve të tjera me përgjegjësi mbikëqyrje ose gjyqësore.

**Shpërdorimi**

**6.33** Shpërdorimi përfshin një sjellje që është mangët ose e pahijshme, krahasuar me sjelljen që një person i matur e konsideron të arsyeshme dhe domosdoshme në praktikën e biznesit, për fakte dhe rrethana të caktuara. Shpërdorimi gjithashtu përfshin keqpërdorimin e autoritetit ose pozitës për interesa personale financiare ose të një të afërmi, anëtarit të familjes apo të një biznesi lidhur me të.<sup>133</sup> Shpërdorimi nuk përfshin domosdoshmërisht mashtrimin, papajtueshmërinë me dispozitat e ligjeve, rregulloreve, kontratave ose marrëveshjeve të grantit.

**6.34** Për shkak se përcaktimi i shpërdorimit është subjektiv, në auditimet e performancës audituesve nuk u kërkohet të zbulojnë shpërdorimet. Megjithatë, si pjesë e auditimeve sipas GAGAS, nëse auditorët bëhen të vetëdijshëm për shpërdorime që mund të jenë materiale nga pikëpamja sasiore ose cilësore për programin që auditohet, audituesit duhet të ndjekin procedura auditimit që kanë të bëjnë mënyrë specifike me përcaktimin e pasojës së mundshme në programin që auditohet brenda kontekstit të objektivave të auditimit. Pas kryerjes së punës shtesë, audituesit mund të zbulojnë se shpërdorimi paraqet mashtrimin e mundshëm ose papajtueshmërinë me dispozitat e ligjeve, rregulloreve, kontratave ose marrëveshjeve të grantit.

---

<sup>133</sup> Shih A. 08 për shembuj shtesë të shpërdorimit.

**Kapitulli 6**  
**Standardet e Punës në Terren për Auditimet e**  
**Performancës**

---

Hetimet dhe  
Procedimet  
Ligjore në  
vazhdim

**6.35** Shmangia e ndërhyrjes me hetimet ose procedimet ligjore është e rëndësishme në ndjekjen treguesve të mashtrimit, papajtueshmërisë me dispozitat e ligjeve, rregulloreve, kontratave ose marrëveshjeve të grantit, apo shpërdorimit. Ligjet, rregulloret dhe politikat mund t'i kërkojnë audituesve t'u raportojnë organeve të zbatimit të ligjit apo hetimore indicie për lloje të caktuara të mashtrimit, mospërputhjes me dispozitat e ligjeve, rregulloreve, kontratave ose marrëveshjeve të granteve apo shpërdorime para kryerjes së procedurave të tjera të auditimit. Kur hetimet ose procedurat ligjore kanë filluar ose janë proces, audituesit duhet të vlerësojnë ndikimin mbi auditimin. Në disa raste, mund të jetë e përshtatshme për audituesit të punojnë me hetuesit ose organet ligjore, ose të tërhiqen apo ta shtyjnë punën e mëtejshme audituese (edhe pjesërisht) për të shmangur përzjerjen me një hetim në vazhdim apo procedim ligjor.

Auditimet e  
Mëparshme  
dhe  
Angazhimet  
për Çertifikim

**6.36** Audituesit duhet të vlerësojnë nëse njësia e audituar ka marrë masat e duhura korrigjuese për gjetjet dhe rekomandimet e auditimeve të mëparshme që janë të rëndësishme në kontekstin e objektivave të auditimit. Gjatë planifikimit të auditimit, audituesit duhet të pyesin menaxhimin e njësisë të auditimit për auditimet e mëparshme, angazhimet për certifikim, auditimet e performancës ose studime të tjera që lidhen drejtpërdrejt me objektivat e auditimit, përfshirë këtu zbatimin e rekomandimeve. Audituesit duhet të përdorin këtë informacion në vlerësimin e riskut dhe përcaktimin e natyrës, kohës dhe shtrirjes së auditimit të planifikuar, duke përfshirë përcaktimin e shkallës në të cilën testimi i zbatimit të veprimeve korrigjuese është i aplikueshëm për objektivat aktuale të auditimit.

Identifikimi i  
Kritereve të  
Auditimit

**6.37** Audituesit duhet të identifikojnë kriteret. Kriteret përfaqësojnë ligjet, rregulloret, kontratat, marrëveshjet e granteve, standardet, kërkesat specifike, masat,

---

**Kapitulli 6**  
**Standardet e Punës në Terren për Auditimet e**  
**Performancës**

---

performancën e pritshme praktikat e përcaktuara të veprimtarisë si dhe standardet kundrejt të cilave performanca krahasohet ose vlerësohet. Kriteret identifikojnë gjendjen apo pritshmërinë e kërkuar ose dëshiruar në lidhje me programin apo operacionin. Kriteret japin një kontekst për vlerësimin e evidencës dhe arsyetimin e gjetjeve, konkluzioneve dhe rekomandimeve të përfshira në raport. Audituesit duhet të përdorin kriteret që janë përkatëse për objektivat auditimit dhe lejojnë vlerësimin e qëndrueshëm të çështjes.<sup>134</sup>

---

Identifikimi i  
Burimeve të  
Evidencës dhe  
Sasisë dhe Llojit  
Evidencës së  
Kërkuar

**6.38** Audituesit duhet të identifikojnë burimet e mundshme të informacionit që mund të përdoren si evidencë. Audituesit duhet të përcaktojnë sasinë dhe llojin e informacionit të nevojshëm për të marrë evidencë të mjaftueshme e të përshtatshme për objektivat e auditimit dhe të planifikojnë me kompetencë punën audituese.

**6.39** Nëse audituesit mendojnë se nuk është e mundur të merret një evidencë e mjaftueshme dhe e përshtatshme, ata mund të rishikojë objektivat e auditimit ose ndryshojnë qëllimin dhe metodologjinë dhe të përcaktojnë procedura alternative për të marrë evidencë shtesë ose forma të tjera të provave për të adresuar objektivat aktuale të auditimit. Audituesit duhet të vlerësojnë nëse mungesa e një evidence të mjaftueshme, të përshtatshme, vjen për shkak të mangësive të kontrollit të brendshëm apo dobësive të tjera të programit si dhe nëse mungesa e një evidence të mjaftueshme e të përshtatshme, mund të jetë bazë për gjetjet e auditimit.<sup>135</sup>

Përdorimi i punës  
së të tjerëve

**6.40** Audituesit duhet të përcaktojnë nëse auditues të tjerë kanë kryer ose janë duke ushtruar auditime të programit që mund të jenë të rëndësishme për objektivat aktuale të auditimit. Rezultatet e punës së audituesve të tjerë mund të jenë burime të dobishme të informacionit për planifikimin dhe kryerjen e auditimit.

**K**

---

<sup>134</sup> Shih paragrafin A6. 02 për shembuj kriteresh

<sup>135</sup> Shih paragrafët 6,56 deri 6,72 për standardet që kanë të bëjnë me evidencën.

**Kapitulli 6**  
**Standardet e Punës në Terren për Auditimet e**  
**Performancës**

---

Nëse audituesit e tjerë kanë identifikuar fushat që e garantojnë punën e mëtejshme të auditimit apo përfundimin e saj, puna e tyre mund të ndikojë në përzgjedhjen e objektivave, fushëveprimin dhe metodologjinë e audituesve.

---

**6.41** Nëse auditues të tjerë kanë përfunduar punën audituese që lidhet me objektivat e këtij auditimi, grupi i auditimit mund të jetë në gjendje të përdorë punën e audituesve të tjerë për të mbështetur gjetjet ose konkluzionet për auditimin e planifikuara dhe në këtë mënyrë, për të shmangur mbivendosjen e punës. Nëse audituesit do ta përdorin punën e audituesve të tjerë, ata duhet të kryejnë procedura që sigurojnë bazë të mjaftueshme për ta përdorur atë. Grupi i Auditimit duhet të marrë evidencë lidhur me kualifikimet dhe pavarësinë e audituesve të tjerë dhe duhet të përcaktojë nëse qëllimi, cilësia dhe koha e punës së auditimit të kryer nga audituesit e tjerë janë të përshtatshme për të mbështetur objektivat aktuale të auditimit. Procedurat që grupi i auditimit mund të kryejë në marrjen e këtij vendimi, përfshijnë shqyrtimin e raportit, programit të auditimit ose dokumentacionit të auditimit të audituesve të tjerë dhe/ose kryerjen e testeve mbi punën e audituesve të tjerë. Natyra dhe shtrirja e evidencës së nevojshme do të varet nga rëndësia e punës së audituesve të tjerë kundrejt objektivave të auditimit aktuale dhe shkalla në të cilën grupi i auditimit do ta përdorë këtë punë.<sup>136</sup>

**6.42** Disa auditime mund të kërkojnë përdorimin e teknikave të specializuara ose metoda që kërkojnë aftësitë e një specialisti të fushës. Specialistët për të cilin zbatohet kjo pikë përfshijnë, por nuk kufizohet në: ekspertë të sigurimeve, vlerësuese, avokatë, inxhinierë, konsulentë mjedisorë, mjekë, statisticienë, gjeologë dhe specialistë të teknologjisë së informacionit. Nëse audituesit do të përdorin punën e specialistëve, ata duhet të vlerësojnë kualifikimet profesionale dhe pavarësinë e specialistëve.

---

<sup>136</sup> Shih paragrafin 3.107 për përdorimin e punës së audituesve të tjerë dhe raportet “peer review”

**Kapitulli 6**  
**Standardet e Punës në Terren për Auditimet e**  
**Performancës**

---

**6.43** Vlerësimi nga ana e grupit të auditimit të kualifikimeve profesionale të specialistëve përfshin:

**a.** certifikimin profesional, licenca ose vlerësime të tjera të aftësisë së specialistit në fushën e tij ose të saj, sipas rastit;

**b.** reputacioni dhe pikëpamjet kolegëve dhe të tjerëve që kanë dijeni për aftësitë e performancën e specialistit;

**c.** Përvoja dhe puna e mëparshme e specialistit për çështjen që auditohet;  
dhe

**d.** Përvoja e mëparshme e audituesve në përdorimin e punës së një specialisti.

**6.44** Vlerësimi i pavarësisë së specialistëve të cilët kryejnë punë audituese përfshin identifikimin e dobësive dhe zbatimin e masave të nevojshme në të njëjtën mënyrë si për stafin auditues.<sup>137</sup>

---

Përcaktimi i  
Stafit dhe  
Burimeve të  
Tjera

**6.45** Menaxherët e auditimit duhet të caktojnë staf dhe specialistë mjaftueshëm me kompetencën e duhur profesionale kolektive për të kryer auditimin.<sup>138</sup> Përcaktimi i stafit në një auditim ndër të tjera përfshin:

**a.** caktimin e stafit dhe specialistëve me njohuri, aftësi, dhe përvojë të përshtatshme të përbashkët,

**b.** caktimi i një numri të mjaftueshëm të stafit dhe mbikëqyrësve të auditimit,

---

<sup>137</sup> Për më tepër shih paragrafët 3,02 deri 3,26 në lidhje me pavarësinë dhe zbatimin e kriterit të pavarësisë.

<sup>138</sup> Për më tepër shih paragrafët 3,72 dhe 3,79 deri 3,81 për përdorimin e specialistëve në auditimet bazuar në GAGAS.

**Kapitulli 6**  
**Standardet e Punës në Terren për Auditimet e**  
**Performancës**

---

c. mbështetja me trajnim gjatë punës audituese,  
dhe

d. përfshirja e specialistëve kur është e nevojshme.

**6.46** Nëse planifikohet të përdoret puna e një specialisti, audituesit duhet të dokumentojnë natyrën dhe fushëveprimin e punës që do të kryhet nga specialist, duke përfshirë:

a. objektivat dhe fusha i punës së specialistit,

b. përdorimi i punës së specialistit në mbështetje të objektivave të auditimit,

c. procedurat e specialistit dhe gjetjet në mënyrë që ata të mund të vlerësohen dhe të lidhen me procedurat e tjera të planifikuara të auditimit,  
dhe

d. hipotezat dhe metodat e punës që do të përdoren nga specialisti.

---

Komunikimi me  
Menaxhimin, të  
Ngarkuarve me  
Qeverisjen dhe  
të Tjerë

**6.47** Audituesit duhet të komunikojnë një përmbledhje të objektivave, fushëveprimit, metodologjisë dhe kohës së auditimit të performancës dhe të raportimit të planifikuar (duke përfshirë çdo kufizim të mundshëm mbi raportin), përveç rasteve kur duke vepruar kështu nuk dëmtojnë në mënyrë të konsiderueshme aftësinë e audituesve për të marrë evidencë të mjaftueshme dhe të përshtatshme, për të adresuar objektivat e auditimit, të tilla si kur audituesit kanë në plan të kryejnë kontroll të paparalajmëruar të arkës ose të zbatojnë procedurat që lidhen me treguesit e mashtrimit. Audituesit duhet të komunikojë me palët si më poshtë:

a. menaxhimin e njësisë të audituar, përfshirë ata me përgjegjësi të mjaftueshme për të ndërmarrë veprime korrigjuese në program apo veprimtarinë që auditohet;

**Kapitulli 6**  
**Standardet e Punës në Terren për Auditimet e**  
**Performancës**

---

**b.** të ngarkuarit me qeverisjen;<sup>139</sup>

**c.** individët kontraktues për ose që kërkojnë shërbime të auditimit, siç janë zyrtarët kontraktorë ose të granteve; dhe

**d.** Komisioni përkatës legjislativ, kur audituesit kryejnë auditimin konform një ligji apo rregullore ose kryejnë këtë auditim për komisionin legjislativ që mbikëqyr këtë subjekt auditimi.

**6.48** Në ato situata ku nuk është një individ apo grup i vetëm që mbikëqyr drejtimin strategjik të njësisë të audituar dhe përmbushjen e detyrimeve të tij, ose në situata të tjera ku identiteti të ngarkuarve me qeverisjen nuk është plotësisht i qartë, audituesit duhet të dokumentojë procesin e ndjekur dhe përfundimet e arritura për identifikimin e individëve të përshtatshëm për realizimin e komunikimit nga grupi i auditimit.

**6.49** Përcaktimi i formës, përmbajtjes dhe shpeshësisë së komunikimit është një çështje e gjykimit profesional, megjithatë këshillohen komunikimet me shkrim. Audituesit mund të përdorin një letër angazhimi për të komunikuar informacionin. Audituesit duhet të dokumentojnë këtë komunikim.

**6.50** Nëse një auditimi është ndërprerë para se të përfundonte dhe nuk është hartuar një raport auditimi, audituesit duhet të dokumentojnë rezultatet e punës deri në datën e ndërprerjes dhe pse auditimit është ndërprerë. Përcaktimi nëse dhe se si t'u komunikohet arsyeja e ndërprerjes së auditimit, zyrtarëve përkatës të njësisë të audituar, entit kontraktor që ka kërkuar auditim dhe zyrtarëve të tjerë varet nga faktet dhe rrethanat dhe për çfarë arsye, është çështje e gjykimit profesional.

---

<sup>139</sup> Për më tepër shih paragrafët A1. 05 deri A1. 07, roli i të ngarkuarve me drejtimin.

**Kapitulli 6**  
**Standardet e Punës në Terren për Auditimet e**  
**Performancës**

---

Përgatitja e  
Planit të  
Auditimit të  
Shkruar

**6.51** Për çdo auditim, audituesit duhet të përgatisin një program auditimi të shkruar. Forma dhe përmbajtja e programit të auditimit të shkruar mund të ndryshojnë sipas auditimeve dhe mund të përfshijnë, strategjinë e auditimit, programin e auditimit, projektin, memon e planifikimit të auditimit dhe dokumentacion tjetër rreth vendimeve kyçe në lidhje me objektivat e auditimit, fushën dhe metodologjinë dhe kriteret bazë të përdorura nga audiuesit për ato vendime. Audituesit duhet ta rinovojnë planin sipas nevojës, për të reflektuar ndonjë ndryshim të rëndësishëm në planin e bërë gjatë auditimit.

**6.52** Një program auditimi i shkruar ofron mundësi, menaxhimit të organizatës audituese për mbikëqyrjen e planifikimit të auditimit dhe për të përcaktuar se,

**a.** objektivat e propozuara të auditimit do të rezultojnë në një raport të dobishëm;

**b.** programi i auditimit adreson drejt risqet përkatëse;

**c.** Shtrirja dhe metodologjia e propozuar e auditimit, përshtaten me objektivat e auditimit;

**d.** evidenca ekzistuese është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për qëllimet e auditimit;  
dhe

**e.** stafit, mbikëqyrësit, dhe specialistë me aftësi kolektive profesionale dhe burimet e tjera në dispozicion për të kryer auditimin, janë të mjaftueshme për të realizuar punën audituese në afatet kohore të pritshme.

---

Mbikëqyrja

**6.53** Mbikëqyrësit e auditimit ose personat e caktuar për të mbikëqyrrur audituesit, duhet ta mbikëqyrin mirë stafin e auditimit.

**Kapitulli 6**  
**Standardet e Punës në Terren për Auditimet e**  
**Performancës**

---

**6.54** Mbikëqyrja e auditimit përfshin udhëzimin dhe orientimin e plotë të stafit të auditimit për të adresuar objektivat e auditimit dhe ndjekjen e kërkesave të përcaktuara, duke u informuar rreth problemeve të rëndësishme të hasura, rishikimin e punës së kryer dhe duke realizuar një trajnim efektiv në vendin e punës.<sup>140</sup>

**6.55** Natyra dhe shtrirja e mbikëqyrjes së stafit dhe rishikimit të punës audituese mund të ndryshojë në varësi të një numri faktorësh, siç janë madhësia e njësisë të audituar, rëndësinë e çështjes si dhe përvojën e stafit.

---

Marrja e  
Evidencës së  
Mjaftueshme dhe  
të Përshtatshme

**6.56** Audituesit duhet të marrin evidencë të mjaftueshme e të përshtatshme për të siguruar një bazë të arsyeshme për gjetjet dhe konkluzionet e tyre.

**6.57** Koncepti i një evidence të përshtatshme dhe të mjaftueshme është pjesë integrale e një auditimi. Përshtatshmëria është masë e cilësisë së evidencës që përfshin rëndësinë e saj, vlefshmërinë dhe besueshmërinë në ofrimin e mbështetjes për rezultatet dhe përfundimet që kanë të bëjnë me objektivat e auditimit. Në vlerësimin e përshtatshmërisë së përgjithshme të evidencës, audituesit duhet të vlerësojnë nëse prova është e rëndësishme, e vlefshme dhe e besueshme. Mjaftueshmëria është një masë e sasisë së provave të përdorura për të mbështetur të gjetjet dhe konkluzionet në lidhje me objektivat e auditimit.<sup>141</sup> Në vlerësimin e mjaftueshmërisë së evidencës, audituesit duhet të përcaktojnë nëse evidenca është e mjaftueshme për të bindur një person (që njih çështjen) se gjetjet janë të arsyeshme.

---

<sup>140</sup> Shih paragrafin 6. 83c për kërkesat e dokumentacionit që lidhet me mbikëqyrjen.

<sup>141</sup> Për më tepër shih paragrafin A6. 05 mbi përshtatshmërinë e evidencës.

**Kapitulli 6**  
**Standardet e Punës në Terren për Auditimet e**  
**Performancës**

---

**6.58** Në vlerësimin e evidencës, audituesit duhet të shqyrtojnë nëse evidenca e marrë si një e tërë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për adresimin e objektivave të auditimit dhe mbështetur gjetjet dhe konkluzionet. Objektivat e auditimit mund të variojnë shumë, ashtu si niveli i punës së nevojshme për të vlerësuar mjaftueshmërinë dhe përshtatshmërinë e evidencës për të adresuar objektivat. Për shembull, në gjykimin e përshtatshmërisë së evidencës, audituesit mund të testojnë besueshmërinë e saj duke marrë dokumentacion justifikues, duke përdorur testimin statistikor, ose duke marrë evidencë vërtetuese. Konceptet e riskut dhe rëndësisë së auditimit ndihmojnë audituesit në vlerësimin e evidencës së auditimit.<sup>142</sup>

**6.59** Gjykimi profesional i ndihmon audituesit në përcaktimin e mjaftueshmërisë dhe përshtatshmërisë së evidencës së marrë si një e tërë. Interpretimi, përmbledhja dhe analiza e evidencës përdoret në mënyrë tipike në procesin e përcaktimit të mjaftueshmërinë dhe përshtatshmërinë së evidencës dhe në raportimin e rezultateve të punës së auditimit. Kur është e përshtatshme, në vlerësimin e mjaftueshmërisë, audituesit mund të përdorin metoda statistikore për të analizuar dhe interpretuar evidencën.

---

**Përshtatshmëria**

**6.60** Përshtatshmëria është masë e cilësisë së evidencës që përfshin rëndësinë, vlefshmërinë dhe besueshmërinë e evidencës së përdorur për adresimin e objektivave të auditimit dhe mbështetur gjetjet dhe konkluzionet.<sup>143</sup>

**a.** Përkatësia ka të bëjë me nivelin që evidenca ka lidhje logjike me çështjen që trajtohet dhe ka rëndësi për të.

---

<sup>142</sup> Shih paragrafët 6,04 dhe 6,05 për një diskutim të rëndësisë dhe rrezikut të auditimit.

<sup>143</sup> Për më tepër shih paragrafin A6.0 5 në lidhje me vlerësimin e përshtatshmërisë së evidencës në lidhje me objektivat e auditimit.

**Kapitulli 6**  
**Standardet e Punës në Terren për Auditimet e**  
**Performancës**

---

**b.** Vlefshmëria ka të bëjë me nivelin që evidenca është një bazë kuptimplotë ose e arsyeshme për të matur atë që vlerësohet. Me fjalë të tjera, vlefshmëria i referohet masës në të cilën evidenca përfaqëson atë që ka për qëllim të përfaqësojë.

**c.** Besueshmëria ka të bëjë me konsistencën e rezultateve kur informacioni është matur ose të testuar dhe përfshin konceptet e të qenit të verifikueshme ose mbështetëse.<sup>144</sup>

**6.61** Ka lloje dhe burime të ndryshme evidence që audituesit mund të përdorin, në varësi të objektivave të auditimit. Evidenca mund të merret me vëzhgim, pyetje ose inspektim. Çdo lloj evidence ka anët e veta forta dhe të dobëta.<sup>145</sup> Përfundimet e mëposhtme janë të dobishme në gjykimin e përshtatshmërisë së evidencës. Megjithatë këto nuk janë të mjaftueshme në vetvete për të përcaktuar përshtatshmërinë. Natyra dhe llojet e evidencës për të mbështetur gjetjet dhe konkluzionet janë çështje të gjyimit profesional të audituesve, bazuar në objektivat e auditimit dhe riskun e auditimit.

**a.** Evidenca e marrë kur kontrolli i brendshëm është efektiv, në përgjithësi është më e besueshme se evidenca e marrë kur kontrolli i brendshëm është i dobët ose nuk ekziston.

**b.** Evidenca e marrë me anë të verifikimit të drejtpërdrejtë fizik, vëzhgimit, llogaritjes dhe inspektimit nga ana e audituesve, në përgjithësi është më e besueshme se evidenca e marrë në mënyrë të tërthortë.

**c.** Shqyrtimi i dokumenteve origjinalë në përgjithësi është më i besueshëm se shqyrtimi i kopjeve.

---

<sup>144</sup> Për më tepër shiko paragrafin 6,66, informacioni i përpunuar me kompjuter dhe udhëzim për besueshmërinë e të dhënave.

<sup>145</sup> Për më tepër shiko paragrafin A6. 04 në lidhje me llojet e evidencës.

**Kapitulli 6**  
**Standardet e Punës në Terren për Auditimet e**  
**Performancës**

---

**d.** Dëshmitë e marra në kushte në të cilat personat mund të flasin lirshëm në përgjithësi janë më të besueshme se evidenca e marrë në rrethana në të cilat personat mund të jenë të frikësuar.

**e.** Dëshmitë e marra nga një individ i cili është paanshëm dhe ka njohuri të drejtpërdrejta në lidhje me fushën, në përgjithësi është më i besueshëm se dëshmitë e marra nga një individ që është i njëanshëm ose ka njohuri të pjesshme apo jo të drejtpërdrejta për fushën.

**f.** Evidenca e marrë nga një palë e tretë që ka dijeni për çështjen, e njohur dhe e paanshme, në përgjithësi është më e besueshme se provat e marra nga menaxhimi i njësisë të auditimit apo të tjerë, të cilët kanë interes të drejtpërdrejtë në njësinë e auditimit.

**6.62** Dëshmitë mund të jenë të dobishme në interpretimin ose konfirmimin e informacionit dokumentar apo fizik. Audituesit duhet të vlerësojnë objektivitetin, kredibilitetin dhe besueshmërinë e evidencës së dalë nga dëshmitë. Evidenca e dokumentuar mund të përdoret si ndihmesë për të verifikuar, mbështetur ose krahasuar evidencën e dalë nga dëshmitë.

**6.63** Pyetëtorët zakonisht sigurojnë informacion të vetë raportuar rreth kushteve ose programeve ekzistuese. Vlerësimi i hartimit të pyetësorëve dhe administratës, ndihmon audituesit në vlerësimin e objektivitetit, kredibilitetit dhe besueshmërisë së informacionit të vetë raportuar.

**6.64** Kur përdoret marrja e modeleve (kampionimi), metoda e përzgjedhjes që është më e përshtatshme, varet nga objektivat e auditimit. Kur nevojitet një model përfaqësues, përdorimi i metodave statistikore zakonisht rezulton si një evidencë më e fortë se ajo që merret me teknikat jostatistikore. Kur nuk nevojitet një model përfaqësues, përzgjedhja mund të jetë efektive nëse audituesit kanë marrë parasysh faktorët e riskut ose kritere të tjera në përzgjedhje.

**Kapitulli 6**  
**Standardet e Punës në Terren për Auditimet e**  
**Performancës**

---

**6.65** Kur audituesit e përdorin informacionin e dhënë nga zyrtarët e njësisë si pjesë e provave të tyre, ata duhet të përcaktojnë se çfarë bëjnë zyrtarët e njësisë të auditimit ose audituesit e tjerë, për të pasur siguri mbi besueshmërinë e informacionit. Audituesi mund të kryejë testimin e procedurave të menaxhimit, për të marrë siguri ose të kryejë testimin e drejtpërdrejtë të informacionit. Natyrën dhe shtrirja e procedurave varet nga rëndësia e informacionit për objektivat e auditimit dhe lloji i informacionit të përdorur.

**6.66** Audituesit duhet të vlerësojnë mjaftueshmërinë dhe përshtatshmërinë e informacionit të përpunuar nga kompjuterat, pavarësisht nëse ky informacion është dhënë për audituesit apo auditorët në mënyrë të pavarur nxjerrë atë. Lloji, koha dhe shtrirja e procedurave të auditimit për të vlerësuar mjaftueshmërinë dhe përshtatshmërinë ndikohen nga efektiviteti i kontrollit të brendshëm të njësisë të auditimit mbi informacionin, duke përfshirë kontrollet e sistemeve të informacionit si dhe rëndësia e informacionit dhe hollësitë e paraqitura nga audituesit te gjetjet dhe konkluzionet, referuar objektivave të auditimit.<sup>146</sup> Vlerësimi i mjaftueshmërinë dhe përshtatshmërinë së informacionit të përpunuar nga kompjuterat përfshin faktorë që lidhen me tërësinë dhe saktësinë e të dhënave për qëllimin që kërkohen.<sup>147</sup>

---

Mjaftueshmëria

**6.67** Mjaftueshmëria është një masë e sasisë së provave të përdorura për adresimin e objektivave të auditimit dhe mbështetur gjetjet dhe konkluzionet. Mjaftueshmëria gjithashtu varet nga përshtatshmëria e evidencës. Në

---

<sup>146</sup> Për më tepër shih paragrafët 6,23 nëpërmjet 6,27, mbi vlerësimin e efektivitetit të kontrolleve të sistemeve të informacionit.

<sup>147</sup> Ref. për udhëzime shtesë: *Vlerësimi i Besueshmërisë së të Dhënave të përpunuara nga Kompjuterat*, GAO-09-680G (Uashington, DC: korrik 2009).

**Kapitulli 6**  
**Standardet e Punës në Terren për Auditimet e**  
**Performancës**

---

përcaktimin e mjaftueshmërisë së dëshmimeve, audituesit duhet të përcaktojnë nëse ekzistojnë prova të mjaftueshme të përshtatshme për të adresuar objektivat e auditimit dhe mbështetur gjetjet dhe konkluzionet.

**6.68** Supozimet e mëposhtme janë të dobishme gjatë shqyrtimit të mjaftueshmërisë së evidencës. Mjaftueshmëria e evidencës së nevojshme për të mbështetur gjetjet dhe konkluzionet është një çështje e gjykimit profesional të audituesve.

**a.** Sa më i madh risku i auditimit, aq më e madhe, sasia dhe cilësia e evidencës së nevojshme.

**b.** Sa më e fortë evidenca, më pak evidencë mund të përdoret.

**c.** Një vëllim i madh i evidencës së auditimit nuk kompenson mungesën e përkatësisë, vlefshmërisë apo besueshmërisë.

---

Vlerësimi i  
përgjithshëm i  
Evidencës

**6.69** Audituesit duhet të përcaktojnë mjaftueshmërinë dhe përshtatshmërinë e përgjithshme të evidencës, për të siguruar një bazë të arsyeshme për gjetjet dhe konkluzionet, në kontekstin e objektivave të auditimit. Gjykimet profesionale në lidhje me mjaftueshmërinë dhe përshtatshmërinë e evidencës janë të lidhura ngushtë me atë se si audituesit interpretojnë rezultatet e testimit të auditimit dhe vlerësojnë se natyra dhe niveli i evidencës së marrë është i mjaftueshëm dhe i përshtatshëm. Audituesit duhet të kryejnë dhe dokumentojnë një vlerësim të përgjithshëm të evidencës së të gjithë grupit të auditimit, të përdorur për të mbështetur të gjetjet dhe konkluzionet, duke përfshirë rezultatet e çdo vlerësimi specifik të kryer mbi vlefshmërinë dhe besueshmërinë e evidencave të veçanta.

**Kapitulli 6**  
**Standardet e Punës në Terren për Auditimet e**  
**Performancës**

---

**6.70** Mjaftueshmëria dhe përshtatshmëria e evidencës janë koncepte relative, të cilat mund të jenë të perceptohen në kushtet e një vazhdimësie më shumë se një situatë absolute. Mjaftueshmëria dhe përshtatshmëria vlerësohen të lidhura me kontekstin e gjetjeve dhe konkluzioneve. Për shembull, edhe pse audituesit mund të kenë disa kufizime apo paqartësi në lidhje me mjaftueshmërinë ose përshtatshmërinë e disa të dhënave, ato megjithatë mund të përcaktojnë se në tërësi ka evidencë të mjaftueshme, të përshtatshme për të mbështetur gjetjet dhe konkluzionet.

**6.71** Kur vlerësojnë mjaftueshmërinë dhe përshtatshmërinë e evidencës, audituesit duhet të vlerësojnë rëndësinë e pritshme të saj për objektivat e auditimit, gjetjet dhe konkluzionet, evidencë mbështetëse në dispozicion si dhe nivelin e riskut të auditimit. Hapat për të vlerësuar evidencën mund të varet nga natyra e evidencës, si ajo është përdorur në auditim ose raport dhe objektivat e auditimit.

**a.** evidenca është e mjaftueshme dhe e përshtatshme kur ajo siguron një bazë të arsyeshme për mbështetjen e gjetjeve ose konkluzioneve në kontekstin e objektivave të auditimit.

**b.** evidenca nuk është e mjaftueshme ose e përshtatshme kur (1) evidenca bart një risk të lartë e të papranueshëm sepse mund ta çojë audituesin në një konkluzion të pasaktë ose të gabuar, (2) evidenca ka kufizime të mëdha, duke pasur parasysh objektivat e auditimit dhe ose qëllimin e përdorimit të evidencës, ose (3) evidenca nuk siguron një bazë të përshtatshme për adresimin e objektivave të auditimit apo mbështetur të gjetjet dhe konkluzionet. Audituesit nuk duhet të përdorin një evidencë të tillë si mbështetje për gjetjet dhe konkluzionet.

**6.72** Evidenca ka kufizime apo paqartësi kur vlefshmëria apo besueshmëria e saj nuk është vlerësuar ose nuk mund të vlerësohet, duke pasur parasysh objektivat e auditimit dhe qëllimin e përdorimit të evidencës. Kufizimet gjithashtu përfshijnë gabimet e identifikuara nga audituesit në testimin e

**Kapitulli 6**  
**Standardet e Punës në Terren për Auditimet e**  
**Performancës**

---

bërë nga ana e tyre. Kur audituesit identifikojnë në evidencë kufizime ose pasiguri që janë të rëndësishme për gjetjet dhe konkluzionet e auditimit, ata duhet të zbatojnë procedura shtesë, sipas nevojës. Këto procedura përfshijnë:

**a.** të kërkojnë evidencë mbështetëse dhe të pavarur nga burime të tjera;

**b.** ri përcaktimin e objektivave të auditimit apo kufizimin e fushës së auditimit për të eliminuar nevojën për të përdorur evidencë;

**c.** paraqitja e gjetjeve dhe konkluzioneve në mënyrë që evidenca mbështetëse të jetë e mjaftueshme dhe e përshtatshme si dhe në raport të përshkruhen kufizimet apo pasiguritë në vlefshmërinë ose besueshmërinë e evidencës, nëse një informacion i tillë është i nevojshëm për të shmangur ç'orientimin përdoruesve të raportit, lidhur me gjetjet ose konkluzionet<sup>148</sup> dhe,

**d.** përcaktimin nëse për të raportuar kufizimet apo pasiguritë si një gjetje, duke përfshirë çdo, mangësi të rëndësishme që lidhet me kontrollin e brendshëm.

---

Puna në Terren,  
Standardet për  
Auditimet e  
Performancës  
Zhvillimi i  
Elementëve të një  
Gjetje

**6.73** Audituesit duhet të planifikojnë dhe aplikojnë procedurat për zhvillimin e elementëve të një gjetjeje, të cilat janë të nevojshme për të përcaktuar objektivat e auditimit<sup>149</sup>. Për rrjedhojë, nëse audituesit janë të aftë për të zhvilluar mjaftueshëm elementët e një gjetjeje, ata duhet edhe të japin rekomandime korrektuese për veprime të caktuara nëse këto

---

<sup>148</sup> Për më tepër shih paragrafët 7.15 mbi kërkesat shtesë të raportimit kur ka kufizime ose pasiguri në vlefshmërinë ose besueshmërinë e evidencës.

<sup>149</sup> Shiko paragrafin A6. 06 për diskutime mbi gjetjet.

**Kapitulli 6**  
**Standardet e Punës në Terren për Auditimet e**  
**Performancës**

---

veprime janë domethënëse, brenda kontekstit të objektivave të auditimit. Elementët e nevojshëm për një gjetje kanë lidhje me objektivat e auditimit. Kështu, një gjetje apo grup gjetjesh është i plotë nëse objektivat e auditimit janë përcaktuar si duhet dhe raporti qartësisht i lidh këto objektiva me elementët e gjetjes. Shembull, një objektiv auditimi mund të jetë përcaktimi i gjendjes aktuale apo kushteve të programit të aktiviteteve, apo progresit në zbatimin e kërkesave legjislative, dhe jo përcaktimi i shkakut apo efektit përkatës. Në këto situata, zhvillimi i kushteve do të përcaktonte objektivin e auditimit dhe, zhvillimi i elementëve të tjerë të një gjetjeje, nuk do të ishte i nevojshëm.

**6.74** Elementët e kriterëve diskutohen në paragrafin 6.37, dhe elementët e tjerë të një gjetje-kushtet, efekti dhe shkak – diskutohen në paragrafët 6.75 - 6.77.

**6.75** Kushtet: Kushtet janë një gjendje që ekziston. Kushtet përcaktohen dhe dokumentohen gjatë një auditimi.

**6.76** Shkak: Shkak identifikon arsyen ose shpjegimin për gjendjen ose faktorin apo faktorët përgjegjës për diferencën midis situatës që ekziston (gjendjes) dhe gjendjes së kërkuar apo dëshiruar (kriteret), e cila mund të shërbejë si bazë për rekomandime për veprimet korrigjuese. Faktorët e përbashkët përfshijnë politikat e hartuara keq, procedurat, ose kriteret; zbatimin kontradiktor, jo të plotë, apo të pasaktë; ose faktorë jashtë kontrollit të menaxhimit të programit. Audituesit mund të vlerësojnë nëse gjetjet ofrojnë një argument të arsyeshëm dhe bindës përse shkak i deklaruar është faktor apo faktorët kyç që kontribuojnë në ndryshimin ndërmjet kushteve dhe kriterëve<sup>157</sup>.

**6.77** Efekti ose efekti i mundshëm: efekti është një lidhje e qartë dhe logjike për të përcaktuar ndikimin në ndryshimin ndërmjet gjendjes që ekziston (kushteve) dhe asaj të dëshiruar

---

<sup>157</sup> Shiko paragrafin A6. 06 për diskutime të mëtejshme mbi shkakun.

**Kapitulli 6**  
**Standardet e Punës në Terren për Auditimet e**  
**Performancës**

---

ose kërkuar (kriteret). Efekti ose efekti i mundshëm, identifikon rezultatet apo pasojat e kushteve. Kur objektivat e auditimit përfshijnë identifikimin e pasojave të kushteve që variojnë (si pozitivisht dhe negativisht) nga kriteret e identifikuar në auditim, “efekti” është një matje e këtyre pasojave. Efekti apo efekti i mundshëm mund të përdoret për të treguar nevojën për veprime korrektuese në përgjigje të problemeve të identifikuar apo risqeve të mundshëm<sup>158</sup>.

---

**Komunikimi i**  
**Hershëm i**  
**Mangësive**

**6.78** Audituesit raportojnë mangësitë në kontrollin e brendshëm, mashtrimin, mospërputhshmërinë me ligjet në fuqi, rregulloret, kontratat apo marrëveshjet e granteve ose shpërdorimet. Për disa çështje, komunikimi i hershëm me menaxherët ose personat përgjegjës të qeverisjes mund të jetë i rëndësishëm për shkak të domethënies përkatëse dhe urgjencës për veprime të mëtejshme korrektuese. Gjithashtu, kur kontrolli mbi mangësitë rezulton me mospërputhshmëri me ligjet, rregulloret, kontratat apo marrëveshjet e granteve, ose shpërdorimet, komunikimi i hershëm është i rëndësishëm për t’i mundësuar menaxherëve të ndërmarrin veprime korrigjuese të menjëhershme për të parandaluar mospërputhjen e mëtejshme. Kur një mangësi komunikohet herët, aplikohen sërish kërkesat mbi raportimin të paraqitura në paragrafët 7.18 - 7.23.

---

**Dokumentet e**  
**Auditimit**

**6.79** Audituesit duhet të përgatisin dokumentet e auditimit lidhur me planifikimin, kryerjen dhe raportimin për çdo auditim. Audituesit duhet gjithashtu të përgatisin dokumentet auditimit në detaje për t’i mundësuar një audituesi me eksperiencë, i cili nuk ka pasur lidhje të mëparshme me këtë auditim, të kuptojë nga dokumentacioni natyrën, kohën, shtrirjen dhe rezultatet e procedurave të kryera të auditimit, të

---

<sup>158</sup> Shiko paragrafin A 6.07 për diskutime shtesë mbi efektin.

**Kapitulli 6**  
**Standardet e Punës në Terren për Auditimet e**  
**Performancës**

---

evidencave të marra të auditimi dhe burimin, si dhe konkluzionet e arritura, duke përfshirë evidencat që mbështesin gjykimet e rëndësishme të audituesit dhe konkluzionet. Një auditues me eksperiencë, nënkupton një individ (i brendshëm ose i jashtëm në organizatë), i cili ka kompetencat dhe aftësitë që i mundësojnë kryerjen e auditimit të performancës. Këto kompetenca dhe aftësi përfshijnë të kuptuarin e (1) proceseve të auditimit të performancës (2) GAGAS dhe kërkesave ligjore dhe rregullatore të kërkuara, (3) çështjen lidhur me arritjen e objektivave të auditimit dhe (4) çështjet lidhur me mjedisin e njësisë të audituar.

**6.80** Audituesit duhet të përgatisin dokumentacionin e auditimit që përmban evidencat, të cilat mbështesin gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet përpara se të dali raporti.

**6.81** Audituesit duhet të hartojnë formën dhe përmbajtjen e dokumentave të auditimit për të qenë në përputhje me rrethanat e auditimit përkatës. Dokumentacioni i auditimit përbën të dhënën kryesore të punës që audituesi ka kryer në përputhje me standartet dhe konkluzionet që ai ka arritur. Sasia, lloji, dhe përmbajtja e dokumentacionit të auditimit, janë pjesë e gjykimit profesional të audituesve.

**6.82** Dokumentimi i auditimit është një element thelbësor i cilësisë së auditimit. Procesi i përgatitjes dhe rishikimit të dokumentacionit të auditimit kontribuon në cilësinë e një auditimi. Dokumentimi i auditimit shërben për (1) të ofruar mbështetjen kryesore për raportin e audituesve, (2) të ndihmuar audituesit në kryerjen dhe rishikimin e auditimit, dhe (3) të mundësuar rishikimin e cilësisë së auditimit.

**Kapitulli 6**  
**Standardet e Punës në Terren për Auditimet e**  
**Performancës**

---

**6.83** Audituesit duhet të dokumentojnë<sup>159</sup>:

a. objektivat, qëllimin dhe metodologjinë e auditimit;

b. punën e kryer dhe evidencat e marra për të mbështetur gjykimet e rëndësishme dhe konkluzionet, duke përfshirë përshkrimet e transaksioneve dhe regjistrimet e shqyrtuara (për shembull, duke renditur numrat e dosjeve, numrat e rasteve, ose mënyra të tjera të identifikimit të dokumenteve specifike të shqyrtuar, por kopjet e këtyre dokumenteve të shqyrtuar apo detajimet e renditura të informacionit nga këto dokumente, nuk kërkohen);  
dhe

c. rishikimin mbikëqyrës, përpara se të dalë raporti, të evidencave që mbështesin gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet e përfshira në raportin e auditimit.

**6.84** Kur audituesit nuk i përmbahen kërkesave të GAGAS të aplikueshme sipas ligjit, rregulloreve, kufizimeve mbi qëllimet, kufizimeve në aksesin ndaj informacionit, apo çështjeve të tjera që ndikojnë auditimin, audituesit duhet të dokumentojnë nisjen nga kërkesat e GAGAS dhe ndikimin mbi auditimin dhe në konkluzionet e audituesve. Kjo aplikohet tek nisjet nga kërkesat e pakushtëzuara dhe nga ato që mendohen si kërkesa të detyrueshme kur procedurat alternative të kryera në ato rrethana nuk kanë qenë të mjaftueshme për të arritur objektivat sipas standartit<sup>160</sup>.

**6.85** Të theksuarit e auditimeve GAGAS është premisa që organizatat e auditimit federale, shtetërore, vendore dhe

---

<sup>159</sup> Shiko paragrafët 6.06, 6.46, 6.48, 6.49, 6.50, 6.69, 6.84, 7.19, 7.22, dhe 7.44 për kërkesat shitesë në dokumentacion lidhur me auditimet e performancës.

<sup>160</sup> Shiko paragrafët 2.24 dhe 2.25 për kërkesat shitesë në citimin e auditimeve të përputhshmërisë me GAGAS.

**Kapitulli 6**  
**Standardet e Punës në Terren për Auditimet e**  
**Performancës**

---

Kompanitë e Auditimit Publik të angazhuara në kryerjen e auditimeve në përputhje me GAGAS, të bashkëpunojnë në programet e auditimit me interes të përbashkët, kështu që audituesit mund të përdorin punën e të tjerëve dhe të evitojnë mbivendosjen e përpjekjeve. Duke qenë subjekt ndaj ligjeve dhe rregulloreve, audituesit duhet t'i adresojnë personat e duhur dhe t'u mundësojnë dokumentacionin e auditimit, sipas kërkesave dhe në kohën e duhur, edhe audituesve të tjerë apo rishikuesve për të përmbushur këto objektiva. Përdorimi i punës së audituesve nga auditues të tjerë mund të lehtësohet nga marrëveshje kontraktuale për auditimet GAGAS që ofrojnë akses të plotë dhe në kohë mbi individët e duhur dhe dokumentacionin e auditimit.

---

## Standardet e Raportimit për Auditimet e Performancës

---

---

### Hyrje

**7.01** Ky kapitull trajton kërkesat lidhur me raportimin dhe udhëzuesit për kryerjen e auditimeve të performancës në përputhje me standardet e auditimit të qeverisë të pranuar përgjithësisht (GAGAS). Qëllimi i këtyre kërkesave mbi raportimin është përcaktimi i qasjes gjithëpërfshirëse për audituesit, të cilët duhet ta aplikojnë këtë në komunikimin e rezultateve të auditimit të performancës. Kërkesat e raportimit për auditimet e performancës lidhen me formën e raportit, përmbajtjen e raportit si dhe nxjerrjen dhe shpërndarjen e tij<sup>161</sup>.

**7.02** Për auditimet e performancës të kryera në përputhje me GAGAS, aplikohen kërkesat dhe udhëzuesit e paraqitur në kapitujt 1 deri 3, 6 dhe 7.

---

### Raportimi

**7.03** Audituesit duhet të nxjerrin raporte auditimi duke komunikuar rezultatet e secilit auditimit performance të përmbyllur.

**7.04** Audituesit duhet të përdorin një formë raporti auditimi që është e përshtatshme për përdorimin dhe që është me shkrim ose e ndonjë forme tjetër të rigjenerueshme<sup>162</sup>. Për shembull, audituesit mund të paraqesin raporte duke përdorur median elektronike që janë të rigjenerueshme nga përdoruesit e raporteve dhe organizatat e auditimit. Nevojat e përdoruesve do të ndikojnë mbi formën e raportit të auditimit. Forma të ndryshme të raporteve të auditimit përfshijnë raporte me shkrim, dokumente zyrtare, prezantime ose materiale të tjera .

---

<sup>161</sup> Shiko paragrafin A7.02 për përshkrimin e elementëve të një raporti cilësor.

<sup>162</sup> Shiko paragrafin 7.43 për raste kur institucionet e auditimit janë subjekt ndaj ligjeve publike.

**Kapitulli 7**  
**Standardet e Raportimit për Auditimet**  
**e Performancës**

---

**7.05** Qëllimet e raporteve të auditimit janë:

(1) të komunikojnë rezultatet e auditimeve tek të ngarkuarit me qeverisjen, zyrtarët e njësisë të audituara, dhe tek zyrtarët e ngarkuar me mbikëqyrje; (2) t'i bëjnë rezultatet lehtësisht të kuptueshme;

(3) t'i bëjnë rezultatet të mundura edhe për publikun, edhe pse me kufizime<sup>163</sup>; dhe (4) të lehtësojnë ndjekjen pas auditimit me qëllim përcaktimin nëse veprimet e duhura korrigjuese janë ndërmarrë.

**7.06** Nëse një auditim mbyllet përpara përfundimit dhe nuk del një raport auditimi, audituesit duhen të zbatojnë udhëzuesin e paragrafit 6.50.

**7.07** Nëse, pasi raporti ka dalë, audituesi zbulon se nuk ka të dhëna të mjaftueshme dhe të duhura për të mbështetur gjetjet e auditimit apo konkluzionet, ata duhet t'ia komunikojnë në të njëjtën mënyrë sikur dhe në kohën e shpërndarjes së raportit, te të ngarkuarit me qeverisjen, zyrtarëve të njësisë, zyrtarëve të organizatave që kërkojnë auditimin, si edhe përdoruesve të tjerë të njohur, në mënyrë që ata të mos mbështeten mbi gjetje apo konkluzione, të cilat nuk janë të argumentuara. Nëse raporti është postuar më parë në faqen e internetit të disponueshme publikisht, audituesit duhet ta tërheqin raportin dhe të publikojnë një njoftim se ky raport është hequr. Më pas audituesit duhet të përcaktojnë nëse duhet të zhvillojnë auditime shtesë të nevojshme për të nxjerrë raportin, duke përfshirë gjetjet e rishikuara ose konkluzionet apo ri-publikimin e raportit origjinal, në rastin kur auditimi shtesë nuk rezulton me ndryshim të gjetjeve apo konkluzioneve.

---

<sup>163</sup> Shiko paragrafin 7.40 për udhëzuesit shtesë mbi përdorimin e kufizuar apo të klasifikuar të raporteve dhe paragrafin 7.44b mbi shpërndarjen e raporteve për audituesit e brendshëm.

---

**Kapitulli 7**  
**Standardet e Raportimit për Auditimet**  
**e Performancës**

---

Përmbajta e  
Raportit

**7.08** Audituesit duhet të përgatisin raporte auditimi që përmbajnë 1) objektivat, qëllimin dhe metodologjinë e auditimit; (2) rezultatet e auditimit, përfshirë gjetjet, konkluzionet, dhe rekomandimet sipas rastit; (3) një deklaratë mbi përputhshmërinë e audituesve me GAGAS; (4) një përmbledhje të këndvështrimeve të zyrtarëve përgjegjës; dhe (5) nëse është e aplikueshme, natyrën e informacioneve sekrete apo të ndjeshme, të cilat janë përfshirë.

---

Objektivat,  
Qëllimi dhe  
Metodologjia

**7.09** Audituesit duhet të përfshijnë në raport një përshkrim të objektivave të auditimit dhe qëllimin e metodologjinë e përdorur për adresimin e objektivave të auditimit. Përdoruesit e raportit kanë nevojë për këtë informacion për të kuptuar qëllimin e auditimit, natyrën dhe shtrirjen e auditimit të kryer, kontekstin dhe perspektivën lidhur me atë që është raportuar dhe çdo kufizim të rëndësishëm në objektivat e auditimit, qëllimin apo metodologjinë.

**7.10** Objektivat e auditimit për auditimet e performancës mund të variojnë së tepërmi. Audituesit duhet t'i komunikojnë këto objektiva në raport në një mënyrë të qartë, specifike, neutrale dhe jo paragjykuese, që përfshin supozimet përkatëse. Kur objektivat e auditimit janë të kufizuara por objektiva më të gjerë mund të futen nga përdoruesit, audituesit duhet të citojnë në raportin e auditimit se disa çështje ishin jashtë qëllimit të auditimit në mënyrë që të evitohen keqkuptime të mundshme.

**7.11** Audituesit duhet të përshkruajnë qëllimin e punës së kryer dhe çdo kufizim, duke përfshirë çështje që do të ishin me rëndësi për përdoruesit, kështu që ata të mund të interpretonin arsyeshëm gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet në raport, pa keqkuptime. Audituesit duhet të raportojnë gjithashtu çdo pengesë domethënëse të imponuar mbi metodën e auditimit nga kufizimet e informacionit apo mospërputhjet me qëllimin, duke përfshirë mohimet apo vonesat e tepruara lidhur me aksesin në regjistra apo individë.

**Kapitulli 7**  
**Standardet e Raportimit për Auditimet**  
**e Performancës**

---

**7.12** Në përshkrimin e punës së kryer për të adresuar objektivat e auditimit dhe për të argumentuar gjetjet, konkluzionet, audituesit duhet ashtu si dhe është e aplikueshme, të shpjegojnë marrëdhënien ndërmjet njerëzve dhe çështjeve të testuara; të identifikojnë institucionet, pozicionet gjeografike, dhe periudhat e mbuluara; të raportojnë llojet e burimeve të evidencave; dhe të shpjegojnë çdo kufizim domethënës apo pasiguri bazuar në vlerësimin e përgjithshëm të mjaftueshmërisë, përshtatshmërisë së evidencave.

**7.13** Në raportimin e metodologjisë së auditimit, audituesit duhet të shpjegojnë sesi puna e kompletuar mbështet objektivat e auditimit, duke përfshirë evidencat e mbledhura dhe teknikat e analizave në detaje të mjaftueshme, për të mundësuar tek përdoruesit e raporteve të tyre, që të kuptojnë sesi audituesit i adresojnë objektivat e auditimit. Audituesit mund të përfshijnë një përshkrim të procedurave të kryera si pjesë e vlerësimit të tyre mbi mjaftueshmërinë dhe përshtatshmërinë e informacionit të përdorur si evidencë auditimi. Audituesit duhet të identifikojnë hipotza domethënëse të bëra gjatë kryerjes së auditimit; të përshkruajnë teknikat krahasuese të aplikuara; kriteret e përdorura; dhe; kur kampionimi mbështet si duhet gjetjet e audituesve, konkluzionet apo rekomandimet, të përshkruajnë zhvillimin e kampionimit, dhe të citojnë pse është zgjedhur, duke përfshirë nëse rezultatet mund të projektohen për popullatën e menduar.

---

Raportimi i  
Gjetjeve

**7.14** Në raportin e auditimit, audituesit duhet të paraqesin evidenca të mjaftueshme, të duhura për të mbështetur gjetjet dhe konkluzionet në lidhje me objektivat e auditimit. Gjetjet e zhvilluara me qartësi<sup>164</sup> i ndihmojnë menaxherët dhe zyrtarët mbikëqyrës të njësisë të audituar të kuptojnë nevojën për

---

<sup>164</sup> Shiko paragrafët 6.73 deri 6.77 për diskutime shtesë mbi zhvillimin e elementëve të një gjetjeje.

**Kapitulli 7**  
**Standardet e Raportimit për Auditimet**  
**e Performancës**

---

ndërmarrjen e masave korrektuese. Nëse audituesit janë në gjendje të zhvillojnë mjaftueshëm elementët e një gjetjeje, ata duhet të japin rekomandime për masa korrektuese nëse janë domethënëse brenda kontekstit të objektivave të auditimit. Megjithatë, shtrirja në të cilën elementët për një gjetje zhvillohen, varen nga objektivat e auditimit. Kështu, një gjetje apo një grup gjetjesh është i plotë në atë masë që audituesit adresojnë objektivat e auditimit.

**7.15** Audituesit duhet të përshkruajnë në raportet e tyre kufizimet apo pasiguritë lidhur me besueshmërinë e evidencave apo vlefshmërinë e tyre nëse (1) evidenca është domethënëse për gjetjet dhe konkluzionet brenda kontekstit të objektivave të auditimit dhe (2) ky hap është i nevojshëm për të evituar keqkuptime për përdoruesit e raportit mbi gjetjet dhe konkluzionet. Ashtu si është diskutuar në paragrafët 6.69 deri 6.72, audituesit mund të kenë pasiguri lidhur me mjaftueshmërinë dhe përshtatshmërinë e disa evidencave, që gjithsesi mund të përcaktojnë se në përgjithësi ka evidenca të mjaftueshme dhe të duhura dhënë gjetjet dhe konkluzionet. Audituesit duhet të përcaktojnë kufizimet apo pasiguritë lidhur me evidencat në lidhje me gjetjet dhe konkluzionet, në vijim të përshkrimit të kufizimeve dhe pasigurive si pjesë të objektivave, qëllimit dhe metodologjisë. Për më tej, ky përshkrim u ofron përdoruesve të kuptuarin më të qartë lidhur me përgjegjësinë që audituesit kanë mbi informacionin.

**7.16** Audituesit duhet t'i vendosin gjetjet e tyre në perspektivë duke përshkruar natyrën dhe shtrirjen e çështjeve të raportuara dhe shtrirjen e punës së kryer që rezulton në gjetje. Për t'i dhënë lexuesit bazat për një gjykim mbi rëndësinë dhe pasojat e gjetjeve audituesit duhet sipas rastit, t'i lidhin shembujt e identifikuar me popullatën apo numrin e rasteve të ekzaminuara dhe përmbajtjen e rezultateve në terma të vlerës së dollarit, apo masa të tjera. Nëse rezultatet nuk mund të jenë

**Kapitulli 7**  
**Standardet e Raportimit për Auditimet**  
**e Performancës**

---

të projektuara, audituesit duhet të kufizojnë konkluzionet e tyre si duhet.

**7.17** Audituesit mund të ofrojnë informata bazë për të përcaktuar kontekstin e mesazhit të përgjithshëm dhe të ndihmojnë lexuesit të kuptojnë gjetjet dhe domethënien e çështjeve të diskutuara. Informacioni i duhur bazë mund të përfshijë informacione sesi programet dhe veprimet funksionojnë; domethënien e programeve dhe veprimeve (p.sh dollarë, impakti, qëllimet, puna audituese e mëparshme, nëse është e nevojshme); një përshkrim të përgjegjësive të njësisë të audituar; dhe shpjegimin e termave, strukturën organizative, dhe bazën statutore për programin dhe veprimet. Kur raportojnë mbi rezultatet e punës së tyre, audituesit duhet të zbulojnë faktet domethënëse lidhur me objektivat e punës së tyre dhe se cili prej këtyre fakteve, nëse nuk zbulohet, mund të ngatërrojë përdoruesit, keqinterpretojë rezultatet, ose fshehtë praktikë të rëndësishme të papërshtatshme dhe të paligjshme.

**7.18** Audituesit duhet të raportojnë gjithashtu mangësitë në kontrollin e brendshëm, shembujt e mashtrimit, pa përputhshmërisë me dispozitat ligjore, rregulloret, kontratat, apo marrëveshjet e granteve, apo shpërdorimet që kanë ndodhur apo mendohet se kanë ndodhur dhe janë domethënëse brenda kontekstit të objektivave të auditimit.

Mangësitë në  
Kontrollin e  
Brendshëm

**7.19** Audituesit duhet të përfshijnë në raportet e auditimit (1) qëllimin e punës së tyre mbi kontrollin e brendshëm dhe (2) çdo mangësi në kontrollin e brendshëm që janë domethënëse brenda kontekstit të objektivave të auditimit dhe bazohen në punën audituese të kryer.<sup>165</sup> Kur audituesit zbulojnë mangësi në kontrollin e brendshëm që nuk janë domethënëse për

---

<sup>165</sup> Shiko paragrafin 6.21 për diskutimet mbi mangësitë e kontrollit të brendshëm në auditimet e performancës dhe paragrafin A. 06 për shembujt e mangësive në kontrollin e brendshëm.

**Kapitulli 7**  
**Standardet e Raportimit për Auditimet**  
**e Performancës**

---

objektivat e auditimit por tërheqin vëmendjen e të ngarkuarve me qeverisjen, ato duhet të përfshijnë këto mangësi në raport ose duhet t'i komunikojnë këto mangësi me shkrim tek zyrtarët e njesisë të audituar. Audituesit duhet t'i referohen këtij komunikimi me shkrim në raportet e auditimit nëse komunikimi me shkrim është i ndarë nga raporti i auditimit. Kur audituesit zbulojnë mangësi që nuk tërheqin vëmendjen e qeveritarëve, vendimi nëse dhe si të komunikohet mbi këto mangësi ndaj zyrtarëve të njesisë të audituar është çështje e gjykimit profesional.

**7.20** Në një auditim performance, audituesit mund të dalin në përfundimin se mangësitë e identifikuara në kontrollin e brendshëm që janë të rëndësishme brenda kontekstit të objektivave të auditimit, janë shkak i një performance të dobët të programit apo veprimeve që janë audituar. Në raportimin e kësaj gjetjeje, mangësia e kontrollit të brendshëm do të përshkruhet si shkak.

---

Mashtrimi,  
Papajtueshmëria  
me Dispozitat e  
Ligjeve,  
Rregulloret,  
Kontratat, dhe  
Marrëveshjet e  
Grantit dhe  
Shpërdorimi

**7.21** Kur audituesit dalin në përfundimin, bazuar në evidencat e duhura dhe të mjaftueshme, se mashtrimi<sup>166</sup> mospërputhja me dispozitat ligjore, rregulloret, kontratat apo marrëveshjet e granteve, apo shpërdorimi<sup>167</sup>, ka ndodhur apo ka mundësi të ndodhë, çka është domethënëse brenda kontekstit të objektivave të auditimit, ata duhet ta raportojnë çështjen si një gjetje. Nëse një veprim i veçantë është në fakt, mashtrim apo mospërputhje me dispozitat ligjore, rregulloret, kontratat apo marrëveshjet e granteve, duhet të vendoset përfundimisht nga një gjykatë apo një organ tjetër gjykses.

**7.22** Kur audituesit zbulojnë mashtrimin, mospërputhjen me dispozitat ligjore, rregulloret, kontratat, marrëveshjet e granteve apo shpërdorimin, që nuk janë domethënëse brenda kontekstit të objektivave të auditimit, por tërheqin vëmendjen e atyre që janë të ngarkuar me përgjegjësi, ata duhet t'i

---

<sup>166</sup> Shiko paragrafin A. 10 për shembujt e treguesve të riskut të mashtrimit.

<sup>167</sup> Shiko paragrafin A. 08 për shembujt e abuzimit.

---

**Kapitulli 7**  
**Standardet e Raportimit për Auditimet**  
**e Performancës**

---

komunikojnë këto gjetje me shkrim tek zyrtarët e subjekteve të audituara. Kur audituesit zbulojnë shembuj mashtrimi, papajtueshmëri me dispozitat ligjore, rregulloret, kontratat apo marrëveshjet e grantit ose shpërdorimin që nuk tërheqin vëmendjen e të ngarkuarve me përgjegjësi, vendimi i audituesve nëse dhe sesi do t'i komunikojnë këto shembuj tek drejtuesit e njësisë është një çështje e gjykimit profesional.

**7.23** Kur mashtrimi, mospërputhshmëria me dispozitat ligjore, rregulloret, kontratat apo marrëveshjet e granteve apo shpërdorimin, ka ndodhur ose mendohet se ka ndodhur, audituesit mund të konsultojnë me autoritetet apo këshillat ligjorë lidhur me raportimin publik të këtij informacioni dhe nëse kjo do të komprometonte veprimtarinë hetimore apo ligjore. Audituesit mund ta kufizojnë raportimin e tyre publik për çështje të cilat nuk do të kompromentonin këto veprimtari dhe për shembull, të raportonin vetëm për informacione që janë me interes për publikun.

**7.24** Audituesit duhet të raportojnë mashtrimin e supozuar apo të njohur, mospërputhjen me dispozitat ligjore, rregulloret, kontratat apo marrëveshjet e granteve apo shpërdorimin direkt tek palët jashtë njësisë të audituar në këto dy rrethana si vijon:

**a.** Kur drejtuesit e njësisë dështojnë në përmbushjen e kërkesave ligjore apo rregullatore për ta raportuar këtë informacion tek palët e jashtme ndaj njësisë siç është specifikuar në ligj apo rregullore, audituesit duhet t'i komunikojnë së pari, dështimin e raportimit të këtij informacioni tek të ngarkuarit me përgjegjësi. Nëse njësisë i audituar ende nuk e raporton këtë informacion tek palët e jashtme ndaj njësisë sa më shpejt pas komunikimit të audituesve me të ngarkuarit me qeverisjen, atëherë audituesit duhet të raportojnë direkt tek palët e jashtme specifikisht.

**b.** Kur drejtuesit e njësisë dështojnë të ndërmarrin hapat e duhur dhe në kohë për t'iu përgjigjur mashtrimit të njohur apo të supozuar, mospërputhjes me dispozitat ligjore, rregulloret,

Raportimi i  
Gjetjeve tek  
Palët Jashtë  
Njësisë të  
Audituar

**Kapitulli 7**  
**Standardet e Raportimit për Auditimet**  
**e Performancës**

---

kontratat ose marrëveshjet e granteve apo shpërdorimit që (1) janë domethënëse për gjetjet dhe konkluzionet dhe (2) përfshijnë fondet e marra drejtpërdrejt ose jo nga agjencitë qeveritare, audituesit duhet së pari të raportojnë dështimin e drejtuesve për të ndërmarrë hapat e duhur dhe në kohë ndaj atyre të ngarkuar me qeverisjen. Nëse njësia i audituar nuk ndërmerr sërish hapat e duhur sa më shpejt pas komunikimit të audituesve me ata që janë të ngarkuar me qeverisjen, atëherë audituesit duhet të raportojnë dështimin e njësisë për të ndërmarrë hapat e duhur drejtpërsëdrejti tek agjencia financuese.

**7.25** Raportimi i trajtuar në paragrafin 7.24 është në vijim të çdo kërkesë ligjore për audituesin që të raportojë këtë informacion direkt tek palët jashtë njësisë të audituar. Audituesit duhet t'i përmbahen këtyre kërkesave edhe nëse ata janë larguar apo hequr nga auditimi përpara përfundimit të tij. Organizatat e auditimit të brendshëm nuk kanë për detyrë të raportojnë jashtë njësisë të audituar vetëm nëse kjo kërkohet nga ligji, rregullat, rregulloret apo politikat e ndryshme<sup>168</sup>.<sup>1</sup>

**7.26** Audituesit duhet të marrin evidenca të mjaftueshme dhe të duhura, si konfirmimin nga palët e jashtme, për të vërtetuar pohimet e drejtuesve të njësisë të audituar që gjetja është raportuar në përputhje me ligjet, rregulloret apo marrëveshjet e financimit. Kur audituesit nuk janë në gjendje për ta bërë këtë, ata duhet të raportojnë këtë informacion drejtpërsëdrejti siç u diskutua në paragrafët 7.24 dhe 7.25.

**Konkluzione**

**7.27** Audituesit duhet të raportojnë konkluzionet bazuar në objektivat e auditimit dhe gjetjet e auditimit. Konkluzionet e Raportit janë lidhje logjike me programin bazuar në gjetjet e audituesve, jo thjesht një përmbledhje e gjetjeve. Pika e fortë

---

<sup>168</sup> Shiko paragrafin 7. 44b për standardet e raportimit për organizatat e auditimit të brendshëm kur raportohet nga jashtë.

**Kapitulli 7**  
**Standardet e Raportimit për Auditimet**  
**e Performancës**

---

konkluzioneve të audituesve varet nga mjaftueshmëria dhe përshtatshmëria e evidencave mbështetëse të gjetjeve dhe logjikën e shëndoshë të përdorur për të formuluar konkluzionet. Konkluzionet janë edhe më detyruese nëse ato çojnë në rekomandimet e audituesve dhe e bindin përdoruesin e raportit se ndërmarrja e veprimeve është e nevojshme.

---

**Rekomandimet**

**7.28** Audituesit duhet të rekomandojnë veprime për të korrigjuar mangësitë dhe gjetjet e tjera të identifikuara gjatë auditimit si dhe të përmirësojnë programet dhe veprimet kur përmirësimi i mundshëm në programe, veprime dhe performancë mbështetet nga gjetjet në raporte dhe konkluzionet. Audituesit duhet të bëjnë rekomandime që kanë një rrjedhë logjike nga gjetjet dhe konkluzionet, drejtohen për të zgjidhur shkakun e mangësive të identifikuara dhe gjetjeve, dhe qartësisht shprehin veprimet e rekomanduara.

**7.29** Rekomandimet efektive nxisin përmirësimet në sjelljen e programeve dhe veprimeve të qeverive. Rekomandimet janë efektive kur i adresohen palëve që kanë autoritetin për të vepruar dhe kur veprimet e rekomanduara janë specifike, praktike, kosto-efektive dhe të matshme.

---

**Raportimi i**  
**Përputhshmërisë**  
**të**  
**Audituesve me**  
**GAGAS**

**7.30** Kur audituesit i përmbahen të gjithë kërkesave të aplikueshme GAGAS, ata duhet të përdorin gjuhën si vijon, që përfaqëson një deklaratë përputhshmërie GAGAS të pa modifikuara në raportin e auditimit, për të treguar se ata e kanë kryer auditimin në përputhje me GAGAS<sup>169</sup>.  
Këtë auditim performance ne e kryem në përputhje me standardet ndërkombëtare të auditimit të pranuar përgjithësisht.

---

<sup>169</sup> Shiko paragrafët 2.24 dhe 2.25 për standardet shtesë që citojnë përputhshmërinë me GAGAS.

**Kapitulli 7**  
**Standardet e Raportimit për Auditimet**  
**e Performancës**

---

Këto standarde kërkojnë që ne të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin në mënyrë që të marrim evidencë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të ofruar bazën e arsyeshme për gjetjet tona dhe konkluzionet bazuar në objektivat e auditimit. Ne besojmë se evidencat e marra ofrojnë bazën e arsyeshme për gjetjet tona dhe konkluzionet bazuar në objektivat e auditimit.

**7.31** Kur audituesit nuk janë në përputhje me të gjitha kërkesat e aplikueshme GAGAS, ata duhet të përfshijnë një deklaratë të modifikuar të përputhshmërisë me GAGAS në raportin e auditimit. Për auditimet e performancës audituesit duhet të përdorin një deklaratë që përfshin gjithashtu si (1) gjuhën në 7.30, të modifikuar për të treguar se kërkesat nuk janë plotësuar ose (2) gjuhën që audituesi nuk ka ndjekur GAGAS<sup>170</sup>.

---

Raportimi i  
Pikëpamjeve të  
Zyrtarëve  
Përgjegjës

**7.32** Audituesit duhet të marrin dhe raportojnë pikëpamjen e zyrtarëve të njësisë të audituar lidhur me gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet të përfshira në raportin e auditimit, ashtu si edhe veprimet korrigjuese të planifikuara.

**7.33** Dhënia e një projekt raporti me gjetjet për rishikim dhe koment nga zyrtarët përgjegjës të njësisë të audituar, i ndihmon audituesit të zhvillojnë një raport që është i drejtë, i kompletuar dhe objektiv. Përfshirja e pikëpamjeve të zyrtarëve përgjegjës rezulton në një raport që paraqet jo vetëm gjetjet e audituesve, konkluzionet dhe rekomandimet, por gjithashtu perspektivën e zyrtarëve përgjegjës të njësisë të audituar dhe veprimet korrigjuese që ata planifikojnë të ndër marrin. Është e pranueshme që komentet të merren me shkrim, por edhe komentet me gojë janë të pranueshme.

---

<sup>170</sup> Shiko paragrafin 2.24 dhe 2.25 lidhur me standardet shtesë ku citohet përputhshmëria me GAGAS.

**Kapitulli 7**  
**Standardet e Raportimit për Auditimet**  
**e Performancës**

---

**7.34** Kur audituesit marrin komentet me shkrim nga zyrtarët përgjegjës, ata duhet të përfshijnë në raportin e tyre një kopje me shkrim të komenteve të zyrtarëve. Kur zyrtarët përgjegjës japin vetëm komente me gojë, audituesit duhet të përgatisin një përmbledhje të komenteve me gojë dhe i ofrojnë një kopje të përmbledhjes zyrtarëve përgjegjës për të verifikuar që komentet janë pasqyruar saktësisht.

**7.35** Audituesit duhet gjithashtu të përfshijnë në raport një vlerësim të përshtatshëm mbi komentet. Në rastet kur njësia e audituar ofron komente teknike shtesë ndaj komenteve me shkrim apo me gojë të raportit, audituesit mund të shprehin në raport që këto komente janë marrë.

**7.36** Marrja e komenteve me gojë mund të jetë e përshtatshme kur, për shembull, ka një datë kritike (të përcaktuar) për raportimin që është e rëndësishme për të përmbushur kërkesat e përdoruesve, audituesit kanë punuar ngushtë me zyrtarët përgjegjës përgjatë gjithë auditimit dhe palët janë të familjarizuara me gjetjet dhe çështjet e adresuara në projekt-raport, ose audituesit nuk presin kundërshti të mëdha lidhur me gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet në projekt-raport, apo me çështjet e trajtuara aty.

**7.37** Kur komentet e njësisë të audituar nuk përputhen apo bien në konflikt me gjetjet, konkluzionet apo rekomandimet në projekt-raport, ose kur veprimet korrektuese të planifikuara nuk adresojnë si duhet rekomandimet e audituesit, audituesit duhet të vlerësojnë vlefshmërinë e komenteve të njësisë. Nëse audituesit nuk bien dakord me këto komente, ata duhet të shpjegojnë në raport arsyet e tyre për këtë mos pranim. Anasjelltas, audituesit duhet të modifikojnë raportin e tyre sipas nevojës, nëse ata mendojnë që komentet janë të vlefshme dhe mbështeten në evidenca të mjaftueshme dhe të përshtatshme.

**Kapitulli 7**  
**Standardet e Raportimit për Auditimet**  
**e Performancës**

---

**7.38** Nëse njësia i audituar refuzon të japë komente ose e ka të pamundur të japë komente brenda një periudhe të arsyeshme kohore, audituesit mund të publikojnë raportin pa i marrë komentet e njësisë të audituar. Në këto raste, audituesit duhet të tregojnë në raport se njësia e audituar nuk ka dhënë komente.

---

Raportimi i  
Informacionit  
Sekret dhe me  
Ndjeshmëri

**7.39** Nëse informacion i caktuar nuk duhet të bëhet publik ose lihet jashtë një raporti për shkak të natyrës së tij sekret dhe me ndjeshmëri, audituesit duhet të shprehin në raport se disa informacione janë përjashtuar dhe arsyen apo rrethanat për të cilat ky përjashtim ka qenë i nevojshëm.

**7.40** Disa informacione mund të klasifikohen ose ndryshe mund të ndalohen për t'u bërë publike nga ligjet dhe rregulloret federale, shtetërore apo vendore. Në këto rrethana, audituesit mund të nxjerrin një raport përdorimi të veçantë, të klasifikuar ose të kufizuar për përdorim, i cili përmban këtë informacion dhe ta shpërndajnë atë vetëm tek personat e autorizuar me ligj ose rregullore për ta marrë atë.

**7.41** Rrethana shtesë të lidhura me mbrojtjen publike, privatësinë ose sigurinë, mund gjithashtu të justifikojnë lënien jashtë të disa informacioneve nga një raport i shpërndarë gjerësisht. Për shembull, informacioni i detajuar lidhur me sigurinë kompjuterike mund të lihet jashtë nga raportet që bëhen publikë për shkak të dëmit të mundshëm që mund të shkaktojë keqpërdorimi i këtij informacioni. Në këto rrethana, audituesit mund të publikojnë një raport të kufizuar që përmban këtë informacion dhe ta shpërndajnë atë vetëm për palët përgjegjëse për të vepruar ndaj rekomandimeve të audituesve. Në disa raste mund të jetë e përshtatshme për të nxjerrë si një raport publik ku është hequr informacioni i ndjeshëm, ashtu dhe një raport për përdorim të kufizuar. Audituesit mund të konsultohen me këshillin ligjor lidhur me çdo kërkesë apo rrethanë për të cilën ky lloj informacioni duhet përjashtuar.

**Kapitulli 7**  
**Standardet e Raportimit për Auditimet**  
**e Performancës**

---

**7.42** Marrja në konsideratë e interesit të madh publik për programin dhe aktivitetet që auditohen, i shërben audituesve kur vendosin nëse të lënë jashtë nga raportet e publikuara për publikun të një lloji të caktuar informacioni. Kur rrethanat çojnë në përjashtimin e një informacioni të caktuar nga raporti, audituesit duhet të vlerësojnë nëse ky përjashtim do të shtrembërojë rezultatet e auditimit ose do të fshehë praktika të paligjshme dhe të pasakta.

**7.43** Kur organizatat e auditimit janë subjekt i ligjeve për të dhënat publike, audituesit duhet të përcaktojnë nëse ligjet për të dhënat publike mund të ndikojnë në vlefshmërinë e raporteve sekretë ose të kufizuar për përdorim dhe të përcaktojnë nëse mjete të tjera komunikimi do të ishin më të përshtatshme për t'u përdorur me drejtuesit dhe të ngarkuarit me qeverisjen. Për shembull, audituesit mund ta përcjellin informacionin e përgjithshëm në një raport të shkruar dhe të përcjellin një informacion më të detajuar, me gojë. Audituesi mund të konsultohet dhe me organet ligjore lidhur me ligjet mbi të dhënat publike të zbatueshme.

---

Shpërndarja e  
Raporteve

**7.44** Shpërndarja e raporteve në përputhje me GAGAS, varet nga marrëdhënia e audituesve me të audituarit si dhe natyrën e informacionit që përmban raporti. Audituesit duhet të dokumentojnë çdo kufizim në shpërndarjen e raportit<sup>171</sup>. Trajnimet e mëposhtme, përcaktojnë shpërndarjen e raportit në përputhje me GAGAS:

**a.** Organizatat e auditimit në subjektet qeverisëse duhet të shpërndajnë raportet e auditimit tek të ngarkuarit me qeverisjen, tek zyrtarët e duhur të njësisë të audituar, si dhe tek organet apo organizatat pëkatëse mbikëqyrëse që kërkojnë ose i organizojnë këto auditime. Sipas rastit, audituesit duhet gjithashtu të shpërndajnë kopje të raporteve tek zyrtarë të tjerë

---

<sup>171</sup> Shiko paragrafët 7.40 dhe 7.41 mbi përdorimin e kufizuar të raporteve që përmbajnë informacion konfidencial apo sensitiv.

**Kapitulli 7**  
**Standardet e Raportimit për Auditimet**  
**e Performancës**

---

që kanë autoritet ligjor mbikëqyrjeje ose që mund të jenë përgjegjës për të vepruar mbi gjetjet e auditimit dhe rekomandimet, si dhe tek të tjerë të autorizuar për të marrë këto raporte.

**b.** Organizatat e auditimit të brendshëm në subjektet qeverisëse mund gjithashtu të ndjekin Standardet Ndërkombëtare për Praktikën Profesionale në Auditimin e Brendshëm<sup>172</sup> të Institutit të Audituesve të Brendshëm (IIA). Në përputhje me GAGAS dhe standardet IIA, drejtuesi i organizatës së auditimit të brendshëm duhet të komunikojë rezultatet tek palët, të cilat mund të sigurojnë që këto rezultate janë duke u marrë në konsideratë si duhet. Nëse nuk është përcaktuar ndryshe, nga kërkesat ligjore apo rregullatore, përpara përhapjes së rezultateve tek palët jashtë organizatës, drejtuesi i organizatës së auditimit të brendshëm duhet: (1) të vlerësojë riskun e mundshëm të organizatës, (2) të këshillohet me drejtuesit e lartë apo këshillin ligjor sipas rastit, dhe (3) të kontrollojë shpërndarjen duke përcaktuar përdoruesit e synuar në raport.

**c.** Kompanitë e Auditimit Publik të kontraktuara për të zhvilluar një auditim në përputhje me GAGAS, duhet të sqarojnë përgjegjësitë e shpërndarjes së raportit me organizatën e angazhuar për këtë. Nëse firma e kontraktuar është përgjegjëse për shpërndarjen, duhet të arrihet një marrëveshje me palën e kontraktuar për auditimin lidhur me përcaktimin se cilët zyrtarë apo organizata do të marrin raportin dhe hapat që do ndërmerren për ta bërë të disponueshëm këtë raport edhe për publikun.

---

<sup>172</sup> Shiko paragrafin 2.21 lidhur me përdorimin e standardeve IIA së bashku me GAGAS dhe paragrafin 2.22 lidhur me përputhshmërinë me një grup tjetër standardesh.

---

## Udhëzues Shtesë

---

---

### Hyrje

**A.01** Seksionet në vijim ofrojnë udhëzime shtesë për audituesit dhe subjektet e audituara për të ndihmuar në zbatimin e standardeve të auditimit të qeverisë të pranuar përgjithësisht (GAGAS). Udhëzuesi nuk përcakton kërkesa shtesë por është konceptuar për të lehtësuar zbatimin nga audituesi të kërkesave të GAGAS nga kapitujt 2-7. Udhëzuesi shtesë në seksionin e parë mund të ndihmojë lidhur me të gjitha llojet e auditimeve që mbulohen nga GAGAS. Seksionet në vijim, ofrojnë udhëzime shtesë për kapitujt specifikë të GAGAS.

---

### Udhëzues Shtesë Përgjithësues

**A.02** Kapitujt 4 deri në 7 trajtojnë standardet për auditimet financiare, angazhimet për certifikim dhe auditimet e performancës. Identifikimi dhe komunikimi i mangësive thelbësore dhe pikave të dobëta në materialet e auditimit të brendshëm, mashtrimi, papajtueshmëria me dispozitat ligjore, rregulloret, kontratat apo marrëveshjet e grantit apo shpërdorimi, janë aspekte të rëndësishme të auditimit të qeverisë. Trajtimi në vijim ofrohet për të ndihmuar audituesit në identifikimin e mangësive thelbësore në kontrollin e brendshëm, shpërdorimin dhe treguesit e riskut të mashtrimit si dhe të ndihmojë audituesit të përcaktojnë nëse papajtueshmëria me aktet ligjore, rregulloret, kontratat apo marrëveshjet e granteve janë të rëndësishme brenda kontekstit të objektivave të auditimit.

---

### Kontrolli i Brendshëm

**A.03** Kontrolli i Brendshëm—Kuari i Integruar<sup>173</sup> publikuar nga Komiteti i Organizatave Sponsorizuese të Komisionit Treadway (COSO) ofron udhëzime mbi kontrollin e brendshëm. Siç trajtohet edhe në kuadrin COSO,

---

<sup>173</sup> Kontrolli i Brendshëm—Kuari i Integruar, Komiteti i Organizatave Sponsorizuese i Komisionit Treadway, 1992.

**Shtojca I**  
**Udhëzues Shtesë**

---

kontrolli i brendshëm konsiston në pesë komponentë të ndërlidhur, të cilët janë (1) kontrolli i mjedisit, (2) vlerësimi i riskut, (3) aktivitetet e kontrollit, (4) informimi dhe komunikimi, dhe (5) monitorimi. Objektivat e auditimit të brendshëm lidhen me (1) raportimin financiar, (2) veprimet/operacionet, dhe (3) përputhshmërinë. Ruajtja e aseteve është një nëndegë e këtyre objektivave. Drejtuesit e zhvillojnë kontrollin e brendshëm për të ofruar siguri të arsyeshme që marrja, përdorimi apo mbajtja e paautorizuar e aseteve, të parandalohet apo zbulohet në kohë dhe të korrigjohet.

**A.04** Në shtesë të kuadrit COSO, botimi, Standardet për Auditimin e Brendshëm në Qeverinë Federale<sup>174</sup>, të cilat përfshijnë konceptet e zhvilluara nga COSO, ofrojnë përkufizime dhe koncepte themelore që i përkasin auditimit të brendshëm në nivel federal dhe mund të jenë gjithashtu të vlefshëm për audituesit në nivele të tjera të qeverisjes. Menaxhimi i Kontrollit të Brendshëm dhe Mjeti Vlerësimi<sup>175</sup>, bazuar në standardet federale të kontrollit të brendshëm, ofron një metodë sistematike, të organizuar dhe strukturuar të vlerësimit për strukturën e kontrollit të brendshëm.

---

Shembuj të  
Mangësive në  
Kontrollin e  
Brendshëm

**A.05** GAGAS përmban kërkesa lidhur me raportimin e mangësive të identifikuar në kontrollin e brendshëm.

**a.** Për auditimet financiare, shiko paragrafët 4.19 deri 4.24.

**b.** Për angazhimet për certifikim, shiko paragrafët 5.20 deri 5.23.

---

<sup>174</sup> Standardet për Kontrollin e Brendshëm në Qeverinë Federale, GAO/AIMD-00-21.3.1 (Washington, D.C.: Nëntor 1999).

<sup>175</sup> Menaxhimi i Kontrollit të Brendshëm dhe Mjeti i Vlerësimit, GAO-01-1008G (Washington, D.C.: Gusht 2001).

**Shtojca I**  
**Udhëzues Shtesë**

---

c. Për auditimet e performancës, shiko paragrafët 7.19 deri 7.20.

**A.06** Sa vijon, janë shembuj të mangësive në kontroll:

a. Vetëdije e pamjaftueshme mbi kontrollin brenda organizatës. Për shembull, “tone at the top” (theksi tek menaxhimi) dhe mjedisi i kontrollit. Mangësi të kontrollit në komponentë të tjerë të kontrollit të brendshëm mund ta çojnë audituesin të dalë në përfundimin se pikat e dobëta ekzistojnë në mjedisin e kontrollit.

b. Mbikëqyrje jo efektive nga ata që janë të ngarkuar me qeverisjen mbi raportimin financiar të njësisë, raportimin mbi performancën, ose kontrollin e brendshëm, apo një strukturë jo efektive e përgjithshme e qeverisjes.

c. Sistemet e kontrollit që nuk kanë parandaluar apo zbuluar dhe korrigjuar gabimet materiale kështu që ka qenë e nevojshme të rivlerësohen pasqyrat financiare të nxjerra më parë ose rezultatet operacionale. Sistemet e kontrollit që nuk kanë parandaluar apo zbuluar gabimet materiale në performancën apo rezultatet operacionale kështu që ka qenë e nevojshme më vonë të bëhen korrigjime të rëndësishme në këto rezultate.

d. Sistemet e kontrollit që nuk kanë parandaluar, apo zbuluar dhe korrigjuar gabimet materiale të identifikuara nga audituesi. Kjo përfshin gabimet materiale që përfshijnë vlerësimin dhe gjykimin për të cilin audituesi identifikon rregullimet e mundshme materiale dhe korrigjimet e shumave të regjistruara.

e. Një funksion jo efektiv i kontrollit të brendshëm apo vlerësimit të riskut tek një subjekt për të cilin këto funksione janë të rëndësishme për monitorimin apo komponentin e vlerësimit të riskut të kontrollit të brendshëm, siç është për shembull, për një subjekt të madh apo kompleks.

**Shtojca I**  
**Udhëzues Shtesë**

---

**f.** Identifikimi i mashtrimit në çfarëdoj mase nga ana e drejtuesve të lartë.

**g.** Dështim nga ana e drejtuesve apo të ngarkuarve me qeverisjen për të vlerësuar efektin e një mangësie domethënëse, që më parë u është komunikuar, si dhe korrigjimit apo daljes në përfundimin se nuk është i nevojshëm korrigjimi.

**h.** Kontrolle të papërshtatshme për ruajtjen e asetëve.

**i.** Evidenca të shmangjeve të qëllimshme të kontrollit të brendshëm nga drejtuesit e lartë në dëm të objektivave të përgjithshme të sistemit.

**j.** Mangësi në hartimin apo funksionimin e kontrollit të brendshëm që nuk arrin të parandalojë apo zbulojë dhe korrigjojë mashtrimin, papajtueshmërinë me dispozitat ligjore, rregulloret, kontratat ose marrëveshjet e grantit, apo shpërdorimin duke patur ndikim material në pasqyrat financiare apo objektivat e auditimit.

**k.** Hartimi i papërshtatshëm i kontrolleve të sistemeve të të informacionit, të përgjithshme, të aplikimit dhe kontrollit të përdoruesve që parandalojnë/ruajnë sistemin e informacionit nga dhënia e informacionit të plotë dhe të duhur në përputhje me objektivat e raportimit financiar, të performancës apo përputhshmërisë, apo nevojave të tjera.

**l.** Dështimi i një kontrolli të aplikimit shkaktuar nga mangësitë në hartimin apo funksionimin e kontrollit të përgjithshëm të një sistemi informacioni.

**m.** Punonjësit apo drejtuesit kanë mangësi në kualifikime dhe trajnime me qëllim përmbushjen e funksioneve të tyre.

**Shtojca I**  
**Udhëzues Shtesë**

---

**Shembuj të Shpërdorimit**

**A.07** GAGAS përmbajnë kërkesa për t'iu përgjigjur shpërdorimeve materiale dhe atyre në raportim, që është shumë e rëndësishme për objektivat e auditimit.

**a.** Për auditimet financiare, shikoni paragrafët 4.07 dhe 4.08 dhe 4.25 deri 4.27.

**b.** Për angazhime për certifikim shikoni paragrafët 5.08 deri 5.09 dhe 5.24 deri 5.26.

**c.** Për auditimet e performancës, shikoni paragrafët 6.33 dhe 6.34 dhe 7.21 deri 7.23.

**A.08** Sa vijon janë shembuj të shpërdorimit, në varësi të fakteve dhe rrethanave:

**a.** Të krijuarit e një kohe shtesë të pa nevojshme.

**b.** Të kërkuarit ndaj stafit që të kryejë punët personale apo të punës të mbikëqyrësit apo drejtuesit.

**c.** Keqpërdorimi i pozicionit të zyrtarit për përfitime personale (duke përfshirë veprime që mund të perceptohen nga një palë e tretë objektive që ka njohuri mbi informacionin përkatës, si të papërshtatshme në përfitim të interesave financiare personale të zyrtarit, apo të një personi të afërt dhe ose familjar, një partneri, një organizatë në të cilën zyrtari shërben si një nëpunës, drejtor, apo punonjës; apo një organizatë me të cilën zyrtari po negocion lidhur me punësimin në të ardhmen).

**d.** Zgjedhje udhëtimi që janë në kundërshtim me politikat ekzistuese të udhëtimit ose janë në mënyrë të panevojshme ekstravagante ose të shtrenjta.

**e.** Prokurimi ose përzgjedhja e furnitorëve të cilët janë në kundërshtim me politikat ekzistuese ose janë në mënyrë të panevojshme ekstravagante/luksi ose të shtrenjta.

**Shtojca I**  
**Udhëzues Shtesë**

---

---

Shembuj të  
Treguesve  
të Riskut të  
Mashtrimit

**A.09** GAGAS përmbajnë kërkesa lidhur me vlerësimin e riskut të mashtrimit.

**a.** Për auditimet financiare, shikoni paragrafët 4.06 dhe 4.25 deri 4.27.

**b.** Për angazhimet për certifikim shikoni paragrafët 5.07,5.20, dhe 5.24 deri 5.26.

**c.** Për auditimet e performanës, shikoni paragrafët 6.30 deri 6.32 dhe 7.21 deri 7.23.

**A.10** Në disa rrethana, kushtet si më poshtë mund të tregojnë një risk të lartë mashtrimi:

**a.** kushtet ekonomike, programatike ose operative të njësisë kërcënojnë qëndrueshmërinë financiare, veprimtarinë ose buxhetin;

**b.** natyra e veprimtarisë së njësisë ofron mundësi për t'u përfshirë në mashtrim;

**c.** monitorimi i përputhshmërisë nga ana e menaxhimit me politikatat, ligjet, dhe rregulloret, është i papërshtatshëm;

**d.** struktura organizative është e paqëndrueshme ose në mënyrë të panevojshme komplekse;

**e.** mungon komunikimi dhe/ose mbështetja për standardet etike nga menaxhimi;

**f.** menaxhimi ka vullnetin të pranojë nivele të larta e të pazakonshme të riskut në marrjen e vendimeve të rëndësishme;

**g.** njësia ka një historik pasaktësish, si : çështje të mëparshme lidhur me mashtrimin, shpërdorimin ose praktika të dyshimta, ose auditime apo hetime me gjetje të dyshimta ose aktivitet kriminal;

**Shtojca I**  
**Udhëzues Shtesë**

---

**h.** politika operative dhe procedura që nuk janë zhvilluar ose që i kanë kaluar afatet kohore;

**i.** dokumentacioni kyç mungon ose nuk ekziston;

**j.** mungon kontabilizimi i aseteve ose procedurat e mbrojtjes;

**k.** pagesa të papërshtatshme;

**l.** informacion fals ose çorientues;

**m.** prokurime të konsiderueshme në buxhet me fonde të mbetura në fund të vitit, në mënyrë që “të përdoren menjëherë të gjitha fondet e mëparshme”;  
dhe

**n.** struktura dhe trende/ tendenca të pazakonshme në kontraktime, prokurime, blerje dhe veprimtari të tjera të njësisë ose programit.

---

Përcaktimi i  
Kuptimit të  
Dispozitave  
Ligjore,  
Rregulloreve,  
Kontratave dhe  
Marrëveshjeve e  
Grantit brenda  
Kontekstit të  
Objektivave të  
Auditimit.

**A.11** GAGAS përmbajnë kërkesa për përcaktimin nëse dispozitat ligjore, rregulloret, kontratat apo marrëveshjet e granteve janë domethënëse brenda kontekstit të objektivave të auditimit.

**a.** Për auditimet financiare, shikoni paragrafët 4.19 deri 4.22.

**b.** Për angazhimet për certifikim shikoni paragrafët 5.07 dhe 5.08.

**c.** Për auditimet e performancës, shikoni paragrafët 6.28 dhe 6.29.

**A.12** Programet qeverisëse janë subjekt ndaj shumë dispozitave ligjore, rregulloreve, kontratave apo marrëveshje të granteve. Njëkohësisht, domethënia e tyre brenda kontekstit të objektivave të auditimit, varion gjerësisht në varësi të objektivave të auditimit.

**Shtojca I**  
**Udhëzues Shtesë**

---

Për audituesit qasja në vijim mund të ndihmojë në vlerësimin nëse dispozitat ligjore, rregulloret, kontratat apo marrëveshjet e granteve janë domethënëse brenda kontekstit të objektivave të auditimit:

**a.** Shprehja e secilit objektiv auditimi në terma të pyetjeve për aspekte specifike të programit që auditohet (qëllimi dhe objektivat, kontrollit të brendshëm, inputet, aktivitetet e programit, outputet dhe rezultatet).

**b.** Identifikimi dispozitave ligjore, rregulloret, kontratat apo marrëveshjet e grantit që lidhen drejtpërsëdrejti me aspekte specifike të programit brenda kontekstit të objektivave të auditimit.

**c.** Përcaktimi nëse objektivat e auditimit apo konkluzionet e audituesve mund të ndikohen ndjeshëm për shkak të mospërputhjes me dispozitat ligjore, rregulloret, kontratat apo marrëveshjet e granteve. Nëse objektivat e auditimit apo konkluzionet e auditimit mund të ndikohen, atëherë dispozitat ligjore, rregulloret, kontratat apo marrëveshjet e granteve janë të rëndësishme për objektivat e auditimit.

**A.13** Audituesit mund të konsultojnë me këshillat e tyre ligjore për (1) përcaktimin e ligjeve dhe rregulloreve që janë të rëndësishme për objektivat e auditimit, (2) hartimin e testeve të përputhshmërinë me ligjet dhe rregulloret, ose (3) për vlerësimin e rezultateve të këtyre testeve. Audituesit gjithashtu mund të konsultojnë këshillat e tyre ligjorë se kur objektivat e auditimit kërkojnë teste të përputhshmërisë me dispozitat e kontratave apo marrëveshjeve të granteve. Në varësi të rrethanave të auditimit, audituesit mund të konsultohen me të tjerë, si staf hetimor, organizata të tjera auditimi apo subjekte qeveritare që kanë ofruar shërbime profesionale ndaj njësisë të audituar, apo autoriteteve të zbatueshmërisë së ligjit, për të marrë informacione mbi çështjet e përputhshmërisë.

**Shtojca I**  
**Udhëzues Shtesë**

---

**Informacion**  
**Shoqërues për**  
**Kapitullin 1**

**A1.01** Kapitulli 1 trajton përdorimin dhe aplikimin e GAGAS dhe rolin e auditimit në përgjegjshmërinë e qeverisë. Të ngarkuarit me qeverisje dhe menaxhimin e organizatave të audituara kanë gjithashtu rol në përgjegjshmërinë e qeverisë. Trajtimi në vijim është dhënë me qëllim që të ndihmojnë audituesit në të kuptuarin e roleve të tjerëve në përgjegjshmërinë. Seksioni që vijon përmban gjithashtu informacion bazë mbi ligjet, rregulloret apo burime të tjera autoritare që kërkojnë përdorimin e GAGAS. Ky informacion ofrohet me qëllim futjen e GAGAS brenda kontekstit të përgjithshëm të përgjegjshmërisë së qeverisë.

**Ligjet,**  
**Rregulloret,**  
**dhe**  
**Burime të tjera**  
**Autoritare që**  
**Kërkojnë**  
**Përdorimin e**  
**GAGAS**

**A1.02** Ligjet, rregulloret, kontratat, marrëveshjet e granteve, apo politikat, shpesh kërkojnë përdorimin e GAGAS<sup>176</sup>. Sa vijon, janë disa prej ligjeve, rregulloreve dhe burimeve të tjera autoritare që kërkojnë përdorimin e GAGAS:

**a.** Ligji për Inspektorin e Përgjithshëm i 1978, i ndryshuar, 5 U.S.C. App kërkon që inspektorët e përgjithshëm federalë të emëruar t'u referohen GAGAS për auditime mbi organizatat, programet, aktivitetet apo funksionet federale. Ligji më tej, citon se inspektorët e përgjithshëm duhet të ndërmarrin hapat e duhur për të siguruar se puna e kryer përputhet me GAGAS.

**b.** Ligji për Zyrtarin e lartë Financiar i 1990 (E Drejta Publike 101-576), i shprehur në Ligjin mbi Reformën Menaxheriale të Qeverisë i 1994 (E Drejta Publike 103-356), kërkon që GAGAS të ndiqen në auditimet e departamenteve të degëve ekzekutive dhe deklaratat financiare të agjencive. Ligji i Kontabilitetit të Taksave në Dollarë i 2002 (E Drejta Publike 107-289) përgjithësisht e shtrin këtë kërkesë në agjencitë

---

<sup>176</sup> Shiko paragrafin 1.06 për diskutime shtesë mbi përdorimin e GAGAS.

**Shtojca I**  
**Udhëzues Shtesë**

---

ekzekutive që nuk janë subjekt i Ligjit mbi Zyrtarin e Lartë Financiar, vetëm nëse nuk përjashtohen për një vit të caktuar nga Zyra për Menaxhimin dhe Buxhetin (OMB).

c. Ndryshimet për Ligjin mbi Auditimin i 1996 (E Drejta Publike 104-156) kërkon që GAGAS të ndiqen në auditimet ndaj subjekteve shtetërore dhe qeverive lokale si dhe subjekteve jo fitimprurëse që marrin fonde federale. Qarkorja OMB Nor A-133, Auditimet Shtetërore, të Qeverive Vendore dhe Organizatave jo fitimprurëse, që i ofron qeverisë udhëzues të gjerë mbi politikat e kryerjes së auditimeve që duhet të përputhen me Ligjin e Auditimit, gjithashtu kërkon përdorimin e GAGAS.

**A1.03** Ligje, rregullore, apo burime autoritare të tjera, mund të kërkojnë përdorimin e GAGAS. Për shembull, për audituesit në nivel shtetëror dhe lokal të qeverisë mund të kërkohet nga ligjet shtetërore dhe lokale si dhe rregullat, që të zbatojnë GAGAS. Gjithashtu, audituesve mund t'u kërkohet nga kushtet e një marrëveshjeje apo kontrate që të zbatojnë GAGAS. Audituesve gjithashtu mund t'u kërkohet të zbatojnë GAGAS nga udhëzuesit federalë që i përkasin kërkesave të programeve, si për shembull ato të nxjerra nga programet e Zhvillimit të Banesave dhe Urban si dhe Ndhimës Financiare për Studentë. Ndjekja e këtyre ligjeve, rregulloreve apo burimeve autoritare të tjera, mund t'i ndihmojë audituesit në kryerjen e punës së tyre sipas standardeve të kërkuara.

**A1.04** Edhe nëse nuk u kërkohet të veprojnë kështu, audituesit mund të ndihmohen nëse zbatojnë GAGAS në kryerjen e auditimeve të programeve të shtetit federal dhe qeverive lokale, ashtu si edhe programeve të parave të qeverisë të administruara nga kontraktorët, subjektet jo fitimprurëse dhe subjekte të tjera jo qeveritare. Shumë organizata auditimi të cilave formalisht nuk u kërkohet ta bëjnë, ndjekin GAGAS, si në SHBA ashtu dhe në vende të tjera.

**Shtojca I**  
**Udhëzues Shtesë**

---

---

Roli i të  
Ngarkuarve me  
Qeverisjen

**A1.05** Gjatë auditimeve të GAGAS, audituesit komunikojnë me të ngarkuarit me përgjegjësi<sup>177</sup>.

- a. Për auditimet financiare, shiko paragrafët 4.03 dhe 4.04.
- b. Për angazhimet për certifikim, shiko paragrafët 5.04 dhe 5.05.
- c. Për auditimet e performancës, shiko paragrafët 6.47 deri 6.50.

**A1.06** Të ngarkuarit me qeverisje janë përgjegjës për mbikëqyrjen e drejtimit strategjik të njësisë dhe detyrimet lidhur me përgjegjshmërinë e njësisë. Kjo përfshin mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar, çështjeve kryesore, apo programeve nën auditim duke përfshirë kontrollet e brendshme përkatëse. Në disa subjekte, që mbulohen nga GAGAS, të ngarkuarit me qeverisjen, mund edhe të jenë pjesë e menaxhimit të njësisë. Në disa subjekte auditimi, palë të shumëfishta mund të jenë të ngarkuara me qeverisje, duke përfshirë organet e mbikëqyrjes, anëtarë ose stafet e komiteteve legjislative, bordet e drejtorëve, komitetet e auditimit, apo palët e kontraktuara për auditimin.

**A1.07** Për arsye se strukturat qeverisëse të njërive të qeverisë dhe organizatave variojnë, mund të mos jetë gjithmonë e qartë se kush është i ngarkuari kryesor me funksionet qeverisëse. Në këto situata, audituesit vlerësojnë strukturën organizative për drejtimin dhe kontrollin e veprimeve për të arritur objektivat e njësisë të audituar. Ky vlerësim përfshin gjithashtu sesi njësia e audituar delegon autoritet dhe përcakton përgjegjshmërinë për stafin e saj menaxherial.

---

<sup>177</sup> Shiko paragrafin 1.02 për diskutime shtesë për të ngarkuarit me qeverisje.

**Shtojca I**  
**Udhëzues Shtesë**

---

---

Roli i  
Menaxherëve

**A1.08** Menaxherët kanë përgjegjësinë themelore për të kryer funksionet qeverisëse<sup>178</sup>. Menaxherët e njësisë të audituar janë përgjegjës për:

**a.** përdorimin e burimeve financiare, fizike dhe informative, ligjrisht, me efektivitet, eficiencë, ekonomikitet, me etikë dhe barazi, për të arritur qëllimet për të cilat këto burime apo programi, u krijuan;

**b.** të zbatuar ligjet, rregulloret në fuqi (duke përfshirë identifikimin e kërkesave për të cilat njësia dhe zyrtari janë përgjegjës për t'u pajtuar me to);

**c.** zbatimin e sistemeve të zhvilluara me qëllim që të arrihet përputhshmëria me ligjet dhe rregullat në fuqi;

**d.** përcaktimin dhe ruajtjen e kontrollit të brendshëm efektiv për të mundësuar që qëllimet e duhura dhe objektivat janë përmbushur; në vijim të ligjeve dhe rregullave; dhe për të siguruar se menaxhimi dhe informacioni financiar është i besueshëm dhe i raportuar si duhet;

**e.** ofrimin e raporteve të përshtatshme për ata që mbikëqyrin veprimet e tyre dhe publikut në mënyrë që të dëshmojnë përgjegjshmëri për burimet dhe autoritetin e përdorur për të zhvilluar programet e qeverisë dhe rezultatet e këtyre programeve;

**f.** adresimin e gjetjeve dhe rekomandimeve të audituesve, si dhe për të përcaktuar dhe ruajtur një proces të ndjekjes së statusit të këtyre gjetjeve dhe rekomandimeve;

---

<sup>178</sup> Shiko paragrafët 1.01 dhe 1.02 për diskutime shtesë mbi menaxhimin dhe zyrtarët e programeve të qeverisë.

**Shtojca I**  
**Udhëzues Shtesë**

---

- f.** Ndjen e praktikave të duhura të prokurimit kur kontraktohet për auditime, duke përfshirë sigurimin e procedurave në fuqi për monitorimin e performancës së kontratave;  
dhe
  - g.** Ndërmarrjen e hapave të duhur dhe në kohë për të korrigjuar mashtrimin, papajtueshmërinë me dispozitat ligjore, rregulloret, kontratat apo marrëveshjet e grantit, apo shpërdorimin që audituesit raportojnë.
- 

**Informacion Shtesë**  
**për Kapitullin 2**

---

**Angazhimet për**  
**Certifikim**

**A2.01** Shembuj të objektivave të angazhimeve për certifikim<sup>179</sup>  
përfshijnë:

- a.** informacion financiar apo të performancës;
- b.** diskutimet e menaxhimit dhe prezantimin e analizave (MD&A);
- c.** kontrolli i brendshëm i njësisë mbi raportimin financiar;
- d.** efektiviteti i kontrollit të brendshëm të një njësie mbi përputhshmërinë e kërkesave specifike, si ato që rregullojnë ofertat, kontabilitetin dhe raportimin mbi grantet apo kontratat;
- e.** përputhshmërinë e një njësie me kërkesat specifike të ligjeve, rregulloreve, politikave, kontratave apo granteve;
- f.** saktësinë dhe besueshmëri e raportimit të masave të performancës;

---

<sup>179</sup> Shiko paragrafin 2.09 për diskutim shtesë mbi angazhimet për certifikim.

**Shtojca I**  
**Udhëzues Shtesë**

---

**g.** nëse kostot e kontratave finale mbështeten me evidenca të kërkuara dhe në përputhje me termat e kontratës;

**h.** lejueshmërinë dhe arsyeshmërinë e vlerave të kontratave të propozuara që bazohen në kostot e detajuara; dhe

**i.** sasinë, kushtet, apo vlerësimin e aseteve të inventarit.

---

**Objektivat e**  
**Auditimit të**  
**Performancës**

**A2.02** Shembujt e efektivitetit të programit dhe rezultatet e objektivave të auditimit<sup>180</sup> përfshijnë:

**a.** vlerësimin dhe shtrirjen në të cilën qëllimet dhe objektivat legjislative, rregullatore apo organizative janë arritur;

**b.** vlerësimin e aftësisë përkatëse të metodave alternative për të ofruar performancë më të mirë të programit apo eliminuar faktorët që pengojnë efektivitetin e programit;

**c.** analizën kosto-efektivitet të një programi apo aktiviteti, duke u fokusuar në kombinimin kosto-informacion apo inpute të tjera me informacion për rezultatet apo përfitimet dhënë nga produkti apo rezultati i arritur;

**d.** përcaktimin nëse rezultatet e parashikuara të një programi të prodhuar apo rezultatet e prodhuara nuk përputhen me objektivat e programit;

**e.** përcaktimin e statusit aktual apo kushteve të veprimeve të programit apo progresin në zbatimin e kërkesave legjislative;

---

<sup>180</sup> Shiko paragrafin 2.11a për diskutime shtesë mbi efektivitetin e programit dhe rezultatet e objektivave të auditimit.

**Shtojca I**  
**Udhëzues Shtesë**

---

- f.** përcaktimin nëse një program ofron akses të barabartë apo shpërndarje të burimeve publike brenda kontekstit të parametrave statutorë;
- g.** vlerësimin për shtrirjen në të cilin programet mbivendosen apo konfliktohen me programe të tjera;
- h.** vlerësimin nëse njësi po ndjek praktikata e duhura të prokurimit;
- i.** vlerësimin e besueshmërisë, vlefshmërisë apo rëndësisë e masave të performancës lidhur me efektivitetin e programit dhe rezultatet, apo ekonomikitetin dhe eficiencën;
- j.** vlerësimin e besueshmërisë, vlefshmërisë apo rëndësisë së informacionit financiar lidhur me performancën e një programi;
- k.** përcaktimin nëse burimet e qeverisë janë marrë me kosto të arsyeshme ndërsa është përmbushur afati dhe cilësia;
- l.** përcaktimin nëse është marrë vlera e duhur bazuar në kosto apo shumat e paguara apo bazuar në shumat e të ardhurave të marra;
- m.** përcaktimin nëse shërbimet e qeverisë dhe përfitimet janë të aksesueshme ndaj individëve që e kanë këtë të drejtë ndaj shërbimeve dhe përfitimeve;
- n.** përcaktimin nëse taksat mbulojnë kostot;
- o.** përcaktimin nëse dhe si kostot e njërive të programit mund të zvogëlohen apo sesi mund të rritet produktiviteti i tij;  
dhe
- p.** vlerësimin e besueshmërisë, vlefshmërisë apo propozimeve të buxhetit apo kërkesave të buxhetit për të asistuar legjislaturat në procesin e buxhetit.

**Shtojca I**  
**Udhëzues Shtesë**

---

**A2.03** Shembuj të objektivave të auditimit lidhur me kontrollin e brendshëm<sup>181</sup> përfshijnë një vlerësim të shtrirjes në të cilën kontrolli i brendshëm ofron sigurinë e arsyeshme nëse:

**a.** misionet, qëllimet dhe objektivat organizative janë arritur me efektivitet dhe eficiencë;

**b.** burimet janë përdorur në përputhje me ligjet, rregulloret apo kërkesa të tjera;

**c.** burimet, duke përfshirë informacionin me ndjeshmëri dhe të disponueshëm apo të ruajtur jashtë perimetrit fizik të organizatës, janë të mbrojtura kundër marrjes, përdorimit apo mbajtjes së paautorizuar;

**d.** informacioni menaxherial, si masat e performancës, dhe raportet publikë janë të kompletuar, të saktë, dhe të mjaftueshëm për të mbështetur performancën dhe vendimmarrjen;

**e.** integriteti i informacionit nga sistemet e kompjuterizuara është arritur; dhe

**f.** planifikimi për sistemet e informatizimit ofron një back-up (kopje) të nevojshëm për të parandaluar shpërndarjen e pajustificuar të aktiviteteve dhe funksioneve që mbështesin sistemet.

**A2.04** Objektivat e përputhshmërisë<sup>182</sup> përfshijnë përcaktimin nëse:

---

<sup>181</sup> Shiko paragrafin 2.11b për diskutime shtesë mbi kontrollin e brendshëm të objektivave të auditimit.

<sup>182</sup> Shiko paragrafin 2.11c për diskutime shtesë mbi përputhshmërinë e objektivave të auditimit.

**Shtojca I**  
**Udhëzues Shtesë**

---

**a.** qëllimi i programit, mënyra në të cilën duhet të kryhet, shërbimet e shpërndara, rezultatet, apo publiku të cilit i shërben, janë në përputhje me dispozitat ligjore, rregulloret, kontratat apo marrëveshjet e granteve, apo kërkesa të tjera;

**b.** shërbimet e qeverisë dhe përfitimet janë shpërndarë apo dorëzuar tek qytetarët bazuar në të drejtën individuale për t'i marrë këto shërbime dhe përfitime;

**c.** kostot e shkaktuara apo të propozuara janë në përputhje me ligjet, rregulloret, kontratat, apo marrëveshjet e granteve në fuqi; dhe

**d.** të ardhurat e marra janë në përputhje me ligjet, rregulloret, kontratat apo marrëveshjet e grantit në fuqi.

**A2.05** Shembujt e objektivave që i përkasin analizave të ardhshme<sup>183</sup> përfshijnë dhënien e konkluzioneve bazuar në:

**a.** trendet aktuale dhe të projektuar si dhe impaktin e ardhshëm të mundshëm mbi programet e qeverisë dhe shërbimet;

**b.** alternativat e programeve apo politikave, duke përfshirë parashikimin e rezultateve të programit nën supozime të ndryshme;

**c.** propozimet e politikave apo ndryshimet legjislative, duke përfshirë avantazhet, disavantazhet, dhe analizën e këndvështrimit të grupeve të interesit;

**d.** informacionin për të ardhmen përgatitur nga menaxherët;

**e.** buxhetet dhe parashikimet që bazohen në (1) supozime lidhur me eventet e pritshme në të ardhmen dhe (2) reagimi i pritshëm i menaxhimit ndaj eventeve të ardhshme; dhe

**g.** supozimet e menaxherëve mbi cilin informacioni bazohen.

---

<sup>183</sup> Shiko paragrafin 2.11d për diskutime shtesë mbi analizën në të ardhmen të objektivave të auditimit.

**Shtojca I**  
**Udhëzues Shtesë**

---

Deklaratat e  
Përputhshmërisë  
sipas GAGAS

**A2.06** Përcaktimi nëse deklaratat e përputhshmërisë sipas GAGAS të modifikuara ose jo, janë të përshtatshme, bazohet në këndvështrimin e efektit individual dhe të grumbulluar të përjashtimeve nga kërkesave të GAGAS<sup>184</sup>. Faktorët sasiorë dhe cilësorë që audituesi duhet të marrë në konsideratë përfshijnë:

**a.** mundësinë që përjashtimet do të ndikojnë perceptimin e përdoruesve të raportit lidhur me gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet;

**b.** shtrirjen e efektit të përjashtimeve në perceptimin e përdoruesve të raportit lidhur me gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet;

**c.** shpërndarjen e përjashtimeve;

**d.** efektin e mundshëm të përjashtimeve në mjaftueshmërinë dhe përshtatshmërinë e evidencave mbështetëse ndaj gjetjeve të auditimit, konkluzioneve dhe rekomandimeve; dhe

**e.** nëse përdoruesit e raportit mund të keq orientohen nëse deklaratat e përputhshmërisë së GAGAS nuk janë modifikuar.

---

Informacion  
Shtesë  
për Kapitullin 3

**A3.01** Kapitulli 3 diskuton standardet e përgjithshme të aplikueshme për auditimet financiare, angazhimet për certifikim, auditimet e performancës në përputhje me GAGAS. Udhëzuesi shtesë si vijon është dhënë për të ofruar ndihmë ndaj audituesve dhe njësisve të audituara në shmangien e dëmeve ndaj pavarësisë, përcaktimin e një sistemi të kontrollit të cilësisë, dhe identifikimin e faktorëve të riskut me anë të rishikimit nga kolegët.

---

<sup>184</sup> Shiko paragrafët 2.24 dhe 2.25 për diskutime shtesë mbi përputhshmërinë me GAGAS.

**Shtojca I**  
**Udhëzues Shtesë**

---

**Kërcënimet ndaj  
Pavarësisë**

**A3.02** Lista është menduar të argumentojë nëpërmjet shembujve llojet e rrethanave që krijojnë kërcënim ndaj pavarësisë që një auditues mund të identifikojë kur aplikon kuadrinkonceptual<sup>185</sup>. Kjo nuk përfshin të gjitha rrethanat që krijojnë kërcënim ndaj pavarësisë; këto rrethana do të jenë unike në varësi të kushteve nën të cilat ndodh vlerësimi.

**A3.03** Shembuj të rrethanave që krijojnë kërcënim të interesit vetjak për një auditues përfshijnë:

**a.** Një pjesëtar i grupit të auditimit që ka një interes direkt financiar në njësinë e audituar. Kjo nuk i ndalon audituesit nga të audituarit e planeve të pensioneve ku marrin pjesë nëse (1) audituesi nuk ka kontroll mbi strategjinë e investimeve, përfitimet apo çështje të tjera të menaxhimit lidhur me planin e pensioneve dhe (2) audituesi i përket atyre planeve pensioni si pjesë e punësimit të tij/saj me organizatën audituese, ky plan ofrohet normalisht për të gjithë punonjësit në pozicione pune ekuivalente.

**b.** Një organizatë auditimi që nuk ka pavarësinë e duhur në të ardhurat nga një njësi e caktuar e audituar.

**c.** Një pjesëtar i grupit të auditimit që fillon negociata pune me njësinë e audituar.

**d.** Një auditues që zbulon një gabim domethënës gjatë vlerësimit të rezultateve të një shërbimi të mëparshëm profesional të bërë nga një pjesëtar i organizatës së auditimit.

---

<sup>185</sup> Shiko paragrafët 3.07 deri 3.26.

**Shtojca I**  
**Udhëzues Shtesë**

---

**A3.04** Shembuj të rrethanave që krijojnë kërcënime vetë-rishikuese për një auditues përfshijnë:

**a.** Një organizatë auditimi që nxjerr një raport mbi efektivitetin e veprimeve financiare apo sistemeve të menaxhimit të performancës pas zhvillimit apo zbatimit të sistemeve.

**b.** Një organizatë auditimi që ka përgatitur të dhënat origjinale të përdorura për të gjeneruar regjistrime që janë njësia kryesore i auditimit.

**c.** Një organizatë auditimi që kryen një shërbim për një subjekt të audituar që ka ndikim të drejtpërdrejtë në informacionin e auditimit.

**d.** Një pjesëtar i grupit të auditimit, që ka qenë apo është punësuar së fundi nga njësia i audituar, në një pozicion ku ka influencë domethënëse mbi çështjet e auditimit.

**A3.05** Shembujt e rrethanave që krijojnë paragjykim për kërcënime për një auditues përfshijnë:

**a.** Një auditues që ka paragjykime për objektivat e programit që auditohet, të cilat janë shumë të forta për të patur ndikimin në objektivitetin e audituesit.

**b.** Audituesi ka paragjykime lidhur me bindjet politike, ideologjike apo sociale që rezultojnë nga anëtarësimi apo punësimi ose besnikëria ndaj, apo niveli i qeverisjes, që mund të ndikojnë objektivitetin e audituesit.

**A3.06** Shembuj të rrethanave që krijojnë kërcënime familjare për një auditues përfshijnë:

**Shtojca I**  
**Udhëzues Shtesë**

---

- a.** Një pjesëtar i grupit të auditimit, të cilit një familjar i afërt i punon si drejtues i lartë në njësinë e audituar.
- b.** Një pjesëtar i grupit të auditimit që ka një familjar të afërt të punësuar në njësinë e audituar, dhe që është në pozitën e të ushtruarit një influencë të madhe mbi çështjet subjekt auditimi.
- c.** Një drejtues ose punonjës is njësisë të audituar në një pozitë për të ushtruar influencë domethënëse mbi çështjet subjekt auditimi dhe që ka shërbyer në grupin e auditimit.
- d.** Një auditues që pranon dhurata apo trajtim preferencial nga një subjekt i audituar, vetëm nëse vlera është e vogël ose e parëndësishme.
- e.** Personel auditues i lartë që ka lidhje të hershme me njësinë e audituar.

**A3.07** Shembuj të rrethanave që krijojnë kërcënime të pa përshtatshme për një auditues apo organizatë auditimi përfshijnë ekzistencën e:

- a.** Ndërhyrjeve të jashtme apo influencat që mund të kufizojnë jo në mënyrë të përshtatshme ose modifikojnë qëllimin e një auditimi ose kërcënojnë ta bëjnë këtë, duke përfshirë ushtrimin e presionit për të reduktuar punën e kryer në mënyrë që të zvogëlohen kostot apo taksat.
- b.** Ndërhyrjeve të jashtme me përzgjedhjen apo aplikimin e procedurave të auditimit ose në përzgjedhjen e transaksioneve që duhen shqyrtuar.
- c.** Kufizimeve të paarsyeshme për kohën e nevojshme për të kompletuar një auditim ose nxjerrjen e raportit.

**Shtojca I**  
**Udhëzues Shtesë**

---

**d.** Ndërhyrjeve të jashtme mbi caktimin, emërimin, kompensimin dhe promovimin e personelit auditues.

**e.** Kufizimeve mbi fondet ose burime të tjera dhënë organizatës së auditimit që ndikojnë në të kundërt aftësinë e organizatës së auditimit për të përmbushur përgjegjësitë e veta.

**f.** Autoritetit për të sunduar ose influencuar me të padrejtë gjykimin e audituesve si dhe përmbajtjen e raportit.

**g.** Kërcënimit për të zëvendësuar audituesit në bazë të një mos dakortësie me përmbajtjen e raportit të audituesit, konkluzionet, apo aplikimin e një parimi të kontabilitetit apo kritere të tjera.

**h.** Influencave që rrezikojnë punësimin e mëtejshëm të audituesve për arsye të tjera veç paaftësisë, sjelljes së keqe apo nevojës për auditime apo vërtetime angazhimi.

**A3.08** Shembujt e rrethanave që krijojnë kërcënim për audituesin nga pjesëmarrja e menaxhimit përfshijnë:

**a.** Një pjesëtar i grupit të auditimit, që ka qenë dikur apo së fundi, një drejtues i lartë i njësisë të audituar.

**b.** Një drejtues ose punonjës i organizatës së auditimit që është anëtar me votë i një komiteti të njësisë apo bordi drejtorësh, që ka vendimmarrje mbi politikat që ndikojnë drejtimin e ardhshëm dhe veprimtarinë e një programi të njësisë, mbikëqyrjen e punonjësve të njësisë, zhvillimin apo miratimin e politikave programore, autorizimin e transaksioneve të njësisë, apo ruajtjen e një asemi të njësisë.

**Shtojca I**  
**Udhëzues Shtesë**

---

**c.** Një drejtues i një organizate auditimi ose një punonjës, që rekomandojnë një individ të veçantë për një pozicion specifik që është kryesor ndaj programit apo njësisë, ose që influencon përzgjedhjen e kandidatit nga drejtuesit.

**d.** Një auditues që përgatit planin e veprimit të menaxhimit për korrigjimin e mangësive të zbuluara në auditim.

**A3.09** Shembujt e rrethanave që krijojnë për një auditues kërcënime strukturale përfshijnë:

**a.** Për organizatat e auditimit të brendshëm dhe të jashtëm, vendosja strukturale e funksionit të auditimit brenda linjës së raportit të fushave nën auditim.

**b.** Për organizatat e auditimit të brendshëm, drejtimi administrativ nga drejtuesit e njësisë të audituar.

---

Sistemi i  
Kontrollit të  
Cilësisë

**A3.10** Kapitulli 3 trajton elementët e sistemit të kontrollit të cilësisë<sup>186</sup> të një organizate auditimi. Udhëzuesi shtesë që vijon është dhënë për të ndihmuar audituesit dhe organizatat e auditimit në përcaktimin e politikave dhe procedurave në sistemet e tyre të kontrollit të cilësisë për të adresuar elementët e mëposhtëm: fillimin, pranimin dhe vazhdimësinë e auditimeve; auditimin e performancës, dokumentet dhe raportimin; dhe monitorimin.

**a.** Organizatat e auditimit të qeverisë i fillojnë auditimet si rezultat të (1) mandateve ligjore, (2) kërkesave nga organet legjislative apo të mbikëqyrjes, dhe (3) zgjedhja e organizatës së auditimit. Në rastin e mandateve ligjore dhe kërkesave, një organizate auditimi të qeverisë, mund t'i kërkohej të kryejë një auditim dhe mund të mos i lejohet të marrë vendime mbi

---

<sup>186</sup> Shiko paragrafët 3.82 deri 3.95 për diskutime shtesë mbi sistemin e kontrollit të cilësisë.

**Shtojca I**  
**Udhëzues Shtesë**

---

pranueshmërinë apo vazhdimësinë dhe mund të mos lejohet të heqë dorë apo tërhiqet nga auditimi.

**b.** Standardet GAGAS për auditimet e performancës, dokumentet dhe raportimin janë, në kapitullin 4 për auditimet financiare, në kapitullin 5 për vërtetimin e angazhimeve në kapitujt 6 dhe 7 për auditimet e performancës. Kapitulli 3 specifikon se sistemi i kontrollit të cilësisë i një organizate auditimi përfshin politika dhe procedura të hartuara për t'i ofruar organizatës së auditimit sigurinë e arsyeshme se auditimet janë kryer dhe janë nxjerrë raportet në përputhje me standardet profesionale dhe kërkesat ligjore dhe rregullatore<sup>187</sup>. Shembuj të këtyre politikave dhe procedurave përfshijnë sa vijon:

(1) komunikimi i ofruar anëtarëve të grupit në mënyrë që ata të kuptojnë mjaftueshëm objektivat e punës së tyre dhe standardet profesionale të aplikueshme;

(2) planifikimin e auditimit dhe mbikëqyrjen;

(3) dokumentacionin e duhur të punës së kryer;

(4) rishikimin e punës së kryer, gjykimet e rëndësishme të bëra dhe dokumentacionin e dalë nga auditimi si dhe raportin;

(5) rishikimin e pavarësisë dhe kualifikimet e secilit prej specialistëve të jashtëm apo kontraktuesve të përdorur, ashtu si edhe rishikimin e qëllimit dhe cilësinë e punës;

(6) procedurat për zgjidhjen e çështjeve të vështira apo mosmarrëveshjeve ndërmjet pjesëtarëve të grupit, duke përfshirë specialistët;

---

<sup>187</sup> Shiko paragrafët 3.82 deri 3.95 për diskutime shtesë mbi politikat dhe procedurat e kontrollit të cilësisë.

**Shtojca I**  
**Udhëzues Shtesë**

---

(7) marrjen dhe adresimin e komenteve nga njësia i audituar në projekt raportet;  
dhe

(8) raportimin e mbështetur në evidencat e marra, dhe në përputhje me standardet profesionale të aplikueshme dhe kërkesat ligjore dhe rregullatorë.

c. Monitorimi është një vlerësim i vazhdueshëm, periodik i auditimeve i hartuar për t'i ofruar drejtuesve të organizatës së auditimit sigurinë se politikat dhe procedurat lidhur me sistemin e kontrollit të cilësisë, janë të hartuara si duhet dhe veprojnë në praktikë me efektivitet<sup>188</sup>. Udhëzuesi si vijon është dhënë për të ndihmuar organizatat e auditimit me zbatimin dhe vazhdimin e monitorimit të cilësisë:

(1) Kush: Monitorimi është më efektiv kur kryhet nga njerëz që nuk kanë përgjegjësi për aktivitetin specifik të monitoruar (p.sh, për auditime specifike ose procese specifike të centralizuara). Stafit ose grupi me anëtarë të stafit i ngarkuar me përgjegjësi për procesin e monitorimit, ka nevojë për kompetenca të mjaftueshme dhe të duhurat si dhe autoritet në organizatën e auditimit, për të marrë përsipër përgjegjësitë. Në përgjithësi, anëtarët e stafit ose grupi me anëtarë të stafit që kryejnë monitorimin, janë jashtë mbikëqyrjes normale të auditimit së bashku me auditimet individuale.

(2) Sa: Shtrirja e procedurave të monitorimit varion bazuar në rrethanat e organizatës së auditimit për të mundësuar organizatën e auditimit të vlerësojë përputhshmërinë me standardet profesionale të aplikueshme dhe politikat dhe procedurat e kontrollit të cilësisë së organizatës së auditimit. Shembuj të procedurave specifike të monitorimit përfshijnë:

---

<sup>188</sup> Shiko paragrafët 3.93 deri 3.95 për diskutimet shtesë mbi monitorimin.

**Shtojca I**  
**Udhëzues Shtesë**

---

(a) ekzaminimin e të dhënave të përzgjedhura, administrative dhe të personelit, që i përkasin kontrollit të cilësisë;

(b) rishikimin e dokumentacionit të përzgjedhur dhe raporteve;

(c) diskutimet me personelin e organizatës së auditimit (sipas procedurës dhe në mënyrën e duhur);

(d) përmbledhjet periodike të gjetjeve nga monitorimi me shkrim (së paku një herë në vit), dhe marrjen në konsideratë të rasteve sistematike të gjetjeve që tregojnë se përmirësimet janë të nevojshme;

(e) përcaktimin e veprimeve korrigjuese për t'u ndërmarrë ose përmirësimet që duhen bërë sipas auditimeve specifike të rishikuar ose politikat dhe procedurat e kontrollit të cilësisë së organizatës së auditimit;

(f) komunikimin e gjetjeve të identifikuar tek drejtuesit e organizatës si dhe ndjekja e tyre (follow-up);  
dhe

(g) shqyrtimin e gjetjeve nga personel drejtues i duhur i organizatës së auditimit që gjithashtu përcakton nëse veprime të nevojshme, duke përfshirë modifikimet në sistemin e kontrollit të cilësisë, janë kryer në kohën e duhur.

(3) Rishikimi i të dhënave të përzgjedhura administrative dhe të personelit: Rishikimi i të dhënave të përzgjedhura administrative dhe të personelit që i përkasin kontrollit të cilësisë mund të përfshijë teste të:

(a) përputhshmërisë me politikat dhe procedurat mbi pavarësinë;

(b) përputhshmërisë me politikat e vazhdueshme të zhvillimit profesional, duke përfshirë trajnimin;

**Shtojca I**  
**Udhëzues Shtesë**

---

(c) procedurave lidhur me rekrutimin dhe punësimin e personelit të kualifikuar, duke përfshirë, punësimin e specialistëve ose këshilltarëve kur është e nevojshme;

(d) procedurave lidhur me vlerësimin e performancës dhe ecurinë e personelit;

(e) procedurave lidhur me fillimin, pranimin dhe vazhdimësinë e auditimeve;

(f) të kuptuarit nga personeli i organizatës së auditimit të politikave dhe procedurave të kontrollit të cilësisë, dhe zbatimi i këtyre politikave dhe procedurave; dhe

(g) procesin e organizatës për përditësimin e politikave dhe procedurave të tij.

(4) Ndjekja (follow-up) e gjetjeve të mëparshme: Procedurat e monitorimit përfshijnë vlerësimin nëse organizata e auditimit ka ndërmarrë hapat korrigjuese të nevojshme për të adresuar gjetjet dhe rekomandimet nga monitorimi i mëparshëm dhe rishikimi vullnetar (rishikimin nga kolegët). Personeli i përfshirë në monitorim e përdor këtë informacion si pjesë të vlerësimit të riskut së bashku me hartimin dhe zbatimin e sistemit të kontrollit të cilësisë të organizatës së auditimit dhe në përcaktimin e natyrës, kohës dhe shtrirjes së procedurave të monitorimit.

(5) Komunikimi: Organizata e auditimit komunikon së brendshmi rezultatet e monitorimit të sistemeve të veta të kontrollit të cilësisë që i mundësojnë organizatës së auditimit të ndërmarrë veprimet e duhura dhe të shpejta kur është e nevojshme. Informacioni i përfshirë në këtë komunikim përfshin:

(a) një përshkrim të procedurave të kryera të monitorimit;

**Shtojca I**  
**Udhëzues Shtesë**

---

**(b)** konkluzionet e dala nga procedurat e monitorimit; dhe

**(c)** kur duhet, një përshkrim të mangësive sistematike, të përsëritura ose të tjera të rëndësishme dhe veprimet e ndërmarra për zgjidhjen e këtyre mangësive.

---

*Peer - review-  
Rishikimi nga  
Kolegët*

**A3.11** Shembuj të faktorëve për t'u marrë parasysh kur kryhet një vlerësim rrisht për rishikimin nga kolegët, në përzgjedhjen e auditimeve për rishikimi nga kolegët<sup>189</sup> përfshijnë:

**a.** qëllimin e auditimeve duke përfshirë madhësinë e njësisë të audituar apo auditimeve që mbulojnë vendndodhje shumëfishe;

**b.** zona funksionale ose lloje programesh të qeverisë;

**c.** lloje auditimesh duke përfshirë shtrirjen e shërbimeve jo audituese dhënë subjekteve të audituara;

**d.** personeli (duke përfshirë stafin e ri ose personel që nuk merret në rutinën e vet me llojet e auditimeve të dhëna);

**e.** auditimet fillestare;

**f.** familjariteti që rezulton nga marrëdhënia e gjatë në kohë me njësinë e audituar;

**g.** ndjeshmëria politike e auditimeve;

**h.** shkurtimet në buxhet për organizatën e auditimit;

**h.** rezultatet e grupit të rishikimit nga kolegët për hartimin e sistemit të kontrollit të cilësisë;

---

<sup>189</sup> Shiko paragrafët 3.99 për diskutime shtesë mbi vlerësimin e rrisht për peer review.

**Shtojca I**  
**Udhëzues Shtesë**

---

**j.** rezultatet e procesit të monitorimit së organizatës së auditimit;

dhe

**k.** risku i ndjeshmërisë të organizatës së auditimit.

**A3.12** Siç u trajtua dhe në paragrafin 3.105, një organizatë auditimi e jashtme duhet të bëjë publik raportin më të fundit të rishikimit nga kolegët. Shembuj sesi të arrihet kjo transparencë përfshijnë, vendosjen e raportit në faqen zyrtare të internetit ose në një file të mundur për t'u disponuar publikisht. Me qëllim që publiku të ndihmohet për të kuptuar raportin e rishikimit nga kolegët, një organizatë auditimi mund gjithashtu të përfshijë një përshkrim të procesit rishikimin nga kolegët dhe si ai aplikohet në organizatë. Sa vijon janë shembuj të informacionit shtesë që organizatat e auditimit mund të përfshijnë për të ndihmuar përdoruesit të kuptojnë kuptimin e raportit të rishikimit nga kolegët.

**a.** Shpjegimi i procesit të rishikimit nga kolegët.

**b.** Përshkrimi i sistemit të kontrollit të cilësisë të organizatës së auditimit.

**c.** Shpjegimi i marrëdhënies ndërmjet rezultateve të rishikimit nga kolegët dhe punës së organizatës së audituar.

**c.** Nëse raporti i rishikimit nga kolegët që përfshin mangësitë është i modifikuar, jepet shpjegimi i planit të rishikuar të organizatës së auditimit për përmirësimin e kontrollit të cilësisë

dhe

**d.** statusit të përmirësimeve.

---

Informacion  
Shoqërues  
për Kapitullin 6

**A6.01** Kapitulli 6 trajton standardet e fushës për auditimet e performancës. Një koncept integral për auditimin e performancës është përdorimi evidencave të mjaftueshme dhen të duhura bazuar në objektivat e auditimit për të mbështetur bazën për gjetjet e auditimit, konkluzionet dhe rekomandimet.

**Shtojca I**  
**Udhëzues Shtesë**

---

Trajtimi si vijon jepet për të ndihmuar audituesit në identifikimin e kritereve dhe llojeve të ndryshme të evidencave, duke përfshirë vlerësimin e përshtatshmërisë së evidencave në lidhje me objektivat e auditimit.

---

**Llojet e Kritereve**

**A6.02** Sa vijon, janë disa shembuj për kriteret<sup>190</sup>:

- a.** qëllimi i përshkruar nga ligji ose rregulloret ose i përcaktuar nga zyrtarët e njësisë të audituar,
- b.** politikat dhe procedurat e përcaktuara nga zyrtarët e njësisë të audituar,
- c.** standardet e zhvilluara teknikisht ose normat,
- d.** opinionet e ekspertëve,
- e.** performanca e periudhave të mëparshme,
- f.** praktikat e përcaktuara të biznesit,
- g.** termat e kontratave ose granteve, dhe
- h.** performanca e subjekteve të tjerë ose sektorëve përcaktuar si standard.

**A6.03** Objektivat e auditimit mund të përshkruajnë statusin ose kushtet aktuale të një programi ose procesi. Për këtë lloj objektive auditimi, kriteret mund gjithashtu të përfaqësojnë sigurinë e shtuar nga audituesi, si rrjedhojë e (1) përshkrimit të statusit ose kushteve, (2) vlerësimit nëse statusi apo kushtet përmbushin disa karakteristika, ose (3) vlerësimit nëse përshkrimi i drejtuesve është i verifikueshëm, i saktë ose i argumentuar.

---

<sup>190</sup> Shiko paragrafin 6.37 për diskutime shtesë mbi identifikimin e kritereve të auditimit.

**Shtojca I**  
**Udhëzues Shtesë**

---

Llojet e  
Evidencave

**A6.04** Në terma të formës sesi është e mbledhur, evidencat mund të kategorizohen si fizike, dokumentare, ose dëshmuese. Evidenca fizike merret me anë të inspektimit të drejtpërdrejtë të audituesve ose vëzhgimit të njerëzve, pasurisë, apo ngjarjeve. Kjo evidencë mund të dokumentohet në përmbledhëse memorandume, fotografi, video, vizatime, grafikë, harta, ose mostra fizike. Evidenca e dokumentuar merret në formën e informacionit tashmë ekzistues, të tilla si letra, kontratat, regjistrat e kontabilitetit, faturat, ekstrakte të të dhënave, informacioni i ruajtur në mënyrë elektronike, dhe të menaxhimit të informacionit mbi performancën. Evidenca dëshmuese, merret nëpërmjet pyetjeve, intervistave, grupeve në fokus, forumeve publike, ose pyetësorëve. Audituesit shpesh përdorin proceset analitike përfshirë llogaritjet, krahasimet, ndarjen e informacionit në komponentë, dhe argumentet racionale për të analizuar çdo evidencë të mbledhur për të përcaktuar nëse kjo është e mjaftueshme dhe e përshtatshme<sup>191</sup>. Pikat e forta dhe të dobëta të çdo lloji evidence, varen nga faktet dhe rrethanat që lidhen me provat dhe gjykimin profesional në kontekstin e objektivave të auditimit.

Përshtatshmëria e  
Evidencave në  
Lidhje me  
Objektivat e  
Auditimit

**A6.05** Një nga faktorët kryesorë që ndikojnë në sigurinë lidhur me auditimin e performancës është përshtatshmëria e provave në lidhje me objektivat e auditimit<sup>192</sup>. Për shembull:

**a.** Objektivat e auditimit mund të fokusohen në verifikimin e rezultateve kuantitative specifike paraqitur nga njësia i audituar. Në këto raste, procedurat e auditimit do të

---

<sup>191</sup> Shiko paragrafët 6.67 dhe 6.60 për përkufizimet e mjaftueshëm dhe përshtatshëm.

<sup>192</sup> Shiko paragrafët 6.60 deri 6.66 për diskutime shtesë mbi përshtatshmërinë e evidencave.

**Shtojca I**  
**Udhëzues Shtesë**

---

fokusoheshin në marrjen e evidencave mbi saktësinë e shumave specifike në fjalë. Kjo punë mund të përfshijë përdorimin e kampionimit statistikor.

**b.** Objektivat e auditimit mund të përqendrohen në performancën e një programi të veçantë ose veprimtarie në agjencinë që po auditohet. Në këto situata, audituesi mund të pajiset me informacione të hartuara nga agjencia nën auditim, me qëllim që t'u përgjigjen objektivave të auditimit. Audituesi mund të shohë të nevojshme për të testuar cilësinë e informacionit, që përfshin si vlefshmërinë ashtu edhe besueshmërinë.

**c.** Objektivat e auditimit mund të përqendrohen në informacionin që janë përdorur për qëllime të pranuar nga të gjithë dhe të marra nga burime përgjithësisht të pranuar si të përshtatshme. Për shembull, statistikave ekonomike të lëshuara nga agjencitë qeveritare për qëllime të tilla si, rregullimet për inflacionin, apo informacion tjetër të tillë të nxjerrë nga organizata autoritare, mund të jetë informacioni më i mirë i mundshëm. Në raste të tilla, mund të mos jetë praktike, ose e nevojshme për audituesit të kryejnë procedurat për të verifikuar informacionin. Këto vendime kërkojnë gjykimin profesional bazuar në natyrën e informacionit, përdorimin e tij të përgjithshëm ose pranimin, dhe sesi është duke u përdorur në auditim.

**d.** Objektivat e auditimit mund të përqendrohen në krahasime ose standardet midis funksioneve të ndryshme qeveritare ose të agjencive. Këto lloje të auditimeve janë veçanërisht të dobishme për analizimin e rezultateve të vendimeve të ndryshme të politikave publike. Në këto raste, audituesit mund të kryejnë analiza, të tilla si statistikave krahasuese të juridiksioneve të ndryshme apo ndryshime në performancë me kalimin e kohës, ku do të ishte jopraktike për të verifikuar të dhënat e detajuara themelore të statistikave. Zbulimi i qartë se në çfarë mase informacioni apo të dhënat statistikore krahasuese janë vlerësuar ose konfirmuar, ka të ngjarë të nxjerrë në pah domosdoshmërinë për të vendosur në kontekst evidencat, për përdoruesit e raportit.

**Shtojca I**  
**Udhëzues Shtesë**

---

e. Objektivat e auditimit mund të përqendrohen në trendin e informacionit bazuar në të dhënat e siguruar nga njësia i audituar. Në këtë situatë, audituesit mund të vlerësojnë provat duke përdorur teste të përgjithshme analitike të të dhënave themelore, të kombinuara me njohuri dhe të kuptuarit e sistemeve apo proceseve të përdorur për hartimin e informacionit.

f. Objektivat e auditimit mund të fokusohen në identifikimin nga audituesi të çështjeve emergjente dhe ndërsektoriale duke përdorur informacione të hartuara apo vetë-raportuara nga agjencitë. Në raste të tilla, mund të jetë e dobishme për audituesit të marrin në konsideratë përshtatshmërinë e përgjithshme të informacionit të hartuar, së bashku me tjetër informacion të vlefshëm në lidhje me programin. Burime të tjera informacioni, siç janë raportet e inspektorit të përgjithshme ose auditime të tjera të jashtme, mund t'u ofrojnë audituesve informacion në lidhje me, nëse ndonjë informacion i paverifikuar apo vetë-raportuar, është në përputhje me, ose mund të vërtetohet nga këto burime të tjera të jashtme të informacionit.

---

**Gjetjet**

**A6.06** Kur objektivat e auditimit përfshijnë shpjegimin pse një lloj i veçantë performance pozitive apo negative e programit, produktit ose rezultatit identifikohet gjatë auditimit se ka ndodhur, atëherë ky shpjegim u referohet atyre si "shkaku"<sup>193</sup>. Identifikimi i shkakut mund të ndihmojë audituesit në dhënien e rekomandimeve konstruktive për korrigjime. Për arsye se mangësitë mund të rezultojnë nga një numër faktorësh të mundshëm apo shkaqe të shumta, rekomandimi mund të jetë më bindës nëse audituesit mund të tregojnë në mënyrë të qartë dhe të shpjegojnë me prova dhe arsyetim, lidhjen midis mangësive dhe faktorit apo faktorëve që i kanë identifikuar si shkakun ose shkaqet.

---

<sup>193</sup> Shiko paragrafin 6.76 për diskutime shtesë mbi "shkakun".

**Shtojca I**  
**Udhëzues Shtesë**

---

Audituesit gjithashtu, mund të identifikojnë mangësitë në hartimin apo strukturën programore si shkak të performancës së mangët. Audituesit mund gjithashtu të identifikojnë mangësi në kontrollin e brendshëm që janë të rëndësishme për çështjen subjekt të auditimit të performancës si shkak i performancës së mangët. Në zhvillimin e këtyre lloj gjetjesh, mangësitë në hartimin e programit ose të kontrollit të brendshëm, do të përshkruhen si "shkaku". Shpesh shkaqet e performancës së mangët të programit janë komplekse dhe përfshijnë faktorë të shumtë, duke përfshirë, shkaqet themelore sistemike në bazë. Përndryshe, kur objektivat e auditimit përfshijnë vlerësimin e efektit të programit për ndryshime në kushtet fizike, sociale, apo ekonomike, audituesit kërkojnë evidenca për shkallën në të cilën vetë programi është "shkaku" i këtyre ndryshimeve.

**A6.07** Kur objektivat e auditimit përfshijnë vlerësimin e shkallës, në të cilën një program ka shkaktuar ndryshime në kushtet fizike, sociale, apo ekonomike, "efekti" është një masë e ndikimit të arritur nga programi. Në këtë rast, "efekti" është shkalla, në të cilën ndryshimet pozitive apo negative në kushtet aktuale fizike, sociale, apo ekonomike, mund të identifikohen dhe t'i atribuohen programit.

---

Informacion  
Shoqërues  
për Kapitullin 7

**A7.01** Kapitulli 7 trajton standardet e raportimit për auditimet e performancës. Diskutimi në vijim është dhënë për të ndihmuar audituesit në zhvillimin dhe shkrimin e raporteve të tyre të auditimit, për auditimet e performancës.

---

Raportimi i  
Elementëve të  
Cilësisë

**A7.02** Audituesi mund të përdorë elementet e cilësisë së raportit kur e zhvillon dhe e shkruan atë, të tillë si i duhur, i plotë, i saktë dhe objektiv, bindës, i qartë dhe konçiz<sup>194</sup>.

---

<sup>194</sup> Shiko paragrafin 7.08 për diskutime shtesë mbi përmbajtjen e raportit.

**Shtojca I**  
**Udhëzues Shtesë**

---

**a. I saktë:** Një raport i saktë, mbështetet nga evidenca të mjaftueshme, të duhura me fakte kyçe, shifra dhe gjetje të gjurmueshme nëpërmjet evidencave të auditimit. Raportet që janë të bazuar në fakte, me një deklaram të qartë të burimeve, metodave, dhe supozimeve në mënyrë që përdoruesit e raportit të mund të gjykojnë, se sa shumë peshë u jepet evidencave të raportuara, ndihmojnë në arritjen e saktësisë. Zbulimi i kufizimeve të të dhënave dhe zbulime të tjera, kontribuojnë gjithashtu për prodhimin e raporteve më të sakta të auditimit. Raportet gjithashtu janë më të sakta, kur gjetjet janë paraqitur në kontekstin më të gjerë të çështjes. Një mënyrë për të ndihmuar organizatat e auditimit të përgatisin raporte të sakta të auditimit, është që të përdorin një proces të kontrollit të cilësisë të tillë si referencat. Referenca është një proces në të cilin një auditues me përvojë, i cili është i pavarur nga auditimi, kontrollon që deklaratat e fakteve, shifrave dhe datat, janë raportuar si duhet, se gjetjet janë të mbështetura si duhet nga evidencat në dokumentacionin e auditimit, dhe se konkluzionet dhe rekomandimet, rrjedhin llogjikisht nga evidencat.

**b. Objektiv:** Objektiv do të thotë se paraqitja e raportit është e balancuar në përmbajtjen dhe tonin. Kredibiliteti i një raporti rritet në mënyrë të konsiderueshme kur paraqet evidencat në mënyrë të paanshme dhe në kontekstin e duhur. Kjo do të thotë të paraqesësh rezultatet e auditimit në mënyrë të paanshme dhe të drejtë. Toni i raporteve mund të inkurajojë vendimmarrësit për të vepruar mbi gjetjet dhe rekomandimet e audituesve. Ky ton i ekuilibruar mund të arrihet kur raportet paraqesin prova të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të mbështetur konkluzionet, ndërsa janë të kufizuar në përdorimin e mbiemrave ose ndajfoljeve që karakterizojnë evidencat në një mënyrë që nënkupton kritika apo konkluzione të pabazuara. Objektiviteti i raporteve të auditimit rritet kur raporti në mënyrë të qartë, deklaron burimin e provave dhe supozimet e përdorura në analizë. Raporti mund të njohë aspektet pozitive të programit të shqyrtuar nëse është një zbatueshme për objektivat e

**Shtojca I**  
**Udhëzues Shtesë**

---

auditimit. Përfshirja e aspekteve pozitive të programit mund të çojë në përmirësimin e performancës nga organizatat të tjera qeveritare që e lexojnë raportin. Raportet e auditimit janë më objektive kur paraqesin se puna është kryer personel profesional, pa paragjykime, i pavarur dhe i ditur.

**c. I plotë:** Të qenit i plotë, do të thotë se raporti përmban evidenca të mjaftueshme, të përshtatshme, të nevojshme për të përmbushur objektivat e auditimit dhe për të promovuar të kuptuarin e çështjeve të raportuara. Kjo gjithashtu do të thotë se raporti citon evidencat dhe gjetjet pa heqjen e informacioneve të rëndësishme në lidhje me objektivat e auditimit. T'u ofrosh përdoruesve të raporteve të kuptuarin e tyre, do të thotë të ofrosh perspektivë për shkallën dhe rëndësinë e gjetjeve të raportuara, të tilla si shpeshhtësinë e ndodhjes në lidhje me numrin e rasteve apo transaksionet e testuar dhe marrëdhënien e gjetjeve me veprimtarinë e njësisë. Të qenit i plotë gjithashtu, do të thotë të deklarohet në mënyrë të qartë se çfarë është dhe nuk është bërë, si dhe duke përshkruar në mënyrë të qartë kufizimet e të dhënave, detyrimet e imponuara për kufizimet mbi aksesin në të dhënat apo çështje të tjera.

**d. Bindës:** Të qenit bindës, do të thotë se rezultatet e auditimit i janë përgjigjur objektivave të auditimit, që gjetjet janë paraqitur në mënyrë bindëse, dhe se konkluzionet dhe rekomandimet rrjedhin logjikisht nga faktet e paraqitura. Vlefshmëria e gjetjeve, arsyeshmëria e konkluzioneve, dhe përfitimi i zbatimit të rekomandimeve, janë më bindës kur mbështeten nga të evidenca të mjaftueshme dhe të duhurat. Raportet e projektuara në këtë mënyrë, mund të ndihmojnë të përqendrohet vëmendja e zyrtarëve përgjegjës në çështjet që ngjallin interes dhe mund të japin një nxitje për marrjen e masave korrigjuese.

**e. I qartë:** Qartësia do të thotë se raporti është i lehtë për t'u lexuar dhe për t'u kuptuar nga përdoruesi. Përgatitja e raportit në një gjuhë të qartë dhe të thjeshtë aq sa njësia e lejon, i ndihmon audituesit në arritjen e qëllimit. Përdorimi i një gjuhe të drejtë dhe jo teknike, ndihmon në thjeshtimin e prezantimit. Përcaktimi i termave teknikë, shkurtesat, dhe akronimet që

**Shtojca I**  
**Udhëzues Shtesë**

---


janë përdorur në raport janë gjithashtu të dobishme. Audituesit mund të përdorin përmbledhjen në kuadër të raportit për të tërhequr vëmendjen e përdoruesit të raportit dhe të nxjerrin në pah mesazhin e përgjithshëm. Nëse përdoret një përmbledhje, është e dobishme që të fokusohet në përgjigjet e veçanta për pyetjet në objektivat e auditimit, të përmbledhë gjetjet më të rëndësishme të auditimit dhe konkluzionet kryesore të raportit, dhe përgatisë përdoruesit të parashikojnë rekomandimet kryesore. Organizimi logjik i materialit, si dhe saktësia në deklarimin e fakteve dhe në nxjerrjen e konkluzioneve, ndihmojnë në qartësimin dhe të kuptuarin e raportit. Shfrytëzimi efektiv i titujve dhe fjalive kyçe, e bën raportin më të lehtë për t'u lexuar dhe kuptuar. Ndihamat vizuale (të tilla si fotografitë, grafikët, dhe hartat), mund të qartësojnë dhe të përmbledhin materiale komplekse.

**f. I Përmbledhur:** Të qenit i përmbledhur do të thotë se raporti është jo më i gjatë sesa është e nevojshme për të përcjellë dhe të mbështetur mesazhin. Detajet pa kuptim, ia ulin vlerën një raporti, madje mund të fshehin mesazhin e vërtetë, dhe mund të ngatërrojnë ose të shpërqendrojnë përdoruesit. Edhe pse ka vend për gjykim të konsiderueshëm në përcaktimin e përmbajtjes së raporteve, ato që janë të bazuar në fakte, por i përmbledhur, kanë më shumë mundësi për të arritur rezultate.

**g. Në kohë:** Për t'u përdorur maksimalisht, është qëllimi i audituesit që të ofrojë evidenca të rëndësishme në kohë për t'iu përgjigjur zyrtarëve të njësisë të audituar, zyrtarëve legjislativë, dhe nevojave legjitime të përdoruesve të tjerë. Po ashtu, dëshmitë e dhëna në raport janë më të dobishme në qoftë se janë aktuale. Prandaj, nxjerrja në kohë e raportit është një qëllim i rëndësishëm i raportimit për audituesit. Gjatë auditimit, audituesit mund të sigurojnë raporte të ndërmjetme të çështjeve të rëndësishme ndaj zyrtarëve përkatës të subjekteve. Këto komunikime alarmi, kërkojnë vëmendje të menjëhershme të zyrtarëve dhe i mundëson atyre të ndërmarrin veprime korrigjuese, para se raporti përfundimtar të përmyllet.

Shtojca II

**GAGAS-Kuadri Konceptual për pavarësinë**



Shtojca III

---

Këshilli Konsultativ pranë Kontrollorit të Përgjithshëm  
mbi Standardet e Auditimit të Qeverisë

---

Anëtarët e  
Këshillit  
Konsultativ

Auston Johnson, Kryetar  
Shteti i Utah  
(2009-2011)

I nderuari Ernest A. Almonte  
Shteti i Rhode Island  
(anëtar 2005-2008)

Christine C. Boesz  
Këshilltare  
(anëtare 2007-2011)

Kathy A. Buller  
Korpusi Paqes  
(anëtare 2009-2011)

Dr. Paul A. Copley  
Universiteti James Madison  
(anëtar 2005-2008)

David Cotton  
Cotton & Co. LLP  
(anëtar 2006-2009)

Beryl H. Davis  
Instituti i Audituesve të Brendshëm  
(anëtar 2007-2011)

Kristine Devine  
Deloitte & Touche, LLP  
(anëtare 2005-2011)

Dr. Ehsan Feroz  
Universiteti iMinnesota Duluth  
(anëtar 2002-2009)

**Shtojca III**  
**Këshilli Konsultativ për Kontrollorin e Përgjithshëm të Standardeve të Auditimit të Qeverisë**

---

Alex Fraser  
Standard & Poor's  
(anëtar 2006-2008)

Mark Funkhouser  
Kansas , Missouri  
(anëtar 2005-2008)

Dr. Michael H. Granof  
Universiteti i Texas, Austin  
(anëtar 2005-2008)

Jerome Heer  
Rajoni i Milwaukee, Wisconsin  
(anëtar 2004-2011)

Michael Hendricks  
Këshilltar  
(anëtar 2010-2012)

Marion Higa  
Shteti i Hawaii  
(anëtare 2006-2009)

I nderuari John P. Higgins, Jr U.S.  
Departamenti i Edukimit  
(anëtar 2005-2008)

Julia Higgs  
Universiteti Atlantik, Florida  
(anëtar 2009-2011)

Russell Hinton  
Shteti i Xhorxhias  
(anëtar 2004-2011)

Drummond Kahn  
Portland, Oregon  
(anëtar 2009-2011)

**Shtojca III**  
**Këshilli Konsultativ për Kontrollorin e Përgjithshëm të Standardeve të**  
**Auditimit të Qeverisë**

---

Richard A. Leach  
Marina e SHBA  
(anëtar 2005-2011)

David W Martin  
Shteti i Floridas  
(anëtar 2010-2012)

Patrick L. McNamee  
PricewaterhouseCoopers, LLP  
(anëtar 2005-2008)

John R. Miller  
KPMG LLP (Në pension)  
(kryetar, 2001-2008)

Nancy A. Miller  
Miller Foley Group  
(anëtar 2010-2012)

Rakesh Mohan  
Shteti i Idahos  
(anëtar 2004-2011)

Inderuari Samuel Mok  
Këshilltar  
(anëtar 2006-2009)

Harold L. Monk, Jr.  
Davis, Monk & Company  
(anëtar 2002-2012)

Stephen L. Morgan  
Austin, Teksas  
(anëtar 2001-2008)

Janice Mueller  
Shteti i Wisconsin  
(anëtar 2009-2011)

**Shtojca III**  
**Këshilli Konsultativ për Kontrollorin e Përgjithshëm të Standardeve të Auditimit të Qeverisë**

---

George A. Rippey  
Departamenti i Edukimit të SHBA  
(anëtar 2010-2012)

I nderuar Jon T. Rymer  
Korporata Federale e Sigurimit të Depozitave  
(anëtar 2009-2011)

Brian A. Schebler  
McGladrey & Pullen, LLP  
(anëtar 2005-2011)

Barry R. Snyder  
Bordi i Rezervës Federale  
(anëtar 2001-2008)

Dr. Daniel L. Stufflebeam  
Universiteti i Western Michigan  
(anëtar 2002-2009)

F. Michael Taylor  
Stockton, California  
(anëtar 2010-2012)

Roland L. Unger  
Shteti i Maryland  
(anëtar 2010)

Edward J. Valenzuela  
Shteti i Floridas  
(anëtar 2007-2009)

Thomas E. Vermeer  
Kolegji Biznesit dhe Ekonomiksit “Alfred Lerner”  
(anëtar 2010-2012)

Sandra H. Vice  
Shteti i Teksasit  
(anëtare 2010-2012)

**Shtojca III**  
**Këshilli Konsultativ për Kontrollorin e Përgjithshëm të Standardeve të**  
**Auditimit të Qeverisë**

---

John C. Weber  
Crowe Horwath LLP  
(anëtar 2010-2012)

George Willie  
Bert Smith & Co.  
(anëtar 2004-2011)

---

**Pjestarët e Projektit GAO**

Jeanette M. Franzel, Drejtor Menaxhimit  
James R. Dalkin, Drejtor i Projektit  
Robert F. Dacey, Krye/kontabilist  
Marcia B. Buchanan, Asistent drejtor  
Cheryl E. Clark, Asistent drejtor  
Heather I. Keister, Asistent drejtor  
Kristen A. Kociolek, Asistent drejtor  
Michael C. Hrapsky, Specialist, Standartet e Auditimit  
Eric H. Holbrook, Specialist, Standartet e Auditimit  
Maria Hasan, Auditues  
Laura S. Pacheco, Auditues  
Christie A. Pugnetti, Auditues  
Margaret A. Mills, Analist Komunikimi  
Jennifer V. Allison, Administrator i Këshillit

---

## Indeks

---

**abuzimi-shpërdorimi (abuse)** (*shiko gjithashtu* angazhimet për çertifikim, puna në terren; angazhimet për çertifikim, raportimet; auditimet financiare, kryerja e auditimeve financiare, raportimi; auditimet e performancës, puna në terren, auditimet e performancës, raportimi) A.07-A.08  
shembuj të A.08

**përgjegjshmëria (accountability)**

qeverisje, roli i të ngarkuarve me A1.05–A1.07

qeverisje 1.01–1.02

zyrtarët dhe menaxherët e qeverisë, përgjegjësitë e 1.02, A1.08

**korrekt (accurate), si element i raportit cilësor** A7.02

**Këshilli Konsultativ mbi Standartet e Auditimit të Qeverisë, anëtarët e** Shtojca III

**Procedura t e pranuar** (*shiko angazhimet për çertifikim*)

**Standartet AICPA**

për angazhimet për çertifikim 2.09, 3.74, 4.21, 5.01, 5.02, 5.03, 5.04, 5.07, 5.16, 5.18, 5.19, 5.22, 5.42, 5.46, 5.48, 5.50, 5.51, 5.54, 5.56, 5.57, 5.58, 5.59*fn*, 5.60, 5.61, 5.64, 5.66, 5.67  
për auditimet financiare 2.08, 4.01, 4.02, 4.03, 4.06, 4.15, 4.17, 4.18, 4.19, 4.24, 4.47  
marrëdhënia me GAGAS 2.20a

**Shoqata Amerikane e Vlerësimit** 2.21b

**Instituti Amerikan i Kontabilistëve Publikë të Çertifikuar** (*shiko gjithashtu* standartet AICPA) 2.20a

**Shoqata Amerikane e Psikologjisë** 2.21d

**përshtatshmëria e evidencës** 6.57, 6.60-6.66, A6.05

**siguria (assurance)** (*shiko* kontrolli dhe sigurimi i cilësisë; siguria e arsyeshme)

**angazhimet për çertifikim (attestation engagements)** (*shiko gjithashtu* GAGAS) kualifikimet për audituesit, shtesë 3.74, 3.75 llojet e 2.09

çështjet nën shqyrtim 2.09

**angazhimet për çertifikim**

angazhimet e ekzaminimit, puna në terren 5.03-5.17

kërkesat e punës shtesë në terren 5.03-5.17

komunikimi i audituesit 5.04-5.05

zhvillimi i elementëve të një gjetjeje 5.11-5.15

dokumentimi 5.16-5.17

mashtrimi, papajtueshmëria me dispozitat ligjore, rregulloret, kontratat dhe marrëveshjet e granteve 5.07–5.10

auditimet e mëparshme dhe angazhimet për çertifikim 5.06

angazhimet e ekzaminimit, raportimi 5.18-5.47

komente shtesë, të tjera 5.45-5.47

kërkesa shtesë të raportimit 5.18

## Indeks

- 
- informacioni sekret dhe me ndjeshmëri 5.39-5.43  
shpërndarja e raporteve 5.44  
gjetjet 5.27-5.28  
kontrolli i brendshëm, mangësitë 5.22-5.23  
raportimi i përputhshmërisë me GAGAS 5.19  
raportimi i mangësive në kontrollin e brendshëm, mashtrimi, papajtueshmeria me dispozitat ligjore, rregulloret, kontratat, marrëveshjet e granteve dhe shpërdorimi 5.20-5.26  
raportimi i gjetjeve jashtë njësisë 5.29-5.31  
raportimi i pikëpamjeve të zyrtarëve përgjegjës 5.32-5.38  
rishikimi i angazhimeve, puna në terren 5.48-5.49  
konsiderata shitesë, të tjera 5.53-5.56  
kërkesa shitesë mbi raportimin 5.50-5.56  
shpërndarja e raporteve 5.52  
raportimi i përputhshmërisë me GAGAS 5.51  
angazhimet për procedurat e pranuar 5.58-5.67  
kërkesat shitesë të punës në terren 5.58-5.59  
kërkesa shitesë mbi raportimin 5.60-5.62  
kërkesa shitesë, të tjera 5.63-5.67  
**objekivi i auditimit (audit objective)** (*shiko* objektivi, auditim)  
**risku i auditimit (audit risk)** 3.65,6.01,6.05, 6.07, 6.10-6.11, 6.12b, 6.18, 6.24, 6.26, 6.29, 6.58, 6.61, 6.68a  
**audituesit (auditors), kualifikimet e (qualifications of)** (*shiko* kompetencat)  
**përgjegjësia e audituesve (auditors' responsibility)** 1.19, 2.14, 3.64, 3.68, 3.77, 3.85a, 3.86, 3.87, 6.30, 7.15  
**auditimet dhe angazhimet për çertifikim, llojet e (audits and attestation engagements, types of)** 2.07-2.11  
**shkaku (cause)** (*shiko* angazhimet për çertifikim, puna në terren, auditimet financiare, kryerja e auditimeve të performancës, puna në terren)  
**informacion i klasifikuar (classified information)** (*shiko* përdorimi i kufizuar zyrtar nën angazhimet për çertifikim, standartet e raportimit; auditimet financiare, kërkesat për raportimin, auditimet e performancës, standartet e raportimit)  
**qartësia (clear), si element i cilësisë së një raporti** A7.02e  
**komente (comments)** (*shiko* mendimi i zyrtarëve përgjegjës nën angazhimet për çertifikim, raportimi, auditimet financiare, raportimi, auditimet e performancës, raportimi)  
**kompetencat (competence)** 3.69-3.81  
angazhimet për çertifikim, kualifikime shitesë për 3.74, 3.75  
edukimi i vazhdueshëm profesional 3.76-3.81  
edukimi dhe eksperiencia 3.71  
auditimet financiare, kualifikimet shitesë për 3.73, 3.75 dhe gjykimi profesional 3.64, 3.71  
aftësitë e nevojshmevojiten, vlerësimi dhe stafi për 3.66

## Indeks

---

specialistët 3.72d, 3.79-3.81

njohuritë teknike dhe aftësitë e kërkuara 3.72

**plotësia, si element i cilësisë së një raporti** A7.02c

**auditimet e përputhshmërisë (compliance audits)** (*shiko* auditimet e performancës)

**përputhshmëria me deklaratat e GAGAS** 2.23–2.25

e modifikuar 2.24b e pa modifikuar 2.24a

**sistemet kompjuterike të informacionit (computer-based information systems)** (*shiko* informacioni)

**konkluzione (conclusions)** 7.27

**rrethanat (condition)** (*shiko* angazhimet për certifikim, puna në terren, auditimet financiare, kryerja e auditimeve të performancës, puna në terren)

**konflikti i interesit (conflict of interest), shmang'ja (avoiding)** (*shiko gjithashtu* pavarësia) 1.19

**i përmbledhur (concise), si element i cilësisë së një raporti** A7.02f

**shërbimet këshillimore (consulting services)** (*shiko* shërbimet jo audituese)

**Edukimi i vazhdueshëm profesional (continuing professional education)** (CPE) 3.76-3.81 orët 3.76

udhëzuesit 3.78

përgjegjësia për 3.78

specialistët 3.79-3.81

subjektet, përkufizimi i duhur 3.77

koha 3.76

**Kuadri COSO** A.03

**bindës (convincing) si element i cilësisë së një raporti** A7.02d

**kriteret (criteria)** (*shiko* angazhimet për certifikim, puna në terren, auditimet financiare, kryerja e auditimeve të performancës, puna në terren)

**besueshmëria e të dhënave (data reliability)** (*shiko* informacioni)

**përkufizime (definitions)** (*see* termat)

**dokumentimi (documentation)** (*shiko gjithashtu* angazhimet për certifikim, puna në terren, auditimet financiare, kryerja e auditimeve të performancës, puna në terren)

edukimi i vazhdueshëm profesional 3.78

GAGAS, fillon nga 2.16, 2.24-2.25

GAGAS, domethënia e mos përputhshmërisë me 2.24a të pavarësisë 3.24, 3.30, 3.34, 3.39, 3.59 të sistemit të kontrollit të cilësisë 3.84

**auditimet e ekonomicitetit dhe efincës (economy and efficiency audits)** (*shiko* auditimet e performancës)

## Indeks

- 
- Efekt/pasoja (effect)** (*shiko* angazhimet për çertifikim, puna në terren, auditimet financiare, kryerja e auditimeve të performancës, puna në terren)
- parimet etike (ethical principles)** 1.10–1.24 konfliktet, shmang'ja 1.19  
si kuadër bazë 1.04  
dhe pavarësia 1.12  
informacioni, përdorimi i qeverisë 1.20–1.21 integriteti 1.12, 1.14b, 1.17–1.18  
objektiviteti 1.12, 1.14c, 1.19  
pozicioni përdorimi i qeverisë 1.14d, 1.20, 1.23 sjellja profesionale 1.14e, 1.24  
interesi publik 1.12, 1.14a, 1.15–1.16  
burimet, përdorimi i qeverisë 1.14d, 1.20, 1.22 përgjegjësia për, personal dhe organizativ 1.12  
toni 1.11  
transparenca 1.21
- material shpjegues (explanatory material)** 2.17-2.18
- rishikimi i kontrollit të cilësisë së jashtëm (external quality control review)** (*shiko* peer review/ rishikim nga kolegët, i jashtëm)
- evidencat (evidence)** (*shiko gjithashtu* angazhimet për çertifikim, puna në terren, auditimet financiare, kryerja e auditimeve të performancës, puna në terren; auditimet e performancës, raportimi, informacioni) 2.10, 6.56-6.72  
shuma dhe lloji i kërkuar, identifikimi i 6.38 të duhurës 6.56-6.57, 6.60-6.66, A6.05  
plani i auditimit 6.51-6.52  
i shkakut 6.76 dokumentimi i 6.79-6.85 i pamjaftueshëm 7.07  
burimet, identifikimi 6.38 mjaftueshmëria e 6.56-6.57, 6.67-6.68  
mjaftueshmëria dhe e duhur, e pasigurtë ose e kufizuar 7.14-7.15  
e mjaftueshme dhe e duhur 6.56-6.72, 7.14–7.15, 7.26, A6.05  
llojet e 6.61-6.62, A6.04
- auditimet financiare (financial audits)** (*shiko gjithashtu* GAGAS)  
kualifikimet për, llojet 3.73-3.75 shtesë të 2.07
- auditimet financiare, kryerja (financial audits, performing)** 4.01-4.16  
shpërdorimi 4.07-4.08

## Indeks

---

standardet AICPA 4.01, 4.02, 4.15, 4.47  
shkaku 4.13  
komunikimi, auditues 4.02-4.04, 4.46, 4.48  
përputhshmëria me dispozitat ligjore, rregulloret dhe marrëveshjet e granteve 4.06-4.09, 4.10, 4.48 rrethanat 4.12  
veprimet korrigjuese 4.05, 4.13-4.14, 4.48  
kriteret 4.11  
përkufizimet 2.07  
dokumentimi 4.04, 4.06, 4.26 efekti 4.14  
evidencat 4.11, 4.12, 4.15a  
gjetjet, zhvillimi i elementëve të 4.10-4.14  
mashttrimi 4.02c, 4.06-09, 4.10n  
GAGAS, duke nisur nga 4.15b  
Qevrisja, identifikimi i atyre që janë të ngarkuar me 4.03, 4.04  
kontrollin e brendshëm 4.10  
materialiteti 4.05, 4.08, 4.46-4.47  
planifikimi 4.05, 4.10, 4.47  
angazhimet e mëparshme, përdorimi i 4.02, 4.05  
risku, vlerësimi 4.05  
rishikimi mbikqyrës 4.15a puna e të tjerëve, përdorimi i 4.16  
**auditimeve financiare, raportimi** 4.17-4.48  
shpëdorimi 4.17c, 4.23, 4.25-4.28, 4.30, 4.33, 4.48  
standartet AICPA 4.17, 4.18, 4.21, 4.24, 4.47  
informacioni i klasifikuar 4.40-4.44, 4.45  
pajtueshmëria me dispozitat ligjore, rregulloret, kontratat dhe marrëveshjet e granteve 4.17-4.32, 4.33  
komunikimi, audituesi 4.17c, 4.23, 4.26, 4.30, 4.44, 4.46b, 4.48  
informacioni sekret dhe me ndjeshmëri 4.17e, 4.40-4.44  
veprimet korrigjuese 4.28, 4.33, 4.34, 4.38  
raportimi i drejtëpërdrejtë tek palët e jashtme 4.30-4.32 shpërndarja 4.45  
dokumentimi 4.45  
gjetjet, paraqitja 4.28, 4.29  
mashtrimi 4.02c, 4.06-4.09, 4.10, 4.17, 4.23-4.30, 4.33  
GAGAS, raportimi i përputhshmërisë nga audituesit me 2.24-2.25, 4.17a, 4.18

---

## Indeks

---

Mangësitë e kontrollit të brendshëm 4.17, 4.19, 4.24, 4.25, 4.28, 4.33  
kontrolli i brendshëm, raportimi mbi 4.17, 4.19, 4.20-4.25, 4.28, 4.33  
procedimet hetimore ose ligjore, kufizimi i raportimit mbi çështje që nuk do të përfshihen 4.27  
përdorimin e kufizuar të raporteve 4.41, 4.42, 4.44  
rekomandimet 4.28, 4.33, 4.34, 4.37, 4.38, 4.42, 4.45a  
pikëpamjet e zyrtarëve përgjegjës 4.17d, 4.33-4.39  
**mashtrimi dhe aktet joligjore, indikatorët e riskut të (fraud and illegal acts, indicators of risk of)** (*shiko gjithashtu* angazhimet për çertifikim, puna në terren, angazhimet për çertifikim, raportimi, auditimet financiare, kryerja, auditimet financiare, raportimi, auditimet e performancës, puna në terren, auditimet e performancës, raportimi) 6.07–A.08

**GAGAS** (*shiko gjithashtu* angazhimet për çertifikim, puna në terren, angazhimet për çertifikim, raportimi, auditimet financiare, kryerja, auditimet financiare, raportimi, auditimet e performancës, puna në terren, auditimet e performancës, raportimi) 2.01-2.25, A2.01-A2.06  
Zbatimi/aplikimi 2.01, A1.02–A1.04  
angazhimet për çertifikim 2.09  
auditimet dhe angazhimet për çertifikim, llojet e 2.03 deklarave të përputhshmërisë 2.23-2.24  
duke nisur nga 2.24b  
materiale shpjeguese 2.17-2.18  
për auditimet financiare 2.07  
udhëzues, shtesë 2.06, A.01–A7.02  
ligje, rregullore, dhe udhëzues A1.02–A1.04  
shërbimet jo audituese 2.12–2.13  
për auditimet e performancës 2.10–2.11  
qëllimi 1.04-1.05  
marrëdhënia me standartet e tjera 2.19-2.22  
kërkesat, kategoritë e 2.24  
terminologjia, përdorimi i 2.06, 2.14–2.18  
**qeverisja, roli i të ngarkuarve me** A1.05–A1.07  
**informacioni i qeverisë, burimet, dhe pozicionet, përdorimi i duhur i** 1.20–1.23  
**udhëzuesve shtesë** A.01–A7.02 abuzimi, shembuj të A.07–A.08  
objektivave të auditimit, auditimeve të performancës A6.03 kriteret A6.02  
evidencat në lidhje me objektivat e auditimit, përputhshmëria e A6.05  
evidencave, llojeve të A6.04  
gjetjet, auditimeve të performancës A6.06  
indikatorët e riskut të mashtimit, shembuj të A.09–A.10  
qeverisja, roli i të ngarkuarve me A1.05–A1.07

## Indeks

---

Përgjegjshmëria e qeverisë, GAGAS në kontekstin e	A1.01–A1.08
pavarësisë, kërcënimeve ndaj	A3.02–A3.09
mangësitë e kontrollit të brendshëm, shembuj të	A.05–A.06
ligjeve, rregulloreve dhe udhëzuesve që kërkojnë GAGAS	A1.02–A1.04
ligjet, rregulloret, dhe dispozitat e kontratave, ose marrëveshjeve të granteve, të rëndësishme për objektivat e auditimit	A.11–A.13
Menaxherët, roli i	A1.08
peer review/ rishikimi nga kolegët	A3.11
Sistemi i kontrollit të cilësisë	A3.10
Raportimi, auditime performance	A7.01–A7.02
elementët e cilësisë së një raporti	A7.02
<b>pavarësia</b> ( <i>shiko gjithashtu</i> objektivitetin)	3.02–3.59
kuadri konceptual	3.06, 3.07–3.26
kërkesat mbi dokumentacionin	3.59
pavarësia e audituesve të jashtëm	3.28–3.30
audituesit e qeverisë, struktura organizative	3.27–3.32
pavarësia në fakt	3.03a
pavarësia në dukje	3.03b
pavarësia e audituesit të brendshëm	3.31, 3.32
shërbimet jo audituese, marrja në konsideratë e shërbimeve specifike të	3.45–3.58
shërbimet jo audituese, vlerësimi i shërbimeve jo audituese të mëparshme	3.42, 3.43,
shërbimet jo audituese përgjegjësitë e menaxhimit	3.35–3.38
shërbimet jo audituese, kërkesat	3.34–3.44
shërbimet jo audituese, aktivitetet e zakonshme	3.40–3.41
shërbimet jo audituese, të përshtatshme, aftësi, njohuri, ose eksperiencia e menaxhimit	3.34
mbrojtja/ruajtja	3.16–3.19
kërcënimet	3.13–3.15, A3.02–A3.09
<b>informacioni</b> ( <i>shiko gjithashtu</i> evidencat, kontrolli i brendshëm)	
përpunimi kompjuterik	6.66
nga zyrtarët e njësisë së audituar	6.65
vetë-raportimi	6.63
<b>Instituti i Audituesve të Brendshëm (IIA)</b>	2.21a, 3.31, 4.46b, 5.44b, 5.52b, 5.62b, 7.44b
<b>Integriteti</b>	1.17–1.18
<b>Auditimi i brendshëm</b>	2.21b, 6.22, 7.44b
pavarësia	3.31–3.32
Shërbimet jo audituese	53

## Indeks

- 
- Raporti i peer review/rishikimit nga kolegët 3.105  
auditimi i performancës 6.22, 7.44b
- Raportimi i jashtëm 4.45b, 5.44b, 5.52b, 5.62b, 7.44b
- Kontrolli i brendshëm** (*shiko gjithashtu* angazhimet për certifikim, puna në terren, angazhimet për certifikim, raportimi, auditimet financiare, kryerja, auditimet financiarët, raportimi, auditimet e performancës, puna në terren, auditimet e performancës, raportimi) si objektiv auditimi 2.11, 2.11b përkufizimi i 6.15c  
mangësitë, shembuj A.05-A.06 në auditimet financiare 2.07a, 4.19-4.24  
për sistemet e informacionit 6.16, 6.23-6.27, 6.66  
si një shërbim jo auditues 3.54-3.56  
objektivat, llojet e 6.19-6.20, A2.03  
në auditimet e performancës 2.11, 6.16-6.27  
si subjekt A2.01  
testimi shtesë dhe raportimi 4.19-4.22
- sistemi i brendshëm i kontrollit të cilësisë (internal quality control system)** (*shiko* sigurimi dhe kontrolli i cilësisë)
- Bordi Ndërkombëtar i Standarteve të Auditimit dhe Sigurisë** 2.20b
- Komisioni i Përbashkët mbi Standartet për Vlerësimin e Arsimimit** 2.21c
- Ligjet, rregulloret, kontratat ose marrëveshjet e granteve, dispozitat e**  
Përcaktimi i domethënies për objektivat A.11-A.13  
në auditimet e performancës 6.15a  
që kërkojnë GAGAS A1.02–A1.04
- Raportet e kufizuara (limited reports)** (*shiko* angazhimet për certifikimin, raportimin, auditimet financiare, raportimi, auditimet e performancës, raportimi)
- roli i menaxhimit (management's role)** A1.08
- auditimi i menaxhimit (management audit)** (*shiko* auditimet e performancës)
- kontrollet e menaxhimit (management controls)** (*shiko* kontrolli i brendshëm)
- aftësitë e menaxhimit, njohuritë, ose eksperiencia (management skill, knowledge, or experience)** 3.34
- menaxherët dhe zyrtarët, përgjegjësitë e qeverisë (managers and officials, responsibilities of government)** 1.02
- shërbimet jo audituese (nonaudit services)** 2.12-2.13  
Pavarësia, *shiko* “pavarësia, shërbimet jo audituese”
- subjektet jo qeveritare, aplikueshmëria e GAGAS ndaj auditimeve të (nongovernmental entities, applicability of GAGAS to audits of)** A1.04
- objektivat, auditimi** (*shiko gjithashtu* auditimet e performancës, puna në terren, auditimet e performancës, raportimi, çështjet subjekt 2.03-2.04, 2.09, 2.11, 2.25, A2.02-A2.05)

## Indeks

---

Angazhimet për çertifikim 2.09 përputhshmëria 2.11c  
Ekonomiciteti dhe eficientia 2.11a  
informacioni i duhur A6.01  
kontrolli i brendshëm 2.11b  
i shumëfishtë ose i mbivendosur 2.11  
auditimi i performancës 2.10, 2.11, 6.03, 6.07-6.08  
efektiviteti i programit dhe rezultatet 2.11a analiza e perspektivës 2.11d  
llojet e 2.02-2.11  
**objektiv, si element i cilësisë së raportit** A7.02b  
**objektivat, qëllimi, dhe metodologjia** (*shiko gjithashtu* auditimet e performancës, puna në terren, dhe auditimet e performancës, raportimi) 7.09–7.13  
**objektiviteti** (*shiko gjithashtu* përgjegjësitë e audituesve , pavarësia) 1.14c, 1.19  
**auditimet operacionale** (*shiko* auditimet e performancës)  
**peer review/ rishikim nga kolegët, i jashtëm** 3.82b, 3.96-3.107  
palët kontraktuese, dhënia e raporteve, 3.106  
transparenca publike 3.105  
vlerësimi i riskut 3.99  
qëllimi 3.96-3.98, 3.102  
raportimi 3.97, 3.100-3.103  
përzgjedhja e angazhimeve 3.99 kriteret e grupit 3.104  
puna e një organizate tjetër auditimit, përdorimi 3.107  
**auditimet e performancës (performance audits)** (*shiko gjithashtu* evidencat)  
objektivat e auditimit, llojet e 11, A2.02-A2.05  
përkufizim 2.10  
GAGAS dhe standarte të tjera 2.21  
**auditimet e performancës, puna në terren** 6.01–6.85  
shpërdorimi 6.33–6.34  
plani i auditimit, përgatitja 6.51–6.52  
risku i auditimit 6.01, 6.05, 6.07, 6.10–6.11, 6.29, 6.36  
shkaku 6.76  
komunikimi, audituesi 6.47–6.50  
objektivat e përputhshmërisë 6.19c, A2.04  
rrethanat 6.75

## Indeks

---

veprimet korrigjuese 6.36 kriteret 2.10, 6.37, A6.02  
pasoja/efekti 6.77  
dokumentimi 6.06, 6.46, 6.48-6.50, 6.69, 6.79-6.85  
objektivat e efektivitetit dhe eficiencës 6.19a  
letra e angazhimit 6.49  
evidencat 6.03, 6.05, 6.07, 6.10, 6.27, 6.37, 6.38-6.39, 6.56-6.72, A6.04-A6.05  
gjetje, elementët e zhvillimit të 6.73-6.77  
mashtrimi 6.30-6.32  
GAGAS, duke nisur nga 2.16, 2.24b, 2.25, 6.84  
kontrollat e sistemeve të informacionit 6.23-6.27  
Kontrolli i brendshëm 6.15c, 6.16-6.22 mangësitë e kontrollit të brendshëm 6.21  
kontrolli i brendshëm, llojet e 6.19-6.20  
Ligjeve, rregulloreve, kontratave dhe marrëveshjeve të granteve 6.15a, 6.28-6.29  
metodologjia (*shiko gjithashtu* planifikimi) 6.07, 6.10  
papajtueshmëria me marrëveshjet e granteve ose kontratat 6.21, 6.28-6.29  
objektivat, auditimi 6.07-6.08, A2.02-A2.05, A6.05  
rezultatet 6.15g rezultatet 6.15f  
planifikimi 6.06-6.52  
angazhimet e mëparshme 6.36  
programi, përkufizimet 6.08  
veprimet e programit 6.15e  
programi, të kuptuarit e 6.13, 6.15  
siguria e arsyeshme 6.01, 6.03  
rëndësia dhe besueshmëria 6.19b  
ruajtja e aseteve dhe burimeve 6.20  
qëllimi (*shiko gjithashtu* planifikimi) 6.07, 6.09  
domethënia 6.01, 6.04, 6.07, 6.11  
stafi, emërimi i 6.45  
specialistëve, përdorimi i punës së 42-6.44  
mbikqyrja 6.53-6.55  
përfundimi përpara përmbushjes së auditimit 6.50  
përdoruesit e raportit të auditimit 6.14  
puna e të tjerëve, përdorimi 6.40-6.44

## Indeks

---

<b>Auditimet e performancës, raportimi (performance audits, reporting)</b>	7.01-7.44
shpërdorimi	7.18, 7.21-7.24
informacioni i klasifikuar	7.40, 7.43
komunikimi, audituesi	7.07, 7.19, 7.22
informacioni konfidencial ose sensitiv	7.39- 7.43
konkluzione	7.27
veprimet korrigjuese	7.05, 7.14, 7.28, 7.32, 7.37
raportimi i drejtëpërdrejtë tek palët e jashtme	7.24 -7.26
shpërndarja	7.44
dokumentacioni	7.19, 7.22, 7.44
evidencat	7.12-7.15, 7.26
gjetjet	7.14-7.26
forma e raportit të auditimit	7.04 fraud 7.18, 7.21-7.23
raportimi i përputhshmërisë së audituesve me GAGAS	7.30-7.31, 2.23-2.25
audituesit e brendshëm	7.44b
mangësitë e kontrollit të brendshëm	7.19-7.20
hetimet ose veprimet ligjore, kompromisi	7.23
raporti për përdorim zyrtar të kufizuar	7.40-7.41, 7.43
metodologjia	7.09, 7.13
objektivat, auditimi	7.10
objektivat, qëllimi dhe metodologjia	7.09-7.13
ligjet e të dhënave publike	7.43
qëllimet	7.05
cilësia, elementët e raportit	A7.02
rekomandimet	7.28-7.29
qëllimi	7.11
mendimet e zyrtarëve përgjegjës	7.08, 7.32-7.38
<b>sjellja profesionale (professional behavior)</b>	1.24
<b>gjykimi profesional (professional judgment)</b>	3.01, 3.60–3.68
përgjegjësia e audituesit	3.68
njohuritë kolektive	3.63 kompetencat dhe 3.62, 3.64
pavarësia, përcaktimi i dëmit të	3.64 niveli i riskut, duke marrë në konsideratë 3.66, 3.67
të kuptuarit, përcaktimi i nivelit të kërkuar	3.66

## Indeks

---

**kërkesat profesionale, përdorimi i terminologjisë në (professional requirements, use of terminology in)** 2.15-2.18 kategoritë e 2.15  
materiali shpjegues 2.17  
publikimet interpretuese 2.18  
kërkesat të prezumuara të detyrueshme 2.15b  
kërkesat e pakushtëzuara 2.15a  
**programet e auditimit ose vlerësimet** (*shiko* auditimet e performancës)  
**efektiviteti i programeve dhe rezultatet e auditimeve** (*shiko* auditimet e performancës)  
**përdorimi i duhur i informacionit të qeverisë, burimet dhe pozicioni** 1.20-1.23  
**Bordi i Mbikqyrjes së Kompanive Publike të Kontabilitetit** 2.20c  
**interesi publik** 1.14a, 1.15, 1.16  
**nevoja e publikut për t'u informuar** 1.02  
**sigurimi dhe kontrolli i cilësisë** (*shiko gjithashtu* peer review/ rishikim nga kolegët, i jashtëm)  
3.82-3.107, A3.10-A3.12  
dokumentimi i 3.85  
monitorimit 3.93-3.95  
peer review/ rishikim nga kolegët 3.96, 3.107, A3.11-A3.12  
sistemi i 3.83-3.85, A3.10  
**sigurisë së arsyeshme** 6.01, 6.03, 6.07, 6.10  
**rekomandimeve** 7.28-7.29  
**elementët e cilësisë së një raporti** A7.02  
**standartet e raportimit** (*shiko* angazhimet e çertifikimit, raportimi, auditimet financiare, raportimi, auditimet e performancës, raportimi)  
**kërkesat, përdorimi i terminologjisë profesionale** (*shiko* kërkesat profesionale, përdorimi i terminologjisë në)  
**aktivitetet të zakonshme (rutinë)** 3.40-3.41  
**qëllimi** 6.09  
**rëndësia** 6.01, 6.04, 6.07, 6.11, 6.58, 6.65, 6.71  
**mangësitë kryesore** (*shiko* angazhimin për çertifikim, raportimi)  
**specialistët**  
kualifikimet 3.79-3.80 përdorimi 6.42-6.44  
**standartet, zgjedhja ndërmjet të aplikueshmes** 2.04  
**standartet e organeve të tjera autoritative** (*shiko gjithashtu* hyrjet individuale për organet e përcaktimit të standarteve)  
2.19-2.22  
**mjaftueshmëria** 6.57, 6.67-6.68

## Indeks

---

### Udhëzues shtesë (shiko udhëzuesin shtesë)

**Termet ( terms)** 2.14-2.18  
Shpërdorimi 4.07, 5.08, 6.33  
përshëmëria 6.57, 6.60-6.66  
angazhimi për çertifikimin 2.09  
organizata e auditimit 1.07b, 3.10  
procedurat e auditimit 6.10  
risku i auditimit 6.05  
auditimi 1.03  
auditues 1.07a  
kompetencat 3.69-3.71  
audituesit me eksperiencë 5.16a, 6.79  
materiali shpjegues 2.17-2.18  
auditimi financiar 2.07  
mashtrimi 58  
pavarësia 3.03  
integriteti 1.17-1.18  
publikimet interpretuese 2.18  
kontrolli i brendshëm 6.15c  
dobësitë në materiale 4.23-4.24, 5.20-5.23, 5.49, 5.59  
materialiteti 4.46, 4.47, 5.44, 5.45  
mund ( may), duhet ( might) dhe mundet ( could) 2.17  
metodologjia 6.10  
deklaratat e përputhshmërisë të modifikuara me GAGAS 2.24b  
duhet ( must) 2.15a  
objektiviteti 1.19  
rezultatet 6.15g  
produktet 6.15f  
opinionet e peer review/ rishikimit nga koleget 3.99  
auditimet e performancës 2.10-2.11  
kërkesat e prezuamuara të detyrueshme 2.15b  
sjellja profesionale 1.24  
gjykimi profesional 3.61-3.63  
skepticizmi profesional 3.61  
programimi 2.10  
aktivitetet e programit 6.15e

## Indeks

---

Përdorimi i duhur i informacionit të qeverisë, burimeve, dhe pozicionit 1.20-1.23

interesi publik 1.15-1.16

Sistemi i kontrollit të cilësisë 3.83

siguria e arsyeshme 6.03

rëndësia 6.60

besueshmëria 6.60

kërkesat 2.14-2.15

qëllimi 6.09

duhet 2.15b

domethënia 6.04

rëndësia 6.04

mangësitë e rëndësishme 4.23-4.24, 5.20-5.23, 5.49, 5.59

çështjet nën auditim 1.23, A2.01

mjaftueshmëria 6.57, 6.67-6.68

mjaftueshmëria, përshtatshmëria e evidencave 6.57

të ngarkuarit me qeverisje A1.06–A1.07

kërkesat e pakushtëzuara 2.15a

deklaratat e pamodifikuara të përputhshmërisë GAGAS 2.24a

vlefshmëria 6.60b

**të ngarkuarit me qeverisje, komunikimi i përgjegjshmërisë** A1.05-A1.07

angazhimet për certifikimin 5.04, 5.05, 5.49, 5.59

auditimet financiare 4.03, 4.04

auditimet e performancës 6.47-6.50

**në kohë, si element i një raporti cilësor** A7.02g

**auditimet e vlerës së parasë** (*shiko* auditimet e performancës)

**pikëpamja e zyrtarëve përgjegjës** (*shiko* angazhimet për certifikim, raportimi, auditimet financiare, raportimi, auditimet e performancës, raportimi)

**shkeljet e kontratave ose marrëveshjeve të granteve** (*shiko* angazhimet për certifikimin, puna në terren, angazhimet për certifikim, raportimi, auditimet financiare, kryerja, auditimet e performancës, puna në terren, auditimet e performancës, raportimi)

**puna e të tjerëve, përdorimi** (*shiko gjithashtu* angazhimi për certifikimin, standartet e punës në terren, auditimet financiare, standartet e performancës, auditimet e performancës, standartet e punës në terren) 3.105

---

## Misionet e GAO's

Zyra e Auditimit të Qeverisë, auditimi, vlerësimi dhe krahu hetimor i Kongresit, është themeluar për të mbështetur Kongresin në përmbushjen e përgjegjësive të tij kushtetuese dhe të ndihmojë për të përmirësuar performancën dhe përgjegjshmërinë e qeverisë federale për popullin amerikan.

GAO ekzaminon përdorimin e fondeve publike; vlerëson programet dhe politikat federale; si dhe ofron analiza, rekomandime dhe mbështetje për të ndihmuar Kongresin të zhvillojë një mbikqyrje e politika të mirëinformuara si dhe vendimmarrje për financime. Angazhimi i GAO's për qeverisjen e mirë pasqyrohet edhe në vlerat themelore të përgjegjshmërisë, integritetit dhe besueshmërisë.

---

## Marrja e Kopjeve të Raporteve të GAO's dhe Dëshmime

Mënyra më e shpejtë dhe e lehtë për të marrë kopje të dokumenteve të GAO's pa kosto realizohet nëpërmjet faqes së internetit të GAO's ([www.gao.gov](http://www.gao.gov)). Çdo ditë pasdite, GAO vendos në faqen e internetit raportet e reja të dala, dëshmi dhe korrespondenca. Për të patur nëpërmjet e-mailit produktet e reja të GAO's shkoni në [www.gao.gov](http://www.gao.gov) dhe përzgjidhni "E-mail Updates."

---

## Porositja e Kopjeve të Printuara

Versioni i printuar i numrit të dhjetorit 2011, rishikimi i Standarteve të Auditimit të Qeverisë mund të porositet nëpërmjet Government Printing Office (GPO) online ose duke telefonuar 202-512-1800 ose 1-866-512-1800.

---

## Njohja me GAO'n

Lidhuni me GAO'n në [Facebook](#), [Flickr](#), [Twitter](#), dhe [YouTube](#). Subscribe to our [RSS Feeds](#) or [E-mail Updates](#). [Podcasts](#). Vizitoni GAO në [www.gao.gov](http://www.gao.gov).

---

## Raportimi i Mashtrimeve, Shpërdorimit dhe Abuzimet me Programin Federal

Kontakte:  
Web site: [www.gao.gov/fraudnet/fraudnet.htm](http://www.gao.gov/fraudnet/fraudnet.htm)  
E-mail: [fraudnet@gao.gov](mailto:fraudnet@gao.gov) □  
Automated answering system: (800) 424-5454 or (202) 512-7470

---

## Ndërlidhja me Kongresin

Ralph Dawn, Managing Director, [dawnr@gao.gov](mailto:dawnr@gao.gov), (202) 512-4400  
U.S. Government Accountability Office, 441 G Street NW, Room 7125 □ Washington, DC 2054

---

## Marrëdhënia me Publikun

Chuck Young, Managing Director, [youngc1@gao.gov](mailto:youngc1@gao.gov), (202) 512-4800  
U.S. Government Accountability Office, 441 G Street NW, Room 7149  
Washington, DC 20548

